

## KONSERVIMI I INTEGRUAR

Sfidat, mundësitë dhe përvojat e integrimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në planifikim hapësinor dhe urban në Kosovë

## INTEGRATED CONSERVATION

Challenges, opportunities and integration experiences of cultural and natural heritage into spatial and urban planning in Kosovo







## KONSERVIMI I INTEGRUAR

Sfidat, mundësitë dhe përvojat e integrimit  
të trashëgimisë kulturore dhe natyrore  
në planifikim hapësinor dhe  
urban në Kosovë

## INTEGRATED CONSERVATION

Challenges, opportunities and integration  
experiences of cultural and natural  
heritage into spatial and urban  
planning in Kosovo

## **PËRMBAJTJA**

**HYRJE - 004**

**STUDIMI - 010**

### **Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor në nivel qendror dhe lokal**

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 + - 032

*Komuna e Mitrovicës - 048*

*Komuna e Vushtrrisë - 070*

*Komuna e Gjakovës - 090*

*Komuna e Pejës - 128*

*Komuna e Hanit të Elezit - 148*

**PUNËTORITË - 220**

*Komuna e Graçanicës - 230*

*Komuna e Vushtrrisë - 250*

*Komuna e Gjakovës - 286*

*Komuna e Partesh-Pasjanë - 322*

*Komuna e Pejës - 342*

**EKIPI REALIZUES I PUBLIKIMIT - 374**

## **CONTENT**

### **004 - INTRODUCTION**

### **010 - CASE STUDY**

#### **Integration of cultural heritage into urban and spatial planning on local and central level**

032 - Kosovo Spatial Plan 2010-2020+

*048 - Municipality of Mitrovica*

*070 - Municipality of Vushtrri / Vučitrn*

*090 - Municipality of Gjakova / Đakovica*

*128 - Municipality of Peja / Pec*

*148 - Municipality of Hani i Elezit / Elez Han*

### **220 - WORKSHOPS**

*230 - Municipality of Graçanicë / Gračanica*

*250 - Municipality of Vushtrri / Vučitrn*

*286 - Municipality of Gjakova / Đakovica*

*322 - Municipality of Partesh-Pasjane / Parteš-Pasjane*

*342 - Municipality of Peja / Pec*

### **374 - PUBLICATION TEAM**

## HYRJE

### Trashëgimia kulturore versus planifikimit hapësinor dhe urban

*“Integrimi i trashëgimisë kulturore në planifikimin urban dhe hapësinor nxit diversitetin si dhe mbështet të drejtën e qytetarëve të jenë bashkëpjesëmarrjes në kulturë. Në rastet kur trashëgimia kulturore me sukses është integruar në planet komunale, kjo krijon kushtet për zhvillim potencial të sektorit të turizmit... Ndërsa vetë integrimi i trashëgimisë kulturore në planifikimin lokal është në përputhje me normat evropiane, standardet evropiane dhe mënyrat e punës kanë qenë gjithashtu të integruar në këtë proces.”\**

Citati i mësipërm i evaluimit të para disa muajsh të punës së CHwB përthekon gjithë inspirimin dhe obligimin që kemi dhe synimit tonë në integrimin e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor dhe urban në Kosovë.

Realisht, gjithçka filloi me vet punën e CHwB në Kosovë, në vitin 2001, në një kohë të vështirë kur trashëgimia kulturore nuk mund të konsiderohej as prioritet i ulët në krahasim me nevojat primare elementare të jetesës dhe procesin e kthimit në jetë normale. Në këtë mozaik sa të zymtë aq edhe të vështirë, CHwB dha një fije shprese për trajtim të trashëgimisë ndërtimore që ishte aq e vlefshme për popullin e Kosovës. Ishte projekti i rindërtimit të *Pesë Kullave* në Rrafshin e Dukagjinit, që sikurse gurë që hidhen në liqe dhe me rrathët koncentrikë përreth në ujë do të zgjërroheshin anembanë Kosovës në 10 vitet e ardhshme.

Nëse guri simbolizon një kullë, kishë apo xhami, rrathët koncentrik në mënyrë figurative do t'i emërtoja si hallka të *Programit të Konservimit të Integruar*. Nevoja e trajtimit të trashëgimisë kulturore të Kosovës në kontekst të planifikimit hapësinor dhe urban, lindi natyrshëm. Pas viteve të emergjencës, vendi përjetoi një fluks të madh, e shpesh edhe të pakontrolluar, të zhvillimeve urbane gjë që ndikuan edhe në strukturën e trashëgimisë kulturore të qyteteve dhe fshatërave të Kosovës. Programi filloi, jozyrtarisht, me disa pilot projekte të ndërmarra në terren sikurse ai në fshatrat Isniq dhe Drenoc të Komunës së Deçanit si dhe me Planin e Konservimit dhe i Zhvillimit të zonës historike të Prizrenit, të realizuara më 2004 dhe 2005. Projekti i Prizrenit, edhe sot e kësaj dite është i vetmi plan i këtij lloji i aprovuar zyrtarisht nga ndonjë autoritet komunal në Kosovë.

Procesi i punës në këtë projekt filloi në 2005 dhe zyrtarisht u aprovua në 2009, gjë që tregon se ka qenë goxha vështirë të punohet në një proces të panjohur deri atë kohë për Kosovën. Për më shumë detaje të këtij plani ju ftoj që ta shfletoni publikimin tonë të veçantë të këtij projekti.

Aktivitetet vazhduan me projektin e *Trashëgimisë së mbetur të Prishtinës dhe Hulumtimit në Novobërdë*, e me disa projekte të realizuara në Komunën e Junikut (shih poashtu publikimin e veçantë për këtë komunë). Kjo filloi të merr përmasa edhe më të theksuara me Punëtoritë e Vizionimit, të promovuar nga UN-HABITAT dhe më vonë edhe të bashkëorganizuar e të bashkëfinancuar edhe nga CHwB, të organizuara për një numër të konsiderueshëm të komunave (shih hartën e bashkangjitur). Përderisa punohej në projekte të ndryshme programi filloi të strukturohej dhe do të përkufizohej në këto vija. Qëllimi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në forcimin e rolit të institucioneve në integrimin e trashëgimisë kulturore në proceset e planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë, si dhe trajtimit të trashëgimisë si një faktor zhvillimi social. Planifikimi konzervues, si një trend global, është një fushë që zhvillohet me shpejtësi e që ka mundësuar kalimin nga modeli *ad hoc* i mbrojtjes në një planifikim sistematik përfshirë strukturën, procesin gjithpërfshirës dhe ruajtjen e biodiversitetit. Kohët e fundit, vëmendja e planifikimit konzervues është përqendruar në përfshirjen e realiteteve socio-ekonomike, e sidomos në aspekt të minimizimit të shpenzimeve të menaxhimit dhe kostove oportune projekteve.

Një nga gurthemet bazë të punës sonë në këtë program është edhe hulumtimi i kryer në fillim të vitit 2009, me gjithsej 30 komuna dhe 11 institucione të nivelit qendror. Ky hulumtim ishte një matje e pulsit të përgjithshëm se ku gjendej Kosova rreth integritet të trashëgimisë në planifikim hapësinor dhe urban në Kosovë. Ndonëse këtu nuk i kemi paraqitur rezultatet e hulumtimit me statistika dhe numra, gjë që do të merre hapësirë goxha të madhe në publikim, pasqyra është më se e zymtë. Shumica dërmuese, nëse jo të gjitha komunat e Kosovës, integrojnë në mënyrë shumë formale trashëgiminë e tyre në planet e tyre për zhvillim të ardhshëm të komunës. Hulumtimi poashtu na tregoi se kjo lëmi komplekse ka shumë probleme që duhet të zgjidhen me një përkushtim, profesionalizëm, bashkpunim dhe më kryesorja – me pasion e kujdes të veçantë.

# INTRODUCTION

## Cultural heritage versus spatial and urban planning

*“The integration of cultural heritage into urban and spatial planning promotes **diversity** and upholds the **right of citizens to partake in culture**. When cultural heritage is successfully integrated into municipal plans, it creates conditions for **potential growth** of the tourism sector... While integrating cultural heritage in local planning is itself in line with **European norms**, European standards and ways of working have also been integrated in the process.”\**

The citation above extracted from the evaluation of the several months ago of CHwB's work captures all the inspiration and commitment that we have and of our endeavor on the integration of cultural heritage in spatial and urban planning in Kosovo.

Indeed, everything started with CHwB's effect in Kosovo in 2001, in times so difficult when cultural heritage couldn't be regarded even as low priority compared to the basic and primary needs of the living and the process of returning to normality. In such stark and difficult mosaic, CHwB bestowed a ray of hope for the treatment of built heritage which remain so valuable to the people of Kosovo. It was the project of reconstruction of *Five Kullas* in Dukagjini Plain that, as stone thrown into the lake, the concentric circles on the surface would expand across Kosovo in the next 10 years.

If the stone symbolizes a kulla, church or mosque, these concentric circles I would figuratively name as the rings of the *Program of Integrated Conservation*. The necessity of treatment of cultural heritage in Kosovo within the spatial and urban planning context naturally came into being. After years of contingency, the country suffered a large influx, often uncontrolled, urban developments which affected the structure of the cultural heritage of the cities and villages of Kosovo. Program began, informally, with some pilot projects undertaken in the field, as the one in Isniq/Isnić and Drenoc/Drenovac villages in Deçan/Dečan Municipality, and the Conservation and Development Plan of the Historic centre of Prizren, carried in 2004 and 2005. Even today, the Prizren project is the only plan of its kind officially approved by any municipal authority in Kosovo.

The process of work on this project began in 2005 and was officially adopted in 2009, which indicates that it has been pretty difficult to work in an unfamiliar process for Kosovo to that time. For more details of this plan I invite you to browse our special publication to this project.

Activities continued with the project *Remainder of Prishtina/Priština's Heritage* and the *Studies in Novobërdë/Novo Brdo*, and with some other projects implemented in the Municipality of Junik (see also the separate publication for this municipality). It started to get even larger in size with the Visioning Workshops promoted by UN-HABITAT, and later co-organized and co-financed by CHwB, for a considerable number of municipalities (see map attached). While various projects were ongoing the programme starts to get its structure and would get outlined in the lines set. The overall objective of the programme is contribution to strengthening the role of institutions in integration of cultural heritage in the spatial and urban planning process in Kosovo as well as treating cultural heritage as a development factor for society. Conservation planning as a global trend is a rapidly evolving field that has enabled a transition from *ad hoc* protection to systematic planning involving pattern, inclusive process and biodiversity persistence. More recently, attention has been focused on incorporating socio-economic realities into conservation planning, particularly in terms of minimizing the management and opportunity costs of the projects.

One of the ground cornerstones of our work in this programme is the survey carried in early 2009, with a total of 30 municipalities and 11 central institutions. This study was the taking of general pulse where does Kosovo stand on integration of the heritage in spatial and urban planning in Kosovo. Although here we haven't presented findings of the survey with statistics and numbers, which would take quite amount of space in the publication, the picture is more than downcast. The vast majority, if not all the municipalities of Kosovo, in a very formal manner integrate heritage in their plans for future development of the municipality. The survey also proved us that this complex subject has many setbacks to overcome with a dedication, professionalism, cooperation and the foremost – with passion and care.



## LEGJENDA

Komunë / Qytet / Qytezë

Fshat

Pyetësor i përgjithshëm i bërë me 30 komunat e Kosovës rreth perceptimit të institucioneve lokale komunale rreth përfshirjes së trashëgimisë kulturore (TK) në planifikim hapësinor dhe urban (PH&U) /viti 2009

Pyetësor i përgjithshëm i bërë me 11 institucione të nivelit qendror rreth perceptimit të përfshirjes së TK në PH&U / viti 2009

Analizë dhe hulumtim mbi gjendjen e përgjithshme të TK në kontekst të PH&U / prej 2004 deri 2011

Punëtori specifikë që trajtojnë vizion për zhvillim të përgjithshëm komunal (PH&U) dhe /apo trashëgiminë natyrore e kulturore / prej 2007 deri 2011

Plane të konservimit e zhvillimit të aprovuara nga autoritetet lokale / prej 2005 deri 2011

*Shënim:*

1. Pyetësori i përgjithshëm i bërë me 30 komunat e Kosovës rreth perceptimit të institucioneve lokale komunale rreth përfshirjes së trashëgimisë kulturore (TK) në planifikim hapësinor dhe urban (PH&U) nuk është kryer në komunat Leposaviç, Zubin Potok dhe Zvečan sepse CHwB nuk kishte qasje në institucionet përkatëse të këtyre komunave.

2. Të njejtat pyetësorë nuk janë kryer në komunat e Graçanicës, Ranillugut, Parteshit dhe Kllokotit sepse këto komuna nuk kanë qenë ende funksionale gjatë kohës së projektit (fillimi i vitit 2009)

## LEGEND

● Municipality / City / Town

■ Village

General survey conducted with 30 Municipalities in Kosovo on the perception of local municipal institutions over the inclusion of cultural heritage (CH) in spatial and urban planning (S&UP) / year 2009

General questionnaire conducted with 11 central level institutions on the perception of inclusion of CH in the S&UP / year 2009

Analysis and study over the general state of CH in the context of S&UP / from 2004 to 2011

Specific workshops addressing vision for general municipal development (S & UP) and / or natural and cultural heritage / from 2007 to 2011


Conservation and development plans approved by local authorities / from 2005 to 2011

*Note:*

1. General survey conducted with 30 Municipalities in Kosovo on the perception of local municipal institutions over the inclusion of cultural heritage (CH) in spatial and urban planning (S & UP) has not been performed in the municipalities of Leposaviq/Leposaviç, Zubin Potok and Zvečan/Zvečan since CHwB had no access to relevant institutions of these municipalities.

2. The same surveys were not conducted in the municipalities of Gračanica/Gračanica, Ranillug/Ranilug, Partesh/Parteš and Kllokot/Klokot as these municipalities have not been yet operational during the project (early 2009)

Paraqitja skematike e angazhimit të CHwB në kontekst të përkrahjes së futjes së trashëgimisë kulturore në agjendën e planifikimit hapësinor dhe urban në Kosovë (2004-2011)



Schematic presentation of CHwB's engagement in the standpoint of supporting the introduction of cultural heritage in the agenda of spatial planning and urban development in Kosovo (2004-2011)

Në publikimin që mbani në dorë, do të gjeni përzgjedhje të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura në kuadër të aktiviteteve të periudhës korrik 2008 – dhjetor 2011. Këto rezultate bëhen edhe më valide sepse dalin nën ombrellën e një bashkëpunimi, tanimë të zyrtarizuar, mes CHwB dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), gjegjësisht Institutit për Planifikim Hapësinor (IPH) si institucion vartës i MMPH-së. Më duhet t'i shprehë falënderimet e mia stafit të përkushtuar të IPH-së që me aq entuziazëm janë shndërruar në avokues më të mirë të integritit të trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor në Kosovë. E ndiejme veten edhe më të fortë sepse në këtë rrugëtim kemi partnerë të përkushtuar si Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, UN HABITAT, institucione ndërkombëtare si dhe një numër të madh komunash që e shohin si potencial trashëgiminë e tyre kulturore dhe natyrore.

Integrimi i trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor nënkupton integrim të saj në jetën tonë bashkëkohore, nënkupton përfshirjen e shoqërisë sonë në proces, që është një nga të drejtat themelore demokratike që kemi dhe me të cilën do të arrijmë t'i transmetojmë vlerat tona tek gjeneratat e ardhshme.

*Enes Toska*

*Program Menaxher i Programit të Konservimit të Integruar*

*në zyrën e CHwB në Kosovë*

*Dhjetor 2011*

*\* in develop.: Raport Final, Vlerësimi i Trashëgimisë Kulturore pa kufij (2008-2011) - Shtator 2011*

In this publication you'll find selection of the activities and performance outputs within the activities for the period July 2008 – December 2011. These results become especially valid for they come under the auspices of cooperation, already recognized, between CHwB and the Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP), namely the Institute for Spatial Planning (ISP) as a subordinate institution of the MESP. I have to express my thanks and appreciation to the devoted staff of ISP for with such verve turned into the greatest advocates for integration of cultural heritage in the spatial planning in Kosovo. We feel ourselves even stronger because in this journey we have such committed partners as the Ministry of Culture, Youth and Sports, UN HABITAT, international institutions and a wide range of municipalities who see them as potential in natural and cultural heritage.

Integration of cultural heritage in the spatial planning means its integration in our contemporary life, means the involvement of our society in the process, which is one of the fundamental democratic rights we have and by which we would get to transmit our values to the future generations.

*Enes Toska  
Programme Manager of the Integrated Conservation Programme in CHwB Kosovo  
Office  
December 2011*

*\* indevelop.: Final Report, Evaluation of Cultural Heritage without Borders (2008-2011) - September 2011*

# STUDIM

**Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor në nivel qendror dhe lokal**

Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin. (Kushtetuta e Kosovës, Neni 52)

# CASE STUDY

**Inclusion of cultural heritage in central and municipal spatial planning**


Nature and biodiversity, living environment and national heritage are, everyone's responsibility. (Constitution of Kosovo, Article 52)



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning



CH  
WB  
Cultural  
Heritage without Borders  
KULTURAN UTAŃ GRANIS



## PËRMBAJTJA E STUDIMIT

|   |
|---|
| Përfshirja e trashëgimisë Kulturore në planifikim hapësinor         |
| Hyrje   |
| Konteksti i gjerë   |
| Konteksti kosovar   |
| Përfshirja e trashëgimisë Kulturore në planifikim hapësinor qendror |
| <i>Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+</i>                         |
| Përfshirja e trashëgimisë Kulturore në planifikim hapësinor komunal |
| <i>Komuna e Mitrovicës</i>  |
| <i>Komuna e Vushtrrisë</i>  |
| <i>Komuna e Gjakovës</i>  |
| <i>Komuna e Pejës</i>   |
| <i>Komuna e Hanit të Elezit</i>                                     |
| Konkluzionet e përgjithshme   |
| Rekomandimet e përgjithshme   |
| Rekomandimet specifike  |
| Shtojcat  |
| Literatura  |

Iniciues i studimit: Trashëgimia Kulturore pa Kufi (CHwB)  
Bartës i studimit: Instituti për Planifikim Hapësinor AMMK/MMPH

## CONTENTS OF THE STUDY

|  |
|--|
| Inclusion of Cultural heritage in spatial planning           |
| Introduction   |
| Broader context  |
| Kosovan context  |
| Inclusion of Cultural heritage in National spatial planning  |
| <i>Spatial Planning of Kosovo 2010-2020+</i>                 |
| Inclusion of Cultural heritage in Municipal spatial planning |
| <i>Municipality of Mitrovica</i>                             |
| <i>Municipality of Vushtri/Vučitrn</i>                       |
| <i>Municipality of Gjakova/Djakovica</i>                     |
| <i>Municipality of Peja/Peć</i>                              |
| <i>Municipality of Hani Elezit/Elez Han</i>                  |
| General conclusions  |
| General recommendations                                      |
| Specific recommendations                                     |
| Annexes  |
| Literature   |

Initiator of the study: Cultural Heritage without Borders (CHwB)  
Bearer of study: Institute of Spatial Planning KEPA/MESP

## Grupi Përgjegjës

- Luan **NUSHI** – Koordinator, planer profesionist, përgjegjës për vlerësimin e dokumentit Plani Hapësinor i Kosovës dhe dokumentet përkatëse të Komunës së Mitrovicës;
- Arbën **RRECAJ** – Anëtar, planer profesionist, përgjegjës për vlerësimin e dokumenteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë;
- Faton **DEVA** – Anëtar, planer profesionist, përgjegjës për vlerësimin e dokumenteve përkatëse të Komunës së Gjakovës;
- Festa **Nixha - NELA** – Anëtare, planer profesionist, përgjegjëse për vlerësimin e dokumenteve përkatëse të Komunës së Pejës;
- Elvida **PALLASKA** – Anëtare, planer profesionist, përgjegjëse për vlerësimin e dokumenteve përkatëse të Komunës së Hanit Elezit;
- Suzana **GORANCI** – Bashkëpunëtoreshë, udhëheqëse e Divizionit për Bashkëpunim Komunal në Departamentin për Planifikim Hapësinor/MMPH

## Lista e Shkurtesave

- MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- IPH – Instituti i Planifikimit Hapësinor
- CHwB – Trashëgimia Kulturore pa Kufij
- MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- IMMK – Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
- AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
- TK – Trashëgimia Kulturore
- TN – Trashëgimia Natyrore
- PHK – Plani Hapësinor i Kosovës
- PZHK – Plani Zhvillimor Komunal
- PZHU – Plani Zhvillimor Urban
- PRRU – Plani Rregullues Urban
- PGJU – Plani Gjeneral Urbanistik
- LNÇ – Lufta Nacionalçlirimtare
- USAID – Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (Organizata Katolike për Asistencë dhe Ndihmë në Zhvillim)
- CORDAID – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
- RSFJ – Ligji i Planifikimit Hapësinor
- LPH – Hani i Elezit
- HE – Qytet historik në Japoni
- NARA – Drejtoritë komunale për kulturë

## Steering Group

- Luan **NUSHI** – Coordinator, professional planner, in charge for assessment Spatial Plan of Kosovo document and respective documents of Municipality of Mitrovica;
- Arbën **RRECAJ** – Member, professional planner, in charge for the assessment of respective documents of Municipality of Vushtrri/Vučitrn;
- Faton **DEVA** – Member, professional planner, in charge for the assessment of the respective documents of Municipality of Gjakovë/Djakovica;
- Festa **Nixha - NELA** – Member, professional planner, in charge for the assessment the respective documents of Municipality of Pejë/Peć;
- Elvida **PALLASKA** – Member, professional planner, in charge for the assessment of the respective documents of Municipality of Hani i Elezit/Elez Han;
- Suzana **GORANCI** – Associate, Head of Municipal Cooperation Division in the Department of Spatial Planning/MESP

## List of Abbreviations

- MESP – Ministry of Environment and Spatial Planning
- ISP – Institute of Spatial Planning
- CHwB – Cultural Heritage without Borders
- MCYS – Ministry of Culture Youth and Sports
- IPMK – Institute for Protection of Monuments of Kosovo
- KEPA – Kosovo Environmental Protection Agency
- CH – Cultural Heritage
- NH – Natural Heritage
- SPK – Spatial Plan of Kosovo
- MDP – Municipal Development Plan
- UDP – Urban Development Plan
- URP – Urban Regulatory Plan
- GUP – General Urban Plan
- NLM – National Liberation Movement
- USAID – United States Agency for International Development
- CORDAID – Catholic Organisation for Relief and Development Aid
- SFRY – Socialist Federal Republic of Yugoslavia
- LSP – Law on Spatial Planning
- HE – Hani i Elezit/Elez Han
- NARA – Historic City in Japan
- MDC – Municipal Departments of Culture



## FALËNDERIM

Studimi i ofruar është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve relevante, kompanive dhe komunave pjesëmarrëse. Me këtë rast dëshirojmë t'i falenderojmë të gjithë ata të cilët ndihmuan në procesin e realizimit dhe hartimit të studimit:

Znj. Vjollca Aliu dhe Burbuqe Deva – Departamenti i trashëgimisë kulturore në MKRS, për përkrahjen e iniciativës dhe gatishmërinë për ofrimin e të dhënave të nevojshme;

Znj. Gjejlane Hoxha – udhëheqëse ekzekutive në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, për përkrahje dhe ofrimin e rekomandimeve për përmbajtjen e studimit;

Z. Enes Toska – menaxher i programit në CHwB, për këshillat dhe përkrahjen e pa rezervë në zhvillimin e studimit;

Z. Luan Kabashi – përfaqësues i kompanisë hartuese të Planit Zhvillimor për Komunën e Mitrovicës, i cili me përkushtim të theksuar ka ofruar një përmbledhje me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me trajtimin e trashëgimisë kulturore në planet e deritashme hapësinore për Komunën e Mitrovicës;

Znj. Rrezarta Loxha, drejtoreshë dhe Hylki Salihu, bashkëpunëtor profesional në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Mitrovicë, për gatishmërinë dhe përkrahjen e studimit në dhënien e informatave të nevojshme për trashëgiminë kulturore për Komunën e Vushtrrisë.

Znj. Elida Bejtullahu – përfaqësuese e Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Gjakovës për ofrimin e të dhënave lidhur me përmbajtjen e planeve përkatëse komunale.

Z. Osman Gojani – Udhëheqës i Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturorë në Gjakovë, për ofrimin e të dhënave dhe rekomandimeve të nevojshme lidhur me trajtimin e trashëgimisë kulturore në Komunën e Gjakovës.

Znj. Merita Kuraja dhe Znj. Violeta Uka – përfaqësuese të strukturave komunale në Pejë, për ofrimin e të dhënave lidhur me planet përkatëse komunale.

Z. Avdyl Hoxha dhe Z. Arsim Mulhaxha – përfaqësues të Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturorë në Pejë, të cilët me informata dhe rekomandimet e tyre, ndihmuan në paraqitjen sa më reale të çështjes së trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës.

Z. Muzafer Dernjani – Nënkryetar i Komunës së Hanit Elezit, për përkushtimin dhe mikpritjen e ofruar, për të gjithë kohën sa ka zgjatur projekti;

Z. Durim Dernjani – Menaxher i Projekteve, DUKMM; Z. Nexhmedin Daci – drejtor në Drejtorin e Urbanizmit; Z. Nazim Laçi – Drejtor në Drejtorinë për Trashëgimi Kulturorë, përfaqësues të Komunës Hani Elezit, për kontributin e dhënë në ofrimin e rekomandimeve dhe të dhënave për të pasqyruar sa më realisht çështjen e trashëgimisë kulturore për Komunën Hani Elezit.

Z. Sami Stagova dhe Z. Pren Domgjoni, zyrtarë në UN-HABITAT dhe Z. Emrush Dernjani, profesor i historisë dhe autor i librit "Shkolla Popullore Shqiptare në Paldenicë", të cilët me përkushtim dhe përkrahje të pazërvë, kontribuan në prezantimin sa më korrekt të çështjes së trashëgimisë kulturore për Komunën e Hanit Elezit.

Një falënderim i veçantë i dedikohet Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (CHwB) dhe stafit të tyre, për iniciativën shumë të qëlluar dhe të përshtatshme me kohën.

Dhe në fund, një kontribut të veçantë kanë dhënë pjesëmarrësit e punëtorisë të mbajtur me 25.05.2011, në të cilën janë dhënë vërejtje dhe rekomandime të çmueshme, që kanë ndikuar në përmbajtjen dhe konsolidimin e versionit përfundimtar të dokumentit.

## ACKNOWLEDGMENT

The study presented has been developed in close cooperation with various representatives of relevant institutions, companies and participating municipalities. On this occasion, we would like to thank all who assisted in the process of implementation and development of this study:

Mrs. Vjollca Aliu and Burbuqe Deva – Department of Cultural Heritage in MCYS, for their support to this initiative and willingness in providing necessary data;

Mrs. Gjejlane Hoxha – Executive Head at the Council for Cultural Heritage in Kosovo, for the support and provision of recommendations on the content of this study;

Mr. Enes Toska – Program Manager at CHwB, for his guidance and limitless support for the progress of this study;

Mr. Luan Kabashi – representative of a Company drafting the Development Plan for the Municipality of Mitrovica, for his outstanding commitment in providing a summary of all data related to the treatment of cultural heritage in the current spatial plans for the Municipality of Mitrovica;

Mrs. Rrezarta Loxha, Director, and Hylki Salihu, Professional Associate in the Regional Centre for Cultural Heritage in Mitrovica, for the willingness and support on this study by providing necessary information about cultural heritage for the Municipality of Vushtrri/Vučitrn.

Mrs. Elida Bejtullahu – representative of the Directorate of Urbanism in the Municipality of Gjakova/Djakovica for providing information regarding the content of the respective municipal plans.

Mr. Osman Gojani – Head of the Regional Cultural Heritage Center in Gjakova/Djakovica, for providing necessary data and recommendations regarding the treatment of cultural heritage in the Municipality of Gjakovë/Djakovica.

Mrs. Merita Kuraja and Mrs. Violeta Uka – representatives of Pejë/Peć Municipality, for providing their inputs in regard to relevant municipal plans.

Mr. Avdyl Hoxha and Mr. Arsim Mulhaxha – representatives of the Regional Cultural Heritage Center in Pejë/Peć, for the information and their recommendations which assisted in a factual presentation of issues of cultural heritage in the municipality of Peja/Peć.

Mr. Muzafer Dernjani - Deputy Mayor of Hani i Elezit/Elez Han Municipality, for his dedication and hospitality offered during the process of this project;

Mr. Durim Dernjani – Project Manager – DUCEP; Mr. Nexhmedin Daci – Director of the Department of Urban Planning; Mr. Nazim Laçi – Director of the Department of Cultural Heritage, representatives of the Hani i Elezit/Elez Han Municipality, for their contribution in providing recommendations and data to reflect more realistically the issue of cultural heritage in Hani i Elezit/Elez Han Municipality.

Mr. Sami Stagova and Mr. Pren Domgjoni, officials of UN-Habitat and Mr. Emrush Dernjani, professor of history and author of “Albanian National School in Paldenica”, who diligently and unwearingly support contributed to more correct presentation of the issue of cultural heritage for the Municipality of Hani i Elezit/Elez Han.

Special credits go to Cultural Heritage without Borders (CHwB) and its staff for their well-minded and such timely-appropriate enterprise.

And, lastly, kudos for the participants of the workshop, held in 25.05.2011, for their precious observations and recommendations, which have influenced the shape of final version of this paper.

## PËRKUFIZIMET SIPAS LIGJIT PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

- *"Trashëgimi kulturore"* përfshinë trashëgiminë arkitekturale, trashëgiminë arkeologjike, trashëgiminë e luajtshme dhe trashëgiminë shpirtërore.
- *"Trashëgimi arkitektural"* përbëhet nga:
  - o Monumentet: Konstruktivet dhe strukturat e dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike shkencore me interes shoqëror ose teknike duke përfshirë elementet e luajtshme si pjesë të saj.
  - o Ansamblet ose tërësia e ndërtesave: Grupet e ndërtesave urbane ose rurale të dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, me interes shoqëror ose teknik, në ndërveprim me njësitë e caktuara topografike.
  - o Fushat e konservimit arkitektural: Fushat që përmbajnë punë të kombinuara të dorës së njeriut dhe natyrës, të dalluara nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, shkencore, të interesit shoqëror dhe teknik.
- *"Trashëgimi arkeologjike"* nënkupton ndërtimet, strukturat dhe grupet e ndërtesave, vendbanimeve të zhvilluara, objektet e luajtshme, monumentet e llojeve të ndryshme dhe përbërjeve të tyre, të gjetura në tokë ose nën ujë. Trashëgimi arkeologjik mund të jetë e mbrojtur përmes një rezervati arkeologjik, ku të mbeturat qoftë të dukshme ose të fshehta (të padukshme) në terren duhet të mbeten të paprekura.
- *"Trashëgimi e luajtshme"* janë objektet që janë shprehje ose evidencë e kreativitetit njerëzor ose e një zhvillimi natyror, të dalluara për nga vlerat historike, arkeologjike, artistike, të rëndësisë dhe të interesit shkencor ose shpirtëror.
- *"Trashëgimi shpirtërore"* përfshin format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festave, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.
- *"Pejsazhet kulturore"* nënkupton një fushë, ashtu siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i të cilës është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzorë; një komponentë esenciale e ambientit të njerëzve, një shprehje e diversitetit të trashëgimisë së përbashkët të tyre kulturore e natyrore, dhe një krijues i identitetit të tyre.
- *"Inventarizim"* është një veprimtari hulumtuese për regjistrimin paraprak dhe dokumentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.
- *"Konservim"* nënkupton krijimin e kushteve të përshtatshme dhe marrjen e masave paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen.
- *"Restaurimi"* nënkupton një veprimtari me qëllim të ruajtjes dhe ekspozimit të vlerave të trashëgimisë kulturore.
- *"Vlerësimi i trashëgimisë kulturore"* nënkupton procesin e hulumtimit, studimit, dokumentimit dhe përzgjedhjes për procesin e mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, administrimit dhe përhapjes së vlerave të saj.
- *"Konservim"* nënkupton krijimin e kushteve të përshtatshme dhe marrjen e masave paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen.

## DEFINITIONS ACCORDING TO CULTURAL HERITAGE LAW

- *“Cultural heritage”* includes Architectural heritage, Archaeological heritage, Movable heritage and Spiritual heritage.
- *“Architectural heritage”* is composed of:
  - o Monuments: Constructions and structures distinguished by values of historical, archaeological, artistic, scientific, social or technical interest including movable elements as their parts.
  - o Ensemble of buildings: Groups of urban or rural buildings distinguished by values of historical, archaeological, artistic, scientific, social or technical interest, interrelated with certain topographic units.
  - o Architectural conservation areas: Areas comprising combined works of human hand and nature distinguished by values of historical, archaeological, artistic, scientific, social and technical interest.
- *“Archaeological heritage”* means constructions, structures and groups of buildings, developed settlements, movable objects, monuments of various kinds and their contents, found on land or under water. The Archaeological Heritage may be protected through an Archaeological Reserve where the remains, whether visible or hidden in the ground are to be left undisturbed.
- *“Movable heritage”* are objects that are expression or evidence of human creativity or of a natural development, distinguished by values of historical, archaeological, artistic, scientific or spiritual importance and interest.
- *“Spiritual heritage”* includes forms of cultural expression of popular traditions or customs, language, celebration, ritual, dance, music, song and other artistic expression.
- *“Cultural landscapes”* means an area, as perceived by people, whose character is a result of the action and interaction of natural and / or human factors; an essential component of peoples' surroundings, an expression of the diversity of their shared cultural and natural heritage, and a foundation of their identity.
- *“Inventory”* is a research activity for preliminary recording and documentation of the values of Cultural Heritage.
- *“Conservation”* means creation of suitable conditions and the taking of preliminary measures for preservation of the Cultural Heritage including maintenance.
- *“Restoration”* means an activity aimed at preservation and displaying of values of the Cultural Heritage.
- *“Evaluation of the Cultural Heritage”* means the process of researching, studying, documenting and selecting for the process of protection, conservation, restoration, administration and propagation of its values.
- *“Conservation”* means creation of suitable conditions and the taking of preliminary measures for preservation of the Cultural Heritage including maintenance.

## TERMINOLOGJIA E PËRDORUR

- Konservim i integruar - një sërë masash me qëllim të sigurimit të përjetësisë së trashëgimisë, mirëmbajtjes si pjesë të një mjedisi të favorshëm, pa marrë parasysh nëse është nga njeriu apo natyra, shfrytëzimit apo adaptimit për nevojat e shoqërisë.
  - Interpretimi i referohet një rangu të gjerë të aktiviteteve në tentim të ngritjes ndërgjegjen publike dhe ngrisë kuptimin e vendeve të trashëgimisë kulturore. Këto mund të ngërthejnë publikimet e shtypura apo/edhe elektronike, prezantime publike, instalime në vend dhe jashtë, programe arsimore, aktivitete të komunitetit si dhe hulumtime, trajnime dhe vlerësime për interpretimin e procesit si të tillë.
  - Prezantimi në më shumë specifika pasqyron komunikimin e kujdesshëm të përmbajtjes interpretative përmes aranzhimit të informatave interpretative, qasjes fizike dhe infrastrukturës interpretative në vendet e trashëgimisë kulturore. Mund të arrihet përmes një morie të masave teknike duke ngërthyer vizitat e organizuara, mësimet nga ciceronët apo udhëheqësit sikur dhe aplikacionet në multimedia dhe ueb-faqe.
  - Infrastruktura interpretative i referohet instalimeve fizike, hapësirave, vendeve të cilat janë të lidhura me vendet e trashëgimisë kulturore dhe mund të përdoren specifikisht për qëllime të interpretimit dhe prezantimit duke ngërthyer mbështetjet e interpretimeve përmes teknologjive ekzistuese.
- Interpretët e vendit i referohet stafit apo vullnetarëve në vendet e trashëgimisë kulturore të cilët janë të angazhuar në mënyrë të përhershme apo për kohë të caktuar për komunikimin publik të informatave lidhur me vlerat dhe rëndësinë e vendit.
  - Vend i trashëgimisë kulturore i referohet vendit, lokalitetit, pejzazhit natyror, vendbanimit, kompleksit arkitekturor, vendit arkeologjik, apo strukturës që qëndron dhe është e njohur në mënyrë legale si një vend historik dhe me rëndësi kulturore.

## TERMINOLOGY USED

- Integrated Conservation - a series of measures to ensure the eternity of heritage, maintenance as part of a favorable environment, whether by the man or nature, exploitation or adaptation to the needs of society.
  - Propagation - refers to a wide range of activities - striving to raise public awareness and improve understanding of cultural heritage sites. These would incorporate print publications - and/or electronic, public presentations, installations at home and abroad, educational programs, community activities and research, training and assessments for the propagation of the process as such.
  - Presentation - in much specificity reflects careful communication of interpretative content through the arrangement of interpretative information, physical access and propagative infrastructure in the cultural heritage sites. It can be achieved through a myriad of technical measures including organized visits, lessons from guides or leaders, and multimedia and web-page applications.
  - Propagative infrastructure - refers to physical installations, areas, facilities which are related to cultural heritage sites and can be specifically used for purpose of propagation and presentation by including support of interpretations through existing technologies.
- Local interpreters - refers to the staff or volunteers in cultural heritage sites engaged permanently or part-time in public communication of information in regard to the values and significance of the sites.
  - Cultural heritage site - refers to the place, locality, natural landscape, settlement, architectural ensemble, archaeological site or structure that stands and legally recognized as historical site and of cultural significance.`

## ORGANIZATAT DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

**UNESCO** – (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë) – Misioni i tij është të kontribuojë në ndërtimin e paqes, zhdukjen e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm dhe dialogun ndërkulturor përmes arsimit, shkencës, kulturës, komunikimit dhe informimit, në kuadër të së cilës është edhe sektori tejet i fuqishëm i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore botërore.

**ICOMOS** – (Këshilli ndërkombëtar për monumente dhe vende) – është organizatë joqeveritare e formuar më 1965, me seli në Paris. ICOMOS merret me terminologjinë, filozofinë, metodologjinë dhe teknikat e konservimit. Është i lidhur ngushtë me UNESCO, në veçanti në rolin e tij sipas konventës për trashëgiminë botërore të vitit 1972.

**Karta e Venedikut** (1964) - kartë ndërkombëtare e arkitektëve dhe profesionistëve tjerë të interesuar në konservim.

**Karta e Burrës** (1977) - Në qytetin e quajtur Burra, në Australinë jugore, më 1979 ICOMOS i australian miratoi udhërrëfyesin për konservimin e vendeve të rëndësishme kulturore. Karta definon standarde të praktikës për ata të cilët ofrojnë këshilla, marrin vendime për/apo ndërmarrin punë për vendet e sinjifikancës kulturore, duke përfshirë pronarët, menaxherët dhe kustosët.

**Deklarata e Quebecut** – del si rezultat i Samitit Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2002. Rekomandimet kryesore të saj janë: zhvillimi i turizmit kulturor në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm përmes ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, përfshirjes së komunitetit në planifikim, zhvillim dhe funksionim si dhe qasje më të lehtë ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

**Karta e ICOMOS-it** – në interpretimin dhe prezantimin e vendeve me trashëgimi kulturore (Kanada, 4 tetor 2008) – promovon etikën e konservimit në të gjitha aktivitetet dhe ndihmon në përmirësimin e vlerësimit të trashëgimisë kulturore, në të gjitha format a saj. Qëllimi i Kartës është definimi i parimeve bazë për interpretim dhe prezantim të cilat paraqesin një komponentë thelbësore të angazhimit për konservim të trashëgimisë; dhe si masa të tilla ndihmojnë në përmirësimin e pranimin dhe kuptimit të vlerave të vendit me trashëgimi kulturore. Duke iu referuar dokumenteve të rëndësishme të planifikimit hapësinor evropian është shumë me rëndësi që gjatë hartimit të planeve zhvillimore përqëndrimin tonë ta drejtojmë edhe ndaj çështjes së trashëgimisë kulturore.

**CEMAT** – Konferenca e Ministrave të Këshillit të Evropës, përgjegjëse për planifikim hapësinor/rajonal. Përgjegjëse për nxjerrjen e politikave dhe rekomandimeve në sektorin e planifikimit hapësinor evropian.

**ESDP**<sup>1</sup> - Në dokumentin Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor, njëra nga tri orientimet kryesore është – “zhvillimi dhe ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore përmes një menaxhimi racional”. Kjo qasje duhet të kontribuojë në ruajtjen dhe përforcimin e identitetit rajonal; në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e llojllojshmërisë natyrore dhe kulturore të regjioneve dhe qyteteve të Evropës në erën e globalizimit. Një orientim i tillë do të thotë shfrytëzim i trashëgimisë natyrore dhe kulturore si potencial për zhvillim.

---

<sup>1</sup> ESDP – European Spatial Development Perspective - njëri nga dokumentet kyçe të zhvillimit hapësinor evropian, që flet kryesisht për zhvillim të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar hapësinor për të gjitha shtetet anëtare.

## INTERNATIONAL ORGANIZATIONS AND DOCUMENTS

**UNESCO** - (United Nations Organization for Education, Science and Culture) - Its mission is to contribute to peace building, eradication of poverty, sustainable development and intercultural dialogue through education, science, culture, communication and information, with a robust section for protection of world cultural heritage.

**ICOMOS** - (International Council on Monuments and Sites) - is a non-governmental organization established in 1965 and headquartered in Paris. ICOMOS deals with terminology, philosophy, methodology and techniques of conservation. It is closely associated with UNESCO, particularly in its role under the world heritage convention of 1972.

**Venice Charter** (1964) - International chart of architects and other experts interested in conservation.

**Burra Charter** (1977) - In 1979, *Australian ICOMOS adopted the guideline for the conservation for the conservation of places of cultural significance* at a meeting at town of Burra, South Australia. Charter defines the standards of practice for those who provide advice, make decisions about, or undertake work for the sites of cultural significance, including owners, managers and curators.

**Quebeck Statement** – came as an outcome of World Summit on Sustainable Development, 2002. The main recommendations of which are: development of cultural tourism in the context of sustainable development through the conservation of natural and cultural heritage, community-involved planning, development and operation, and easier access to natural and cultural heritage.

**ICOMOS Charter** - for interpretation and introduction of cultural heritage sites (Canada, October 4, 2008) - promotes the conservation ethics in all the activities and helps improve the assessment of cultural heritage in all forms. The purpose of the Charter is the definition of basic principles for interpretation and introduction which are essential components of commitment to heritage conservation, and as such help to improve acceptance and understanding of the values of the countries with cultural heritage.

Referring to the important European spatial planning documents it is of a great importance to have our focus on the issue of cultural heritage during the preparation of development plans.

**CEMAT** - Council of Europe Conference of Ministers Responsible for Spatial/Regional Planning - responsible for generating policies and recommendations for spatial planning in Europe.

**ESDP<sup>2</sup>** - In the document *European Spatial Development Perspective*, one of three main directions is – “development and preservation of natural and cultural heritage through a rational management. This approach should contribute to the preservation and strengthening of regional identity, preservation and maintenance of natural and cultural diversity of the regions and cities of Europe in the era of globalization. Such orientation means the use of natural and cultural heritage as the potential for development.

---

<sup>2</sup> ESDP – European Spatial Development Perspective - one of the key documents of European spatial development, which mainly speaks for sustainable and balanced spatial development in all member states.



**Konventa e Granades**<sup>3</sup> - Dokumenti thekson se: trashëgimia arkitekturore përbën shprehje të pazëvendësueshme të pasurisë dhe diversitetit të trashëgimisë kulturore të Evropës, dhe se ajo duhet të jetë një prej dëshmimeve të pazëvendësueshme të së kaluarës sonë, dhe se e gjithë kjo duhet të prezantojë një trashëgimi të përbashkët evropiane.

**Konventa e Valetës**<sup>4</sup> - Në dokument mes tjerash theksohet nevoja për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike duke u reflektuar si njëra nga çështjet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural si dhe në politikatat e zhvillimit të kulturës në përgjithësi. Në aspektin e përgjegjësisë, dokumenti thekson se: mbrojtja e trashëgimisë arkeologjike nuk duhet të jetë çështje e vetëm një shteti përkatës, por që ky duhet të jetë interes universal i të gjitha vendeve evropiane, me të vetmin qëllim mbrojtjen nga rreziku i shkatërrimit dhe humbjes së kujtesës kolektive evropiane.

<sup>3</sup> Konventa për mbrojtje e trashëgimisë arkitekturore të Evropës – Granada, 03 Tetor 1985.

<sup>4</sup> Konventa evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike – Valeta, Janar 1992.

## KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LEGJISLATIVE

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka të themeluar Departamentin e Trashëgimisë Kulturore, përgjegjës për menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) është po ashtu përgjegjës që të rregullojë kushtet për ndërhyrjet dhe restaurimin e trashëgimisë ndërtimore.

MKRS, IKMM dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore, si qendra për mbrojtjen e monumenteve të kulturës janë përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe autorizimin e zhvillimit urban brenda zonës historike.

Këshilli Kosovës për Trashëgimi Kulturore është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2007. Sipas Nenit 4, Pika 8 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore ky Këshill *“është organ i cili krijohet nga Kuvendi i Kosovës, i cili përcakton edhe objektin e veprimtarisë së tij në fushën e trashëgimisë kulturore”*.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjet për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës:

- Ligji nr. 02/L-88 - Ligji për trashëgiminë kulturore. Ligj me të cilin bëjmë mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Objekti i këtij ligji është mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore duke siguruar edhe mjetet ligjore dhe teknike për inventarizim, dokumentim, selektim, mbrojtje, konservim, restaurim, administrim, prezantim dhe përhapje të këtyre thesareve, në përputhje me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore që është nën mbrojtje.

**Granada Convention**<sup>5</sup> - This document notes that: architectural heritage constitutes an irreplaceable expression of wealth and cultural diversity of Europe, and that it should be an irreplaceable evidence of our past, and all that should present a common European heritage.

**Valetta Convention**<sup>6</sup> - This document among others emphasizes the need for the protection of archaeological heritage, reflected as one of the main issues in the urban and rural planning and the policies of development of culture, in general. In terms of accountability, the document states that: protection of archaeological heritage should not only be a matter of the relevant state, but this should state the universal interest of all European countries, with the sole purpose of protection from the risk of destruction or loss of European collective memory.

## INSTITUTIONAL AND LEGAL FRAMEWORK

Ministry of Culture, Youth and Sports has established the Department of Cultural Heritage, responsible for the management of cultural heritage in Kosovo.

Institute for Protection of Monuments of Kosovo (IPMK) is also responsible in regulation of the conditions for intervention and restoration of built heritage.

MCYS, IPMK and Regional Cultural Heritage Centers as bodies for protection of monuments of culture are responsible for the protection and preservation of cultural heritage and approval of urban development within the historical area.

Kosovo Council for Cultural Heritage was established by the Assembly of Kosovo in 2007. According to Article 4, Paragraph 8 of the Cultural Heritage Law this Council *“is a body which will be established by the Assembly of Kosovo who will also determine the objects of its activity in the field of cultural heritage.”*

Kosovo Assembly has promulgated laws for the protection, preservation and promotion of cultural heritage in Kosovo:

- Law no. 02/L-88 - Law on Cultural Heritage. This law was adopted to establish protection, preservation and promotion of cultural heritage of Kosovo. The object of this law is to protect values of cultural heritage by also providing legal and technical tools for inventory, documentation, selection, protection, conservation, restoration, administration, presentation and propagation of these treasures in accordance with international charters and conventions, regardless of the ownership of cultural heritage under protection.

---

<sup>5</sup> Convention for the protection of architectural heritage of Europe - Granada, October 3, 1985.

<sup>6</sup> European Convention for the protection of archaeological heritage – Valletta, January 1992.

- Ligji nr.03/L-039 – Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura. Ky ligj do të sigurojë mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, vendeve tjera fetare si dhe vendeve historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb si dhe për komunitetet e tjera në Republikën e Kosovës nëpërmjet themelimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtura.
- Ligji nr. 02/L-18 –Ligji për mbrojtjen e natyrës. Zonë e mbrojtur e natyrës është zonë e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peizazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve të tjera.
- Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre dhe të ruajnë e përmirësojnë elementet esenciale të identitetit të tyre, veçanërisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë e tyre kulturore. Vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie është thesar i tërë popullit të Kosovës.
- Ligji për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 - Qëllim kryesor i tij është promovimi i zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, arritjen e drejtëpeshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura dhe mbrojtjes së mjedisit, dhe sjelljes së regjimit të planifikimit hapësinor të Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.
- Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 Nr 03/L-106;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – është përgjegjëse për mbulimin e fushave të rëndësishme që kanë të bëjnë kryesisht me politikat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit hapësinor.
- Departamenti i Planifikimit Hapësinor – Është pjesë e MMPH-së dhe aktivitetet kryesore kanë të bëjnë me hartimin e rregullativës ligjore dhe përcaktimin e politikave në fushën e planifikimit hapësinor në Kosovë.
- Instituti për Planifikim Hapësinor - është pjesë e MMPH-së dhe kryesisht merret me hartimin e planeve hapësinore të nivelit qendror (PH të Kosovës, planeve hapësinore për zona të veçanta, dokumenteve tjera në fushën e planifikimit), u ofron këshilla dhe ndihmë profesionale komunave në hartimin e planeve dhe shërbime tjera në fushën e planifikimit hapësinor.
- Drejtoritë përkatëse komunale për planifikim dhe menaxhim urban – përgjegjëse për përgatitjen e planeve përkatëse komunale dhe menaxhimin e zhvillimeve urbane në kuadër të komunave.

- Law no.03/L-039 - Law on Special Protective Zones. This law shall ensure the protection of Serbian orthodox monasteries, churches, other religious sites, as well as historical and cultural sites of special significance for the Serb community and other communities in the Republic of Kosovo, through the establishment of Special Protective Zones.
- Law no. 02/L-18- Law on Nature Conservation. Protected nature zone is the area designated for the conservation and care of biodiversity, landscapes, natural features and cultural heritage and to provide effective administration through legal means and other measures.
- Law no. 03/L-047 – Law on Protection and Promotion of the rights of Communities and their Members in the Republic of Kosovo. For the purposes of this law, communities are defined as national, ethnic, cultural, linguistic or religious group traditionally present in the Republic of Kosovo that are not in the majority. Communities and their members shall have the right to freely maintain, express and develop their culture and identity and to preserve and enhance the essential elements of their identity, namely their religion, language, traditions and cultural heritage. Historical and cultural value of this heritage is the treasure of all the people of Kosovo.
- Law no. 2003/14 – Law on Spatial Planning. Its main purpose is to promote rational development and spatial planning, achieving the balance between development and preservation of open spaces and environmental protection, and bringing the spatial planning regime of Kosovo in accordance to European and international standards.
- Law no.03/L-106 Amending Law on Spatial Planning No. 2003/14
- Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP) - is responsible for covering the important areas dealing mainly with environmental protection policies and spatial development.
- Department of Spatial Planning - is part of the MESP and its key activities are related to the design of legal and policy setting in the field of spatial planning in Kosovo.
- Institute for Spatial Planning - is part of the MESP and mainly deals with the design of spatial plans in a central level (SP in Kosovo, spatial plans for special zones, other documents in the field of planning), provides advice and professional assistance to municipalities to design municipal-level plans and other services within the field of spatial planning.
- Respective municipal departments for urban planning and administration - responsible for preparing the respective municipal plans and administration of urban development within the municipalities.


## Qëllimi i studimit

Përmes këtij studimi të ndërmarrë në bashkëpunim me CHwB-në, do të tentohet të përshkruhet dhe analizohet çështja e trashëgimisë kulturore dhe përfshirja e saj në planet hapësinore të niveleve të ndryshme. Një vështrim i veçantë do t'i bëhet draft Planit Hapësinor të Kosovës dhe rekomandimeve që dalin nga ky dokument i rëndësishëm i zhvillimit hapësinor të Kosovës. Në mënyrë më specifike, analiza dhe hulumtimi do të realizohet në dokumentet përkatëse hapësinore për komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Gjakovë, Pejë dhe Hani Elezit, të cilat në aspektin e trashëgimisë kulturore përfaqësojnë komunat me karakteristika specifike. Komuna e Prizrenit, që poashtu dallohet me karakteristika të veçanta sa i përket trashëgimisë kulturore, nuk është marrë në trajtim pasi zona historike e Prizrenit ka një plan rregullues urban "Plani i Konservimit dhe i Zhvillimit të Zonës Historike", një nga planet e rralla të kësaj natyre në Kosovë. Pjesë e rëndësishme e këtij studimi do të jenë përfundimet dhe rekomandimet e fundit, që do të ndihmojnë në përcaktimin e qartë të hapave të nevojshëm, për të kontribuar në trajtimin e drejtë të trashëgimisë kulturore në planifikimin hapësinor në Kosovë.

## Korniza e studimit (metodologjia)

Për t'iu përgjigjur pyetjes së studimit nëse planet hapësinore në Kosovë janë të hartuara në mënyrë që të trajtojnë denjësisht mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë, është sajuar korniza e hulumtimit (Fig.1), e cila në fakt paraqet metodologjinë e aplikuar dhe rrjedhjen logjike të aktiviteteve deri në përfundim të studimit. Një metodologji të tillë e kemi ndryshuar në rastin e Komunës së Hanit të Elezit (kryesisht bazohet në shtatë parimet që dalin nga Karta e ICOMOS-it për interpretimin dhe prezantimin e zonave të trashëgimisë kulturore), me të vetmin qëllim testimin e një qasjeje tjetër e cila mund të shfrytëzohet si alternativë për rastet të ngjashme.

Fig.1 – Korniza e studimit




## The purpose of the study

In the course of this study undertaken in cooperation with CHwB, attempts in describing and analyzing the issue of cultural heritage were made, and its inclusion in different levels of spatial planning. A particular overview shall be conducted to the Draft of Spatial Planning of Kosovo and to the recommendations arising from such important document for spatial development of Kosovo. The analysis and research will be conducted more exclusively in related spatial documents for the municipalities of: Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn, Gjakovë/Djakovica, Pejë/Peć and Hani i Elezit/Elez Han, which in terms of cultural heritage represent distinctive municipalities in Kosovo. Prizren municipality, which also stands out for its special features in terms of cultural heritage, was excluded in this paper since the historic zone of Prizren already has been embodied with a regulatory plan "Conservation and Development Plan of Historic Zone", one of the rare plans of this kind in Kosovo. Important part of this study shall be the final conclusions and recommendations that will facilitate clear definition of steps necessary to contribute to the adequate treatment of cultural heritage within the spatial planning in Kosovo.

## Framework of the Study

To answer the survey's question whether the spatial plans in Kosovo are drawn in order to properly address protection of cultural heritage in Kosovo, a study framework had been designed (Fig.1), which actually shows the logical flow of activities until the conclusion of the study. One such methodology we have changed in the case of Hani i Elezit/Elez Han Municipality (supported mainly on seven principles of the ICOMO's Charter on interpretation and presentation of cultural heritage sites) with the sole purpose of testing a different approach which can be utilized as alternative to similar cases.

Fig.1 – Framework of the study



## HYRJE

### Konteksti i gjerë

Politikat zhvillimore të qyteteve në tranzicion shpesh herë nuk janë në bashkërenditje me fushat tematike zhvillimore apo dhe sfidat zhvillimore, nëse zanafilla e tyre historike dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, ndoshta dhe përcaktuese të identitetit, nuk merren parasysh.

Zhvillimet e shpejta të qyteteve, shumë shpesh në emër të zhvillimeve ekonomike, kanë rrezik evident neglizhencën apo dhe humbjen e trashëgimisë kulturore, të llojllojshme dhe shumë të pasur mijëvjeçare, duke marrë parasysh vjetërsinë e qyteteve të Ballkanit.

Sipas "Agjendës së Lisbonës", në bazë të së cilës qytetet luajnë rol vendimtar në gjenerimin ekonomik, krahas trendit të zhvillimit të qyteteve në botë edhe qytetet në Kosovë do të duhej të shikohen si gjeneratorë të zhvillimeve ekonomike lokale por dhe atyre nacionale.

Në një anë është shumë evidente se ekonomitë lokale do të duhej të bazohen në resurse lokale, me shfrytëzim racional dhe qasje të favorshme. Shpejtë do ti afrohem ditës kur qytetet në Kosovë do të garojnë me njëra tjetrën me resurset e veta për atraktivitet të tyre karshi qytetarëve dhe vizitorëve, sikurse dhe është rasti në gjithë Evropën.

Njëri ndër resurset është ai i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, resurs i cili bashkëjeton me zhvillimet e reja. Fryma konkurruese stimulon zhvillimet e reja, porse në anën tjetër kërkon dhe bashkëpunime me qytete fqinje, bashkëpunime ndër-urbane dhe për më tepër, bashkëpunime regjionale, ndërkufitare dhe ndërkombëtare.

Nevoja e bashkëpunimit sjell deri tek kërkesa e partnerëve strategjikë në vazhdimësi për të arritur qëllimin e mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit të vlerave të Trashëgimisë Kulturore në qytet/komunë/regjion.

### Konteksti kosovar

*Trashëgimia kulturore në Kosovë, është në rrezik!* – ky konstatim është emëruesi i përbashkët i shumë debateve, analizave dhe raporteve të fundit, të dala nga struktura të ndryshme, që përfaqësojnë nivele të ndryshme të shoqërisë në Kosovë. Janë shumë raste dhe dëshmi që e vërtetojnë një situatë të tillë, dhe padyshim se kjo është një dukuri ndaj të cilës duhet të reagohej në mënyrë të duhur.

Duke ju referuar situatës në terren, shumë ndërtesa, tërësi ndërtesash dhe objekte të ndryshme të dëshmuara të trashëgimisë kulturore, për çdo ditë e më shumë po e humbin vlerën e tyre. Në disa qytete të Kosovës nuk mund të flitet më për qendrat e vjetra të qyteteve. Këto zona dhe objekte, janë lënë në mëshirën e zhvillimeve të pakontrolluara, pa ndonjë kriter dhe plan paraprak, të shtyra prej interesave të ndryshme, që tregohen si shkaktarët kryesor të një gjendje të tillë. Situata rreth këtyre përmbajtjeve është alarmante, një pjesë e madhe e tyre i janë nënshtruar rrezikut nga zhdukja e tërësishtme. Vetëm disa iniciativa të pakta të ndërmarra nga bashkëpunimi privat-publik dhe aktivitetet e disa organizatave jo-qeveritare, ngjallin ndjenjën se diçka po ndodhë në drejtim të trajtimit adekuat të tyre. Nga vala e madhe e ndërtimeve të pakontrolluara janë zhdukur dhe janë në proces të zhdukjes tërësi dhe objekte me vlera të mëdha.

## INTRODUCTION

### Broader context

Development policies of the cities in transition often are not synchronized with the thematic development areas or development challenges; if their historical origins and values of cultural heritage, maybe even determining the identity, are not taken into account.

Rapid developments of the cities, often in the name of economic development, bear an apparent risk of negligence and loss of diverse and abundant millennial cultural heritage, taking into account the age of the cities in the Balkans.

According to the "Lisbon Agenda", under which the cities play a crucial role in generating economic growth, along with the trend of development of cities in the world, the cities in Kosovo should also be perceived as generators of both local and national economic development.

In a way it is very evident that local economies should be footed on local resources, but with a rational use and favorable access. Soon shall the day approach when the cities in Kosovo will race one another with their own resources for attracting citizens and visitors, as it is the case throughout Europe.

One of such resources is the cultural and natural heritage, a resource which coexists with the latest expansion. Competitive spirit stimulates new developments but on the other hand requires cooperation with neighboring cities, inter-urban mutual aid, and for more, regional, border and international cooperation.

The need of cooperation leads to ongoing demand of strategic partners in achieving the goal of protection, preservation and promotion of values of cultural heritage in the city/municipality/region.

### Kosovan context

*Cultural heritage in Kosovo is in danger!* – This conclusion is a common designation of many debates, analysis and latest reports, emerging from different structures that represent different levels of Kosovo's society. There are many cases and evidence to confirm such a situation, and obviously it is an observable fact to which must react appropriately.

Referring to the situation on the ground, many facilities, ensembles and buildings proven for their cultural heritage, by day are losing more of their value. In some cities in Kosovo there is nothing left from the old traditional city centers. These areas and facilities are left at the pity of uncontrolled developments, without prior criteria and planning, deferred from various interests, which are the main causes of such a condition. Situation over these contents is disturbing; some of them are subject to the risk of a total disappearance. Only few initiatives undertaken by private-public cooperation and activities of some non-governmental organizations incur a feeling that something is occurring towards their adequate treatment. Many objects of great value are in process of extinction or completely lost due to the wave of unrestrained building constructions.



Ky trend po vazhdon edhe sot, dhe shumë shpejtë do të përballemi me situatën kur do të na vije keq për veprimet dhe mosveprimet e bëra, pjesë e të cilave jemi të gjithë. Përgjegjësia bien së pari te autoritetet qendrore, të cilat duhet të insistojnë në përforcimin e infrastrukturës ligjore dhe përcaktimin e qartë të pozicionit të të gjitha institucioneve përgjegjëse. Përgjegjës janë edhe autoritetet komunale të cilat nuk janë treguar të gatshme t'i përgjigjen kërkesave për ndërtim, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve kanë qenë të ndërlidhura me qendrat dhe zonat e vjetra të qyteteve. Deri më tash janë punuar një mori planesh të niveleve të ndryshme, në të cilat çështja e trashëgimisë kulturore ka mbetur e patrajtuar në mënyrën/nivelin e duhur. Një përgjegjësi e madhe i takon edhe profesionistëve, të cilët me ose pa vetëdije, shkelin rregullat e ndërtimit në zonat historike në dobi të arkitekturës moderne. Përgjegjës janë edhe qytetarët një pjesë e të cilëve, të ndodhur në situatë të vështirë ekonomike në një rën anë dhe para presionit të ndërmarrësve nga ana tjetër, me lehtësi po heqin dorë nga e kaluara historike e familjes.

Krahas gjithë kësaj rrëmuje, një shkaktar tjetër i rëndësishëm paraqitet dhe "diskriminimi kulturor" që po ndodhë me shpalljen e listës së zonave të veçanta të mbrojtura. Në fakt, lista e prezantuar është pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe trajtimi i tyre me ligj të posaçëm është duke krijuar bindjen se zonat tjera që nuk janë pjesë e kësaj liste janë më pak të vlefshme. Kjo situatë në mënyrë të drejtpërdrejt po ndikon në krijimin e pikëpamjes se ndaj tyre dhe përreth tyre mund të sillemi pa ndonjë kriter dhe procedurë të caktuar.

Fig.2. - Rrënimi i një pjese të vjetër të qytetit të Prishtinës

Fig.2. – Pulling down an old part of Prishtina/Priština



Such trend continues even nowadays and soon we shall face the situation when we'll lament for such acts and omissions made, for which the guilt lies on each of us. Responsibility falls firstly to central authorities, which must insist on strengthening legal infrastructure and clearly defining the position of all relevant institutions. However municipal authorities are to blame also, for failing to show readiness in responding to requests for constructions that in most cases were associated to the city centers and the old areas of the cities. So far, a variety of plans of different levels have been accomplished in which the issue of cultural heritage has been left untreated in the right way or level. A major responsibility remains to the professionals, who consciously or not, infringe the construction rules in the historic areas in favor of modern architecture. Citizens bear an amount of responsibility, who being in a difficult financial situation on one side, and facing pressure by entrepreneurs on the other, easily give up the history of their family.

Next to this entire muddle, other key issue is the “cultural discrimination” that is taking place with the promulgation of the list of special protective zones. In fact, the presented list is part of the cultural heritage of Kosovo, but their treatment by special law generates the belief that other areas, that are not part of that list, are considered less valuable. This situation is directly affecting the general opinion that toward and around these areas we could act without any criteria and certain procedure.

Fig.3 - Rrënimi i një pjese të vjetër të qytetit të Prishtinës

Fig.3 - Destroying an old part of Prishtina/Priština



## PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR QENDROR

### Plani Hapësinor i Kosovës (PHK)<sup>7</sup>

Plani Hapësinor i Kosovës është dokumenti kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor i cili është ndërtuar në bashkëpunim me të gjithë sektorët e rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës. Në hartimin e tij kanë marrë pjesë edhe profesionistë të dalluar të fushës, institucionet e ndryshme shkencore, universiteti, organizata të ndryshme jo-qeveritare, përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të nivelit lokal dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, ndihma dhe përkrahja e te cilave ka qene pa dyshim shumë e rëndësishme.

Në mesin e sfidave të identifikuar dhe çështjeve të trajtuara në këtë dokument, është edhe trashëgimia kulturore dhe natyrore. Përkundër përpjekjeve, krijohet përshtypja se gjendja e trashëgimisë kulturore nuk është prezantuar në masë të kënaqshme. Të dhënat që disponojmë janë të mangëta dhe nuk shprehin gjendjen reale të shtrirjes hapësinore. Mungon valorizimi dhe gjendja e objekteve, monumenteve dhe zonave që për momentin janë vetëm emra të një liste të dyshimtë.




Fig.4 - PHK – Strategjia e përgjithshme  
Fig.4 - SPK – The overall strategy


<sup>7</sup> Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ është aprovuar në Kuvendin e Kosovës me 16 Qershor 2011.



Dokumenti me të drejtë i referohet rastit të Prishtinës<sup>9</sup> për të cilin konstatohet se numri i objekteve që dëshmojnë të kaluarën e qytetit është i vogël. Edhe ato pak objekte të mbetura janë ngulfatur nga ndërtimet dhe zhvillimet që po ndodhin përreth tyre.

Në bazë të një hulumtimi që është zhvilluar gjatë hartimit të Planit Hapësinor i cili për temë ka pasur zhvillimin urban në vite, zonat urbane janë rritur në sipërfaqe për afër tri herë. Analiza është bërë për shtatë qendrat e mëdha urbane, të cilat në fakt paraqesin pikat drejt të cilave, në vitet e fundit është ndjerë lëvizja më e madhe e popullatës.

Fig. 6 - Rritja e qendrave kryesore urbane 1980 – 1999  
Fig. 6 – Growth of the main urban centers 1980 - 1999




<sup>9</sup> PHK – Kaptina e profilit, f.51

The document accurately refers the case of Prishtina/Priština<sup>10</sup> for which it was concluded that the number of objects witnessing the past of the city is minute. Yet, those few remaining objects are swallowed up by buildings and ongoing constructions around them.

According to a survey conducted during the drafting of the Spatial Plan whose subject was the urban development in years - urban areas have enlarged approximately by three times in surface. The analysis is conducted for seven large urban centers, which in fact represent points towards which, in recent years were impacted with greater movement of population.

Fig. 7 - Rritja e qendrave kryesore urbane 1980 - 1999  
 Fig. 7 - Growth of the main urban centers 1980 - 1999



<sup>10</sup> SPK – Chapter profile, p. 51

Natyrisht se kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të banorëve në zonat urbane, që në mënyrë direkte ka ndikuar edhe në rritjen e sipërfaqes së vet zonës. Në skemën e mëposhtme paraqitet rritja hapësinore e disa qendrave të mëdha urbane të Kosovës në periudhën 1980 – 1999.

Nga këto lëvizje ndikimet më të mëdha vërehen në qytetin e Prishtinës, i cili në bazë të vlerësimeve dhe asaj që po ndodhë në aspektin urban – “nuk ka qenë i përgatitur” për këtë. Fluksi i madh i ardhjes dhe më këtë i kërkesave për sigurimin e një vendi për banim në njërën anë, dhe në anën tjetër mosgatishmëria e autoriteteve komunale që të ofrojnë hapësira legale për ndërtim, janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në parregullsinë urbane të Prishtinës.

Në figurën e mëposhtme tregohet rasti i Prishtinës dhe rritja e saj në vite, tregohet raporti në mes zonës së vjetër dhe pjesës tjetër urbane. Në mënyrë të qartë tregohet trendi i zhvillimit të deritashëm dhe tendenca në vazhdim.

Pa dyshim se në gjithë këtë parregullsi, presioni më i shprehur është bërë dhe po i bëhet qendrës, në zonën me numrin më të madh të objekteve të klasifikuara si vlera të trashëgimisë kulturore.

Shumë nga këto objekte nuk ekzistojnë më – në të shumtën e rasteve ato janë zëvendësuar me objekte të “arkitekturës moderne” që në fakt, në mënyrë serioze po ndikojnë në humbjen e identitetit të zonës së vjetër të qytetit.

E njëjta gjë po ndodh edhe në qytetet tjera. Zhdukja e së “vjetrës” po vazhdon në mënyrë sistematike dhe janë vetëm përpjekjet e rralla të individëve entuziastë, dhe të ndonjë organizate joqeveritare, ato që deri në një masë ndihmojnë në ruajtjen e këtyre përmbytjeve. Gjendjen ekzistuese të trashëgimisë kulturore e rëndojnë pasojat katastrofale të konfliktit të fundit që ndodhi në Kosovë. Një pjesë e madhe e objekteve dhe tërësive të dëshmuara u dogjën, ose u dëmtuan në masë të madhe. Në anën tjetër, pamundësia financiare për rehabilitimin e tyre krijon kushte që edhe ato pak vlera të mbetura, nën ndikimin e kushteve atmosferike dhe vet njeriut, të zhduken fare.

Fig.8 - Rritja e zonës urbane të Prishtinës në vite  
Fig.8 – Expansion of urban area of Prishtina/Priština in years`



Clearly, this has increased the number of residents in urban areas that directly affected in the increase of its surface area. The scheme below shows the spatial growth of some large urban centers of Kosovo in the period 1980 to 1999.

The largest impacts of these movements were observed in the city of Prishtina/Priština, which according to assessments and what is happening in urban context – “was not prepared” for this. Massive influx of arrivals and the requirements for providing a place for housing in one hand, and on the other the unwillingness of local authorities to provide legal spaces for construction are major causes that have influenced and continue to affect in the irregularity of the urban area of Prishtina/Priština. The following figure shows the case of Prishtina/Priština and its growth in years, indicating the ratio between the oldest area and the rest urban areas. Clearly shows the trend of development so far and the ongoing trends.


No doubt that in all this disarray, the direct pressure was centered and boiling in the city center, the area with the largest number of objects classified as values of cultural heritage. Many of these buildings no longer exist, in most cases those are replaced with objects of “modern architecture”, in fact, seriously affecting in the loss of the identity of the old town area.

Same occurrence is happening in other cities, too. The disappearance of an “old” is continuing systematically and only rare efforts of enthusiastic individuals and few non-governmental organizations that at some extent are helping maintaining these contents. Existing state of cultural heritage plagues from the catastrophic consequences of the recent conflict that occurred in Kosovo.

A large part of the facilities and proven sites were burned down or severely damaged. On the other hand, financial inability to revitalize them are bringing to situation when those few remaining values affected by the atmospheric conditions and people would completely disappear.

Fig.9 - Objektet sakrale<sup>11</sup>

Fig.9 – Oobjects of worship<sup>12</sup>



<sup>11</sup> Harta e prezantuar dëshmonë mungesën e shënimeve për të gjithë territorin e Kosovës.

<sup>12</sup> Presented map shows the lack of data for the entire territory of Kosovo.



Dokumenti, në pjesën e parë të tij, me të drejtë vë në pah rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen e saj si njërin ndër faktorët kryesor të zhvillimit në përgjithësi. Njëri nga parimet kryesore është: "Përparimi i trashëgimisë kulturore si faktor për zhvillim, mbrojtja e trashëgimisë kulturore si pjesë integrale e zhvillimit të shoqërisë, pasuritë kulturore trajtohen si potencial i zhvillimit të zonës në të cilën gjenden, në aspektin e zhvillimit ekonomik"<sup>13</sup>.

Pjesë e rëndësishme e dokumentit është deklarata e vizionit<sup>14</sup> të zhvillimit të ardhshëm hapësinor të Kosovës. Në bazë të kësaj deklarate çështja e trashëgimisë kulturore prezantohet si njëra nga çështjet më të rëndësishme mbi të cilën, në mënyrë të qartë, janë dhënë synimet, objektivat dhe aktivitetet që ndikojnë në trajtimin e duhur të çështjes.

Një përfshirje dhe një analizë më përmbajtësore është bërë lidhur me zonat e veçanta të mbrojtura<sup>15</sup>. Duke ju referuar Ligjit për këto zona, është bërë identifikimi dhe është prezantuar shtrirja e tyre hapësinore sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Ligji në fjalë është pjesë përbërëse e Pakos së Ahtisarit<sup>16</sup> të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2008. Sipas këtij Ligji, në territorin e Kosovës janë identifikuar 45 zona të tilla, që kryesisht i përkasin trashëgimisë kulturore ortodokse.

Fig.10 - Shtrirja e zonave të veçanta të mbrojtura në Kosovë<sup>17</sup>  
 Fig.10 – The extent of special protective zones in Kosovo<sup>18</sup>



<sup>13</sup> PHK – Kaptina e Profil, f.51

<sup>14</sup> PHK – Kaptina e Vizionit, Deklarata e Vizionit, f. 117

<sup>15</sup> Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+, f. 130

<sup>16</sup> Propozim gjithëpërfshirës për marrëveshjen për Statusin e Kosovës.

<sup>17</sup> Shtresa (layeri) e sipërfaqes së Zonave të veçanta të mbrojtura është marrë nga UNOSEK-u.

<sup>18</sup> The layer of the surface of special protective zones taken from UNOSEK

The document, in the first part of it justly points out the importance of cultural heritage and its inclusion as one of the main factors of development, in general. One of the key principles is: "Promotion of cultural heritage as a part of development, protection of cultural heritage as an integral component of social development, cultural assets are treated as a potential for the development of area in which are setted, in terms of economic growth".

An important part of the document is a mission statement of a vision of the future spatial development of Kosovo. According to this statement the issue of cultural heritage is presented as one of the most important virtue of which, clearly are given goals, objectives and activities effecting the proper handling of the case.

A substantive analysis and an involvement have been conducted in regard to Special Protective Zones . Referring to the Law on these zones the spatial extension has been identified and presented according to criterias specified in this Law. The Law in question is part of the Ahtisaari package approved by the Assembly in June 2008. Under this Act, 45 such sites were identified in the territory of Kosovo, which mainly belong to the Orthodox cultural heritage.

Fig.11 - Zonat e Veçanta të Mbrojtura për rajonin e Mitrovicës  
 Fig.11 – Special Protective Zones for Mitrovica region



<sup>19</sup> SPK – Profile Chapter, p.51

<sup>20</sup> SPK – Vision Chapter, Vision Statement, p. 117

<sup>21</sup> Spatial Plan of Kosovo 2010 – 2020+, p. 130

<sup>22</sup> Comprehensive Proposal for Kosovo Status Agreement.

Këto zona janë të ndara në tri grupe të cilat janë me karakteristika të ndryshme. Në grupin I-rë bëjnë pjesë zonat kufiri i të cilave është caktuar me anë të hartave. Në grupin II-të bëjnë pjesë zonat të cilat kanë një bufer zonë prej 100m' nga perimetri i "oborrit" të tyre dhe në grupin III-të bëjnë pjesë zonat të cilat kanë një bufer zonë prej 50m' nga perimetri i "oborrit" të tyre.

Për zonat në fjalë, janë të caktuara kriteret sipas të cilave përcaktohen aktivitetet e ndaluara brenda tyre që kanë të bëjnë kryesisht me: ndërtimet e objekteve industriale, digave (pendave), centraleve elektrike, furrave, fabrikave, rrugëve tranzite në zonat rurale dhe ndërtimeve që bëjnë shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit të asaj zone. Sipas të njëjtave kriteret janë përcaktuar edhe aktivitetet e kufizuara që kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimet e objekteve eventuale me etazhitet më të lartë se monumenti që duhet mbrojtur, ndërtimet e rrugëve, punëtorive, restoranteve, hoteleve, klubeve të natës, pompave me karburante të naftës, riparimet e automjeteve, vetëshërbimet, tubimet publike dhe urbanizim të tokës bujqësore.

Kapitulli i parafundit dhe i fundit i Planit Hapësinor paraqet veprimet dhe dispozitat për zbatim, që në mënyrë përmbytësore rekomandojnë ruajtjen dhe trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore në Kosovë, duke potencuar se planifikimi urban/hapësinor duhet të shfrytëzohet si instrument për kontrollin e zhvillimeve në zona me vlera kulturo-historike.

Dokumenti konkretisht rekomandon<sup>23</sup>:

Duke e ndjerë shkallën e lartë të rrezikut nga degradimi i vazhdueshëm i tërësive urbane, arkitektonike, mjedisore dhe monumenteve të trashëgimisë së qyteteve dhe zonave specifike, duhet përcaktuar ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore si qëllim kryesor i parimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Në kontekstin e mbrojtjes nga degradimi i vazhdueshëm i trashëgimisë kulturore janë listuar synimet dhe veprimet që duhet të ndermirren:

- Inventarizimi (data baza) i objekteve dhe tërësive në tërë territorin e Kosovës

- Duhet të bëhet inventarizimi i objekteve dhe tërësive sipas kriterëve nga MKRS;
- Të bëhet vlerësimi i objekteve dhe tërësive të inventarizuara dhe të propozohet lista për monumente të reja, që do ta kenë statusin e mbrojtjes në nivel të Kosovës;
- Kontrollimi i gjendjes së monumenteve me status të mbrojtjes, në periudha të caktuara, që do të realizohen nga organet përgjegjëse të përcaktuara nga MKRS;
- Të bëhet digjitalizimi i të gjitha monumenteve me status të mbrojtjes.
- Mbrojtja, ruajtja dhe restaurimi i detajeve origjinale arkitektonike të objekteve të rëndësishme, që kontribuojnë në ngritjen e vlerave të trashëgimisë.

<sup>23</sup> PHK – Kaptina e Strategjisë dhe veprimeve për zbatim, f.176

These areas are divided into three groups by different specific features. Group I consists the areas borders of which are assigned by the maps. Group II includes areas that contain an area of 100 m of “buffer zone” from the perimeter of their yard; group III includes areas that have an area of 50 m of “buffer zone” from the perimeter of their yard.

For the areas in question there are certain criterias defining prohibited activities within such zones dealing mainly with: construction of industrial facilities, dams, power plants, bakeries, factories, transit roads in rural areas and construction related to deforestation or pollution of the environment of that area. According to same criterias there are limited activities defined, related mainly to the eventual construction of buildings higher than the monument to be protected, construction of roads, workshops, restaurants, hotels, nightclubs, fuel pumps, vehicle repair shops, supermarkets, public meetings and urbanization of agricultural land.

Penultimate and final chapter of the Spatial Plan presents actions and enforcement provisions that substantially recommend conservation and proper treatment of cultural heritage in Kosovo, stressing that urban/spatial planning should be utilized as an instrument for controlling developments in areas with cultural and historical value.

The document specifically recommends<sup>24</sup>:

Having perceiving the high degree of the risk from the continued degradation of urban sites, architectural, environmental and heritage monuments of the cities and specific areas, should determine the conservation and protection of cultural heritage as the main purpose of the principles for sustainable development.

In the perspective of continuous protection from degradation of cultural heritage enlisted are targets and actions to be undertaken:

- Inventory (database) of facilities and sites throughout the territory of Kosovo

- Inventory of facilities and sites should be undertaken by the criterias set by MCYS;
- Evaluation of the inventorized objects and sites and propose a list of new monuments, which shall coat them with the protection status in Kosovo level;
- Inspection of the protected monuments, in certain periods, that shall be implemented by the responsible bodies set by MCYS;
- Digitalization of all protected monuments;
- Protection, preservation and restoration of original architectural details of the important buildings, which contribute to the increase of heritage values.

---

<sup>24</sup> SPK – Chapter on the Strategy and actions for implementation, p.176

- Definimi i zonave historike me trashëgimi kulturore (TK)
  - Hartimi i planeve rregulluese për zonat me TK, planeve për konservim dhe menaxhim të zonave me trashëgimi kulturore;
  - Kontrollimi i zhvillimeve do të bëhet me anë të planeve rregulluese.
  - Ndërtimet moderne nuk duhet të kenë ndikime përçarëse, komerciale dhe uniforme, por ato duhet të inkorporohen, harmonizohen me të vjetrën dhe t'a pasurojnë edhe më shumë trashëgiminë kulturore;
- Vetëdijesimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore (TK)
  - Inkorporimi i TK dhe TN në planprogramet shkollorë;
  - Specializimi i kuadrove në sfera të caktuara për trashëgimi kulturore;
  - Aftësimi i ciceronëve për TK dhe TN në nivel lokal dhe qendror;
  - Shenjzërimi i të gjitha monumenteve dhe tërësive të mbrojtura të TK dhe TN;
  - Përgatitja e hartave, broshurave, fletëpalosjeve etj. për monumente dhe tërësi të TK dhe TN;
- Bashkëpunimi ndërshtetëror në sferën mbrojtjes së TK
  - Konkurrimi në fonde ndërkombëtare me projekte që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm në aspekt të mbrojtjes së TK;

- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (Konventa Evropiane mbi Peizazhet, Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike të Evropës – Konventa e Granadës 1985, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike – Valletta 1992, etj.)
- Bashkëpunimi ndër-institucional i nivelit qendror dhe lokal
  - Mbështetje nga ana e nivelit shtetëror mbi rëndësinë dhe rolin e TK, përmes politikave zhvillimore, që do të jenë bazë për arritjen e qëllimit tonë që është mbrojtja e TK nga degradimi i vazhdueshëm.
  - Realizimi i projekteve të përbashkëta duke i harmonizuar detyrat dhe obligimet që dalin nga institucionet e veçanta;
  - Respektimi i hierarkisë ndër-institucionale, gjithmonë me përmbushjen e kërkesave me qëllim të zhvillimit të planifikuar dhe të qëndrueshëm.
- Turizmi kulturor si faktor i zhvillimit ekonomik të vendit
  - Të bëhet përfshirja funksionale e këtyre zonave, mundësimi i qasjes së lirë të vizitorëve, preferohet të bëhet jetësimi i tyre, përmes ndërrim destinimit p.sh. restoran, shitore me punime artizanale, muze, galeri, ekspozita etj. pra, në funksion të zhvillimit të turizmit;
  - Ofrim i lehtësimeve të pronarëve të objekteve me TK, përmes stimulimeve në kontekst të mbrojtjes së TK dhe TN;

- Setup of historic areas of cultural heritage (CH)

- Development of regulatory plans for areas of CH, plans for conservation and administration of cultural heritage sites;
- Examination of developments shall be conducted by the regulatory plans.
- Modern buildings should not be of divisive, commercial and uniform in nature, but should be incorporated, matched with an old and enriching cultural heritage;

- Awareness and information on the role and importance of cultural heritage (CH)

- Incorporation of CH and NH in the school curricula;
- Staff specialty in certain areas of cultural heritage;
- Training of curators on CH and NH in both central and local level;
- Marking of all the protected monuments and sites of CH and NH;
- Preparation of maps, brochures, leaflets, etc, for monuments and sites of CH and NH;

- Interstate cooperation in the area of CH protection

- Competing for international funds with projects that enable sustainable development in terms of protection of CH;

- Ratification of international conventions (European Landscape Convention, Convention for the protection of the Archaeological Heritage of Europe-Granada Convention 1985, European Convention on Protection of the Archaeological Heritage – Valletta 1992, etj.)

- Interagency cooperation in central and local level

- Support from the central level on the importance and role of CH through policy development, which will be the basis for achieving our goal that is the protection of CH from continuous degradation.
- Implementation of joint projects by balancing the duties and obligations arising from specific institutions;
- Compliance of inter-institutional hierarchy, always meeting the requirements in order of a planned and sustainable development.


- Cultural tourism as part of economic development

- Setting a functional inclusion of these areas, enabling free access to visitors, preferably by vitalising those, for example, through shift on the purpose e.g. restaurant, craftwork shops, museums, galleries, exhibitions, etc, in view of the growth of tourism;
- Provide incentives to owners of buildings of CH, through encouragement in the context of protection of CH and NH;


Plani Hapësinor i Kosovës përfundon me kapitullin e dispozitave për zbatim<sup>25</sup>, që në fakt paraqesin rregullat dhe përgjegjësitë që duhet të ndikojnë në ruajtjen dhe trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Sipas këtyre rregullave duhet:

- Planifikimi urban/hapësinor duhet të shfrytëzohet si instrument për kontrollin e zhvillimeve në zona me vlera kulturo-historike;
- Duhet të bëhet trajtimi i zonave të definuara në të gjitha nivelet e planifikimit;
- Zbatimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe ligjeve tjera si: Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Ligji për Parkun Nacional "Mali Sharr", Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës etj;
- Në zonat me lokalitete arkeologjike, ndalohet çfarëdo ndërtimi;
- Në zonat historike të qyteteve duhet të kërkohet leje (edhe nga niveli qendror) për ndonjë ndryshim apo ndërtim në zona;
- Aplikimi i mekanizmave ligjorë, të koordinuar, me bashkëpunim dhe pjesëmarrje të koordinuar nga niveli qendror, përmes nivelit lokal të qeverisjes deri te qytetari i thjeshtë. Të bëhet kompletimi i inventarizimit (bazës së të dhënave) i të gjitha objekteve dhe tërësive me vlera në fushën e trashëgimisë kulturore, sipas standardeve europiane me qëllim të sigurimit të bazës për mbrojtje të TK;

Fig.12- Detaj nga harta kryesore e PHK-së  
Fig.12- A detail from the focal map of SPK



<sup>25</sup> PHK – Kaptina e dispozitave për zbatim, f.187



Spatial Plan of Kosovo ends with a chapter of provisions for enforcement<sup>26</sup>, which in fact speaks for the rules and responsibilities that should effect the conservation and proper treatment of cultural heritage in Kosovo. According to these rules should:

- Use urban/spatial planning as an instrument for inspection of developments in the areas of cultural and historical values;
- Administer defined areas at all planning levels;
- Implementation of the Law on Spatial Planning and other laws: the Law on Cultural Heritage, the Law on Special Protective Zones, Law on National Park "Sharr Mountain", the Law on Protection of Environment, Law on Nature Protection, etc.
- In areas with archeological sites any construction is prohibited;
- In historic zones of cities permits should be sought (from the central level, too) for any alteration or construction in such zones;
- Application of coordinated legal mechanisms, with centrally-coordinated cooperation and participation, from the local government level down to the citizen. Completion of the inventory (database) of all facilities and sites with cultural heritage values, according to European standards, in order to provide a basis for the protection of CH;

Fig.13 - Detaj nga harta kryesore e PHK-së  
 Fig.13 – A detail from the focal map of SPK

<sup>26</sup> SPK – Chapter of the Provisions for Implementation, p.187



- Të bëhet rivlerësimi i monumenteve të cilat kanë status të mbrojtjes dhe të kemi një raport mbi gjendjen e tyre sot;
- Të bëhet vlerësimi i objekteve dhe tërësive të TK të inventarizuara dhe plotësimi me monumente tjera me status të mbrojtjes për Kosovën;
- Restaurimi, rikonstruimi dhe revitalizimi i objekteve dhe monumenteve të Kosovës duhet të kryhet nga persona të kualifikuar në fusha të caktuara.
- Të definohen kjo të aktivitetet e lejuara të zonave të mbrojtura të TK;

Duke pasur parasysh nivelin e planit në aspektin e përmbajtjes dhe në aspektin e hierarkisë së planeve, mund të konstatojmë se, çështja e trashëgimisë kulturore në aspektin statistikor nuk është e trajtuar sa duhet. Arsye për këtë janë mungesa e të dhënave, kapacitetet e pamjaftueshme humane dhe vullneti politik për të trajtuar çështjen në mënyrën e duhur. Ndërsa sa i përket strategjisë dhe hapave për veprim konstatojmë se dokumenti ofron rekomandime të mjaftueshme për trajtimin të duhur të çështjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë.

- Revaluation of the monuments which hold the protective status thus obtain a report on their condition today;
- To assess the facilities and sites of inventoried CH and providing with other protected monuments of Kosovo;
- Restoration, reconstruction and revitalization of buildings and monuments in Kosovo should be performed by persons qualified in certain areas of specialties.
- Clearly define the activities allowed in protected areas of CH;

Given the level of the plan in terms of content and in terms of the hierarchy of plans, we can conclude that the issue of cultural heritage in statistical terms is not addressed sufficiently. Reasons for this include the lack of data, inadequate human capacities and political will to address the issue properly. As for the strategy and steps for taking we could deduce that the document offers sufficient recommendations to properly handling the issue of cultural heritage in Kosovo.

## PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANIFIKIM HAPËSINOR KOMUNAL

### KOMUNA E MITROVICËS

#### Historiku i shkurtër

Mitrovica është një prej vendbanimeve më të vjetra në Kosovë. Pozita strategjike dhe gjeografike në mes dy lumenjve të rëndësishëm, Ibrit e Sitnicës, si dhe motivet ekonomike kanë bërë që territori i Mitrovicës të popullohet qysh në parahistori. Prej kohës antike deri në mesjetë njihet si Albanik (*Monte Argentarum*), vend i pasur me argjend e plumb. Zhvillim të hovshëm Mitrovica përjetoi në shekullin e 19-të, pasi u zbuluan burime të mineraleve dhe xeheve, përderisa më vonë u shndërrua në qytetin më të zhvilluar industrial në Kosovë. Komuna e Mitrovicës gjendet në veri të Kosovës në një distancë afërsisht 40 km nga Prishtina, me një sipërfaqe prej 326 km katrorë dhe paraqet rreth 3.25 për qind të territorit të Kosovës. Komuna e Mitrovicës numëron 46 vendbanime. Shtrihet në shkallën 42. 53 shkallë të gjerësisë gjeografike veriore dhe në 25.52 shkallë të gjatësisë lindore. Lartësia mbidetare e Mitrovicës është 508 - 510 metra. Nga të dhënat që bazohen në regjistrimin e fundit zyrtar që është bërë në vitin 1981, mandej të dhënat nga Zyra Statistikore e Kosovës, regjistrimin e vitit 1991, 1998 etj, del se Komuna e Mitrovicës ka rreth 126,000 banorë, prej të cilëve 110,000 mijë jetojnë në jug të qytetit, ku pos shqiptarëve përfshihen edhe minoritetet tjera si boshnjakë, turq, romë dhe ashkali.



Fig.14 - Foto e vjetër e qytetit të Mitrovicës  
Fig.14 – Early photo of the town of Mitrovica

Në territorin e sotëm të trevës së Mitrovicës janë zbuluar disa gjurmë ndërtesash, një nekropol ilir, statuja të ndryshme prej balte e prej plumbi, një sarkofag, figura e Terpsikorës (Muzës së vallëzimit) etj. Me ardhjen e sllavëve në këto treva, harta toponomastike ndryshoi fytyrën rrënjësisht. Shumë emërtime të vjetra ilire-shqiptare u zëvendësuan me emërtime të reja sllave<sup>27</sup>.

<sup>27</sup> Teksti i shkëputur nga web faqja e Komunës së Mitrovicës

## INCLUSION OF CULTURAL HERITAGE IN MUNICIPAL SPATIAL PLANNING

### MUNICIPALITY OF MITROVICA

#### A brief history

Mitrovica is one of the earliest settlements in Kosovo. Strategic and geographic position between two major Ibrë and Sitnica rivers, and economic reasons have made the territory of Mitrovica populated since prehistoric ages. From ancient times until the Mediaeval was known as Albanik (*Monte Argentarum*), rich in silver and lead. Mitrovica experienced rapid development in 19<sup>th</sup> century, after being discovered the sources of minerals and ores, and later turned into the most developed industrial city in Kosovo. Municipality of Mitrovica is located in northern Kosovo at a distance approximately 40km from Prishtina, with an area of 326 square km and represents about 3.25 percent of the territory of Kosovo. Municipality of Mitrovica numbers 46 settlements. It lies on the 42.53 of north degree latitude and 25.52 degrees eastern of longitude. Altitude of Mitrovica is 508 to 510 meters. According the data extracted from the latest official census conducted in 1981, then the data from the Statistical Office of Kosovo, the census of 1991, 1998 etc. appears that Municipality of Mitrovica has about 126,000 inhabitants, of which 110,000 live in south of town, where among Albanians live other communities as Bosniaks, Turks, Roma and Ashkali.



Fig.14a - Foto e vjetër e qytetit të Mitrovicës  
Fig.14a – Early photo of the town of Mitrovica

In today's territory of Mitrovica some traces of buildings were found – an Illyrian necropolis, various clay and lead statuettes, a sarcophagus, the figure of Terpsikhore (Muse of dance), etc. With the arrival of Slavs in these regions, the toponomy map radically changed the appearance. Many old Illyrian-Albanian names were replaced with new Slavic designations<sup>28</sup>.

<sup>28</sup> Extract from the official website of Municipality of Mitrovica

## Lista e objekteve të TK-së nën mbrojtje<sup>29</sup>

Momentalisht ka një paqartësi lidhur me listën definitive të objekteve të TK nën mbrojtje. Informatat që i disponojmë rrjedhin prej disa burimeve, nga të cilat më të besueshmet janë listat që janë marrë nga MKRS (lista e pranuar më 11.04.2006), PZHK (2009) dhe dokumenti i punuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS, Dhjetor 2009), i cili është shfrytëzuar për prezantimin e mëposhtëm të detajuar të objekteve nga kjo listë.

Edhe pse historikisht në Mitrovicë kanë jetuar kultura të ndryshme të lashta, Mitrovica e sotme shpreh shumë pak nga kjo trashëgimi. Vetëm nëntë monumente janë marrë në mbrojtje që prej një gjysmë shekulli. Asnjë monument nuk ka fituar statusin e monumentit të mbrojtur që nga viti 1980. Monumentet e mbrojtura kanë filluar të rrënohen, ndërsa monumentet e inventarizuara, apo ato të pidentifikuara, së shpejti mund të humben tërësisht. Trashëgimia kulturore e Mitrovicës mbetet një çështje me gjemba, që mban mbi supë barrën e viteve të neglizhencës<sup>30</sup>.

Mitrovica ka nëntë monumente të mbrojtura:

1. Hamami i qytetit (Hamami i vjetër)
2. Kisha katolike Shën Pjetri (Kisha katolike e Sasve)
3. Xhamia me varre
4. Rrënojat e qytetit mesjetar të Trepçës
5. Gjyteti i Trepçës
6. Rrënojat e kompleksit mesjetar në sipërfaqen e Trepçës së vjetër
7. Shtëpia në rrugën Ilia Bircani (Shtëpia e Ehat Köroğlu)
8. Shtëpia e Bllagoje Gjorgjeviqit
9. Shtëpia në rrugën Zelengora (Konsullata Ruse)

<sup>29</sup> Të gjitha të dhënat lidhur me listën, fotot dhe historikun e objekteve janë shkëputur nga dokumenti i punuar nga IKS – Iniciativa Kosovare për Stabilitet e përkrahur nga Iniciativa për Reforma në Qeverisje Lokale dhe Shërbime Publike (LGI) – Dhjetor 2009. Burim i të dhënave është edhe MKRS dhe Plani Zhvillimor Komunal 2009-2025+ (harta e trashëgimisë kulturore).

<sup>30</sup> Nga dokumenti i punuar nga IKS – Iniciativa Kosovare për Stabilitet e përkrahur nga Iniciativa për Reforma në Qeverisje Lokale dhe Shërbime Publike (LGI) – Dhjetor 2009

Kjo listë e shkurtër në asnjë mënyrë nuk e përfaqëson denjësisht trashëgiminë e pasur të njerit nga vendbanimeve më të vjetra të Kosovës.

Në vjeshtën e vitit 2009, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është përpjekur të përcaktojë vendndodhjen e nëntë monumenteve të mbrojtura të Mitrovicës, për të parë nga afër gjendjen aktuale të tyre. Ky udhëtim nëpër Mitrovicë, përfshiu përpjekjet për të gjetur adresat e përcaktuara në listën zyrtare, të cilat nuk përkonin më me emrat e rrugëve. Ndërkohë që një nga monumentet e mbrojtura u gjet i shkatërruar tërësisht, të tjerat ishin në gjendje të mjerë, që dëshmohet nga materialet paraqitura në vijim.

## List of protected objects of CH<sup>31</sup>

Currently there is uncertainty regarding the definitive inventory of protected objects of CH. Information available derive from several sources of which the most reliable lists are those received from MCYS (the list received on 11/04/2006), MDP (2009) and from the document prepared from Kosovar Stability Initiative (IKS, December 2009) that is used for the following detailed presentation of the objects from this list. Although historically the home of various ancient cultures, today's Mitrovica divulges very little of its heritage. Only nine monuments received protective status in the last half century. Any other monuments have been granted protective status since 1980. The already protected monuments are falling apart and the other inventoried or unidentified monuments may soon be lost. Mitrovica's cultural heritage remains a thorny issue, carrying on its shoulders the weight of years of the neglect<sup>32</sup>.

There are nine protected monuments in Mitrovica:

1. The City Hammam (Old Hammam);
2. Catholic Church St. Peter (Shën Pjetri or Sasve);
3. The Mosque and Graves;
4. The Ruins of the medieval town of Trepça/Trepča;
5. Trepça City (Gjytet);
6. The Ruins of the Medieval Complex on the area of Old Trepça;
7. The House on Ilia Bircani Street (Ehat Köroğlu's house);
8. The House of Blagoje Djordjević;
9. The House on Zelengora Street (Russian Consulate);

This undersized list in no way represents the rich heritage of one of Kosovo's oldest settlements.

In fall of 2009, the Kosovar Stability Initiative (IKS) tried to locate nine protected monuments in Mitrovica in order to assess their condition. The journey through Mitrovica involved searching for addresses on the official list that no longer corresponded with the street names. Meanwhile it was found that one of the protected monuments had been completely destroyed. The others were in dreadful condition, as the following sections discuss.

---

<sup>31</sup> All information regarding the list, photos and history of the objects are extracted from a paper drafted from IKS - Kosovar Stability Initiative supported by the Initiative for Local Governance Reform and Public Utilities (LGI) - December 2009. Data source is also the MCYS and the Municipal Development Plan 2009-2025 + (map of cultural heritage).

<sup>32</sup> From a paper drafted from IKS - Kosovar Stability Initiative supported by the Initiative for Local Governance Reform and Public Utilities (LGI) - December 2009.


### **Hamami i qytetit (në mbrojtje në vitin 1957)**

Hamami i Mitrovicës daton nga shekulli XVIII. Dikur përbënte një pjesë esenciale të qendrës së qytetit të vjetër otoman. Sipas pronarëve të tij, hamami ishte ndërtuar nga Sulejman Pashë Berisha dhe nipi i tij Zejnullah Beg Berisha. Ndërtimi i kësaj banje me stil tipik oriental zgjati dy vite. Hamami ishte funksional deri në maj të vitit 1959. Disa muaj më pas, Muzeu dhe Arkivat e qytetit u vendosën brenda premisave të hamamit. Për gjysmë shekulli, Muzeu i Mitrovicës i vendosur në të ofronte një ekspozitë interesante të veglave nga epoka neolitike brenda kësaj banje të vjetër otomane. Kulmi i hamamit është riparuar kohëve të fundit, në maj të vitit 2009, nga UNESCO. Përveç problemeve me sistem të drenazhit, hamami është në përgjithësi në gjendje të mirë.

### **Kisha katolike Shën Pjetri (në mbrojtje në vitin 1958)**

Kisha katolike Shën Pjetri, e njohur gjithashtu si kisha Sase, daton nga shekulli XIII. Ajo ishte ndërtuar për minatorët saksonë dhe tregtarët katolikë që tregtonin në qytetin e Trepçës. Sot, rrënojat e saj gjenden në qytetin e vjetër të Stari Tërgut, i njohur gjithashtu si "Trepça Turke" për shkak të vendosjes së kolonëve turq nga shekulli XIV. Sot kësaj kisha i ka mbetur vetëm një mur. Themelet e kishës aludojnë për bukurinë dhe arkitekturën e dikurshme. Rreziku i degradimit të mëtejshëm të strukturës ekzistuese vlerësohet si lartë.

Fig.14b - Pamje nga Hamami i qytetit  
Fig.14b – Image of the city Hammam



### **The City Hammam (listed since 1957)**

The Hammam of Mitrovica dates back to the 18<sup>th</sup> century. It once formed an essential part of the old Ottoman city centre. According to the owners, the hammam was built by Sulejman Pashë Berisha and his nephew Zejnullah Beg Berisha. The construction of this typical oriental style public bathhouse lasted two years. The hammam operated until May 1959. A few months later the Museum and City Archives were situated inside the hammam. For half a century Museum of Mitrovica was located there, presenting an interesting exhibit of Neolithic era tools inside the old Ottoman bathhouse. The hammam's roof was restored in May 2009 by UNESCO. Except for problems with the drainage system, the hammam generally is in good condition.

### **Catholic Church St. Peter/Shën Pjetri (listed since 1958)**

The Roman Catholic Church Shën Pjetri (St. Peter), also known as Sase Church, dates back to 13<sup>th</sup> century. It was built for Saxon miners and catholic merchants trading in the city of Trepça. Today, its ruins are located in the town of Stari Tërg/Stari Trg, also referred to as the “Turkish Trepça” due to the settlement of the Turkish colony in the late 14<sup>th</sup> century. Only a single wall of the church remains. The foundations of the church allude to its once sizable architecture and beauty. Its existing structure is at risk of further degradation.

Fig.14c - Pamje nga Kisha katolike Shën Pjetri  
Fig.14c – Image of St. Peter Catholic Church







Fig.14d - Pamje nga rrënojat e Xhamisë në Mazhiq  
 Fig.14d –Ruins of the Mosque in Mazhiq

#### **Xhamia me varre (në mbrojtje në vitin 1966)**

Xhamia me varre me vendndodhje në fshatin Mazhiq është ndërtuar në shekullin XIV për komunitetin mysliman. Përreth saj gjenden shumë pak dëshmi të mbetura nga ndërtesat e tjera publike të kësaj periudhë, si hamami, premiset për karavane, shitoret, hanet dhe rrënojat e varrezave myslimane. Në xhami vërehen efektet e kohës; nuk ka mbetur asgjë përveç mureve gjysmë të rëna. Nuk ka asnjë gjurmë të minares apo kupolës së saj.

#### **Rrënojat e qytetit mesjetar të Trepçës (në mbrojtje në vitin 1966)**

Qyteti mesjetar i Trepçës daton nga shekujt XIII dhe XIV. Rrënojat e qytetit gjenden në vendndodhjen që sot njihet si fshati Vidishiq. Qyteti është zhvilluar me shpejtësi gjatë mesjetës nën pushtetin e Serbisë, me shfrytëzimin e minierave dhe me përpunimin e xeheve të argjendit, arit dhe çelikut. Kjo qendër e rëndësishme minerare dhe komerciale e Ballkanit zhvillonte marrëdhënie aktive tregtare me qytetet bregdetare përgjatë tërë Detit.

#### **Rrënojat e kompleksit mesjetar të Trepçës së vjetër (marrë në mbrojtje në vitin 1967)**

Kompleksi mesjetar i Trepçës së vjetër daton nga shekujt XIV-XVI. Besohet se Trepça është themeluar nga minatorët saksonë. Banjska Karta (1313–1316) dëshmon praninë e saksonëve në Trepçë. Në mesin e shekullit XIV, në Trepçë gjithashtu jetonin banorë sllavë dhe latinë.

#### **“Gjyteti i Trepçës” (në mbrojtje në vitin 1966)**

“Gjyteti i Trepçës” daton nga shekujt XIII dhe XIV. “Gjyteti” ishte ndërtuar pranë minierave, sipër lumit të Sremkovnicës. Ai shërbente si fortifikatë krahas atij të Zveçanit, duke mbrojtur kësaj vendbanimit pranë minierës në kohë të trazirave. “Gjyteti” nuk dihet të ketë pasur vendbanim. Fortifikata modeste duket të ketë luajtur ekskluzivisht rol strategjik. Një pjesë e vogël e kësaj fortifikate ndodhet pranë fshatit malor Rashan.

### **The Mosque with Graves (listed since 1966)**

The Mosque with Graves, located in the village of Mazhiq, was built in the 14<sup>th</sup> century for the local Muslim community. Very few evidences of other public buildings from that period surrounding it have remained, such as the foundations of the hammam, caravansary, shops, inns, and the ruins of Muslim graves. The mosque shows the signs of time; little remains but its half-standing walls. There is no trace of a minaret or cupola.

### **The Ruins of the Medieval City of Trepça (listed since 1966)**

The medieval city of Trepça dates back to the 13<sup>th</sup> and 14<sup>th</sup> century. The ruins of the city are located in what is known today as the village of Vidishiq/Vidišić. The city developed quickly during the Mediaeval under the state of Serbia due to mining and the processing of silver, gold, and lead ores. The important Balkan mining and commercial center entertained active trade relations with coastal towns along the Sea.

### **The Ruins of the Medieval Complex on Old Trepça (listed since 1967)**

The medieval complex of the Old Trepça dates back to the 14<sup>th</sup> to 16<sup>th</sup> centuries. It is believed that Trepça was founded by Saxon miners. The *Banjska Karta* (1313-1316) proves the presence of Saxons in Trepça. In the mid of 14<sup>th</sup> century Trepça was also home to Slavic and Latin inhabitants.

### **The City of Trepça (*Gjytet*) (listed since 1966)**

*"Gjytet"* dates back to the 13<sup>th</sup> and 14<sup>th</sup> centuries. *Gjytet* was built near the mines above the Sremkovnica river. It served as a fortification together with Zvečan/Zvečan fort, protecting the settlements near the mines in times of trouble. *Gjytet* was found to have no traces of any settlement. The modest fortification appears to have played exclusively a strategic role. Little remains of this fortification located near the mountainous village of Rashan.

Fig.14e - Pamje nga rrënojat e Xhamisë në Mazhiq  
Fig.14e – Image of the Mosque ruins in Mazhiq



### **Shtëpia e Köroğlu në rrugën Ilia Bircani (në mbrojtje vitin 1978)**

Shtëpia tradicionale e familjes Köroglu daton nga mesi i shekullit XIX. Ajo ndodhet pranë qendrës së qytetit të vjetër otoman në lagjen që tani njihet si "Kaçamak Mahalla". Kjo shtëpi tipike otomane është ndërtuar nga familja Köroglu para afro 200 vitesh. Për shkak të gjendjes jo të mirë, kjo shtëpi nuk përdoret më nga familja. Ergin Köroglu, ish-Zëvendësministër për Kulturë, Rini dhe Sport, është pronar i shtëpisë, ndërsa familja e tij jeton në ndërtesën fqinje. Shtëpia ka ruajtur strukturën origjinale por mund të mos mbijetojë edhe gjatë nëse nuk riparohet. Adresa e dhënë në listën e monumenteve të mbrojtura nuk korrespondon me emrin e ri të rrugës, i ndryshuar në Rruga Ferat Dragaj në vitet 1999 dhe 2000.

### **Shtëpia e Bllagoje Gjorgjeviqit (në mbrojtje në vitin 1980)**

Në vjeshtë të vitit 1941, në shtëpinë e Bllagoje Gjorgjeviqit u themelua Këshilli i Fondit Rajonal Nacionalçlirimtar, një institucion që grumbulloi mjete financiare dhe materiale për Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Bllagoje Gjorgjeviq, pronar i shtëpisë, udhëhiqte me këtë këshill. Bodrumi i shtëpisë shërbente si vendstrehim gjatë luftës nacionalçlirimtare. Gjorgjeviqi dhe i biri i tij u arrestuan nga Gestapo në vitin 1944. Pas luftës, kjo shtëpi u shndërrua në muze. Shtëpia është e vendosur në Mitrovicën e veriut.

### **Shtëpia në rrugën Zelengora (nën mbrojtje në vitin 1980)**

Ndërtesa e ish-Konsullatës Ruse në Mitrovicë daton nga fillimi i shekullit XX. Grigori Stepanovich Shcherbin, konsulli rus është vrarë në atë ndërtesë gjatë një revolte të më se 2.000 protestuesve shqiptarë që sulmuan garnizonin otoman. Shtëpisë i është vënë zjarri në vitin 1999. Është rrafshuar me tokë në vitin 2003. Kjo ndërtesë është dëmtuar përtej çdo mundësie për riparim.

Fig.14f – Pamje nga shtëpi tradicionale në Komunën e Mitrovicës  
Fig.14f – Traditional house in Mitrovica municipality



### **The Köroğlu House on Ilia Bircani Street (listed since 1978)**

The traditional house of the Köroglu family dates back to mid-19th century. It is located near the old Ottoman city center in what is locally known as the “Kaçamak Mahalla.” This typical Ottoman house was built by the Köroglu family approximately 200 years ago. Due to its poor conditions, the house is no longer used by the family. Ergin Köroglu, former Deputy Minister of Culture, Youth and Sports, owns the house and his family lives next door. The house still has its original structure, but may not survive much longer if not restored. The address on the List of Protected Sites does not correspond with the new street name, changed to Ferat Dragaj Street in 1999-2000.



### **The House of Blagoje Djordjević (listed since 1980)**

In the fall of 1941, the house of Blagoje Đorđević hosted the establishment of the Council of the Regional National Liberation Fund, an institution that collected financial and material means for the National Liberation Movement of Yugoslavia. Blagoje Đorđević, the owner of the house, headed this council. The basement of the house served as a shelter for activists during the national liberation war. Đorđević and his son were arrested by the Gestapo in 1944. After the war, the house became a museum. The house is located in north Mitrovica.

### **The House on Zelengora Street (listed since 1980)**

The building of the former Russian Consulate in Mitrovica dates back to the early 20<sup>th</sup> century. Grigori Stepanovich Shcherbin, the Russian Consul in Mitrovica, was shot there in 1903 during a revolt of more than 2,000 Albanian marchers who attacked the Ottoman garrison. The house was set afire in 1999 and any remains were razed in 2003. The building has been destroyed beyond repair.

## Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet komunale

Dokumenti i parë që merret me planifikim urban dhe hapësinor është “Plani Gjeneral Urbanistik i Mitrovicës së Kosovës” i vitit 1960, në të cilin sipas hulumtimeve të bëra – trashëgimia kulturore është anashkaluar tërësisht.

Aktualisht ky duhet të jetë edhe fillimi i keqtrajtimit dhe i zhdukjes graduale të të gjithë asaj që është e vjetër – në emër të rindërtimit të vendit. Sipas asaj që shihet në terren dhe në bazë të diskutimeve me qytetarët që janë dëshmitarë të kohës, një veprim i tillë ka ndodhë në të gjitha qendrat urbane të Kosovës. Dëshmi për këtë është, foto e mëposhtme që paraqet procesin e rrënimit të kompleksit të dyqaneve në Qytetin e Prishtinës.

Më tutje, në vitin 1988 është hartuar “Plani Hapësinor për Komunë e Mitrovicës së Titos” në të cilin vërehen hapat e parë në trajtimin e duhur të Trashëgimisë Kulturore. Duke nxjerrë si konstatim angazhimin e pamjaftueshëm për vite me radhë, dokumenti ofron rekomandime që kanë për qëllim përmirësimin e situatës sa i përket trashëgimisë kulturore në Komunë.

Sipas këtij dokumenti rekomandohet: themelimi i institucioneve komunale përkatëse që do të merren me TK; vazhdimi i punës në “rekognosimin” dhe hulumtimin sistematik të tyre; hartimi i dokumentacioneve teknike; vazhdimi i punës në konservimin dhe restaurimin e pasurisë monumentale; prezantimi i objekteve dhe gjendja e tyre teknike etj. Për arritjen e këtyre rekomandimeve propozohet që: njësisia e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve, të avancohet në Ent Regional për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore-Historike.

Ky institucion do të merrej kryesisht me ndalimin e keqtrajtimit të trashëgimisë kulturore siç janë: dëmtimi i zonave arkeologjike; rrënimi i objekteve të vjetra të banimit duke i përfshirë kullat dhe objektet tjera. E gjithë kjo sipas rekomandimeve në dokument, nuk mund të bëhet pa mbështetje të rregullt financiare.

Në Maj të vitit 1993, nga Enti Urbanistik i Vojvodinës është hartuar dokumenti: “Plani Hapësinor për Komunën e Mitrovicës së Kosovës”.

Fig.15 – Rrënimi i një pjese të vjetër të Qytetit të Prishtinës

Fig.15 – Pulling down of an old part of the city of Prishtina/Priština



## Inclusion of cultural heritage in respective municipal plans

The first document that deals with urban and spatial planning is “Urban General Plan of Mitrovica of Kosovo” of 1960, which according to research conducted - cultural heritage has been overlooked entirely.

Actually, this should be the beginning of the abuse and the gradual disappearance of all that is old - in the name of rebuilding the country. According to what is seen on the ground and based on discussions with people witnessing the time, such action is taking place in all urban areas of Kosovo. Evidence for this is the following picture showing the process of demolition of the complex of shops in the city of Prishtina.

Furthermore, in 1988 “Spatial Plan for the Municipality of Mitrovica e Titos” had been drafted, which set the first visible steps in the proper handling of cultural heritage. By concluding out insufficient commitment for years, the document offers recommendations aimed at improving the situation in terms of cultural heritage in the municipality.

According to this document it was recommended: the establishment of relevant municipal institutions that deal with CH; continuation of work on “recognising” and their systematic research; drafting of technical documentation; continuation of work on conservation and restoration of monumental resources, introduction of objects and their technical condition; etc. In achieving these recommendations it was proposed that: a unit of the Provincial Office for the Protection of Monuments be established as a Regional Office for Protection of Cultural-Historic Monuments.

This institution would deal mainly with the prevention of abuse of cultural heritage such as: damage to archaeological sites, demolition of old buildings including traditional towers (kulla) and other facilities. All this, according to the recommendations in the document, can not be accomplished without regular financial support.

In May of 1993, the Urban Institute of Vojvodina had drafted a document: “Spatial Plan for the Municipality of Mitrovica e Kosovës/Kosovska Mitrovica”.

Fig.16 - Plani Gjeneral Urbanistik, 1960.

Fig.16 – Urban General Plan, 1960.



Nga harta e prezantuar më sipër, edhe në këtë dokument vërehet përpjekja për trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore, edhe pse për nga aspekti i trajtimit të saj, dallon nga ai paraparak. Në dokumentin e ri (në “Librin e Parë”) përshkrimi i situatës përcillet edhe me rekomandime përkatëse të formës më tepër teknike.

Për “Qytetin e Trepçës” i njohur si lokalitet me emër “Gjyteti” – shkruhet se “i tërë kompleksi është i ndërtuar nga guri i thyer me suva të kualitetit shumë të dobët. Lokaliteti nuk është i hulumtuar prandaj është e domosdoshme të realizohen hulumtime arkeologjike-arkitektonike dhe të fillohet me punët e restaurimit<sup>33</sup>”. Në të njëjtën mënyrë vazhdohet edhe me objektet tjera nga lista e objekteve me status të mbrojtjes.


Në “Librin e Dytë” nga po i njëjti dokument, shihet një tendencë e shtuar në trajtimin e trashëgimisë kulturore. Sipas kësaj pjese të dokumentit, trashëgimia kulturore paraqitet si njëri nga problemet më komplekse, me të cilin duhet të merret institucioni përkatës për mbrojtjen e monumenteve të kulturës në Kosovë. Thelbi i problemit është shkatërrimi i vazhdueshëm i shumë objekteve, pa marrë parasysh nëse ato janë objekte të arkitekturës profane apo asaj sakrale. Sipas informatave të kohës, në komunë e Mitrovicës janë 16 monumente kulturore, që e kanë statusin e mbrojtjes dhe të cilat fatkeqësisht janë duke u shikuar si objekte të izoluara. Vihet në pah se deri atëherë, në shumë pak raste janë trajtuar vetëm vlerat e tyre arkitektonike, duke e përjashtuar në mënyrë sistematike trajtimin e këtyre vlerave në aspektin hapësinor.

<sup>33</sup> Plani Hapësinor për Komunën e Mitrovicës së Kosovës – 1993, Libri I parë

Duke ju referuar materialeve në këtë dokument, “rekognosimi” i fundit i kësaj zone është kryer në mesin e viteve të 70-ta, nga Enti i atëhershëm Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Më tutje dokumenti i referohet rekomandimeve që dalin nga Plani i atëhershëm Hapësinor i Republikës së Serbisë sipas të cilit, vihet në dukje “nevoja për mbrojtjen e monumenteve kulturore, duke rekomanduar që mbrojtja të fillojë nga monumenti më i vjetër dhe më me vlerë, për të vazhduar me monumentet e kohës më të re”.

Fig.16a - Foto të shkëputura nga dokumenti i vitit 1993.

Fig.16a –Photos extracted from the document of 1993



From the map presented above, this document attempts to observe proper handling of new cultural heritage, albeit in terms of its treatment, differs from the previous. In the new document (Book One) description of the situation is followed-up by appropriate recommendations on highly technical form.

For the City of Trepça known as the site named “Gjyteti” - states that “the entire multiplex is built from rugged stone with a plaster of a very poor quality. The site is not explored, so it is necessary to carry architectural-archaeological research and restoration works begin<sup>34</sup>.” In the same manner to continue with other objects enlisted in protective status.

Fig.16b – Photos extracted from the document of 1993.  
Fig.16b - Foto të shkëputura nga dokumenti i vitit 1993.



In the *Book Two* of the same document, it is noticeable an added tendency towards the administration of cultural heritage. According to this part of the document, cultural heritage is presented as one of the thorniest problems, which should be dealt by relevant institution for the protection of cultural monuments in Kosovo. The crux of the problem is constant destruction of many buildings, whether of being objects of profane or of sacral architecture. According to the information of the time, there are 16 cultural monuments in the Municipality of Mitrovica, which have the protected status and which, unfortunately, are being considered as isolated objects. It is noted that by then, in very few cases, those were treated only in their architectural values, systematically excluding addressing these values in spatial terms. Referring to the material of this document, the last “recognition” of this area was conducted in the mid-70s, by then Regional Office for the Protection of Cultural Monuments. Further, document refers to recommendations arising from the Spatial Plan of the Republic of Serbia where is emphasized “the need for protection of cultural monuments, recommending the start of the protection of oldest and most valuable monuments to continue with the monuments of the latter.”

<sup>34</sup> Spatial Plan for Municipality of Mitrovica e Kosovës – 1993, Book One



Theks i veçantë në këtë drejtim, duhet ti kushtohet mbrojtjes së trashëgimisë urbane dhe rurale, që përfaqësojnë qendrat e këtyre vendbanimeve<sup>35</sup>. Është me interes të theksohet se sipas rekomandimeve në dokument, mbrojtja nuk duhet ti dedikohet vetëm monumentit por edhe rrethit në të cilën ndodhet monumenti përkatës, në mënyrë që sa më shumë të jetë e mundur të ruhet autenticiteti i gjithë zonës. Për këtë, duhet të ekzistojnë mekanizma të qartë në mënyrë që pronat private të mund të zhvillohen në mënyrë të kontrolluar. Kjo nënkupton shërbime të organizuara, mjete të konsiderueshme financiare dhe dokumentacion të nevojshëm teknik. Një veprim i tillë, do të mundësonte ruajtjen e qëndrueshme të vlerave kulturore në Komunën e Mitrovicës, e cila mund të shërbejë edhe si model për komunat tjera në Kosovë.

#### **Cilat janë masat e propozuara në këtë dokument:**

Duke e theksuar rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen e sajë, dokumenti ofron këto masa mbrojtëse:

- Plani hapësinor i komunës duhet të jetë bazë për paracaktimin e veprimeve themelore në drejtim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore.
- Programi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore i Entit Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, duhet të jetë në harmoni me planet urbanistike dhe planet tjera që rrjedhin nga Plani Hapësinor I Komunës;

- Në territorin e komunës, sipas planit hapësinor, ekziston lista prej 16 monumenteve nën mbrojtje ligjore, për të cilat janë bërë hulumtimet e nevojshme.
- Është i domosdoshëm valorizimi dhe kategorizimi i të gjithë monumenteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore-historike, lokaliteteve të tyre dhe zonave të rëndësishme urbane dhe rurale;
- Të përshpejtohen dhe të përcaktohen veprimet për mbrojtjen e tyre ligjore;
- Të gjitha vlerat kulturore duhet të ruhen në formën e tyre burimore;

Më tutje, dokumenti vazhdon (duke potencuar mbrojtjen) me prezantimin e listave të monumenteve nga arkitektura sakrale, arkitekturës profane, monumentet etnologjike, monumentet turko-islame dhe monumentet e LNÇ-së.

Mirëpo, duke ju referuar gjendjes ekzistuese në terren, mund të konstatohet se përkundër përcaktimit të masave specifike për trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore të përshkruara më sipër, nuk ka pasur veprime konkrete për zbatim të tyre.

<sup>35</sup> Plani Hapësinor për Komunën e Mitrovicës së Kosovës – 1993, Libri I parë

Special emphasis in this regard should be given to protection of areas of urban and rural heritage, representing the centres of these settlements<sup>36</sup>. It is worth noting that under recommendations of the document; this protection must not only address the monument, but also the environment revolving the relevant monument, so to preserve as much as possible the authenticity of the entire area. As for this, there should be set clear mechanisms, so that private property can be developed in a controlled manner. This means, the organized services, substantial financial resources and necessary technical documentation. Such action would facilitate the sustainable preservation of cultural values in the Municipality of Mitrovica, which can be sought as a model for other municipalities in Kosovo.

**Course of actions proposed in this document:**

Stressing the importance of cultural heritage and its preservation, the document provides the following safeguards:

- Municipal spatial planning shall be the basis for the prearrangement of core actions for the preservation of cultural heritage.
- Program of cultural heritage protection of Provincial Office for the Protection of Monuments of Culture, should be in accord with urban plannings and other plans derived from the Municipal Spatial Plan (according to me, it is supposed to be the opposite);

- In the territory of the municipality, according to spatial planning, there is a list of 16 monuments under legal protection, for which the necessary researches were done.
- It is necessary to bring the assessment and classification of all important monuments of historical and cultural heritage, their locations and important urban and rural areas;
- To accelerate and determine actions for their legal protection;
- All the cultural values must be preserved in their original form;

In addition, the document continues (emphasizing protection) with the presentation of lists of monuments of sacral architecture, profane architecture, ethnological monuments, the Turkish-Islamic monuments and monuments of NLM.

However, referring to the existing situation on the ground it can be stated that, despite the specific measures for setting the appropriate treatment of cultural heritage described above, there were no concrete actions in implementing of many of them.

---

<sup>36</sup> Spatial Plan for Municipality of Mitrovica e Kosovës – 1993, Book Two

## Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) – Mitrovica 2009 – 2025+

Më 04.05.2009, me vendim të Kuvendit Komunal të Mitrovicës është miratuar Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban për Komunën e Mitrovicës. Për herë të parë Komuna e Mitrovicës aplikon metodën e re të planifikimit të bazuar në proces dhe veprim, e cila për nga përmbajtja por edhe metoda e hartimit dallon nga planet e vjetra, të orientuara vetëm në produkt. Plani është hartuar në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor, sipas të cilit duhet të respektohen të gjitha parimet që do të ndikojnë në veçanti në: rregullimin dhe shfrytëzim racional të hapësirës; në ruajtjen dhe mbrojtja e të mirave natyrore, kulturore, historike, arkeologjike; në mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e kushteve për zhvillim dhe ngritjen e kualitetit të jetës; dhe në zhvillim të qëndrueshëm në përgjithësi. Sipas shqyrtimeve dhe analizave që disponojmë në sektorin i planifikimit hapësinor në MMPH, procesi i hartimit të Planit Zhvillimor për Komunën e Mitrovicës, klasifikohet si njëri ndër proceset më të konsoliduar, i cili në përgjithësi në mënyrë të kënaqshme i ka përmbushur kërkesat që dalin nga rregullativa ligjore në fuqi dhe draft Plani Hapësinor i Kosovës. Edhe përkundër këtij fakti, sa i përket trashëgimisë kulturore, në raport me dokumentet paraprake komunale, ky dokument shkon një hap prapa. Në pjesën e parë të dokumentit në fjalë, bëhet një përshkrim i shkurtër i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunë, për të vazhduar me një konstatim të përgjithshëm sipas të cilit: "Në situatën e nderë politike, kultivimi dhe zhvillimi i mëtejshëm trashëgimisë kulturore paraqet një sfidë të madhe ...". E kemi përshtypjen se një konstatim i tillë, që nga fillimi i dokumentit përcakton jo-gatishmërinë dhe pasigurinë për tu ballafaquar me çështjen e TK në dokument.

Në vazhdim të dokumentit prezantohet lista e objekteve të inventarizuara për Komunën e Mitrovicës<sup>37</sup>. Sipas kësaj liste, në komunë ekzistojnë 89 objekte të inventarizuara, nga të cilat vetëm pesë (5) prej tyre e kanë statusin e mbrojtjes. Kjo e dhënë dallon nga harta e trashëgimisë kulturore e prezantuar në dokumentin e PZHK-së (e paraqitur më poshtë), sipas të cilës në komunë ekzistojnë nëntë (9) objekte me status të mbrojtjes. Këto informata dhe kjo paqartësi përcillet edhe në dokumentin e Planit Zhvillimor Urban (PZHU), i cili për nga niveli hierarkik i planifikimit nuk ofron synim, objektiva dhe rekomandime të qarta për trajtimin e trashëgimisë kulturore. Duke i pasur parasysh informatat e më sipërme dhe duke u bazuar në hulumtimin lidhur me përfshirjen dhe trajtimin e trashëgimisë kulturore në PZHK dhe PZHU të Komunës së Mitrovicës, konstatojmë se:

- përshkrimi i trashëgimisë kulturore është shumë i varfër dhe krijon huti në aspektin statistikor dhe përmbajtësor;
- nuk ka një kategorizim bazik të TK;
- nuk ka synim, objektiva dhe rekomandime të qarta për TK;
- ngritja e vetëdijes për TK dhe themelimin e muzeut historik, janë të vetmet kërkesa të parashtruara në pjesën e tretë të dokumentit (Korniza e Zhvillimit Hapësinor Komunal);
- dokumenti përfundon me Dispozitat për Zbatim, dhe me të vetmen masë shumë të përgjithësuar sipas të cilës – "masat për mbrojtjen e ... trashëgimisë kulturore – historike nënkuptojnë veprimet e duhura dhe me kohë të institucioneve relevante ndaj zhvillimeve të cilat mund të afektojnë ... tërësitë kulturore – historike".

<sup>37</sup> Informatë e marrë nga Qendra për Trashëgimi Kulturor - Mitrovicë

## **Municipal Development Plan (MDP) – Mitrovica 2009 – 2025+**

On 04.05.2009, the Municipal Assembly of Mitrovica approved with a decision a Municipal Development and Urban Plan for the Municipality of Mitrovica. For the first time Municipality of Mitrovica applies new method-based planning and action process, which in its content but also the newly adopted method of differs from the old, solely product-oriented plans. The plan is drafted according to the Law on Spatial Planning, under which must respect all the principles that will affect in particular: regulation and rational use of space; the preservation and protection of natural, cultural, historical and archaeological assets; protection of environment and providing conditions for development and improvement of the quality of life; and a sustainable development in general. According to the review and analysis available, in the MESP's division of spatial planning, the process of drafting the Development Plan for the Municipality of Mitrovica is classified as one of most consolidated processes, which generally has satisfactorily met the requirements arising from regulations in force and the draft Spatial Plan for Kosovo. Despite this fact, in terms of cultural heritage in relation to municipal previous documents, this paper goes a step back.

First part of the document in question contains a brief description of cultural and natural heritage in the municipality to continue with a general statement according to which: "In the tense political situation, nurture and further development of cultural heritage represents a challenge..." We have the impression that such conclusion, since the beginning of the document defines the non readiness and uncertainty in dealing with the issue of CH in the document.

Further the document envisages a list of inventoried facilities for the Municipality of Mitrovica<sup>38</sup>. According to the list, there are 89 objects inventoried in the municipality, of which only five (5) have been given protective status. This data differs from the map of cultural heritage presented in the MDP (described below), under which there are nine (9) objects with protective status in the municipality. This information and this ambiguity in the document forwarded to the Urban Development Plan (UDP), which as for the hierarchical level of planning does not provide goals, objectives and clear recommendations for the administration of cultural heritage. Given the information above and based on research related to inclusion and treatment of cultural heritage within MDP and UDP of the Municipality of Mitrovica, we find that:

- description of cultural heritage is very poor and creates confusion in statistical and substantial terms;
- there is no elementary categorization of CH;
- no goals, no objectives and clear recommendations for the administration of CH;
- awareness building for CH and establishing a history museum are the only requirements set out in the third part of the document (Municipal Spatial Development Framework);
- document concludes with Provisions for Implementation, and with just general provision under which – "actions for the protection of... cultural-historical heritage mean the appropriate and timely actions of relevant institutions towards developments that may affect... cultural – historical ensembles."

---

<sup>38</sup> Information taken from the Cultural Heritage Centre - Mitrovica

## Konkluzion

Rasti i Komunës së Mitrovicës paraqet një rast tipik ku pasqyrohet qartë kronologjia e zhvillimit të vetëdijes dhe qasjes ndaj trajtimit të trashëgimisë kulturore, si një çështje shumë të ndjeshme dhe me rëndësi jo vetëm për komunën e Mitrovicës, por edhe të shoqërisë kosovare në përgjithësi. Varësisht nga faza e zhvillimit politik dhe socio-ekonomik të vendit dhe komunës, ka ndryshuar dhe qasja dhe përkushtimi ndaj trajtimit të TK. Në planin e parë hapësinor të evidentuar (1960) për Komunën e Mitrovicës, tema e trashëgimisë kulturore nuk trajtohet fare. Sipas hulumtimeve<sup>39</sup> konstatojmë se, ky duhet të jetë edhe fillimi i shkatërrimit të trashëgimisë kulturore. Në emër të rindërtimit të vendit, janë rrënuar objekte dhe komplekse të tëra të trashëgimisë tonë kulturore.

Pas kësaj periudhe më të gjatë se njëzet vjeçare, fillon një etapë e re e planifikimit dhe zhvillimit komunal, në të cilën vërehet një tendencë pozitive në drejtim të ruajtjes dhe trajtimit adekuat të TK.

Në planin hapësinor komunal të vitit 1988, çështjes së trashëgimisë kulturore i është dhënë një hapësirë e konsiderueshme. Në veçanti, vërehet një përpjekje për prezantimin korrekt të të gjitha kategorive të trashëgimisë kulturore, për të cilat me të drejtë ofrohen rekomandime dhe masa për trajtim adekuat të cilave fatkeqësisht u mungon realizimi. Dhe së fundi, pas luftës së vitit 1999 autoritetet komunale fillojnë procesin e hartimit të dokumentit Plani Zhvillimor Komunal, i cili me pëlqim të MMPH-së aprovohet në vitin 2009. Për nga aspekti i trajtimit të trashëgimisë kulturore, fatkeqësisht ky dokument paraqet një hap prapa. Në dokument nuk ka një prezantim të qartë të gjendjes momentale të TK, nuk ka një synim të qartë dhe nuk ka as objektiva të matshme që do të duhej të mbështeteshin nga masa, rekomandime, projekte ose edhe aktivitete specifike, në drejtim të ruajtjes së TK në komunë. Një konstatim i tillë pa dyshim se është rezultat i shumë faktorëve, nga të cilët më me ndikim mund të jenë:

- mospërfshirja e ekspertëve të fushës në proces të planifikimit;
- mungesa e përgjithshme e ekspertëve të fushës së TK;
- mospërfillja dhe pasiguria për tu ballafaquar me TK;
- problemet e shumta zhvillimore komunale;
- prioritizimi i çështjeve;
- vullneti i pamjaftueshëm politik;
- mungesa e të dhënave;
- mosnjohja e problematikës;
- buxheti i pamjaftueshëm;
- paqartësia në vendimmarrje e sektorit të TK në përgjithësi;

<sup>39</sup> Konstatimi është rezultat i diskutimit me ekspertë të fushës si dhe përjetimit të qytetarëve të kohës.

## Conclusion

The case of Mitrovica represents a typical case where clearly is reflected the chronology of the increase of awareness and access to treatment of cultural heritage as a very sensitive and important issue not only for Mitrovica, but also for the Kosovar society. Depending on the stage of political and socio-economic development of the country and the municipality itself, also the approach and commitment to the treatment of CH has changed. In the first recorded spatial planning (1960) for the Municipality of Mitrovica, the topic of cultural heritage has not been treated at all. According to the research conducted<sup>40</sup> we could note that this is to be the beginning of the destruction of cultural heritage. On behalf of rebuilding the country entire objects and set of buildings of our cultural heritage were ruined.


After this period of more than twenty years, begins a new stage of planning and municipal development, within which there is a positive trend in terms of conservation and proper treatment of CH. In the municipal spatial plan of 1988, a considerable place was given to the issue of cultural heritage. In particular, there is an attempt of accurate presentation of all categories of cultural heritage, for which there were offered fair recommendations and measures for adequate treatment but, sadly, lacking the implementation.

And finally, after the war of 1999, municipal authorities began the process of drafting the document Municipal Development Plan, which having the consent of MESP, was approved in 2009. In terms of treatment of cultural heritage, unfortunately, this document represents a step backwards. In the document there is no clear presentation of the current situation of CH; there is no clear intention and has no measurable targets that should be supported by actions, recommendations, projects or even specific activities towards the preservation of CH of the municipality. Such a finding is undoubtedly the result of many factors, of which with the most impact would be:

- exclusion of experts from the planning process;
- overall lack of experts in the field of CH;
- disregard and uncertainty to deal with the issue of CH;
- numerous municipal development issues;
- the prioritization of issues;
- Insufficient political will;
- lack of data;
- unfamiliarity with the issue;
- insufficient budget;
- ambiguity in decision making in the field of CH, in general;

---

<sup>40</sup> Conclusion is the result of discussion with experts of the field and experience of the people at the time.





# PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL PLANI ZHVILLIMOR URBAN MITROVICË

## MONUMENTET KULTURORE TE MBROJTURA ME LIGJ

|      |           |                 |
|------|-----------|-----------------|
| 1927 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1928 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1929 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1930 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1931 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1932 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1933 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1934 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1935 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1936 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1937 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1938 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1939 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |
| 1940 | MITROVICË | KISHA E VARGJIT |

- \*\* KARAHISTORIA
- \*\*\* KANTIKA
- \*\*\*\* SHEKULLI I NESEMI (MESJETA)

## EVIDENTIMET E VLERAVE NATYRORE

- ZONA TE EVIDENTUARA
- BURIME UJORE
- TRUNGJET



Fig.17 - Harta e trashëgimisë kulturore në Komunën e Mitrovicës – shtrirja hapësinore e objekteve nën mbrojtje.  
Fig.17 - Map of cultural heritage in the municipality of Mitrovica – spatial layout of facilities under protection.



## KOMUNA EVUSHTRRISË

### Trashëgimia Kulturore në Komunën e Vushtrrisë

#### Historiku i shkurtër

Territori i komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës, në mes të këtyre koordinatave gjeografike: X1 : 200 50' 09" dhe X2 : 210 07' 05", Y1 : 420 42' 20" dhe Y2 : 420 55' 12". Ai shtrihet në një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup> dhe zë afër 3.2% të territorit të Republikës së Kosovës.

Vushtrria ose Vicianumi siç është quajtur përpara sipas emrit të vjetër ilir, është lokalitet antik, që daton qysh para Perandorisë Romake, përkatësisht që nga koha e dardanëve. Viciania në fund të shekullit I para epokës së re pushtohet nga Perandoria Romake. Pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, Viciania mbeti në kuadër të Bizantit. Në shekullin XIV Perandoria Osmane filloi ta pushtojë Ballkanin. Në Vushtrri prezenca e osmanëve së pari shënohet në vitin 1439. Deri në fillim të shekullit XX Vushtrria ishte nën Perandorinë Osmane. Gjatë Luftës së Parë Botërore, përkatësisht gjatë viteve 1915 – 1918, Vushtrria u pushtua nga Austro-Hungaria. Në Luftën II Botërore (1941-1945) Vushtrria me rrethinë i takonte zonës së pushtuar nga gjermanët. Në nëntor 1944, në Vushtrri u vendos administrata komuniste jugosllave. Në qershor të vitit 1999 forcat serbe u dëbuan nga Kosova dhe aty u vendos administrata e OKB. Më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës e shpallë Kosovën shtet të pavarur.

Sipas regjistrimit të popullsisë më 1981 në territorin e komunës së Vushtrrisë jetonin 65419 banorë (vetëm në qytet 20176), kurse tani vlerësohet se jetojnë përafërsisht 105000 banorë në 67 vendbanime. Prej këtyre 92% janë shqiptarë, 4% serb, 3% malazez dhe 1% turq, ashkalinj etj.

## Monumentet e trashëgimisë arkitekturale dhe mbetjet arkeologjike

Në komunën e Vushtrrisë monumentet kulturo-historike janë të shumta dhe të llojllojshme. Ato e argumentojnë lashtësinë e këtij qyteti. Vushtrria konsiderohet ndër qytetet më të vjetra në Kosovë, por edhe në Ballkan. Është lokacion antik, mesjetar dhe bashkëkohor që gjatë historisë së tij ka luajtur rol me rëndësi të madhe në pikëpamje ekonomike, kulturore dhe qytetëruese. Popullsia e tij ka kaluar nëpër kultura të ndryshme, si pasojë e sundimeve nga romakët, turqit, sllavët etj. Gjatë periudhave të ndryshme kohore sunduesit kanë lënë vulën kulturore të tyre, përveç tjerash edhe duke ndërtuar objekte të ndryshme (xhami, kisha, kulla, ura, hamame etj.). Pra, përveç lashtësisë, Vushtrria është e njohur për trashëgiminë e begatshme kulturore dhe historike. Objektet e lashta kulturore dhe historike gjenden kryesisht në qytetin e Vushtrrisë dhe në disa fshatra afër tij. Këto objekte kanë rëndësi të madhe sepse tregojnë të kaluarën e këtyre vendbanimeve, duke përfshirë: mënyrën e jetesës, kulturën, besimet fetare, sundimet e huaja etj.

## MUNICIPALITY OF VUSHTRRI/VUČITRN

### Cultural Heritage in the Municipality of Vushtrri/Vučitrn

#### A brief history

The territory of the Municipality of Vushtrri/Vučitrn is located in the northern part of Kosovo, between the geographical coordinates: X1: 200 50' 09" and X2: 210 07' 05", Y1: 420 42' 20" and Y2: 420 55' 12". It expands in an area of 345 km<sup>2</sup> and occupies close to 3.2% of the territory of the Republic of Kosovo.

Vushtrri/Vučitrn or *Vicianum*, as called before by its old Illyrian name, is the ancient location dating since before the Roman Empire, from the time of Dardania. Viciania, at the end of century I BC was occupied by the Roman Empire. After the fall of the Roman Empire, Viciania remained under Byzantium. In XIV century the Ottoman Empire began conquering the Balkans. The presence of the Ottomans in Vushtrri/Vučitrn is first recorded in 1439. By the early of XX century Vushtrri was under the Ottoman rule. During World War I, respectively during 1915 - 1918, Vushtrri/Vučitrn was administered by Austro-Hungary. In World War II (1941-1945) Vushtrri/Vučitrn with the surrounding came under German occupation. In November 1944, the Yugoslav Communist administration was established in Vushtrri/Vučitrn. In June 1999, Serb forces were driven out from Kosovo and then the UN administration steps in. On February 17, 2008, Assembly of Kosovo declares Kosovo an independent state.

According to the census of 1981, in the territory of the Vushtrri/Vučitrn Municipality were 65,419 inhabitants (20,176 only in town), while with today's estimation there are approximately 105,000 inhabitants living in 67 settlements. Of these 92% are Albanians, 4% of Serbian, 3% Montenegrins and 1% Turks, Ashkali, etc.

## Monuments of architectural heritage and archaeological remnants

In the municipality of Vushtrri/Vučitrn historic and cultural monuments are numerous and kind-diverse. Those point out the antiquity of this city. Vushtrri/Vučitrn is considered among the oldest cities in Kosovo, but also in the Balkans. It is an ancient, medieval and contemporary location that in its history has played a role of great importance in economic, cultural and civilizational viewpoint. Its population has gone through different cultures, as a result of occupation by Romans, Turks, Slavs, etc. During different periods of time rulers have left their cultural stamp, among other also by building various facilities (mosques, churches, house towers, bridges, hammams etc.). So, in addition to that, except the ancientness, Vushtrri/Vučitrn is known for rich cultural heritage, historical and archeological sites. Ancient cultural and historical sites are mostly located in Vushtrri/Vučitrn and several villages close to it. These items have great importance because they document the past of these settlements, including: lifestyle, culture, religious beliefs, foreign reigns, etc.

**Tab.1 - Lista e monumenteve me status të mbrojtjes**

| KOMUNA E VUSHTRRIË - Monumentet me status të mbrojtjes |     |  |                   |                  |
|--|-----|--|-------------------|------------------|
|  | Nr. | Objekti / tërësia  | Vendbani mi       | Viti i shpalljes |
| Monumente arkeologjike                                 | 1   | Muret e quajtura "Kalaja e vjetër", shek.XIV                         | Vushtrri          | 1949             |
|  | 2   | Mbeturinat mesjetare të Kompleksit në kodrën Çeçan, shek.V-VI        | Budisalc          | 1970             |
|  | 3   | Mbeturinat e lokalitetit antik në potezin "Ligata" shek.III-IV       | Stanovc i Poshtëm | 1971             |
|  | 4   | Lokalitet arkeologjik "Selishte - Çerminiç", Parahistori dhe antikë  | Banjicë           |                  |
|  | 5   | Lokalitet arkeologjik "Gornji Jorgovan", shek.X-XV                   | Novosellë         |                  |
|  | 6   | "Qyteza", shek.II-XIV,   | Samadrexhë        |                  |
|  | 7   | "Qytezë", Parahistori antike dhe mesjetë                             | Strovc            | 1988             |
|  | 8   | Lokalitet arkeologjik në potezin "Selishte" - te shtëpia, shek.II-VI | Vërnice           |                  |
| Mon. kulti ortodokse dhe katolike                      | 9   | Kisha Samadrexhë - Kisha e Shën Llazarit, hek.XIV, e renovuar 1932   | Samadrexhë        | 1964             |
|  | 10  | Mbeturinat e kishës së Shën e Premtes, shek.XVI                      | Gojbulë           | 1965             |
| M. kulti mus-lim.                                      | 11  | Xhamia e Gazi Ali Begut, 1444  | Vushtrri          | 1966             |
| Ndërtime popullore banimi                              | 12  | Shtëpia e Badivukut, rr.B.Kidric nr.62-64, shek.XIX                  | Vushtrri          |                  |
|  | 13  | Shtëpia. rr.B.Kidric nr.46. shek.XIX                                 | Vushtrri          |                  |
|  | 14  | Shtëpia e Qamilit, rr.Maçvës nr.33, shek.XIX                         | Vushtrri          |                  |
| Nd. popullore shoqërore                                | 15  | Ura e vjetër e gurit, shek.XIV-XVI,                                  | Vushtrri          |                  |
|  | 16  | Ndërtesa e Hamamit të vjetër, shek.XV                                | Vushtrri          | 1968             |

**Tab.1 – The list of protected monuments**

| MUNICIPALITY OF VUSHTRRI/VUÇITRN – Protected monuments |     |   |                   |                      |
|--|-----|---|-------------------|----------------------|
|  | No. | Object / ensemble   | Settlement        | Year of announcement |
| Archaeological monuments                               | 1   | Ruins of "Kalaja e vjetër" (Old Castle), XIV century                              | Vushtrri          | 1949                 |
|  | 2   | Ruins of Medieval Complex in the hill of Çeçan, V-VI century                      | Budisalc          | 1970                 |
|  | 3   | The ruins of ancient site in "Ligata" III-IV century                              | Stanovc i Poshtëm | 1971                 |
|  | 4   | Archaeological location "Selishte - Çerminiç", prehistoric and ancient            | Banjica           |                      |
|  | 5   | Archaeological location "Gornji Jorgovan", X-XV century                           | Novosella         |                      |
|  | 6   | "Qyteza" (settlement), II-XIV century   | Samadrexha        |                      |
|  | 7   | "Qytezë", (settlement) Prehistoric, ancient and medieval                          | Strovc            | 1988                 |
|  | 8   | Archaeological location in "Selishte" - te shtëpia, II-VI century                 | Vërnica           |                      |
| Orthodox and Catholic mons.                            | 9   | Samadrexha Church – The Church of St. Lazarus, XIV century, reconstructed in 1932 | Samadrexha        | 1964                 |
|  | 10  | Remains of the St. Friday's Church, XVI century                                   | Gojbula           | 1965                 |
| Muslim Monuments                                       | 11  | Gazi Ali-Bey's Mosque, 1444   | Vushtrri          | 1966                 |
| Vernacular dwelling buildings                          | 12  | House of Badivuku, B.Kidric Str. nr.62-64, XIX century                            | Vushtrri          |                      |
|  | 13  | Shtëpia (House). B.Kidric Str. nr.46. XIX century                                 | Vushtrri          |                      |
|  | 14  | Qamil's House, Maçva Str. nr.33, XIX century                                      | Vushtrri          |                      |
| Vernacular social buildings                            | 15  | Old Stone bridge, XIV-XVI century   | Vushtrri          |                      |
|  | 16  | The building of old Hammam, XV century  | Vushtrri          | 1968                 |

## Kalaja e Vjetër

Objekti gjendet në qendër të qytetit të Vushtrrisë. Historianët shqiptarë si Dr. Skënder Riza, Dr. Jahja Drançolli dhe të tjerë thonë se kalaja është ndërtuar në kohën antike iliro-dardane. Mr. Izet Miftari thekson në mënyrë eksplicite se kalaja është ndërtuar në shekullin e shtatë (VII) nga perandori bizantin me prejardhje faraoni, Justinijani i parë (I). Konstatimin e tyre e mbështet sidomos ekzistenca e themeleve të vjetra mbi të cilët është rindërtuar kalaja. Ismet Bylykëmini, një ekspert i njohur i trashëgimisë historike nga Vushtrria, me vendbanim në Turqi tregon se themelet e vjetra ishin zbuluar në vitin 1981 kur po punohej për restaurimin e kalasë. Atë vit z. Bylykëmini ishte anëtar i ekspeditës hulumtuese. Siç pohohet në një shkrim të profesor Hilmi Saraçi me titull „Lashtësia, emërtimi dhe trashëgimia kulturore, historike, arkeologjike e qytetit të Vushtrrisë”, dëshmi tjetër për autorësinë ilirodardane të kalasë, deri vonë ka qenë ekzistenca e disa gurëve çift piramidale me mbishkrime të kohës së ilirëve, por fatkeqësisht këta gurë nuk janë më. Kalaja ishte shkatërruar dhe rindërtuar në mesjetë. Udhëpërshkruesi i njohur turk Evlia Çelebia që ka jetuar në shekullin e XVII, kur e kishte përmendur Vushtrrinë kishte thënë: „Pasi e kishte pushtuar Vushtrrinë, sulltan Murati i parë e kishte shkatërruar kalanë, mirëpo ajo u rindërtua disa herë dhe ka mbijetuar deri më sot...”

Në kohën antike kalaja kishte shërbyer si strehimore për pushimin e karvaneve tregtare. Gjatë sundimit osman, një kohë kishte shërbyer edhe si burg, pastaj depo armësh e sipas nevojës ishte përdorur edhe për qëllime të tjera.

Fig.17a – Kalaja në të shkuarën

Fig.17a – Fortress before



## Old Fortress

The facility is located in the center of Vushtrri/Vučitrn. Albanian historians like Dr. Skender Riza, Dr. Jahja Drançolli and others say the fortress was built during the early illyro-dardanian period. Mr. Izet Miftari explicitly states that the fortress was built in the seventh century (VII) by a Byzantine emperor, pharaoh descendant, *Justinijan I*. Their findings are supported on the existence of old foundations on which the fortress was rebuilt. Ismet Bylykemi, a prominent expert of historic heritage of Vushtrri/Vučitrn, living in Turkey, explains that the old foundations were discovered in 1981 when conducting works for restoration of the fortress. That year Mr. Bylykemi was a member of the research expedition. As stated in a paper of Professor Hilmi Saraçi titled "Ancientness, designation and cultural, historical and archaeological heritage of city of Vushtrri", further evidence for the illyro-dardanian authorship of the fort, until recently has been the existence of some cone-shaped twin stones, with inscriptions from the Illyrian era, but unfortunately these stones are not there anymore. The Fortress was destroyed and rebuilt again in Medieval. Turkish traveller Evliya Çelebia, who lived in the XVII century, when mentioning Vushtrri, noted: "Once he had conquered Vushtrri, Sultan Murad the First had destroyed the fortress, but it was rebuilt several times and has survived until today..."

In ancient times fortress had been served as a shelter for the rest of trading caravans. During Ottoman rule, for a time it also served as a prison, then as an arms depot, and due to necessity was also used for other purposes.

Fig.17b – Kalaja sot

Fig.17b – Fortres today



Kalaja e Vjetër është ndërtuar nga gurët e lidhur me gëlqere të shuar. Sipërfaqja e kalasë është 1.100 metra katrorë. Ajo e ka përgun me sipërfaqe afër 100 metra katrorë. Muret e kalasë janë të larta 10- 12 metra, kurse trashësia e tyre është 3 - 4 metra. Dikur kalaja kishte gypat e kanalizimit. Gjatë gërmimit janë gjetur gypa me diametër afër 40 cm. Brenda kalasë gjendet një zgafellë që sipas legjendës në rast rreziku do të shërbente për të dalur në lumin Sitnicë.

### **Ura e Vjetër e Gurit**

Ura e Vjetër e Gurit gjendet në pjesën veriperëndimore të qytetit të Vushtrrisë, në rrugën e vjetër Prishtinë-Mitrovicë. Kjo urë është një ndër urat më të vjetra të ndërtuara në Kosovë. Një grup i autorëve serb në librin „Kosova, dikur dhe sot” të botuar në Beograd më 1973 thonë se urën e ndërtuar në shekullin XIV feudalët Vujanoviq duke pretenduar kështu se kjo urë i përket trashëgimisë kulturore të serbëve, mirëpo njëkohësisht autorët e pranojnë se janë mbështetur vetëm në gojëdhënat e popullit. Në librin tjetër „Historia e popujve të Jugosllavisë” („Istorija Naroda Jugosllavije”) të shkruar nga autorë serb, kjo urë paraqitet si urë turke pra e ndërtuar nga turqit menjëherë pas ardhjes së tyre si pushtues në Vushtrri. Sipas Bedri Xhemës, drejtor i Muzeut Historik dhe Etnografik të Vushtrrisë, disa studiues serb e pranojnë se pesë harqet e Urës së Vjetër të Gurit janë ndërtuar shumë përpara shekullit XIV. Kjo lë të kuptohet se ura origjinale pra nuk është ndërtuar as nga turqit. Bedri Xhema thotë poashtu se në bazamentin e urës ka qenë një pllakë me mbishkrim me shkronja latine, të cilën e kishin gdhendur (fshirë) disa studiues serbë nga Beogradi, në kohën e ish-Jugosllavisë gjatë një vizite të bërë nga ata me qëllim që t’ia humbin urës identitetin e saj të vërtetë.

Fig.17c – Ura e Vjetër e Gurit në të shkuarën  
Fig.17c – The Old Stone Bridge before



The Old Fortress was built from the stones joint with slaked lime. The fortress area is 1,100 square meters. It has a tower in an area about 100 square meters. Walls of fortress arise from 10 to 12 meters and 3 to 4 meters thick. Once, the fortress had sewage pipes. During excavations pipes of about 40 cm in diameter were found. Inside the fort is a vault, which, according to legend, in case of danger would serve to walk out to the Sitnica River.

### **The Old Stone Bridge**

The Old Stone Bridge is located in north-western part of Vushtrri, along Prishtina-Mitrovica old route. This bridge is one of the oldest bridges built in Kosovo. A group of Serbian authors in the book "Kosovo, the Past and Present", published in Belgrade in 1973, say the bridge was built in XIV century by noble Vujanović family thus claiming the bridge belongs to Serbian cultural heritage, but both authors acknowledge that they've supported claims only on the legends told. In another book of Serbian authors "The History of People of Yugoslavia" ("Istorija Naroda Jugoslavije"), this bridge is acknowledged as Turkish bridge built by the Turks just after their seizure of Vushtrri/Vučitrn. According to Bedri Xhema, head of History and Ethnography Museum in Vushtrri/Vučitrn, some Serb scholars acknowledge that the five arches of the old Stone Bridge were built long before the fourteenth century. This implies, therefore, that the original bridge was not built either by the Turks. Bedri Xhema also says that on the foundations of the bridge there was a Latin inscription plaque, which was sculpted (erased) by researchers of Serbian nationality from Belgrade, at the time of former Yugoslavia during a visit made in order to wipe away the bridge's true identity.

Fig.17d – Ura e Vjetëre Gurit sot  
Fig.17d – The old Stone Bridge today





Në dokumentin e vitit 2009 të planit zhvillimor komunal të komunës së Vushtrrisë thuhet se pesë harqet e mesme të urës janë iliro-romake, ndërsa ato anësore janë të kohës osmane, të punuara nga mjeshtrit shqiptarë. Sipas Mr. Izet Miftarit kjo urë i takon periudhës së antikitetit, përkatësisht periudhës romake dhe është ndërtuar në shekullin e dytë (II), në kohën kur është ndërtuar rruga – Mintiminicium (Mitrovicë). Në shkrimin me titull „Lashtësia, emërtimi dhe trashëgimia kulturore, historike, arkeologjike e qytetit të Vushtrrisë” të profesor Hilmi Saraçit thuhet se ura është ndërtuar në shekullin e V p.e.r. në kohën e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe përforsimit të shteteve të atëhershme ilire, si Lidhja e Mollosëve, Mbretëria Taulante dhe në pjesën kontinentale Mbretëria Dardane ku edhe gjendet ura.

Ura e Vjetër e Gurit i ka 9 harqe, është e gjatë 135 m dhe e gjerë 6 m. Teknika e ndërtimit të kësaj ure ishte e përsosur. Qemerët ishin të ndërtuar me blloqe gurësh dy ngjyrësh kuq e bardh, fugat ndërmjet gurëve janë të lidhura me plumb të shkrirë. Gurët e urës janë të gjatë një meter dhe të trashë 40 cm. Janë të gdhendur mirë dhe të murosur në rende paralele. Parapeti i urës është i lartë 90cm dhe i gjerë 60cm dhe është realizuar me blloqe guri që fiksohen në taban me kunjja metalike, ngulur në plumb të shkrirë.

### **Hamami i Vushtrrisë**

Për hamamin e vjetër të Vushtrrisë, nga disa studjues serb thuhet se ka qenë kishë ortodokse, kurse Branisllav Nushiq në veprën e tij “Kosovo” e kishte pranuar se hamami nuk ka qenë kurrë kishë ortodokse. Ai pohon se edhe nëse ka qenë kishë, ajo ka qenë kishë katolike.

Fig.17e – Hamami i Vushtrrisë në të shkuarën  
Fig.17e – Hammam of Vushtrri/Vučitrn before



In the 2009 document of the Municipal Development Plan of Vushtrri/Vučitrn Municipality it is mentioned that five waist arches of the bridge are Illyrian-Roman, while those on the fringe belong to Ottoman-era built by the Albanian craftsmen. According to Mr. Izet Miftari, this bridge belongs to the period of antiquity, namely the Roman period, and it was built in the II century, during the pavement of Mintiminicium (Mitrovica) route. In the article titled "Ancientness, designation, cultural, historical and archaeological heritage of the city of Vushtrri" of Professor Hilmi Saraçi, this bridge was built in V century AD at the time of social and economic growth and the strengthening of the Illyrian states at the time, as the Molos League, Kingdom of Taulantii and in the mainland of Dardanii Kingdom where the bridge is located.

Old Stone Bridge has nine arches, over 135 m long and 6 m wide. The technique of building of this bridge was considered perfect. Arches were constructed from shaped stones, red and white in colour, merged with molten lead. The stones on the bridge are over a meter long and 40cm thick. Those are well carved and parallelly immured. Bridge's parapet is 90 cm in height and 60 cm wide and constructed with stone blocks fixed in the pan with metal pins, inserted in molten lead.

### **Hammam of Vushtrri/Vučitrn**

As for the old Hammam of Vushtrri, some Serbian nationality scholars claimed it as Orthodox Church, while Branislav Nušić in his book "Kosovo" had admitted that Hammam has never been an Orthodox Church. He argues that even if being a church, it definitely was a Catholic Church.

Fig.17f – Hamami i Vushtrrisë sot

Fig.17f – Hammam of Vushtrri/Vučitrn today



Sipas Nesim Ispahiut poet dhe fotografist i njohur në Vushtrri, Hamami i Vushtrrisë është ndërtuar nga turqit (shekulli XIV-XV), pra i takon periudhes osmane. Hamami sipas traditës është ndërtuar edhe me toalet të veçantë brenda tij, ndërsa kishat nuk posedojnë një gjë të tillë brenda tyre. Kjo, sipas Ispahiut, e demanton pohimet se hamami dikur ka qenë kishë katolike apo ortodokse. Duke iu referuar, siç thotë ai, burimeve të literaturës historike, Hilmi Saraçi në shkrimin e tij „Lashtësia, emërtimi dhe trashëgimia kulturore, historike, arkeologjike e qytetit të Vushtrrisë” thot se hamami është ndërtuar në shekullin e XV në kohën kur është ndërtuar edhe Xhamia e Gazi Ali Beut. Gazi Ali Beu në atë kohë ishte sundimtar dhe kishte urdhëruar të ndërtohet kjo banjo publike.

Banjoja publike (hamami) është e ndërtuar me gurë të butë e të bardhë. Pullazi është me formë të kupollës. Pjesa më e hershme e hamamit është përdhësë me tri kupolla të ulëta. Këtu ndodhen hapësira e ndërmjetme, dy hapësira të larjes dhe depozita e ujit. Në pjesën lindore të banjës është tertorja për tharjen e rrobave dhe tualeti. Dyshemeja është shtruar me gurë mermeri të bardhë. Kazani për nxjerrjen e ujit gjendet në pjesën lindore të banjës. Ky vend quhet “qullan”. Uji nxehet me dru. Në kupollat sipër hamamit gjenden vrima të vogla në formë të rrethit, të mbuluara me qelq, të cilat kanë shërbyer për ndriçimin e lokaleve të brendshme me anë të rrezeve të diellit.

### **Xhamia e Gazi Ali Beut**

Xhamia e Gazi Ali Beut u ndërtua në vitin 1444. Në luftën e fundit (1999), një granatë e forcave serbe e hodhi në ajër minaren e saj. Në vitin 2002 minarja u rindërtua dhe xhamia u renovua, por fatkeqësisht nuk u kthye në gjendjen siq ka qenë më parë. U ndërtua një minare krejtësisht tjetër nga ajo e para, pastaj aneksi në hyrje dhe u larguan disa gurë të varrezave nga oborri, pra u shtrembërua pamja origjinale e xhamisë.

### **Xhamia e Çarshisë**

Xhamia e Çarshisë u ndërtua në vitin 1761. Më 27 mars 1999, xhamia u dogj tërësisht nga forcat serbe. Sot ajo është e rindërtuar. Duke u bazuar në fototekën e arkivuar shihet se etazhiteti i xhamisë ka qenë p+1, me planimetri katërkëndore dhe e mbuluar me kulm katërfaqësor. Në anën e majtë dhe të djathtë të derës hyrëse të xhamisë ishin shkallët njëkrahëshe të cilat kishin pikë takimi doksatin që ishte i dalur jashtë në katin e sipërm.

According to Nesim Ispahiu, known poet and photographer in Vushtrri/Vučitrn, the hamam in Vushtrri/Vučitrn was built by the Turks (XIV-XV century), thus belongs to the Ottoman period. According to the tradition hamam was built with separate toilet in it, while churches do not retain such thing within its structure. This, according Ispahiu, dispute the claims that hamam was either Catholic or Orthodox Church. Referring to, as he says, historical literature sources of Hilmi Saraçi in his paper "Antiquity, denomination and cultural, historical, and archaeological heritage of city of Vushtrri" says the hamam was built in XV century the time when Gazi Ali Bey's Mosque was built. At his time Gazi Ali Bey was the ruler and ordered to build this public bath.

Public bath (hammam) is built from soft white stones. The ceiling is dome-shaped. The earliest hammam's structure had a groundfloor with three low cupolas. There are separated spaces, two spaces of bathing and the water deposit. In the eastern part of hammam are a drying compartment and the toilet. The floor is paved with white marble stones. The water tank is situated at the eastern part of hammam. This place is called "qullan". Water is heated with firewood. The domes on the top of hammam have circle-shaped small holes covered with glass which served to insolate the interior of the premises.

**Gazi Ali-Bey's Mosque** –Gazi Ali Bey's Mosque was built in 1444. In the last war (1999), a Serbian army grenade blew its minaret down. In 2002 the minaret got rebuilt and the mosque was renewed, but unfortunately did not return to the structure before. Totally different minaret from that of before was built, then the carrel at the entrance and some grave-stones were removed completely from the yard, thus the original appearance of the mosque was defaced.


**Çarshia's Mosque (Bazaar's Mosque)** – Bazaar's Mosque was built in 1761. On March 27, 1999, the mosque was completely burnt down by Serb forces. Today stands reconstructed. Based on the archived phototeque the mosque had a p+1 and tetragonal level, covered with four-sided roof. On the left and the right of the entrance door there were two one-sided staircases joining up to a cantilevered porch on the upper storey.

## **Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet përkatëse komunale Plani Zhvillimor i Komunës (PZHK)**

**Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes** – Në pjesën e profilit në planin zhvillimor komunal të Vushtrrisë është dhënë lista e monumenteve kulturo-historike dhe e lokaliteteve arkeologjike që gjenden në territorin e komunës. Mungon grupimi i këtyre monumenteve sipas destinimit dhe të dhënat për statusin e tyre të mbrojtjes. Vetëm për Urën e Vjetër të Gurit thuhet se mbrohet me Ligjin mbi Zonat me Mbrojtje të Veçantë Nr.03/L-039, kurse për monumentet tjera nuk thuhet asgjë kur dihet se ka edhe monumente tjera në Vushtri që janë nën mbrojtje. Ekziston një përshkrim shumë i shkurtër për 4 nga këto monumente, por mungon historiku i tyre prandaj dhe nuk është e qartë se nga cila periudhë kohore datojnë ato, përveç për Xhaminë e Çarshisë që është treguar kur është ndërtuar. Në dokument janë dhënë aktivitetet e ndaluara dhe ato të kufizuara brenda zonave të veçanta të mbrojtura sipas ligjit Nr. 03/L-039, gjë që nuk e ka vendin tek pjesa e profilit por tek pjesa e pestë e PZHK ku jepen dispozitat për zbatim. Nuk ka informacion për gjendjen fizike të monumenteve të TK dhe nëse shfrytëzohen nga publiku. Poashtu nuk thuhet asgjë nëse është ndërmarrë diç për sanimin e dëmeve që u janë shkaktuar monumenteve të TK në luftën e fundit dhe nëse po - a është ruajtur autenticiteti i monumenteve. PZHK nuk jep informacion për buxhetin që do të thotë për përqindjen nga buxheti komunal dhe nga BKK që ndahet për TK. Në këtë pjesë nuk flitet fare për trashëgiminë shpirtërore, që do të thotë për traditat dhe zakonet popullore, ritet, vallet, muzikën, këngën, prozën, poezinë etj.

Sa i përket hartave, PZHK ka një hartë që paraqet kufijtë e komunës, brenda të cilëve janë dhënë vendbanimet me monumente kulturore-historike dhe lokalitete arkeologjike. Dokumenti i planit i ka poashtu edhe dy harta ortofoto të qytetit të Vushtrrisë ku janë nënvizuar disa nga monumentet e trashëgimisë kulturore. PZHK në këtë pjesë nuk ka ndonjë hartë tjetër më të detalizuar ku do të paraqiteshin hapësirat të kufizuara si zona historike me monumente kulturore-historike brenda tyre.

Fig.18 - Hartat për trashëgiminë kulturore në PZHK të Vushtrrisë  
Fig.18 – Maps of cultural heritage of Vushtrri/Vučitrn MDP



## **Inclusion of cultural heritage in respective municipal plans Municipal Development Program (MDP)**

### **Profile of spatial development and the analysis of the situation –**

In the part of the Profile of the Municipal Development Plan of Vushtrri/Vučitrn is an inventory of cultural-historical monuments and archaeological sites located in the municipality. The categorization of these monuments and the data on their protection status is absent. Only the Old Stone Bridge has a protective status by the Law on Special Protective Zones No.03/L-039, but not other monuments knowing that there are other monuments in Vushtrri/Vučitrn being under protection. There is a very brief description on 4 of these monuments, but their history is missing, and therefore it is not clear from which period those date, except for the Çarshia Mosque (Bazaar Mosque) ascertained for its construction date. The document describes prohibited and restricted activities within special protective zones by Law no. 03/L-039, which should not be in the first chapter of the Profile but on the fifth chapter of MDP, in the Provisions for Implementation. No information about the physical condition of the monuments of CH, and whether are used by the public. It also says nothing about whether the repairment of the damages caused to the monuments of CH during the last war were undertaken, and if so, whether the authenticity of monuments had been preserved. MDP does not provide information on the budget which means the allocations for CH from municipal budget and KCB. In this section nothing is mentioned about spiritual heritage such are the traditional customs, rites, dances, music, songs, prose, poetry, etc.

As for the maps, the MDP contains a map that shows the boundaries of the municipality within which the settlements with cultural and historical monuments and archaeological sites were given. This document also has two orthographic maps of the town of Vushtrri/Vučitrn which highlight some of the monuments of cultural heritage. MDP, in this part, has no additional detailed map that would introduce restricted areas as historical sites and the historic-cultural monuments within them.

Fig.19 - Modeli i përvetsuar i zhvillimit (PZHK)

Fig.19 – Attained development pattern (MDP)





Fig.20 - Pozita e disa monumenteve kulturore-historike (PZHK)  
 Fig.20 - Setup of some historical monuments (JDP)



Fig.21 - Pozita e Urës së Vjetër të Gurit - ortofoto (AKK)  
 Fig.21 - Position of Old Stone Bridge -ortophoto(KCA)

**Vizioni, parimet dhe caqet** – Në këtë pjesë të PZHK-së si pjesë e vizionit për të ardhmen e komunës së Vushtrrisë është edhe mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore. Kjo trashëgimi konsiderohet si bazë për zhvillimin e turizmit kulturor. Synimet që janë listuar këtu janë ndarë në synime për zonën rurale dhe synime për zonën urbane. Sa i përket TK-së, si synim për zonën rurale është „Mbrojtja e mjedisit, trashëgimia natyrore dhe kulturore” dhe si objektiv për këtë synim është „Zhvillimi i konceptit komunal për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore”, kurse synim për zonën urbane është „Vushtrria, qytet modern me rrënjë të lashta” dhe njëri prej objektivave është ai i lartpërmenduri dhe tjetri është „Ngritja e vetëdijesimit në popullsi për trashëgiminë kulturore”. Objektivimi për zhvillimin e konceptit komunal për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore madje është futur në listën e prioriteteve strategjike.

**Korniza e zhvillimit hapësinor** - Në pjesën e tretë është thënë se trashëgimia kulturore duhet të ruhet si një potencial për zhvillimin e turizmit kulturor dhe një zonë me këtë potencial është paraqitur në hartë. Në këtë pjesë, me tri fjali përpiluesit e planit thirren në objektivat për trashëgiminë kulturore që i ka përcaktuar Plani Hapësinor i Kosovës pa treguar se cilat janë ato. Pra nuk ka objektiva për TK në këtë pjesë të planit, por janë listuar disa veprime për të cilat është menduar se duhet t'i kryejnë organet komunale me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së TK. Ato janë: aprovimi i masave për ruajtjen dhe përmirësimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, aplikimi i mekanizmave ligjorë në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe qendrore dhe me qytetarët lokalë, si dhe kompletimi i listës së objekteve të vlefshme që duhet të përkujdesen edhe më tej. Pra PZHK-ja nuk i cakton vet masat por ia lë Komunës që ajo t'i përcaktojë ato. Këto veprime nuk është dashur të jepen në këtë pjesë por në pjesën e katërt të PZHK-së.

**Vision, principles and targets** - in this part of the MDP as part of the vision for the future of municipality of Vushtrri/Vučitrn is the protection and preservation of cultural heritage. This heritage is considered as the basis for the development of cultural tourism. Goals listed here are divided into goals for rural areas and goals for urban areas. As for CH, the goal intended for rural areas is "Protecting the environment, natural and cultural heritage" and the objective for this goal is "Municipal development concept for the protection of natural and cultural heritage", while target for the urban area is "Vushtrri, modern town with ancient roots" and one is the above mentioned objective while the second is "Awareness of the population on the cultural heritage." The objective for developing the municipal pattern for the protection of natural and cultural heritage has been inserted in the strategic priorities list.

**Spatial Development Framework** – The third part notes that cultural heritage should be preserved as a potential for development of cultural tourism and the area of such potential is shown on the map. In this section, with three sentences, the drafters of this plan waive on the objectives for cultural heritage defined in Spatial Plan of Kosovo, without introducing which they are. So, there are no targets for CH in this part of the plan, but only some actions listed for which it is thought that local authorities should develop for the protection and preservation of CH. Those are: the adoption of measures for preservation and improvement of cultural heritage sites, application of legal mechanisms in cooperation with local and central authorities and local citizens, as well as completing the list of valuable facilities that should be taken care further. Subsequently, MDP does not appoint the measures but leaves those to the municipal authority for assigning. These actions should not have been given in this section but in the fourth chapter of MDP.

Fig.22 – Xhamia e Carshisë  
Fig.22 – Çarshia Mosque





**Strategjitë dhe veprimet për zbatim** – Sa i përket përfshirjes së TK-së në pjesën e katërt ku paraqitet strategjia që përmban veprimet e nevojshme për arritjen e objektivave është dhënë synimi i përgjithshëm „Mbrojtja e objekteve dhe e zonave të trashëgimisë kulturore dhe historike“. Në këtë pjesë të planit nuk shihet ndonjë strategji e qartë me të cilën do të arriheshin synimet dhe objektivat për TK të cilat janë dhënë në pjesën e dytë të PZHK. Këtu përveç që thuhet se duhet përpiluar planet rregullative, dhe një koncept për revitalizimin e qendrës së Vushtrrisë, mungojnë veprimet tjera konkrete dhe projektet me realizimin e të cilëve do të arriheshin objektivat, e pikërisht këto do të duhej të ishin prezente në këtë pjesë të planit. PZHK-ja e Vushtrrisë i ka caktuar vendbanimet e komunës dhe zonat e qytetit brenda të cilave ka edhe monumente të trashëgimisë kulturore e për të cilat duhet të përpilohen planet rregullative. Kjo do të thotë se përpiluesit e këtij plani ua kanë lënë planeve rregullative trajtimin e zonave historike dhe monumenteve kulturore-historike brenda tyre. Pra plani nuk i trajton ato në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe hollësisht por tërthorazi.

**Dispozitat për zbatim** – Këtu, tek Dispozitat për Zbatim, tek dispozita 5.2.2. “Kushtet për rregullimin e hapësirës” thuhet se kushtet e lokacionit duhet të përcaktojnë përveç tjerash edhe „Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore“. Tek dispozita 5.2.2.a “Zonat ndërtimore për vendbanime” thuhet se zhvillimi i vendbanimeve duhet të kontrollohet, përveç tjerave, edhe në „Zonat me trashëgimi të pasur kulturore dhe natyrore“. „...Duhet bërë përzgjedhjen e elementeve të trashëgimisë kulturore të cilat duhet mbrojtur dhe duhet miratuar rregullore përkatëse për to“, thuhet midis tjerash tek dispozita 5.2.8 “Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike”. Në fund tek dispozita për zbatim 5.6 “Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm” thuhet se duhet të hartohen plane dhe politika, përveç tjerave edhe për zonat arkeologjike.

#### **Plani Zhvillimor Urban (PZHU)**

Sa i përket përfshirjes në PZHU-së së Vushtrrisë, gjatë përshkrimit të destinimit të sipërfaqeve të qytetit të Vushtrrisë në mënyrë të përgjithësuar janë përmendur ndërtesat kulturore fetare në kuptim të përfshirjes së tyre në hapësira të caktuara të qytetit. Destinimi i sipërfaqeve është dhënë në mënyrë skematike, në modelin e zhvillimit hapësinor të qytetit, dhe është treguar se në hapësira me destinime të caktuara brenda kësaj skeme ndodhen përveç tjerash edhe ndërtesat kulturore historike. Kjo është e tëra sa i përket trashëgimisë kulturore në këtë plan, me fjalë të tjera trashëgimia kulturore shumë pak, gati se fare nuk është trajtuar në PZHU të Vushtrrisë.

**Strategies and actions for implementation** - Regarding the inclusion of CH in the fourth chapter where the strategy containing the actions necessary in achieving the objectives are introduced, the general goal stands "Protection of buildings and sites of cultural and historic heritage." In this section of the plan it is not foreseen any comprehensible strategy by which the goals and objectives for cultural heritage would be achieved, which are noted in the second part of MDP. In this part, except that should develop regulatory plans and a concept for the revitalization of the centre of Vushtrri/Vučitrn, there are absent further tangible actions and projects whose implementation would achieve the goals; namely these should be introduced in this part of the plan. Vushtrri/Vučitrn MDP has designated settlements of the municipality and areas of the town within which there are cultural heritage monuments and for which should develop regulatory plans. This means, the drafters of this plan have left the administration of historical sites and cultural-historical monuments to regulatory plans. As a result, the plan does not treat them directly and thoroughly, but only indirectly.

**Provisions for implementation** – In the provisions for implementation, provision 5.2.2. "Requirements for the regulation of the area" says that condition of the locations should determine, *inter alia*, the "Measures for environmental protection and protection of natural sites and cultural heritage." In the section 5.2.2.a "Areas of Residential Construction" brings that the development of settlements should be inspected, among others in "Areas with rich cultural and natural heritage." "...Should select the elements of cultural heritage which there are to be protected and should adopt appropriate regulations for those" is stated among other in the provision 5.2.8 "Measures for the protection of landscapes, natural values and cultural and historical sites." At the end of the provisions for implementation 5.6 "Basics and guidelines for further research" it is said that, among other, should draft plans and policies for archaeological sites.

#### **Urban Development Plan (UDP)**

Regarding the inclusion of UDP of Vushtrri/Vučitrn, during description of the surfaces of the town of Vushtrri/Vučitrn, religious cultural buildings were mentioned in a vague manner, in terms of their inclusion in certain areas of the town. End-targets of the surfaces are given in schematic, on the pattern of spatial development of town, and only pointing out that in certain areas within the scheme, among others, are cultural-historical buildings. This is all in terms of cultural heritage in this plan; in other words very little of cultural heritage, almost nothing is addressed in Vushtrri/Vučitrn UDP.

## **Konkluzion**

Nga analiza që i është bërë përfshirjes së TK në planin zhvillimor komunal dhe planin zhvillimor urban të Vushtrisë ka rezultuar se kjo përfshirje nuk është e kënaqshme. Kjo sidomos vlen për PZHU-në ku TK është përfshirë nën minimumin e dëshiruar. Sa i përket PZHK-së, edhe këtu në çdo kapitull të këtij dokumenti ka mangësi të përfshirjes por kjo është më e shprehur tek pjesët (kapitujt) ku duhet të ipen objektivat për TK dhe strategjia me veprimet për arritjen e këtyre objektivave.

Cilët do të mund të ishin shkaktarët e një përfshirje jo të kënaqshme të TK në këto dy dokumente? Shkaktarë të kësaj do të mund të ishin:

- mospërfshirja ose angazhimi i pamjaftueshëm i ekspertëve të TK në procesin e përpilimit të PZHK;
- mungesa e të kuptuarit nga përpiluesit rëndësinë e vërtetë që ka përfshirja e gjithanshme e TK në dokumentet e planifikimit hapësinor;
- fakti që TK nuk është prioritet i qeverisë qendrore dhe atyre komunale
- mungesa e të dhënave.

## **Conclusion**

From the analysis conducted to the inclusion of cultural heritage in Municipal Development Plan and Urban Development Plan of Vushtrri/Vučitrn, it has resulted that this inclusion is not satisfactory. This does especially apply to UDP, where cultural heritage is included below the minimum desired. As for the MDP, in also every chapter of this document we could observe deficiency in inclusion but it is lightly expressed in parts (chapters) which should contain goals for cultural heritage and the strategy with actions in achieving these goals.

What could be the parent of an unsatisfactory inclusion of CH in these two documents? Grounds of this would be:

- exclusion or inadequate involvement of experts of CH in the process of drafting the MDP;
- the drafters' lack of understanding of the plan's real significance on the overall inclusion of CH in spatial planning documents;
- the fact that CH is not a priority for the central and municipal authorities
- the lack of data.

## KOMUNA E GJAKOVËS

### Trashëgimia kulturore në komunën e Gjakovës

#### Historiku I shkurtër

Qyteti i Gjakovës, me atitudat gjeografike prej 42.24° të gjerësisë veriore (N) dhe 20.26° të gjatësisë lindore (E)<sup>41</sup>, shtrihet në pjesën Perëndimore të Republikës së Kosovës. Pozita e saj qendrore në tërësinë e madhe të luginës gjeografike-natyrore të Rrafshit të Dukagjinit, me maja të pakta që kalojnë kuotën prej 400 m.l.m, luan rol të rëndësishëm në lidhjen e qytetit të Pejës në veri me Prizrenin në jug si dhe për të gjitha vendbanimet e Kosovës është urë lidhëse me Shqipërinë.

Zona e komunës së Gjakovës, me territor prej 587 km<sup>2</sup>, ka qenë e banuar që nga koha antike dhe parahistorike. Kjo mund të dëshmohet me ekzistencën e vendbanimeve, fortifikimeve, tumave dhe varrezave llire, që janë shumë afër qytetit të sotëm. Më vonë, është zhvilluar qyteti i tregut të Gabuleos, si pjesë e strukturës së vendbanimit, në udhëkryqin e rrugëve llire – Romake *Via de Zenta* (Trieshtë – Shkodër - Stamboll) dhe *Lajsus Lajsus* (Lezhë – Nish – Sofje).

Gjakova, me emrin e saj të sotëm (**Jakova** – që d.m.th **livadhet e Jakut**) i cili rrjedh nga emri i një tregtari të pasur Jak Vula, ishte themeluar gjatë shekullit të XVI-të, kurse për herë të parë në literatura të ndryshme është përmendur në vitin 1574.



Fig. 23 - Ura e Islam Begut dhe Çarshia e Madhe (MKRS).  
Fig. 23 - Islam Begu's Bridge and Grand Bazaar (MCYS).



Fig.24 - Foto Ura e Tabakëve (IPH).  
Fig.24 – Image of Tabakëve Bridge (ISP).

<sup>41</sup> Instituti për Arkitekturë, Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i Fakultetit të Arkitekturës. *Plani Gjeneral Urbanistik i Qytetit Gjakovës (1988 faqe 5)*, Sarajevë, Janar, 1988.

## MUNICIPALITY OF GJAKOVA/DJAKOVICA

### Cultural Heritage in Gjakova/Djakovica Municipality

#### A brief history

The town of Gjakova/Djakovica, with the geographical latitude 42.24° north (N) and 20.26 ° eastern length (E)<sup>42</sup>, lies in the western part of Kosovo. Its geographic position in the totality of the great central valley of Dukagjini Plain, with few peaks exceeding 400 m, plays an important role in linking the town of Peja/Peć in north, of Prizren in the south, and bridging all settlements of Kosovo with Albania.

The area of the municipality of Gjakova which is 587 km<sup>2</sup> has been inhabited since prehistoric and ancient times. It may be proven by the existence of settlements, fortifications, Illyrian tumuli and cemeteries, which are very close to the actual city. Later, Gabuleos city market developed as part of the settlement, at the junction of Illyrian – Roman *Via de Zenta* (Trieste – Shkodra – Istanbul), and “*Lissus Lissus*” (Lezhë – Nish - Sofia).

Gjakova, original name ***Jakova*** meaning ***Jaku's meadows*** and deriving from the name of a rich merchant Jak Vula, was founded during the XVI century, and for the first time mentioned in some literature in 1574.

<sup>42</sup> Institute of Architecture, Urbanism and Spatial Planning of the Faculty of Architecture. *Urban General Plan of the town of Gjakova* (1988, page 5), Sarajevo, January, 1988.

Fig.24a – Çarshia sot

Fig.24a – Bazaar today (Çarshia)



Zanafilla dhe bërthama e qytetit ishte ndërtuar ndërmjet lumit Krena në lindje dhe kodrës së Çabratit në perëndim, ku lagjja më e vjetër me emrin “Mëhalla e Hadumit” është vendosur përreth Xhamisë së Hadum Agës të ndërtuar në vitin 1592/93.

Ndërtimi i urave të ndryshme mbi lumin Krena në qytet dhe mbi lumin Ereniku përreth qytetit, ka lehtësuar rrugëtimin e karvanëve tregtarë të kohës.

Më vonë qyteti vazhdon të zgjerohet dhe të shtrihet në pjesën lindore. Në vitin 1662, kur përfaqësuesi tregtar Otoman kaloi nëpër Gjakovë, kishte regjistruar 2,000 banorë, ndërsa në vitin 1838, qyteti numëronte më shumë se 20,000 banorë.

Fig.24b – Pamje nga Çarshia natën

Fig.24b – Image of Bazaar/Çarshia at night



Qendra më e madhe e pazarit - zona e tregtisë, zhvillimin ekonomik e kishte të bazuar në tregtinë e lëkurës, prodhimeve bujqësore, të rrobaqepësisë, etj, kurse nga viti 1900 kjo qendër tregtare, Çarshia e Madhe, kishte mbi 1.000 ndërmarrje të ndryshme.

Aktualisht, duke u bazuar në zyrën e regjistrimit të UNMIK-ut, në komunën e Gjakovës, llogaritet të jetojnë rreth 150,000 banorë, prej nga 90,000 në qytet dhe 60,000 në fshatra. Pasi që nuk ka të dhëna të sigurt, pasi regjistrimi i fundit zyrtar ishte më 1981, numri i banorëve mund të jetë më i lartë.

OSBE në “Profilin e Komunës së Gjakovës”, shkurt 2005, vlerëson numrin e popullsisë për Komunën e Gjakovës prej 153,000 banorëve. Shumica dërmuese janë shqiptarë të Kosovës – 143,300 ose 95,5 %, 6.000 (ose 4%) banorë i përkasin komuniteteve tjera etnike si egjiptian/ashkali dhe 700 janë romë (ose 0,4%). Kurse, sipas regjistrimit të përgjithshëm të vitit 1991, me rreth 3,000 banorë (ose 2%) ishin të popullsisë serbe në këtë komunë, shumica banorë të qytetit të Gjakovës.

### **Trashëgimia kulturo-historike në Komunën e Gjakovës**

Dihet se shtrirja e trashëgimisë kulturo-historike ka gjurmë gjithandej Kosovës, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, e cila me luginat e shumta lumore ka mundësuar vendosjen e vendbanimeve dhe të civilizimeve gjatë shekujve. Bashkëveprimi i tokës bujqësore me trashëgiminë kulturo-historike dhe trashëgiminë natyrore, në këtë zonë (si në hartën e mëposhtme nga PHK 2009-2020+, faqe 165), është potencial i çmuar për zhvillimin e turizmit të kësaj ane në veçanti dhe për zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi, duke prirë me Alpet Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna) në Veri dhe duke përfunduar në Jug me Malet e Sharrit (pjesë e të cilave është edhe Parku Nacional).

The birth and the nucleus of the town developed between Krena river in the east and Çabrati height to the west, where the old neighborhood named *Hadum Mahalla* is set around Hadum Aga Mosque, built in 1592/93.

The construction of different bridges on Krena river in town and on Erenik river, in the verge of the town, has facilitated the journey of trade caravans at the time.

Later the city continued to expand and extend to the east. In 1662, when Ottoman trader went through Gjakova/Djakovica, he had recorded 2.000 inhabitants, while in 1838, the city counted more than 20.000 inhabitants. The larger center of the bazaar - the trade area has seen its economic development mainly on skin trade, agricultural products, tailoring, etc. and since 1900 this marketplace Grand Bazaar (*Çarshia e Madhe*) had over 1,000 different enterprises.

Currently, according to UNMIK's registration office, the population is estimated about 150,000 inhabitants in Gjakova/Djakovica municipality, from which 90,000 in the city and 60,000 villages. As there is no reliable data, because the last official census was in 1981, the number of residents may be higher.

According to OSCE's "Profile of the Municipality of Gjakova/Djakovica" - February 2005, the population estimations for the municipality were for 153.000 residents. Kosovo Albanians are most dominant 143.300 or 95.5%, 6.000 (or 4%) residents belong to other ethnic communities as Egyptian/Ashkali and 700 are Roma (or 0.4%). But, according to the census of 1991, about 3.000 inhabitants in the municipality (or 2%) were Serb, mostly living in town.

### **Cultural-historic heritage in Municipality of Gjakova/Djakovica**

It is known that the expansion of cultural and historical heritage has its traces throughout Kosovo, especially in the Dukagjini Plain, which in many river valleys has enabled the establishment of settlements and civilizations over the centuries. Interaction of agricultural land with cultural and historical heritage and natural heritage in this area is valuable potential for tourism development in this area in particular and economic development of the country north and ending at the South Mountains (part of which is the National Park).

Fig.24c – Pamje nga Çarshia në të shkuarën  
Fig.24c – Image of Bazaar/Çarshia before






Gjakova gjithashtu, e cila gjendet në mesin e kësaj zone, është mjaft e pasur me objekte dhe tërësi të trashëgimisë natyrore dhe veçmas asaj kulturo-historike, siç tregojnë edhe të dhënat nga MKRS dhe IMMK për rajonin e Gjakovës.

Trashëgimia kulturo-historike në Komunën e Gjakovës ka shumë më shumë monumente me vlera karakteristike, që janë evidentuar gjatë procesit të inventarizimit 2003–2010, prej Institutit Rajonal (IMMK) – Gjakovë, se sa që janë të prezantuara në PZHK / PZHU 2008, në listën e mëposhtme të monumenteve të mbrojtura me ligj.

Fig.25 - Harta e PHK 2009 – 2020+ (IPH)






















Fig.25 – Map of SPK 2009 – 2020+ (ISP)





## Konfliktet dhe sinergjitë me tokën bujqësore

### Legjenda

-  Sinergjitë me trashëgimin nat. dhe kult.
-  Konflikti me TZHEK
-  Konflikti me mihjen sip.
-  Konflikti me autoudhë
-  Zgjerimi i Rrugëve rajonale
-  Akumulimet e parapara
-  1125
-  1126 - 2961
-  2962 - 3765
- Zgjerimi  
7 qendrave  
sip. në Ha**
-  Zgjerimi i Aeroporteve
-  22 Qendrat tjera Komunale
-  Zona me tokë kualitative bujqësore
-  Liqenet
-  Kullosat
-  Pyjet
-  Bazenet e llogjtit
-  Hekurudhat
-  Traseja e autoudhës
-  Rruget magjistrale
-  Zonat me Cr
-  Zonat me Ni, Pb, Zn, Ag.

Gjakova/Djakovica, which is located in the heart of this area, is very rich in artefacts and natural heritage as a whole, and specifically in field of cultural-historic heritage, as shown by data from the MCYS and IPM of Gjakova/Djakovica.

Cultural and historical heritage in the municipality of Gjakova has more monuments with characteristic values that were identified, during the 2003-2010 inventories, from the Regional Institute (IPMK) – Gjakova/Djakovica, than those presented in the MDP / UDP 2008, in the following list of monuments protected by law.

Tab.2 - Lista e monumenteve<sup>43</sup> të mbrojtura me Ligj në komunën e Gjakovës.

|                              | nr. | Objekti / tërësia/viti i shpalljes nen mbrojtje                             | Vendbanimi |
|------------------------------|-----|---|------------|
| Monumente Arkeologjike       | 1   | Lokalitet arkeologjik, shek.II - IV./67                                     | Doblibare  |
|                              | 2   | Nekropola Ilire me tuma (shek.VIII-III p.e.sonë)/67                         | Qerim      |
|                              | 3   | Tumë Ilire te Ura e Shejtë (shek.VIII-III p.e.sonë)/67                      | Uizë       |
|                              | 4   | Kompleksi i Sukës së Crmjanit (shek.V p.e.sonë)/67                          | Cërmjan    |
| M. kulti ortod. & katolike   | 5   | Kisha e të Ngjiturit e Zoniës në Qiell (shek.XVI e rindnë'23)/67            | Gjakovë    |
|                              | 6   | Mbeturinat e objektit në vendin e quajtur "Kisha katolike" (shek.II-IV)/68  | Raçë       |
| Monumente kulti muslimane    | 7   | Xhamia e Hadumit (shek.XVI, ose 1001 sipas hixhrit)/55                      | Gjakovë    |
|                              | 8   | Teqja e Sheh Eminit me ceshme dhe tyrbe, rr.B.Kidric 52 dhe 54(shek.XIX)/58 | Gjakovë    |
|                              | 9   | Xhamia e Hasan Agës(shek.XVI)/70  | Rogovë     |
|                              | 10  | Teqja e Sheh Deniollit (shek.XIX)/78  | Gjakovë    |
| Ndërtime popullore banimi    | 11  | Shtëpia e Selim Bakijes/50  | Gjakovë    |
|                              | 12  | Ndërtesa banesore, rr.M. Tito nr.442 (shek.XIX)                             | Gjakovë    |
|                              | 13  | Ndërtesa banesore, rr.M. Tito nr.378 /348-350/ (shek.XIX)/55                | Gjakovë    |
|                              | 14  | Ndërtesa banesore, rr.M. Tito nr.380 /346/ (shek.XIX) /55                   | Gjakovë    |
|                              | 15  | Shtëpia e Dragutin Gjorgjeviqit, rr.E.Duraku 111 /64/ (LNÇ)/58              | Gjakovë    |
|                              | 16  | Shtëpia e vjetër e Jelena Jakicit, rr. E.Duraku nr.67 (XIX)/58              | Gjakovë    |
|                              | 17  | Shtëpia e Naim Zajmit (LNÇ)/71  | Gjakovë    |
|                              | 18  | Kulla e Zenun Ahmetit (shek.XIX)/80   | Brovinë    |
|                              | 19  | Kulla e Adem Ademit (shek.XIX)/80   | Batushë    |
|                              | 20  | Kulla e Ibish Alies (shek.XIX)/80   | Brovinë    |
|                              | 21  | Kulla e Musë Lushit (shek.XIX)/80   | Brovinë    |
|                              | 22  | Kulla e Hysni Koshit (shek.XIX)/80  | Gjakovë    |
|                              | 23  | Shtëpia e Sylejman Vokshit, rr. F.Noli nr.1 (shek.XIX)/80                   | Gjakovë    |
| Ndërtime popullore shoqërore | 24  | Tërësia Urbanistike "Carshia e Vjetër" (shek.XVI-XX)/55                     | Gjakovë    |
|                              | 25  | Ura e Terzive (shek.XVIII)/58   | Bistrazhin |
|                              | 26  | Ura e Tabakëve (shek.XVIII) /62   | Gjakovë    |
|                              | 27  | Ura e Taliqve (shek.XVIII) /62  | Gjakovë    |

<sup>43</sup> Lista e monumenteve të mbrojtura me ligj në Kosovë, DTK – MKRS, Në listë mungon Libri "Kodeksi i Ungjillit të Shenjtë" pjesa I dhe II, të Dr. Pjetër Bogdanit – që është trashëgimi e luajtshme.

Tab.2-The list of protected Monuments in Gjakova/Djakovica<sup>44</sup>

|                                  | n.r. | Object / ensemble/year of declaring under protection                   | Settlement |
|----------------------------------|------|--|------------|
| Archaeological monuments         | 1    | Archaeological locality, II – IV c. - IV./67                           | Doblibare  |
|                                  | 2    | Illyrian necropolis tombs (VIII-III BC)/67                             | Qerim      |
|                                  | 3    | Illyrian tumuli Shejtë bridge (VIII-III BC)/67                         | Uizë       |
|                                  | 4    | Suka Cermjani complex (V BC)/67  | Cërmjan    |
| Orthdx. & Catholic Mnmts.        | 5    | Church of the Assumption in Heaven (XVI, rebuilt in 1823)/67           | Gjakova    |
|                                  | 6    | Ruins at the place called "Catholic church" (.II-IV)/68                | Raçë       |
| Muslim Mnmts.                    | 7    | Hadumi Mosque (XVI, or 1001 according lunar calend.)/55                | Gjakova    |
|                                  | 8    | Sheikh Emin's Tekke with fountain and tomb, B.Kidric 52 dhe 54(XIX)/58 | Gjakova    |
|                                  | 9    | Hasan Aga's Mosque(XVI)/70   | Rogova     |
|                                  | 10   | Teke Sheh Denjollit (XIX)/78   | Gjakova    |
| Vernacular residential buildings | 11   | Selim Bakija's House /50   | Gjakova    |
|                                  | 12   | Residential building, M.Tito nr.442 (XIX)                              | Gjakova    |
|                                  | 13   | Residential building, M.Tito nr.378 /348-350/ (Cent.XIX) /55           | Gjakova    |
|                                  | 14   | Residential building, M.Tito nr.380 /346/ (Cent.XIX) /55               | Gjakova    |
|                                  | 15   | Dragutin Djordjević's House, E. Duraku 111 /64/ (NLM)/58               | Gjakova    |
|                                  | 16   | Jelena Jakić's Old house, E.Duraku nr.67 (XIX)/58                      | Gjakova    |
|                                  | 17   | Naim Zajmi's house(NLM)/71   | Gjakova    |
|                                  | 18   | Zenun Ahmeti's Kulla (XIX)/80  | Brovina    |
|                                  | 19   | Adem Adem's Kulla (XIX)/80   | Batusha    |
|                                  | 20   | Ibish Alia's Kulla (XIX)/80  | Brovina    |
|                                  | 21   | Musë Lushi's Kulla (Cent.XIX)/80                                       | Brovina    |
|                                  | 22   | Hysni Koshi's Kulla (Cent.XIX)/80                                      | Gjakova    |
|                                  | 23   | Sylejman Vokshi House, F.Noli Str no.1 (Cent.XIX)/80                   | Gjakova    |
| Popular social buildings         | 24   | Urban ensemble Grand Bazaar (.XVI-XX) /55                              | Gjakova    |
|                                  | 25   | Terzive bridge(XVIII)/58   | Bistrazhin |
|                                  | 26   | Tabakët Bridge(XVIII) /62  | Gjakova    |
|                                  | 27   | Taliqet Bridge (Cent.XVIII) /62  | Gjakova    |

<sup>44</sup> The list of monuments protected by law in Kosovo, DTK - MCYS. The list lacks the book "Code of the Holy Gospel" Part I and II, of Dr. Peter Bogdani – movable heritage.

Prandaj, nga evidentimi i kërkuar për inventarizimin e objekteve dhe tërësive të trashëgimisë kulturo – historike në komunën e Gjakovës, janë regjistruar edhe shumë elemente (artikuj) të saj të reja përveç atyre nën mbrojtje. Nga ky proces i gjithmbarshëm i kryer gjatë viteve 2003 - 2010, mes tjerash, kanë dalë edhe objekte dhe tërësi nga trashëgimia e paluajtshme që propozohen të shpallen për “monumente” dhe të mbrohen me ligj për vlerat e dalluara që kanë.

**Monumentet Arkeologjike** - Përveç, monumenteve të mbrojtura me ligj, që gjenden në listën e mësipërme janë të identifikuar edhe disa lokalitete nga të cilat më të rëndësishme janë:

- Lokaliteti Arkeologjik i shekullit II – IV, Doblbare;
- Nekropola Ilire me Tumë, shek. VII – III P.E. Sonë, Qerim;
- Tuma Ilire te Ura e Fshejtë, shek. VIII – III P.E. Sonë, Ujzi;
- Kompleksi i Sukës së Cërmjanit, shek. V P. E. Sonë deri shek. V, Cërmjan, dhe
- Gërmadhat e objektit në vendin e quajtur “Kisha Katolike”, shek. IV – VI, Raçë,

Në listën e propozimeve për monumente të mbrojtura me ligj janë dhe **23 objekte dhe tërësi arkeologjike**, që dalin nga evidentimi i trashëgimisë kulturore sipas procesit të inventarizimit<sup>45</sup> prej vitit 2003 deri më 2010.

**Monumentet arkitektonike, varrezat dhe përmendoret** - Përveç monumenteve të listuar më lartë në listën e monumenteve të mbrojtura me ligj, janë edhe **71 objekte apo komplekse tjera** arkitektonike, në listën e propozimeve për monumente që duhet mbrojtur me ligj, nga evidentimi i trashëgimisë kulturore gjatë këtij procesit të inventarizimit, me shtrirjen e tyre hapësinore në komunë (dhe qytet) të Gjakovës.

Në vazhdim, prezantimi i monumenteve me vlera të trashëgimisë kulturore dhe historike do të shoqërohet me përshkrim dhe historik të shkurtër të tyre. Analiza e monumenteve të përzgjedhura në këtë pjesë është ndarë në grupe me karakteristika të ngjashme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore:

**Kompleksi Çarshia e Madhe** – Është nën mbrojtje të ligjit që nga viti 1955 dhe paraqet njërin nga komplekset monumentale urbanistike më të mëdha jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj. Shtrirja e saj nga veriu në jug arrin në afër 1000 m', ndërsa sipërfaqja e gjithmbarshme e saj është 34.000 m<sup>2</sup>. Ajo, për rajonin e Gjakovës, ishte vatër e zhvillimit ekonomik shoqëror dhe kulturor, sepse në të u zhvilluan të gjitha llojet e zejeve të mundshme.

Në pikëpamje urbanistike Çarshia e Madhe paraqet një shembull të gjallë të planit urbanistik oriental, me elemente të pasura arkitektonike, që frymëzojnë sot çdo arkitekt. Ky kompleks paraqet, një muze të vërtetë të veshur me mozaikun e vërtetë të larmishëm të zejeve me arkitekturën specifike të enterierëve të pasur. Është një laborator i madh shkollor me modele të panumërta të krijimtarisë popullore në të cilën pasqyrohet kreativiteti i pashoq i ndërtuesit si dhe përpunuesit e latuesit të përsosur të drurit.

<sup>45</sup> IMMK Gjakovë. *Lista e Objekteve dhe Tërësive Arkeologjike të Propozuara për Monumente të Mbrojtura me Ligj, nga procesi "Evidentimi i monumenteve të kulturës sipas Inventarizimit" 2003 – 2010.*

Therefore, from the evidence required for the inventory of facilities and sites of cultural and historic heritage in Gjakova/Djakovica municipality, were also recorded many elements (items) in addition to those under protection. From this overall process carried out during the years 2003 - 2010, among others, have emerged totalities and objects from immovable heritage which are proposed to be proclaimed as "monuments" and protected by law for the distinct values they carry.

**Archaeological Monuments** - In addition to the monuments protected by law, contained in the above list are also identified several locations of which the most important are:

- Archaeological site of century II-IV, Doblibare;
- Illyrian necropolis with tumulus, VII - III century BC, Qerim;
- Illyrian Tumulus at the Fshejtë Bridge, VIII - III century BC, Ujzi;
- Suka e Cërmjanit complex, V century BC, Cërmjan
- Ruins of a building at the place called "Catholic Church", IV - VI century, Raçë

In the list of proposals for monuments to be protected by law, there are **23 objects and archaeological ensembles** arising from the identification of cultural heritage under the inventory<sup>46</sup> process from 2003 to 2010.

**Architectural monuments, cemeteries and memorials** - Besides monuments listed above for the monuments protected by law, there are *71 buildings or other architectural ensembles*, the list of proposals to monuments that should be protected by law, the identification of heritage cultural events during the inventory process, with their spatial extent in the municipality (and town) of Gjakova/Djakovica.

In addition, the introduction of monuments of cultural and historic heritage will be accompanied by short description and their history. Analysis of selected monuments in this part is divided into groups with similar characteristics of natural and cultural heritage:

**Ensemble of Grand Bazaar (Çarshia e Madhe)** - is under protection since 1955 and represents one of the larger urban monumental ensembles not only in Kosovo but also abroad. Its scope reaches from north to south at near 1.000 m, while its overall area is 34.000 m<sup>2</sup>. For the region of Gjakova/Djakovica, it was the source of social and cultural economic development, because it helped develop all the types of craftsmanship.

From urbanistic point of view, Grand Bazaar presents a vivid example of oriental urban plan with rich architectural elements that inspire today's architects. This complex represents a true museum dressed with a true mosaic of diversified crafts of a rich architectural interior. It's a great educational lab with countless patterns of creativity in which is reflected the unmatched vernacular building and creativity in wood ornamentation.

---

<sup>46</sup> IPM of Gjakova/Djakovica, *List of Archaeological Objects and Sites Proposed for Law Protection*, the process of "Identification of cultural monuments according the Inventory" from 2003 to 2010.

Në pikëpamje të arkitekturës, Çarshia paraqet një shkollë të modeleve më të bukura të arkitekturës popullore dhe të shkathtësisë ndërtimore duke filluar nga detajet më të imëta e deri tek tërësitë, prej objekteve deri në ambiente, prej ambientit deri në urbanizëm, duke mos humbur në asnjë rast masën e vërtetë, të cilën mjeshtri gjenial anonim dhe me përvojë të gjatë e ka gjetur në jetën dhe në shprehjet e zejtarëve, në hapësirën e nevojshme të domosdoshme në dimensionet njerëzore.

Çarshia e Madhe ka vlera shumë të mëdha kulturore dhe historike por edhe shkencore. Është rast i rrallë për një tërësi urbane, prej 525 objekteve, që ruhet plotësisht dhe jeton gati e paprekur nga jeta moderne dhe si e tillë është edhe shembull i rrallë i bashkëjetesës së harmonishme të së vjetrës me të renë në një vend. Më 1999, prej tyre u dogjën 431 objekte, me të gjitha përmendoret kulturore historike tjera në të. Pjesa më e madhe e saj u ringjall pas lufte falë investimeve private dhe ndihmës së organizatave ndërkombëtare USAID, CORDAID, etj, përderisa edhe 59 objekte tjera, akoma të pa rindërtuara, janë në pritje të vullnetit dhe ndihmës - donacioneve. Për momentin, edhe përkundër investimeve jo të vogla në rindërtimin e objekteve të kompleksit, një pjesë e madhe e tyre janë jashtë funksionit adekuat. Deri më tash janë marrë disa iniciativa për ngjalljen e kësaj zone, të cilat kanë përfunduar pa ndonjë rezultat. Në bazë të informatave dhe diskutimeve me përgjegjësit e komunës u dakordua se kjo zonë ka nevojë për një studim dhe analizë më serioze e cila pa dyshim se do të sjellë edhe rezultatet e pritura.

**Kompleksi Xhamia e Hadum Agës** – Kompleksi i Xhamisë së Hadumit, është i mbrojtur me ligji që nga viti 1955 dhe paraqet simbolin e qytetit të Gjakovës me të cilën, sipas traditës, lidhej edhe fillimi i jetës qytetare, paraqet qendrën kulturore, arsimore dhe fetare të këtij vendbanimi. Pranë saj gjendej biblioteka, më e madhe se vetë xhamia, si dhe përbri saj shkolla.

Sulejman Hadum Aga, pos këtij kompleksi, ndërtoi në afërsi një muvaki-hane, një han, një hamam dhe disa dyqane që përbëjnë bërthamën e Çarshisë së Madhe. Të huajt e konsideronin "Monument i kulturës shqiptare... monument unik në të gjitha trojet shqiptare..." (*Ridelmajer*), dhe që "...mund të bënte gara lirshëm me xhamitë në Stamboll". (*Myller*)

Planimetria e saj përbëhet nga salla e lutjeve, hajati dhe minarja. Salla është e mbuluar me kube të konstruuar drejtpërdrejtë mbi trompe në këndet e mureve konstruktive. Ky konstruksion specifik guri paraqet të vetmen zgjidhje të këtyllë ndërtimore në Kosovë. Me themele katrore me kupolë mbi trompe dhe triemin me tri kupola mbi shtylla masive, për nga mënyra e ndërtimit dhe madhështia e saj, paraqet përmendore të rëndësishme të arkitekturës mesjetare islame.

Enterierët janë të zbukuruar me arabeska, me pikturë murale, me peizazhe të stilizuara, me motive të arkitekturës popullore, natyra të qeta, ornamente bimore, fig. gjeometrike, citate te Kuranit, etj.

From the architectural viewpoint the Bazaar is a school of architecture presenting popular construction skills, ranging from minute details of up to ensembles, from objects to settings, from facilities up to urbanism, not losing in any case the real measure, which the nameless genius artisan, with his abundant experience, has found in the life and habits of artisans, in the space necessary and required for the human dimensions.

Big Bazaar (Çarshia) has great cultural, historic and scientific values. It is a rare case of for an urban ensemble with 525 facilities to stand fully preserved which lives almost untouched by modern life and as such is the rare example of tuneful coexistence of the old with the new in one place. In 1999 the bazaar was burnt down with 431 objects, with all the historical cultural monuments in it. Much of it revived after the war due to private investments, international aid organizations, USAID, CORDAID, etc. Remaining 59 objects, not yet rebuilt, are waiting for the will and aid - donations. Currently, in spite large investments for the reconstruction of the ensemble, a large portion of them are out of their function. So far, several initiatives were taken for the wake of this ensemble, ending with any result. According to the information and discussions with the municipal officials we agreed that this area needs a more serious study and analysis which will undoubtedly bring the expected results.

**Hadum Aga's Mosque ensemble** – Hadum Mosque ensemble is under the law protection since 1955 and represents the symbol of the town of Gjakova/Djakovica in which, according to tradition, plugged the beginning of civic life, presents the cultural, educational and religious center of this settlement. Nearby it's found a library bigger than the mosque and the adjacent school.

Hadum Suleiman Aga, besides this complex built a *muvakkithane* (timing room), an inn, a hammam and some stores that constitute the core of the Big Bazaar. Foreigners considered it "a monument of Albanian culture ... a unique monument in all Albanian lands" (*Riedlmayer*), which "could freely defy mosques of Istanbul" (*Mueller*).

Its layout consists of a prayer hall, a minaret and the porch. Its hall is covered with constructed cubes directly put in the corners of the constructive walls. This specific stone structure represents the only solution to such construction in Kosovo, with the dome on square foundations and covered porch with three domes on massive pillars, is an important pillar of Islamic medieval architecture.

The interior is decorated with arabesque, mural painting, stylized landscapes, popular architecture motifs, peaceful nature, ornament plants, geometric figures, verses from the Qur'an, etc.



Në arsyetimin e vendimit mbi mbrojtjen e këtij kompleksi, që përfshinte xhaminë, bibliotekën, shkollën, shatërvanin dhe varrezat. Më 1999, ky kompleks u dogj, nga i cili kishte shpëtuar vetëm xhamia me minaren e granatuar, me derën e hyrjes të djegur dhe me arabeskat e dëmtuara.



Fig. 26 - Xhamia e Hadum Agës (IPH)

Fig. 26 – Hadum Aga's Mosque (ISP)

**Ura e Taliqit** – Është e ndërtuar mbi lumin Krena dhe lidhë pjesën më të vjetër të qytetit të Gjakovës, që shtrihet në anën perëndimore me pjesën më të re në anën lindore të tij. Ura është e gjatë 21.50 m, me gjerësi 4.05 m dhe ka lartësi prej 5.0 m. Kishte tre qemer me kurriz me dy dritare shkarkuese, ndërsa më vonë kishte dy harqe të mëdha dhe dy shtylla. Në gjatësi prej 7.0 m shte konstruksion prej druri. Në vendimin e vitit 1962 mbi mbrojtjen e saj thuhet se ka vlera historike, sociologjike, artistike, urbanistike dhe kulturore.

**Ura e Tabakëve** – Ura e tabakëve mbi lumin Erenik, e ndërtuar nga Esnafi i Tabakëve të Gjakovës, më 1771, lidhte Gjakovën me Shkodrën. Është e gjatë 127 m dhe ka 14 qemerë me dritare shkarkuese. Në të janë të gdhendura shumë reliefë. Në njërin nga qemerët e urës është e gdhendur një pëllëmbë dore me gishta, një rozetë e Vogël me një sferë në mes dhe me rreze në mes të saj, me një figurë në trajtë gërshëre, vegël pune e esnafit që e ndërtoi urën. Në vendimin mbi mbrojtjen e urës me ligj të vitit 1962 thuhet se ka vlera historike, sociologjike, artistike, urbanistike dhe kulturore.

In the reasoning of the decision on the protection of this complex, which included the mosque, the library, the school, the fountain and the cemetery. In 1999, complex was burned, from which only the mosque survived with its shelled minaret and with the entrance door burned and the damaged arabesque.

**Taliqi Bridge** - is built on the river Krena and connects the older part, stretching on the west side, with the newest, on the eastern side of it. The bridge is over 21.50 m long, 4.05 m wide and with a height of 5.0 m. There were three backed vaults with two discharging windows, and later had two large arches and two columns. It had on 7.0 m of length a wooden construction. The decision of 1962 on its defence reports that it has historical, sociological, artistic, urban and cultural values.

**Tabak Bridge** - It was built on the River Erenik by the Esnaf of Gjakova in 1771, linking Gjakova to Shkodra. It is 127m long and has 14 lintel windows with discharge. Reliefs are carved on them too. In one of the archway of the bridge a hand palm with fingers is carved, a rosette with a small sphere and radius within, a scissors-like figure, the working tool of the esnaf (craftsman) who built the bridge. In the decision on the protection of the bridge by the law of 1962 it is said to have historical, sociological, artistic, urban and cultural values.

Fig. 27 - Ura e Taliqit (MKRS)  
Fig. 27 – Taliqi Bridge (MCYS)



Fig. 28 - Ura e Tabakëve (MKRS)  
Fig. 28 – Tabakëve Bridge (MCYS)

**Kulla e Koshit** – E ndërtuar në shek. XIX në Krye të Pazarit është nën mbrojtje prej vitit 1980. Paraqet një banesë kullë trekatëshe prej guri. Më herët Quhej kulla e Batushave, sepse ishte pronë e agëve të Batushës, një familje e njohur, pjestarët e së cilës morën pjesë në disa luftëra gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Është ndër shembujt e rrallë të kullës së gurit, të ruajtur në qytet.

Më 1927, Hysni Koshi nga kjo kullë i pengoi xhandarët e “kralit” që kishin filluar ta rrënonin varrin e Maxhar Pashës me pushkën e fshehur me mjeshtri nga i zoti.

Në arsyetimin e cekët të vendimit mbi mbrojtjen e këtij monumenti shquhet si kullë fortifikuese e Rrafshit të Dukagjinit e ndërtuar nga mjeshtrë shqiptar.

**Teqja e Shejh Eminit** – Teqja i takon Tarikatit Sadi. Është ndërtuar nga vet Shejh Emini (arkitekt i njohur i Gjakovës që projektoi shumë objekte dhe komplekse të ndryshme arkitekturore) më 1730 dhe e rindërtuar më 1856, ndërsa nën mbrojtje me ligj qëndron nga viti 1956. Në konceptin arkitekturor objekti i takon arkitekturës popullore qytetare. Paraqet një kompleks objektesh me teqen, tyrben, samahanen, krojet, shtëpi dhe objekte të tjera përcjellëse. Si në enterier ashtu edhe në eksterier është e pasur me elemente dekorative druri të gëdhendur. Ky element shquhet për dhomën e mysafirëve në kat që e ka formën e tetkëndëshit.

Në vendimin për mbrojtjen e këtij objekti thuhet se ky monument është shumë interesant në pikpamje arkitekturore, se paraqet ekzemplar të rrallë të arkitekturës sakrale që do të shërbej për studimin e përmendoreve të këtij lloji.



Fig. 29 - Kulla e Koshit (IPH)

Fig. 29 – Koshi's Kulla (ISP)

**Koshi's Kulla** – Built in XIX century, at the top of the bazaar, is under law protection since 1980. It presents a three-story dwelling kulla of stone. Earlier it was known as Batushas' kulla because it was owned by the Aghas of Batusha, a known family, whose members participated in several wars during the Albanian National Renaissance. It is among the rare examples of the stone tower, preserved in the city.

In 1927, from this Kulla Hysni Koshi prevented with his rifle the King's gendarmes that had begun to break the tomb of Maxhar Pasha.

In the reasoning of the decision on its protection it stands out as a typical fortified tower of Dukagjini plain built by Albanian masters.

**Tekke of Sheikh Emini** – belongs to Sad Tariqa (Sufi order). It was built by Sheikh Emini own (famous architect who designed many premises in Gjakova and various architectural complexes), in 1730 and reconstructed in 1856, while it is enlisted since 1956.

The architectural concept belongs to the vernacular civic architecture. It presents an ensemble of different objects such as tekke, tomb, samahane, springs, homes and other associated facilities. As in the interior, the exterior is rich in elements carved in decorative wood. This element is known for the guestroom in the floor that has an octacular form. In the reasoning of the decision on its protection, the tekke stands out as very important for the architectural values as it presents rare samples of sacral architecture, useful for the analyse of this type of monuments.



Fig. 30 - Muzeu Etnografik (MKRS)

Fig. 30 – Ethnographic Museum (MCYS)

### **Shtëpitë e vjetra qytetare** (Muzeu Etnografik)

Është ndërtuar rreth vitit 1810 dhe nën mbrojtjen e ligjit është që nga viti 1955. Paraqet një arritje kulmore të banesës qytetare me “qyshk” në Kosovë. Ka dy kate dhe dy qoshqe interesante me sitem edhe më interesant të ngrohjes. Tavanet janë të zbukuruara me drugdhendje.

Në arsyetimin e varfër të vendimit mbi mbrojtjen e këtij objekti, thuhet se është objekt shumë interesant arkitekturor, i cili përmban të gjitha karakteristikat e arkitekturës banesore qytetare. Në këtë ndërtesë është i vendosur Muzeu Rajonal. Këtu, në këtë zonë janë edhe Hani i Haraqisë, Kulla e Sahatit, Lapidari i Lidhjes së Prizrenit dhe Kompleksi i Sylejman Vokshit e të tjera.

**Ura e Terezive në Bishtazhin.** Ura më 11 harqe në formë gjysmë harku dhe me 10 dritare shkarkuese midis tyre, është ndërtuar me material guri, më 1730 dhe që nga viti 1962 është nën mbrojtje me ligj. Ndërtimi i saj me gjatësi prej 192.8 m dhe gjerësi prej 5.1 m, u bë mbi lumin Erenik, që lidhte Gjakovën me Prizrenin, nga *Esnafet – Terzi* të Gjakovës. Në vendimin mbi mbrojtjen e saj thuhet se përmban vlerë historike, sociologjike, artistike, urbanistike dhe kulturore.



Fig. 31 - Ura e Terezive në Bishtazhin (MKRS)

Fig. 31 – Terezive Bridge in Bishtazhin (MCYS)

**Vernacular dwelling house (Ethnographic Museum)** - was built around the year 1810 and protected by law since 1955. It represents an achievement of the flat roof vernacular dwelling with 'qyshk' in Kosovo. There are two floors and two corners ('qoshqe') with the most interesting operating heating systems. Ceilings are decorated with carved wood. In the poor reasoning of the decision on the protection of this building, it is mentioned as a very interesting architectural object, which contains all the characteristics of urban residential architecture. In this building is situated Regional Museum which contains also Haraqija Inn, the Clock Tower, the monolith of the League of Prizren and Sylejman Vokshi's Complex, etc.

**Terzive Bridge in Bishtazhin** – The Bridge has 11 arches in half-arch shapes and 10 discharging windows between them. It is built with stone material, around the 1730 and since 1962 is protected by law. It is a construction with a length of 192.8 meters and a width of 5.1 m, on Erenik River, which linked Gjakova and Prizren by Gjakova's esnafs/terzis (artisans). The decision on its protection reports that it has historical, sociological, artistic, urban and cultural values.



Fig. 32 - Ura e Fshajt (IPH)

Fig. 32 – Fshajt Bridge (ISP)



Fig. 33 – Kanjoni i Drinit (IPH)  
Fig. 33 – The Canyon of Drin (ISP)

### **Xhamia e Hasan Agës**

Është nën mbrojtjen e ligjit që nga viti 1970. Në vendimin mbi mbrojtjen e këtij objekti thuhet se xhamia me minaren janë të mbuluara me llamarinë plumbi dhe se në pjesën e brendshme të mureve ekzistojnë tetë pilastra të fortë, që bartin trompet dhe kupolën. Sipas sistemit të ndërtimit, konsiderohet i dytë i këtij lloji në vend. Mënyra e ndërtimit e kësaj xhamie ka ngjashmëri me Xhamin e Hadumit në Gjakovë dhe xhamin e Sinan pashës në Prizren. Në të ishin të ruajtura lokalet e shkollës, në të cilën edukoheshin dhe arsimoheshin fëmijët e shumë familjeve provinciale, që ishte gjë e rrallë në shek. XVII e XVIII. Zbukurimet e mbrëndshme pasqyrojnë artin provincial. Përreth saj ekzistonin varrezat me nishane dhe mbishkrime, të periudhës më të hershme, deri më 1932, kur aty u ndërtua shkolla.

### **Kanjoni i Drinit Bardhë dhe Ura e Fshajtë në Ujëz**

Në këtë zonë, përveç monumenteve të shumta kulturo-historike, gjenden edhe fenomenet e trashëgimisë natyrore Kanjoni Gryka e Drinit Bardhë në Ujëz dhe Druri Unik në Evropë "Brosha" në Rugovë. Ardhja e vizitorëve në zonë, mund të joshet edhe nga shumë opsione tjera që ofrohen në zonë për kënaqësinë e tyre turistike, sikur: Larja dhe noti në të hapur, Kërcimi dhe Zhytja në ujë, Shikimi i Garave Tradicionale "Kërcimi nga Ura e Fshajtë", Peshkimi garues dhe ai rekreativ gjatë gjithë vitit, Lundrimi me barka, Kampingu, etj. Në këtë zonë, gjenden edhe Fortifikimi i shek. IV – VI në Gexhë; Tuma Ilire te Ura e Fshajtë, shek. VIII – III P.E. Sonë në Ujëz si dhe Tuma parahistorike, Ura dhe Vendbanimi i shek. I – IV, Varreza mesjetare, Ura e Hijes së Metës dhe Kulla e Ymer Pogës (e vetmja me kupolë) të gjitha në Rogovë.

**Hasan Aga's Mosque** - It is under law protection law since 1970. In the decision on the protection of this facility it is reported that the mosque with minaret is covered with lead sheet and that on the inside of the walls there are eight stron pilastras, and trompe-bearing dome. It is considered the second of its kind in the country. The method of construction of this mosque has similarities with the Hadum Mosque in Gjakova and Sinan Pasha Mosque in Prizren. There were preserved classrooms, which educated many children of many provincial families were educated that was a rare thing in XVII and XVIII century. Interior decorations reflect provincial art. There existed around marked graves of the earlier period until 1932, when a school was built there.

**The canyon of White Drin and the Fshajtë Bridge in Ujëz** - In addition to numerous monuments of cultural and historical heritage in this area there are also two natural phenomena, the canyon of the White Drin in Ujëz and a unique wood in Europe "Brosha" in Rugova. The arrival of visitors in the area may be tempted by many other options offered for touristic pleasure, like sunbathing and swimming in the open, diving and the water jump, traditional spectacle of the "Fshajt Bridge Jump" competition, fishing, recreational run around the year, boat navigation, camping, etc. This area is a home to a Fortification of the IV - VI century in Gexhë; the Illyrian tumulus in Fshajtë Bridge, c. VIII – B.C. in Ujëz and prehistoric tumulus, the bridge and the settlement from I – IV centuries, the medieval cemetery, the bridge of Hija e Metës and Ymer Poga's kulla (the only one with the dome), all in Rogova.



Fig. 34 - Xhamia e Hasan Agës në Rogovë (MKRS)  
Fig. 34 – Hasan Agha's Mosque in Rogova (MCYS)



Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet përkatëse komunale

### Planifikimi dhe zhvillimi urban i komunës së Gjakovës

Qyteti dhe komuna e Gjakovës është ndër të parat nga zonat dhe qendrat e mëdha urbane të Kosovës që është zhvilluar duke u bazuar në Plane si: Plani Hapësinor për Komunën e Gjakovës (1988), Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban (2006), Plani Gjeneral Urban (1968 dhe 1973) dhe Plani Gjeneral Urban (1988), Planet e Përgjithshme Urbanistike për 23 Fshatra, 6 Planet Detale Urbane si dhe 6 Zgjidhjes Urbanistike për zonat e veçanta, e tjera.


Duhet theksuar se Planet Hapësinore Komunale dhe ato Gjenerale Urbanistike të Gjakovës, prej viteve të '60-ta e deri para konfliktit të armatosur të 1999-ës, janë përgatitur në harmoni me sistemin dhe sipas kërkesave të kohës, kur edhe janë dizajnuar. Dihet se atë botë, akoma nuk ishin ngritur kapacitetet njerëzore dhe institucionale Kosovare (vendore), si në grumbullimin e të dhënave ashtu edhe në hartimin e planeve hapësinore dhe urbane. Përderisa, hartuesit e këtyre planeve ishin nga trevat tjera të ish Jugosllavisë, atëherë edhe mënyra e përfshirjes dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore dhe historike varej nga dëshira, vullneti por edhe angazhimi i tyre profesional për sigurimin e informatave të nevojshme dhe bashkëpunimin me ekspertë vendor (sado që në numër të vogël ekzistonin) rreth çështjes së trashëgimisë kulturo-historike.

Përfshirja e trashëgimisë kulturore dhe historike në planet e deritanishme hapësinore, zhvillimore dhe urbane është analizuar në disa plane që i përkasin periudhave të ndryshme të zhvillimit hapësinor të komunës.

### Plani Gjeneral Urban i Gjakovës - Viti 1968 dhe 1973

Fig.35 - Kufiri i zonës urbane sipas PGJU 1968 (PZHK, 2006).

Fig.35 - Boundary of urban zone according to GUP 1968 (MDP, 2006)



Inclusion of cultural heritage in the respective municipal plans

### **Spatial and urban development in Gjakova/Djakovica**

The city and municipality of Gjakova/Djakovica is among the first of the areas and large urban centers of Kosovo that was developed based on the plans as Spatial Plan for the Municipality of Gjakova/Djakovica (1988), Municipal and Urban Development Plan (2006), Urban General Plan (1968 and 1973) and General Urban Plan (1988), the General Urban Plan for the 23 villages, 6 Detailed Urban Plans and Urban Settlement for 6 separate zones, etc.

Should be noted that General Municipal Plans and Urban Plans for Gjakova, from the 60-sto the armed conflict in 1999 have been prepared in accordance with the system and the needs of the time. It is known that during that time human and institutional capacities of Kosovo (local) were not set up neither for data collection nor for the design of spatial and urban plans. While the compilers of these plans were from other regions of former Yugoslavia, the method of inclusion and treatment of cultural and historical heritage depended on their will, and also on their professional commitment to provide the necessary information and cooperation with local experts (that existed however in small numbers) on the issue of cultural and historical heritage.

The inclusion of cultural and historical heritage issues in the past spatial, urban and development plans has been separated into two phases:

### **Urban General Plan of Gjakova - 1968 and 1973**

Fig.36 - Planin Hapësinor për Komunën e Gjakovës, (1988).

Fig.36 – Gjakova/Djakovica Municipality Spatial Plan, (1988).



Plane të mëhershme hapësinore për tërë komunën e Gjakovës nuk ka pasur. Mirëpo, ishte Plani Gjeneral Urban (PGJU) i vitit 1968 si dhe PGJU i vitit 1973, të cilët zhvillimin dhe shtrirjen e qytetit të Gjakovës e shihnin në drejtimin Veri – Jug (përgjatë rrugës Pejë – Prizren) deri për rreth lumit Erenik.

Trashëgimia kulturore dhe historike nuk është përfshirë dhe trajtuar sa dhe si duhet. Nuk mund të pritej një gjë e tillë të ndodhte në këtë kohë sepse, aso kohe, ishte trend tjetër, lëvizja kah modernizimi dhe shkatërrimi i së kaluarës. Mungonin apo ishin të rrallë, ekspertët vendor për themelimin dhe udhëheqjen e Institucioneve përkatëse për planifikim dhe për hulumtimin dhe grumbullimin e të dhënave të reja mbi trashëgiminë kulturore dhe historike si dhe përkujdesjen ndaj asaj të njohur.

Hartimi i këtyre Planeve bëhej nga ekspertët nga institucionet jashtë Kosovës (nga ish RSFJ/Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë), të prirë nga politika e kohës, duke mos përfshirë ekspertët e rrallë Kosovar të trashëgimisë dhe të planifikimit në ekipet punuese, si dhe duke mos i angazhuar fare për bashkëpunim.

Trashëgimia kulturo-historike në këto plane, është shprehur si shumë e varfër dhe atë përmes disa fotove të vjetra të rrugëve dhe objekteve të qytetit, pa ndonjë shtrirje dhe trajtim tekstual dhe hartografik adekuat. Ngelet të supozohet se ajo ekzistonte vetëm në bërthamën (zonën) e vjetër të qytetit të Gjakovës. Me përfshirjen e tillë të trashëgimisë kulturo-historike në këto plane, lë përshtypjen e mungesës së të dhënave por edhe të shtynë të dyshohet në profesionalizmin dhe vullnetin e hartuesit të huaj të dokumentit.

Fig.37 – Detaj nga Plani Gjeneral Urbanistik (1980)  
Fig.37 – A detail from the General Urban Plan (1980)



Spatial plans for the municipality of Gjakova/Djakovica as a whole never existed, but it was the Urban General Plan (GUP) of the 1968 and GUP of 1973, which regulated the development and the expansion of the town in a north - south axis (along the Peja – Prizren road) to the river Erenik.

Cultural and historical heritage was not included and treated as it should, which we also cannot expect such thing to happen at the time. At that time, there was another trend, the movement toward modernization and the destruction of the past. Local experts for the establishment and management of relevant institutions for planning and for research, investigation and collection of new data on cultural and historical heritage were absent or very rare.

The development of these plans was done by experts from institutions abroad (from the former SFRY), led by political agendas of that time, not including the rare kosovar experts in regard to heritage and planning in the working teams or not offering them cooperation.

Cultural and historical heritage in these plans is poorly expressed through some old pictures of streets and buildings of the city, without any stretch of textual and cartographic treatment and adequate information. It has to be assumed that it existed only in the nucleus (area) of the old town of Gjakova. By such a bad inclusion of cultural and historical heritage in these plans, the impression is the lack of data but also is pushed to doubt the professionalism and willingness of foreign compilers of the document.



Fig.38 - Harta e Planit Gjeneral Urbanistik (1988)  
Fig.38 – The map of General Urban Plan (1988)

## Plani Hapësinor për Komunën e Gjakovës - Vitit 1988<sup>47</sup>

Në pjesën e I-rë **“Gjendja dhe Vlerësimi i rregullimit hapësinor”**, të Planit Hapësinor për Komunën e Gjakovës (Dhjetor 1988), trashëgimia kulturore-historike është përfshirë dhe trajtuar së bashku me atë natyrore në mënyrë të varfër nga sa pritej nga Instituti i Sarajevës. E gjithë përfshirja dhe paraqitja e saj, si pjesë tekstuale si dhe shtrirja e saj hapësinore në hartën e territorit komunal të Gjakovës, haset vetëm në këto dy faqe, siç shihet edhe në foton e mësipërme. Këtu, në listën e atëhershme të monumenteve të mbrojtura me ligj, përmenden objektet dhe tërësitë nga:

Trashëgimia natyrore / Parkut Nacional “Alpet Shqiptare (apo Bjeshkët e Nemuna)”, Rariteti natyror “Gryka e Drinit” dhe Parku Memorial “Qabrati” / si dhe

Trashëgimia kulturore e historike, e listuar ndaras, sipas vlerave dhe kohëve të ndryshme /Koha e metalit (Ujz, Rogovë dhe Qerim), Antika (Doblibare dhe Bishtazhin), Mesjeta (Urat e Terezive, Tabakëve dhe Taliqëve), Arkitektura e qytetit (Xhamia e Hadumit, Teqja e Sheh Eminut dhe katër shtëpi banimi në ish rrugën M. Tito), Ansambli arkitektonik në Cërmjan, Zona e Urbanizimit historik “Çarshia e Madhe në Gjakovë” dhe Tetë Përmendoret të cituara nga Lufta Nacional Çlirimtare (LNÇ-ja ku janë: Shtëpi, Pllaka Përkujtimore dhe Përmendore nëpër rrugë me emra të ndryshëm).

Në pjesën e II-të, **“Interesi i Përbashkët dhe Caqet e Rregullimit Hapësinor”**, nuk e gjejmë të përmendet ndonjë cak (synim) i veçantë për trashëgiminë kulturo-historike, por mund të përfshihet disi në, atë synim të rreshtuar si i fundit faqe 58, citoj: “Të sigurohet ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të krijuara natyrore, në bashkërendim të interesit mbrojtës ndaj zhvillimit të aktiviteteve tjera, kur njëkohësisht rigjallërimi dhe rregullimi i këtyre vlerave vihet në funksion të plotësimi të nevojave shpirtërore dhe fizike”.

<sup>47</sup> Instituti për Arkitekturë, Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i Fakultetit të Arkitekturës në Sarajevë, **Plani Hapësinor për Komunën e Gjakovës (1988)**, Janar 1989 Sarajevë.

Në pjesën e III-të, **“Projeksionet e Rregullimit Hapësinor”** faqe 103, një ndër politikat e zhvillimit Ekonomik ceket edhe: “Aktivizimi i Çarshisë së Madhe dhe Hotelit Ri do të nxisin zhvillimin e turizmit tranzitor e me të edhe funksionimin e zanateve dhe punës dorës”.

Në pjesën e IV-të, **“Korniza e Masave dhe Orientimet për Zbatimin e Zhvillimit Hapësinor”**, nuk e gjejmë asnjë masë që tregon për përfshirje apo trajtim të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Këtu mund të vërehet se, Fazat e këtij Plani janë të ngjashme me fazat e Planit Hapësinor, që kërkohen edhe me Ligjin për PH 2003.

## Plani Gjeneral Urbanistik i Qytetit të Gjakovës 1988<sup>48</sup>

Ky Plan, siç shihet edhe në fig. 25, zhvillimin e qytetit të Gjakovës e orientonin kah zgjerimi i tij në drejtimin Lindje – Perëndim, për dallim nga planet e mëparshme, që ishte në drejtimin Veri - Jug.

Në këtë Plan, trashëgimia kulturo-historike është përfshirë pak më shumë dhe brenda mundësive dhe informatave në dispozicion hartuesit e Planit. Duhet theksuar këtu, se nuk ka munguar edhe aq shumë dëshira dhe vullneti i hartuesit, përderisa i është dhënë hapësirë më e madhe sa i përket përfshirjes dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore dhe historike. Kjo tregohet edhe në pjesën hyrëse, në kaptinën II faqe 17, kur theksohet se në qytet dhe në afërsinë e tij janë gjetur gërmadha të rastësishme nga epokat e ndryshme, që nga Iliria dhe Roma, mirëpo pa ndonjë shënim më të saktë dhe shtrirje të caktuar të saj. Vlen të theksohet këtu, se në fund të kësaj pjese mbi gjendjen ekzistuese (të faqes 28), jepet vërejtje e nënvizuar, që thotë: “Bazuar në të dhënat gojore, që dispononim ne, ky qytet ka material të bollshëm mbi thesarin e shumë të trashëgimisë kulturore dhe historike, por akoma të pa publikuar. Prandaj, me keqardhje konstatojmë se nuk patëm mundësinë e trajtimit të saj në këtë Plan, porse nga këtu kërkohet që hulumtimet e bëra të përpunohen në hollësi dhe në veçanti, sepse trashëgimia kulturo – historike e Gjakovës e meriton këtë”.

<sup>48</sup> Instituti për Arkitekturë, Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i Fakultetit të Arkitekturës në Sarajevë, **Planin Gjeneral Urbanistik të Qytetit Gjakovës ( 1988)**, Janar 1988 Sarajevë.

## Spatial Plan for the Municipality of Gjakova/Djakovica of 1988

In the Part I of **“The Situation and Evaluation of spatial regulation”** of the Spatial Plan for the Municipality of Gjakova/Djakovica (December 1988), cultural, historical and natural heritage is included and treated very poorly from the Institute of Sarajevo. Its entire inclusion and presentation, text and the spatial stretch of the territory of Municipality of Gjakova/Djakovica is limited to only two pages, as seen in the picture above. Here, in the list of monuments protected by law are mentioned the buildings and sites of:

Natural Heritage / National Park “Albanian Alps (or Accursed Mountains)”  
Natural Rarity “Drini Canyon” and Memorial Park “Qabrati”, and  
Cultural and historical heritage, listed separately, under different values and recent / the Iron Age (Ujz, Rogova and Qerim), Antique (Doblibare and Bishtazhin), Middle Ages (Terezive bridges, Tabakeve and Taliqëve)  
city architecture (The Hadum Mosque, Tekke Sheikh Emini and the four houses in the former M. Tito street), the architectural ensemble in Cërmjan, the historic urban area of the Grand Bazaar in Gjakova, and the cited eight monuments from NLM (Houses, commemorative plaques and Monuments) in the street with different names.

In Part II, **“Common Interest and Spatial objectives”**, no objective is found concerning cultural and historical heritage, but could be included somehow the page 58, which quotes: “The preservation and protection of natural values must be ensured in harmony and in coordination with protective interests and the development of other activities, when both revival and regulation of these values is put in place to meet the spiritual and physical needs.”

In Part III, **“Projections of Urban Space”**, page 103, one economic development policy also noted, “Start of the Big Bazaar will stimulate tourism development and along with it the functioning of crafts and hand-working.”

---

<sup>49</sup> Institute of Architecture, Urbanism and Spatial Planning of the Faculty of Architecture in Sarajevo, the Spatial Plan for the Municipality of Gjakova (1988), January 1989, Sarajevo.

In Part IV, **“Framework for Action and guidelines for the implementation of Spatial Development”**, we don't find any measure of involvement or treatment concerning historical and cultural heritage. Phases of this plan are similar to the stages of the Spatial Plan required by Law for SP 2003.

## Urban General Plan for the City of Gjakova 1988<sup>50</sup>

This plan, as seen in figure 25, oriented the development of the city of Gjakova towards its expansion in the direction east - west, unlike previous plans where the expansion of the city was oriented in the direction North - South.

In this Plan, the historical and cultural heritage is a bit more and included within the information available for the drafters of the Plan. It should be noted that here, there has been so much desire and will of the drafters, as has been given greater space in terms of inclusion and treatment of cultural and historical heritage. This is shown in the introductory section, in Chapter II page 17, where the emphasis is on the Roman and Illyrian relics found in random areas of the city and its vicinity.

It is worth mentioning here, that at the end of this section (at page 28), was given the following remark:

*“Based on oral information that we have, this city has abundant material on the treasures of cultural and historical heritage, but still unpublished. Therefore, with regret we did not conclude the treatment of this treasure in this Plan, but we ask for research to be done in detail and in particular for cultural and historical heritage – because Gjakova deserves it.”*

---

<sup>50</sup> Institute of Architecture, Urbanism and Spatial Planning of the Faculty of Architecture in Sarajevo, **the Spatial Plan for the Municipality of Gjakova (1988)**, January 1989 Sarajevo.

Prandaj, në këtë Plan<sup>51</sup>, jepen përshkrime të shkurtra, për tërësinë monumentale të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, të ilustruara edhe me skica si në figurën më poshtë, ashtu edhe për monumentet më vete nga lista e tyre nën mbrojtje e atëhershme.

Në fund, nga aspekti strategjik, nga ky Plan dalin kërkesat për hartimin e disa planeve, si të:

- planeve të përgjithshme urbanistike për disa fshatra (vendbanime rurale)
- planeve detale urbanistike për disa zona të qytetit dhe zgjidhjeve urbanistike për disa zonave me interes të veçantë, me kërkesën e mëparshme të përmendur, për hulumtimin më të hollësishëm të të dhënave dhe trajtim më të kujdesshëm të trashëgimisë kulturore dhe historike gjatë hartimit të planeve të përmendura.




Fig.39 - Skica nga pjesë të Çarshisë së Madhe në PGJ (1988).

Fig.39 – A sketch from the parts of the Bazaar/Çarshia e Madhe in GUP (1988).

<sup>51</sup> Në kaptinën III, faqe 25 deri në 28

Therefore, in this Plan<sup>52</sup>, are provided brief descriptions, for the Grand Bazaar in Gjakova, illustrated with sketches as in the figure below, as well as informations on monuments other than those contained in the protection list of that time.

Finally, from strategic point of view, this plan gave birth to requirements for certain plans, such as:

- general urban plans for some villages (rural areas)
- detailed urban plans for some areas of the city, and urban solutions for several areas of particular interest, with the previous requirement for more detailed research of data and careful treatment of historic and cultural heritage during the drafting of general and detailed plans and future urban solutions.




Fig.39a - Skica nga pjesë të Çarshisë së Madhe në PGJU (1988).

Fig.39a – A sketch from the part of the Çarshia e Madhe in GUP (1988).

<sup>52</sup> Chapter III, page 25 to 28



## Plani Zhvillimor Komunal dhe Zhvillimor Urban i Gjakovës (PZHK / PZHU 2008)<sup>53</sup>

Trashëgimia kulturo-historike dhe natyrore, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban, të hartuara nga kompania "InTECH" dhe nën menaxhim të Drejtorisë për Urbanizëm, janë trajtuar paksa më shumë nga planet e mëparshme. Këtu nuk ka munguar bashkëpunimi i hartuesit me institucionet dhe ekspertët për planifikim dhe trashëgimi kulturo-historike dhe natyrore. Mirëpo, punimet, publikimet dhe sugjerimet e tyre nuk janë përfillur gjitha.

Falë bashkëpunimit të ndërsjellë, të kapaciteteve të ngritura njerëzore dhe institucionale si në nivelin lokal në Gjakovë ashtu edhe në atë qendror në Kosovë, niveli i trajtimit dhe i shtrirjes hapësinore të trashëgimisë kulturore e historike dhe asaj natyrore është ngritur.

Nga analiza për vlerësim të përfshirjes së trashëgimisë kulturo-historike në PZHK dhe PZHU, që në rastin e Gjakovës janë të bashkërenditura në një kornizë vëllimore, bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor (LPH 2003), përfundimet e dala krahas hartës si ilustrim, janë dhënë si në vijim.


Në këto plane të nivelit komunal, vendndodhjen e zonave me peizazhe dhe trashëgimi natyrore: të liqenit ekzistues të Radoniqit dhe atij të ardhshëm të Morinës, kodrës së Çabratit dhe të Sukës së Cërmanit si dhe grykën e Drinit të Bardhë, e gjejmë të trajtuar dhe të shtrirë në hapësirën komunale të Gjakovës (si në hartën ilustruese). E njëjta, nuk mund të thuhet edhe për zonat e objekteve dhe tërësive me trashëgimi kulturo-historike.

Për dallim nga planet e mëparshme, këtu trashëgimia kulturo-historike, është përfshirë dhe trajtuar më tepër. Është pasuruar "Lista e monumenteve të mbrojtura me Ligj" dhe paralajmërohet për një spektër më të gjerë të monumenteve nga inventarizimi në proces e sipër prej vitit 2003 në trevat e komunë së Gjakovës.

<sup>53</sup> Kuvendi Komunal i Gjakovës dhe Konsorciumi në krye me Institutin e Shkencës dhe Teknologjisë "InTECH", *Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Gjakovës (2006)*, Gjakovë, Mars 2008.

Fig.40 - Hartat nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban, 2008.

Fig.40 - Maps from Municipal Urban and Development Plan, 2008.



## Municipal Development Plan and Urban Development of Gjakova/Djakovica (MDP / UDP 2008)<sup>54</sup>

Cultural, historical and natural heritage, within the Municipal Development Plan and Urban Development Plan, designed by the company "InTECH" and under the management of the Department of Urbanism, is treated to some extent than in earlier plans. Here there has been cooperation with institutions and experts for planning and cultural, historical and natural heritage. However, works, publications and suggestions are equally neglected.

Thanks to mutual cooperation, the drafting company of the plans and human and institutional capacity set up at the local level in Gjakova and in central Kosovo, the level of treatment of cultural, historical and natural heritage is more important than previous plans.

From the analysis for the assessment of the inclusion of cultural-historical heritage in the MDP and UDP, which in the case of Gjakova forms part of the same framework based on the Law on Spatial Planning (LSP 2003), conclusions along with the resulting map as an illustration, are given as follows.


In these plans at the municipal level, the location of areas with landscapes and natural heritage, of the existing lake of Radoniq and the future Morina Lake, Çabрати hill and the Cërmjanit Sukës and the White Drin gorge, are found to be elaborated and extended within the municipal area of Gjakova/Djakovica (as in the illustrative map), the same can not be said for areas of monuments and sites of cultural and historical heritage.

Unlike earlier plans, cultural and historical heritage here, is included and handled better. The list of monuments protected by law is enriched and will continue to grow in a wider range with monuments from the ongoing inventory (since 2003) in the lands of the municipality of Gjakova/Djakovica.

<sup>54</sup> Municipal Assembly of Gjakova and Consortium led by the Institute of Science and Technology "InTECH", *Municipal and Urban Development Plan of Gjakova (2006)*, Gjakova, March 2008.

Fig.41 - Hartat nga Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban, 2008.

Fig.41 – Maps from Municipal Urban and Development Plan, 2008.



Në **Profilin e gjendjes ekzistuese**, kjo trashëgimi është trajtuar si thesar dhe potencial për joshjen e vizitorëve dhe zhvillimin e turizmit, janë evidentuar monumentet dhe tërësitë me trashëgimi dhe vendndodhja e tyre, mirëpo pa ndonjë shtrirje në hapësirë apo zonë të përcaktuar me kufij të definuar. Kështuqë, këtu është paraqitur në mënyrë simbolike, vendndodhja “e mundshme” e objekteve dhe tërësive nga “Lista e monumenteve të mbrojtura me Ligj”, si në hartën e mësipërme- majtas. Përderisa, shtjellimi tekstual i çështjes së trashëgimisë, edhe pse pjesë të shumta janë përshkruar nga PHK 2009 – 2020+, nuk sjell diçka të re në informata, përveç disa rekomandimeve, të cilat janë dhënë si Objektiva, se si duhet vetëdijesuar popullin dhe trajnuar rininë për ruajtjen e trashëgimisë, tek analiza SWOT. Tek **Vizioni**, trashëgiminë kulturore dhe historike e hasim që në fillim të skemës zhvillimore dhe të Deklaratës së Vizionit. Mirëpo, edhe pse atë e gjejmë të jetë potencial për joshje të vizitorëve të huaj, nuk e gjejmë të inkuorporuar drejtpërdrejtë në asnjërin nga Parimet e Përgjithshme, përderisa në Caqet dhe Potencialet Zhvillimore Afatgjate e hasim si të pësuar në luftën e fundit (të vitit 1999). Më tej, në **Kornizën e Zhvillimit Hapësinor Komunal dhe Urban**, tek “Perspektiva e Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore”, nën Objektivat e përgjithshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me veprimet që duhet ndërmarrë organet komunale, i gjejmë ato të jenë marrë dhe cituar nga PHK 2005 – 20015 (tani i rishikuar 2010 – 2020+). Përderisa në **Strategjinë dhe Veprimet për Zbatim**, trajtohen në formën e “ruajtjes për peizazhet e luginave lumore dhe gjelbërimi i Çabratit dhe zonave të degraduara”, nuk hasim në asnjë veprim të ardhshëm t'i jetë kushtuar trashëgimisë kulturore dhe historike. Nuk është kërkuar as edhe trajtim i veçantë i trashëgimisë kulturore dhe historike gjatë “hartimit të planeve rregulluese për zonat ekzistuese dhe të reja, planeve ri-zhvilluese të zonave industriale, planeve zhvillimore urbane për vendbanimet rurale të caktuara për qendra sekondare”, që kërkohen me këtë Plan.

<sup>69</sup> Declaration of Vision, -“Peja a modern centre for tourism, agro-industry, education and healthcare, with pro European objectives strengthened by good road connections with the region, with a suitable private business environment, swift economic development through industrial zones and business parks, which affect the employment rate and improvement of living conditions for all the citizens of the city, where the city will be characterised with a clean and pleasant environment, with the preservation and renovation of cultural and historical monuments and the traditions of an ancient civilisation.” – MDP of Peja, p.63.



Në pjesën e strategjisë flitet për rëndësinë dhe mbrojtën e trashëgimia kulturore, me theks të veçantë pjesën e vjetër të qytetit dhe Patriarkanën e Pejës. Një paqartësi ekziston kur thuhet në vazhdim se objektet tjera që duhet mbrojtur do të integrohen në Sistemin Informativ Gjeografik.

Në dokument më tutje kemi një ndarje me rajone, në të cilën përshkruhet funksioni i tyre, veprimet dhe restriksionet e mundshme.

Në Rajonin Urban përshkruhen funksionet dhe propozimet për mundësinë e lidhjes së bjeshkëve të Rugovës me qytetin e Pejës, përmes:

- mbrojtjes së Bjeshkëve të Nemuna në kuptim të resurseve natyrore që posedon,
- ndalimit të ndërtimit të lartë në pjesën qendrore të Pejës, për arsye të ruajtjes së vizurave si nga bjeshka në qytet ashtu edhe nga qyteti në bjeshkë;

Element tjetër i propozuar është edhe mundësia e zhvillimit të turizmit me ofrimin e produkteve vendore në dyqanet e qendrës së qytetit, gjegjësisht Çarshisë së Pejës.

Po ashtu është propozuar, rilokimi i pjesës industriale që i takon zonës urbane të qytetit dhe ndalimi i ndërtimit në pjesën arkeologjike që sot në këtë pjesë gjendet fabrika e baterive.

Disa nga veprimet e propozuara janë: dislokimi i vendbanimeve joformale nga lokacionet padëshirueshme; dhe mbrojtja e zonave të gjelbra të qytetit.




Fig.57 – Detaj nga harta e Strategjisë së komunës  
Fig.57 – A detail from the Strategy map of municipality

This part of the strategy discusses the importance and the protection of cultural heritage, with a special onus on the old part of the city and the Patriarchate of Peja. It is unclear what is meant by the following conclusion which indicates that other buildings that need to be protected will be integrated into the GIS.

The document continues by determining a separation of regions, in which their functions are described, actions and possible restrictions.

In the Urban region the functions and proposals are described on the possibility of linking the mountains of Rugova with the city of Peja, through:

- Protection of the Cursed Mountains, meaning the natural resources it possesses
- Prevention of high-rise constructions in the central part of Peja, for the purpose of preserving the view from mountains to the city and from the city to the mountains;

Another proposed element is the possibility of tourism development with the provision of local products in the shops of the city centre, specifically the Peja Market.

The relocation of the industrial zone was proposed, which falls within the urban zone of the city, and the prohibition of construction in the archaeological areas, in which the battery factory currently stands.

Some of the proposed actions are: the relocation of informal settlements from inappropriate locations; and protection of the city green areas.




Fig.58 - Infrastruktura kulturore dhe turistike  
Fig.58 – Cultural and touristic infrastructure

Disa nga Restriksionet e propozuara për ndërtim dhe shfrytëzimin e tokës:

- Dendësia maksimale e vendbanimeve ekzistuese duhet të jetë 40 shtëpi/ha;
- Etazhiteti i objekteve të jetë P+2, përveç në zonat e përcaktuara me PZHU;
- Nuk do të lejohet industria që ndot ajrin dhe prodhon zhurmë përveç në zonën industriale të caktuar me PZHU;
- Nuk do të ketë ndërtesa në zonat e rezervuara për gjelbërim.

Një aktivitet me rëndësi në dokument është rekomandimi dhe kërkesa për autoritetet komunale që të vendosin kufijtë e saktë për zonat me interes të veçantë për Kosovën të cilat në Komunën e Pejës janë: Patriarkana e Pejës, kullat karakteristike, zona e Bjeshkëve të Nemuna etj. Në pjesën e fundit të dokumentit - Dispozitave për zbatim<sup>70</sup>, janë dhënë Kushtet dhe masat për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçantë:

- Kërkesa për hartimin e PH për zona të veçanta të propozuara nga niveli komunal (Për zonën e Patrikanës së Pejës)
- Hartim të PRrU për zonat e përcaktuara me PZHU, dhe
- Studim i fizibilitetit të lokaliteteve arkeologjike

Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike;

- Përzgjedhja e elementeve të trashëgimisë kulturore të cilat duhet mbrojtur
- Miratimi i rregulloreve përkatëse

**Plani Zhvillimor Urban<sup>71</sup> 2007 (PZHU)** – është plan i nivelit të dytë për nga rëndësia e zhvillimit hapësinor komunal, në të cilin në mënyrë më të detajuar janë trajtuar të gjitha qështjet e parapara në Planin Zhvillimor Komunal. PZHU përpunon principet e përmendura në PZHK për hapësinën urbane. Në dokument është elaboruar vetëm Kornizës dhe strategjia e zhvillimit urban të komunës së Pejës, sepse është konsideruar se pjesët tjera janë të ngjashme, prandaj nuk janë trajtuar në dokument. Në bazë të strukturave me karakteristika të ndryshme hapësinore të zonës urbane të Pejës është bërë ndarja në disa rajone me karakteristike, me përshkrim të principeve për struktura të caktuara. Propozimet, aktivitetet dhe rekomandimet për zonat e trajtuara, vlerësohen si hap pozitiv në drejtim të ruajtjes dhe trajtimit adekuat të trashëgimisë kulturore të përfshirë në këtë plan.

**Në Zonën qendrore** të qytetit dhe ngritje të atraktivitetit të saj, propozohet jetësimi i dyqaneve, kafeterive, restoranteve, shtëpive, shesheve, rrugëve, ndriçimit dhe komunikacionit dhe lumit që kalon në këtë pjesë të qytetit.

**Në Zonën arkeologjike të qytetit**, propozohet Zhvendosja e industrisë ekzistuese; Mundësia e gërmimeve arkeologjike; dhe Ndërtimi i parkingjeve, dyqaneve, një hoteli në afërsi të lokalitetit dhe mundësinë e qasjes së vizitorëve në lokalitet.

**Në Zonën e Sahat kullës**, propozohet kufizimi i etazhitetit në kontekst të mbrojtjes së peizazhit.

**Në Zonën e Patriarkanës së Pejës** propozohet, ndalimi i ndërtimit në këtë zonë duke i përjashtuar nevojat e Patriarkanës, dhe gjetja e zgjidhjes për lidhjen e Patriarkanës me bukuritë që e rrethon dhe me vet zonën urbane të Pejës.

<sup>70</sup>Plani Zhvillimor Komunal 2007, Dispozitat për zbatim, faqe 102

<sup>71</sup>Nga dokumenti i PZHU-së Pejë, i aprovuar më 14.05.2007

Some of the proposed Restrictions on constructions and land use are:

- Maximum population density in existing settlements should be 40 houses/ha;
- The height of building should be Ground + 2 upper floors, except for zones determined otherwise by the UDP;
- No industry that pollutes the air and produces noise will be allowed except for in the industrial zone, as determined by the UDP;
- There will be no buildings in the zones reserved for green areas.

An important activity foreseen in the document is the recommendation and request to the municipal authorities to determine the boundaries of special interest zones in Kosovo, which in the Municipality of Peja envisage: The Peja Patriarchate, Characteristic Kullas, The Cursed Mountains Zone (Bjeshkët e Nemuna), etc.

In the last part of the document – Implementation provisions<sup>72</sup>, the Conditions and Measures for the regulation of zones and areas of special value are determined:

- The need to develop the SP for special zones proposed by the municipal level (for Peja Patriarchate zone)
- Development of the RUPs for the zones determined by the UDP, and
- The feasibility study for archaeological sites

Measures for the protection of landscapes, natural values and cultural and historical areas:

- Selection of cultural heritage elements that need to be protected
- Adoption of appropriate regulations

**The Urban Development Plan<sup>73</sup> of 2007 (UDP)** – is a plan of a second level of importance in relation to municipal spatial development, in which all the issues foreseen in the Municipal Development plan are treated in a more detailed manner. The UDP processes the principles mentioned in the MDP related to urban areas. The document elaborates only on the Framework and urban development strategy for the municipality of Peja, because other parts were considered to be similar, and therefore, not treated in this documented.

Based on structures with different spatial characteristics of the urban zone of Peja, the separation in a number of regions with given characteristics has been made, with a description of principles for the given structures. All the proposals, activities and recommendations for the zones treated, are considered as a positive step in the direction of preservation and proper treatment of cultural heritage that is included in this plan.

**In the central zone** of the city and in order to make it more attractive, the revival of shops, cafeterias, restaurants, squares, streets, public lighting and traffic, and the river that crosses through this part of the city is proposed.

**In the archaeological zone of the city**, the relocation of the existing industry is proposed; the possibility of archaeological digging; development of parking areas, shops, a hotel near the site and provision of access for visitor to the site.

**In the Sahat Kulla zone**, the limitation on the height of buildings is proposed in the context of protecting the landscape.

**In the Peja Patriarchate zone**, the prevention of constructions in this area is proposed, excluding those for the need of the Patriarchate, and identifying the solution to linking the Patriarchate to the natural beauty that surrounds it, and with the urban zone of Peja itself.

---

<sup>72</sup>Municipal Development Plan 2007, Implementation provisions, page 102

---

<sup>73</sup>From the UDP document of Peja, approved on 140507

## Konkluzion

Në bazë të analizës së mësipërme të planeve të hartuara me vite dhe së fundi PZHK-së dhe PZHU-së, si dhe në bazë të përvojës së fituar gjatë vlerësimit të planeve zhvillimore komunale, në përgjithësi trajtimi i çështjes së trashëgimisë kulturore për rastin e Pejës është i nivelit të kënaqshëm.

Ndryshimet në sistemin politik, shoqëror dhe ekonomik të Kosovës, gjatë periudhave sa janë hartuar planet, kanë ndikuar në sistemin e planifikimit hapësinor, si dhe në përfshirjen dhe trajtimin e trashëgimisë kulturore të saj. Ky ndikim vërehet edhe në rastin e Komunës së Pejës.

Në dokumentin e parë të vitit 1956 – Plani Gjeneral Urbanistik i qytetit të Pejës, në mënyrë të detajuar përshkruhet çështja e trashëgimisë kulturore si dhe mundësitë e ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre.

Më tutje në Planin e Përgjithshëm Urban të vitit 1983, vërehet një rënie e dukshme për përfshirje të objekteve me vlerë të TK, e në disa raste edhe përpjekje për zhvlerësim deri në zhdukje të monumenteve jo ortodokse në tërësi.

Sipas informatave në periudhën prej 1993-1996 është hartuar Plani i Përgjithshëm Urban, i cili nuk është aprovuar në Asamble komunale dhe si të tillë komuna e Pejës nuk e posedon ndonjë kopje të tij.

Së fundi në PZHK dhe PZHU për komunën e Pejës, të vitit 2007, vërehet një qasje re në fushën e planifikimit, gjegjësisht trajtimit të trashëgimisë kulturore. Me Planifikim Strategjik të përvetësuar në këto dokumente, orientohen zgjidhjet e çështjeve të identifikuara dhe propozohen zhvillimet e ardhshme hapësinore, duke respektuar parimet si: gjithpërfshirja, transparenca, efikasiteti etj, që do të rezultojë me zhvillim më dinamik dhe me mundësi konkrete për zbatimin e tij. Kjo qasje është aplikuar edhe për çështjen e trashëgimisë kulturore si njëra ndër çështjet më të rëndësishme të komunës.

## Conclusion

Based on the analyses made above on the plans developed over the years and lastly the MDP and UDP, and based on the experience gained from the evaluation of municipal development plans, in general the treatment of the cultural heritage issue, in the case of Peja reaches a satisfactory level.

Changes to the political, social and economic system in Kosovo, during the different periods when these plans were developed, have had an effect on the system of spatial planning, and in the inclusion and treatment of cultural heritage in them. This effect is apparent also in the case of Peja Municipality.

In the initial documents of 1956 – the General Urban Plan of the city of Peja, a detail description is given to the issue of cultural heritage and the possibilities of its preservation and protection.

Further on, in the General Urban Plan of 1983, a considerable decline is noticed in the inclusion of buildings of value to CH, and in some instances attempts to devalue to the point of destroying Non-Christian Orthodox monuments in their entirety, is noticed.

According to information for the period of 1993-1996 a General Urban Plan was developed, but which was not approved by the Municipal Assembly and as such the municipality of Peja does not possess a copy of this document.

Lastly, in the MDP and UDP of 2007 for the municipality of Peja, a new approach is noticed in the field of planning, specifically the treatment of cultural heritage. With the Strategic Planning adopted in these documents, guidance is given on the resolution of identified issues and future spatial developments are proposed, by respecting principles like: comprehensiveness, transparency, efficiency, etc. which will result in a more dynamic development with concrete opportunities for its implementation. This approach was applied even in the issue of cultural heritage as one of the most important issues of the municipality.

## KOMUNA E HANIT ELEZIT

### Trashëgimia kulturore në komunën e Hanit Elezit

#### Historiku i shkurtër

Kosova ka një të kaluar të rëndësishme që përfaqëson periudha të ndryshme historike, dhe me të dhe të Elez Hanit, e cila karakterizohet me gjetje arkeologjike nga epokat parahistorike, duke përfshirë periudhën neolitike, romake, dhe periudhën e hershme dhe të vonshme mesjetare. Ashtu si edhe në pjesën tjetër të Kosovës, Hani Elezit është i pasur me mbetje arkeologjike dhe monumente kulturore që datojnë nga periudha të ndryshme.

Hani i Elezit, dikur pjesë e Komunës së Kaçanikut, është njëra ndër tri komunitat e reja, të cilat janë formuar më 2005. Si komunë në vete Hani i Elezit është themeluar me Urdhëresën Administrative 2005/11 me datë 27 shtator 2005. Neni 2 i kësaj urdhërese kërkon themelimin e pesë pilot-njësive të komunave Brenda komunave pjesë e së cilave kanë qenë. Kësisoj në bazë të kësaj urdhërese është formuar komuna e Junikut, Parteshit, Hanit të Elezit, Mamushës dhe Graçanicës.

Hani i Elezit përbëhet nga 10 fshatra dhe një njësi urbane. Kjo komunë ka një shtrirje gjeografike të veçantë, ku vendbanimi urban gjenden në mes të një grope gjeografike, kurse fshatrat gjenden përreth në 400 deri 800 metra lartësi mbidetare. Gryka e Kaçanikut ka qenë e banuar qysh në kohën e sundimit romak. Në këtë lokalitet është gjetur mbishkrimi latin i kohës romake, perandori e cila kishte pushtuar viset Ilir-Dardane: "Imp(eratori) Ceasari/divi Traiani Parthici f(ilio)/divi Nervae nepoti/Traiano Hadriano/Aug(usto) pr (o)pr (aetore) col (onia) Scupin (orum) m (ilia) p (assuum) VIII; (Ae)lia (ose ngjashëm diqka) / Clau-/dia/ coniu-gi (bene) m (erenti) p (osuit)."

Aty ka ekzistuar edhe një fortifikatë Romako-Bizantine. Në Fushëgropën e Hanit të Elezit të sotëm, vendbanimet ilire kanë qenë të ndërtuara në afërsi të grykës, aty ku kanë qenë edhe rrugët e lashta, të cilat lidhnin Kosovën me Shkupin. Praninë e vendbanimeve të tilla e dokumentojnë materialet e gjetura arkeologjike të kohës antike. Përveç mbetjeve të kështjellës, në këtë trevë janë zbuluar edhe materiale të rëndësishme kulturore arkeologjike, që flasin për praninë e popullatës iliro-dardane në këtë anë.

Emërtimi i parë i këtij vendbanimi daton nga shek. XVI. Të dhënat e shkruara historike dëshmojnë se rrëzë malit Sharr deri vonë figuron vendbanimi me emërtimin Sharr i cili ka të bëjë me Hanin e Elezit të sotëm (1564, 1589, 1689, 1690, 1730, 1775, 1788, 1812, 1822)

Më vonë vendbanimi Sharr përmendet me emërtimin e Hanit të Elezit, kësaj radhe në kuptim të komunikacionit transportues të mallrave me karvane kuajsh e qeresh. Ngaqë nëpër grykën e Kaçanikut, udhëtimi natën ka qenë i vështirë dhe i pa sigurt, karvanet e qerreve dhe udhëtarët ndaleshin pa hyrë në grykë për a kaluar natën. Në gjysmën e parë të shekullit XIX në këtë vendbanim ndërtohet një han<sup>74</sup>/bujtinë.

---

<sup>74</sup>Hanin, sipas të dhënave e ndërtoi një fshatar i quajtur Elez nga fshati Dimce, sipas të cilit dhe u emërtua vendbanimi. Pas këtij Hani, edhe Bajram Daci nga Pusat e Nikës, gjatë kohës së sundimit Osman e hap një han/bujtinë tjetër.

## MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT

### Cultural heritage in the Municipality of Hani i Elezit

#### A Brief history

Kosovo has an notable past representing various historical periods, including Hani i Elezit, which is characterized by archaeological findings from prehistoric eras including Neolithic period, Roman period, and the period of early and later medieval. As in the rest of Kosovo, Hani i Elezit is rich in archaeological and cultural remnants dating from different periods of times.

Hani i Elezit, once part of Municipality of Kaçanik, is one of three new municipalities, which were established in 2005. As its own municipality Hani i Elezit was formed by Administrative Order 2005/11 dated September 27, 2005. Section 2 of this order requires the establishment of five pilot municipalities within the municipalities parts of which have been. Therefore according to this order were established municipalities of Junik, Partesh/Parteš, Hani i Elezit, Mamusha/Mamuša and Gračanica/Gračanica.

Hani i Elezit consists of 10 villages and one urban unit. This municipality has a specific geographic stretch, where the urban settlement is found among a geographic cavity while the surrounding villages are at 400 to 800 meters of altitude. Kacanik Gorge has been inhabited since the times of Roman rule. In this locality is found latin inscription of the Roman time, Empire which had conquered Illyrian-Dardani areas: "Imp(eratori) Ceasari/divi Traiani Parthici f(ilio)/divi Nervae nepoti / Traiano Hadriano / Aug(usto) pr(o)pr(aetore) col(onia) Scupin(orum) m(ilia) p(assuum) VIII; (Ae)lia (ose ngjashëm diqka) / Clau-/dia/ coniu-gi (bene) m(erenti) p(osuit)."

There also existed a Roman-Byzantine fortification. In the valley of today's Hani i Elezit, there have been Illyrian settlements built near the gorge, where the ancient routes tied Kosovo with Shkup/Skopje. Presence of such settlements is documented with the findings of archaeological materials of an ancient era. Besides the Castle remains, there were significant cultural and archaeological materials found in this part proving the presence of Illyrian-Dardan population in this area.

Initial toponym of this settlement dates from XVI century. Written historical records indicate that, until recently, at the slopes of Sharr Mountain a settlement named Sharr appears, which has to do with today's Hani i Elezit (1564, 1589, 1689, 1690, 1730, 1775, 1788, 1812, 1822).

Later, Sharr settlement is mentioned by the name Hani i Elezit, this time in terms of transport of goods with horse caravans and carts. Since travelling during the night through Kaçanik Gorge was difficult and unsafe, caravans of carts and travelers stopped for passing a night. In the first half of XIX century in this township was built an Inn (*Han*)<sup>75</sup>.

---

<sup>75</sup> According to data the Inn (Han) was built by villager named Elez from Dimce village, according to which the settlement was named. Following this Inn, Bajram Daci from the Pusat e Nikës, during Ottoman rule, opens another inn.



Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, saktësisht në vitin 1873, afër Hanit ndërtohet stacioni i hekurudhës, i cili ekziston dhe sot. Pas pushtimit të kësaj treve nga pushteti serb, për qëllime të caktuara ndërrohet toponimi prej Hanit të Elezit në Gjeneral Jankoviç, sipas gjeneralit famëkeq serb i cili me ushtrinë e vetë e pushtoi dhe bëri vrasje mbi këtë trevë në vitin 1913.

Në të dhënat statistikore të vitit 1914, Hani i Elezit nuk ishte regjistruar si vendbanim, porse kishte vetëm dy kafene dhe një dyqan ushqimor/bakallhane si dhe vend ushqim të karvaneve që shkonin në drejtim veri-jug dhe anasjelltas.

Që nga viti 1920 vendbanimin e Hanit të Elezit, filluan ta banojnë familjet shqiptare të fshatrave përreth. Këtu u vendosën familja Topojani dhe Vila nga fshati Demiraj (Neshaci), Imishtët nga Kaçaniku, Dacët, Bushët nga Pusat e Nikës, Vilat nga Paldoniku dhe pastaj shumë të tjerë, pothuaj nga të gjitha fshatrat përreth kësaj treve, si nga Dimca, Burimi (Seqishta), Paldoniku, Pusat e Nikës, Goranca, Rezhanca e shumë të tjerë. Në këtë kohë, ndoshta më parë ishin vendosur edhe disa familje rome. Fabrika e Çimentos e vitit 1936 ishte një mundësi e mirë për zhvillimin dhe punësimin e punëtorëve të kësaj ane<sup>76</sup>.

Fig.59- Pamje e përgjithshme e qytetit  
Fig.59 – Overview on the town

Në Han të Elezit, përveç trashëgimisë kulturore, kemi dhe trashëgiminë natyrore, shkak i konfiguracionit të terrenit, lumit Lepenc dhe pejzazheve natyrore të kombinuara me ndërtesa tradicionale të banimit të cilat përfaqësojnë vlerë të madhe që duhet trajtuar dhe mbrojtur. Inventari i monumenteve kulturore të Kosovës (1999) nuk përfshin monumentet e mbrojtura me ligj nga komuna e Hanit të Elezit. Qendra për trashëgiminë kulturore në Gjilan, e themeluar në vitin 2005 ka krijuar një listë të re të propozuar për rajonin jug lindor të Kosovës dhe në bashkëpunim me MKRS, krijoi një bazë të dhënash të inventarit. Lista e propozuar do të nënshtrohet vlerësimit të vlerave kulturore nga ekspertë

<sup>76</sup> Draft PZHK–Hani i Elezit 2010-2020



In the second half of the XIX century, precisely in 1873, by Hani i Elezit a railway station was built, which exists till today. After the conquest of this area by the Serbian authorities, for certain purposes the toponym Hani i Elezit was changed to Djeneral Jankovic, the ill-famed Serb general who, with his troops, took over this territory committing murders in 1913.

In the statistical data of 1914 Hani i Elezit was not registered as a settlement, but had only two cafes and a grocery store and food-place for convoys travelling north-south and vice-versa.

Beginning of 1920 Hani i Elezit start being populated with Albanian families from nearby villages. Here were settled Topojani and Vila families moved from the village Demiraj (Neshaci) Imishta from Kaçanik, Daci family, Bushi from Pusat e Nikës, Vila from Paldonik, and many others then, almost from all the villages around this area, such Dimca, Burim (Seqishta) Paldonik, Pusat e Nikës, Goranca, Rezhanca, and many others. At this time, perhaps earlier, the place also sheltered several Roma families. Cement Factory of 1936 was a good opportunity for the development and employment of workers of this area<sup>77</sup>.



In Hani i Elezit, besides cultural heritage there is also a natural heritage because of terrain configuration, Lepenci River and natural landscapes combined with traditional residential buildings which represent great value to be administered and protected. The inventory of cultural monuments of Kosovo (1999) does not include monuments protected by law in the Municipality of Hani i Elezit. Cultural Heritage Center in Gjilan, founded in 2005, has created a new proposed list for southeastern region of Kosovo and in close cooperation with MCYS, created an inventory database. The proposed list shall be subject of assessment of cultural values by experts.

Fig.60- Pamje e përgjithshme e qytetit  
Fig.60 - Overview on the town

---

<sup>77</sup>Draft MDP – Hani i Elezit 2010-2020

Zbulimet arkeologjike dëshmojnë se vendndodhja e Hanit të Elezit ka qenë e banuar gjatë periudhave të ndryshme. Për shkak të vendndodhjes së saj, komuna e Hanit të Elezit është përdorur për lidhjet me rajonin e Scupit (Shkupit), si një vendbanim i rëndësishëm në Greqinë e lashtë. Mbetjet nga monumentet fetare të gjetura në fshatrat Gorancë, Dermjak, monedhat e gjetura në Paldenicë, Dimcë, Secishtë, Necafo, Krivenik dhe Pustenic, dëshmojnë për rëndësinë strategjike të territorit të Hanit të Elezit.

Linja e trenit Akropolis ishte e përdorë deri në vitin 1990. Vendbanimet e Hanit të Elezit u përmendën edhe në arkivat osmane nga shekujt XV-XIX.

Zona rurale karakterizohet me objekte individuale të banimit, dhe me pejzazhe të mrekullueshme të jetës dhe punës në ato zona malore.

Elementet arkitektonike të ndërtimeve u ndikuan nga periudha osmane, të ndërtuara dhe përdorura nga vendasit. Trashëgimia jo materiale e zonës përfshin një trashëgimi të pasur me tradita lokale. Veç riteve fetare, njerëzit kanë mbajtur edhe ritet tradicionale pagane.

### Lista e objekteve të trashëgimisë kulturore në komunën e Hanit të Elezit<sup>79</sup>

#### Trashëgimia kulturore në qytetin e Hanit Elezit

Objekti i Hanit – shek XIX. - Supozohet se hani i parë – bujtinë për kalimtarët ishte në vend të objektit të sotëm në qendër të qytetit të Hanit të Elezit. Në shekullin XIX komunikacioni transportues i mallrave bëhej ende dhe me karvane kuajsh e qeresh. Ngaqë nëpër Grykën e Kaçanikut udhëtimi natën ka qenë i vështirë dhe i pa sigurt, karvanet e qerreve dhe udhëtarët ndaleshin pa hyrë në grykë për ta kaluar natën. Meqë në gjysmën e parë të shekullit XIX në këtë vendbanim ndërtohet një Han-bujtinë e ndërtuar nga një fshatar i quajtur Elez nga fshati Dimcë.

Tab.4 - Lista e trashëgimisë kulturore sipas PZHK-së të HE

Tab.4 – The list of cultural heritage according HE MDP

| No | Përshkrimi objektit<br>Description of objects          | Hani i Elezit | Gorance | Pustenic | Dermjak | Krivenik | Seçishtë | Paldenicë |
|----|--|---------------|---------|----------|---------|----------|----------|-----------|
| 1  | Zona arkeologjike<br>Archaeological sites              |               |         |          |         |          |          | 1         |
| 2  | Xhami<br>Mosques                                       | 1             |         | 1        |         | 1        | 1        |           |
| 3  | Mbetje kishash<br>Church remains                       |               | 1       |          | 1       |          |          |           |
| 4  | Vlera tradicionale-popullore<br>Vernacular values      |               |         | 3        | 5       | 1        | 1        |           |
| 5  | Komplekse ndërtesash<br>Building compounds             |               |         | 2        |         |          |          |           |
| 6  | Ndërtesë për shfryt. Publik<br>Buildings of public use |               |         |          |         |          | 1        |           |
| 7  | Monument epigraf<br>Epigraph monument                  |               |         |          |         |          |          | 2         |
| 8  | Monolit<br>Monolith                                    |               |         | 1        |         |          |          |           |
| 9  | Strehimore<br>Shelter                                  |               |         | 1        |         |          |          |           |
| 10 | Obelisk<br>Obelisque                                   |               |         |          |         | 1        |          |           |

<sup>79</sup> Lista e trashëgimisë kulturore sipas PZHK të Hanit të Elezit

Archaeological discoveries show that the location of Hani i Elezit has been inhabited during different periods. Because of its location, the municipality of Hani i Elezit is used for connections with the region of Scupi (Shkup/Skopje) as an important habitat in ancient Greece. The remains of religious monuments found in villages Gorancë and Dermjak, coins found in Paldenica, Dimce, Secishtë, Necafo, Krivenik and Pustenik attest the strategic importance of the territory of Hani i Elezit.

Acropolis railway was used until 1990. Settlements of Hani i Elezit were mentioned in the Ottoman archives from XV-XIX centuries.

Rural area is characterized by individual residential buildings, and wonderful landscapes for life and work in those mountainous areas.

Architectural elements of buildings were influenced by the Ottoman period, built and used by locals. Intangible heritage of the area includes rich local customs. Besides religious rituals, people have kept the traditional pagan rites.

#### **The list of cultural heritage in the Municipality of Hani i Elezit<sup>79</sup>**

The object of Inn (Han) - XIX century – It is supposed that the first inn (Han) for travellers was in the place of today's building in the downtown of Hani i Elezit. In XIX century transportation of goods was still done by horses and carts caravans. Since travelling during the night through Kaçanik Gorge was difficult and unsafe, caravans of carts and travelers stopped for passing a night. In the first half of XIX century the inn was built in this settlement by a villager named Elez from village Dimce

---

<sup>79</sup> The list of cultural heritage in Hani i Elezit MDP

Fig.61 - Fabrika e çimentos

Fig.61 – Cement Plant



Sipas pronarit të Hanit të Elezit, dhe vendi filloi të quhet Hani i Elezit, pas së cilës fillojnë të ndërtohet dhe tjetri han si psh ai i Bajram Dacit nga Pusat e Nikës. Duhet theksuar se tokat e këtij vendbanimi ishin prona të fshatrave përreth, Paldenicë, Burimit apo Seçishtë, Dërmjak, Dimcë etj.

**Objekti i fabrikës së çimentos** – 1936. - Në foto shihen pjesë të vjetra të fabrikës së çimentos dhe lidhja e tyre me linjën hekurudhore të transportit. Ekziston mundësia që një pjesë e vjetër e fabrikës të shndërrohet në muze industrial<sup>80</sup>.

### **Trashëgimia kulturore në Paldenicë - Paldonik**

Fshati Paldenicë gjendet në një terracë të gjerë, në anën e majtë të lumit Lepenc, 3km në veri të qytetit të Hanit të Elezit, më një sipërfaqe prej 404 ha. Lagjet e fshatit janë të ndara dhe emruara sipas familjeve ndërsa ka dhe mikrotoponime karakteristike.

Është vendbanim i vjetër iliro-dardan. Në të është zbuluar nekropoli (shek II - III), në bregun e majtë të lumit Lepenc, kah Hani Elezit. Në vendin Livadhet e kishës janë zbuluar varreza të vjetra. Gjithashtu në këtë vendbanim është gjetur një stellë e vjetër në themelet e një muri prej gurit. Nga pllaka shihet (në mbishkrim) se ajo i përket Genticilit, perandorakut Julius, të cilat në koloninë Scupi janë mjaft të gjetura, kurse ne Municipium Ulpianum më pak. Në atë pllakë shihet figura e reliefit të njeriut dhe mbishkrim në gjuhën latine. Kjo pllakë i është ngritur të birit 40 vjeçar Klensit (shek. III e.s.) Gjithashtu janë gjetur dy monedha me diametër 1,5 cm ku shihet fytyra e sundimtarit me diademë në kokë dhe figura e luftëtarit në anën e kundërt i cili në dorën e majtë mban gjahun dhe heshtë. Kjo monedhë bronzi është gjetur te ara me emrin Te Zabeli të lagjes Jasharaj mbi rrugën për Paldenicë.

<sup>80</sup> Është punuar projekt diplome në arkitekturë, për muze industrial (Ajeti V., 2009)

<sup>81</sup> Dërnjani, Çupi, Ramukaj, Krasniqi, Bela, Asotiçi, Axhami, Vila, Curri, Loku, Thaçi, etj ndërsa ka dhe mikrotoponime karakteristike si: Prroni i Binollit, Kepi i Markit, Mulosajt, Buktevec, Livadhi i kishës,



Fig. 62 - Stella<sup>82</sup> në oborrin e shkollës “Kështjella e Diturisë”<sup>83</sup>)

Fig. 62 – The Stella in<sup>84</sup> the “Kështjella e Diturisë” schoolyard<sup>85</sup>)

<sup>82</sup> Stella e cila u gjet në vitin 1995

<sup>83</sup> Stella si dhe dy bazamentet e shtyllave janë ngjyrosur nga persona të papërgjegjshëm

<sup>84</sup> Stella e cila u gjet në vitin 1995

XIX century an Inn/guesthouse (Han) was built in this settlement by a villager named ELEZ from village Dimce. Hani i Elezit started being called by the owner's name. After, another guesthouse (Han) was built such as that of Bajram Daci from Pusat e Nikës. It should note that the lands of this settlement were the property of surrounding villages, Paldenica, Burim or Seçisht, Dërmjak, Dimce etc.

**The building of the Cement factory** – 1936. - Picture tells parts of the old cement factory and its connection to the transport railway. There is a possibility that an old part of the plant become industrial museum .

### **Cultural heritage in Paldenica - Paldonik**

Paldenica village is located on a wide terrace, on the left side of the river Lepenc, 3km north of the town of Hani i Elezit, with an area of 404 ha. Village neighborhoods are divided and named according to families but there are and some characteristic microtoponyms.

It's an old Illyrian-dardanii settlement. There was discovered a Necropolis (c. II-III), on the left bank of Lepenc river, towards Hani i Elezit. At the place Livadhet e kishës (church's meadows) there were discovered ancient cemeteries. Also, in this settlement an ancient stela was found, in foundations of a stone wall. From the plaque it is discovered (the inscription) that it belongs to Genticili, Emperor Julius, which in Scupi colony many were found, while in Municipium Ulpianum those are less. At the plaque is engraved the relief of human figure and the inscription in Latin. This stele was erected to his 40-years old son Klensi (III century AD). There were found also two coins with a diameter of 1.5 cm having the face of the ruler with diadem on his head and the figure of the warrior on the opposite side which in his left hand holds prey and a lance. This bronze coin was found in the field called *Te Zabeli* of Jasharaj neighborhood, on the route to Paldenica.



Fig.63 - Bazamentet e gjetura të shtyllave Paldenicë

Fig.63 – Basements of pillars found in Paldenica

<sup>85</sup> Stella si dhe dy bazamentet e shtyllave janë ngjyrosur nga persona të papërgjegjshëm

<sup>86</sup> A Draft of a graduation work was prepared for industrial museum (Ajeti V., 2009)

<sup>87</sup> Dërnjani, Çupi, Ramukaj, Krasniqi, Bela, Asotiçi, Axhami, Vila, Curri, Loku, Thaçi, etc, while there are microtoponyms such: Binolli' Stream, Mark's Cape, Mulosajt, Buktevec, Church's meadow, Kodovush (Livadhista/meadow), Fujzë, Hurdhë, Qamur's Meadow, Gjolltë e Selmanit, Kolorashë, mites' Stream, Stockyard, Frashën, Rabbit's field, etc.

Monedha e dytë me diametër 2,7 cm është gjetur të shkolla e fshatit. Na vers është fytyra e sundimtarit e kthyer në të djathtë me mbishkrimin: IMP (orator) MIVLPN... ndërsa në revers PROVIN A...DACIA, një figurë femre që në dorën e djathtë mban një lule, kurse në dorën e majtë nuk vërehet. Sipas mbishkrimit monedha është prodhuar në provincën e Dakisë - Rumaninë e sotme.

Sipas dokumenteve të shkruara osmane, pronarë të tokave ishin Shkupjani, Isa-beg-Ishaku, i cili në vitin 1452 kishte 30 shtëpi, në vitin 1468 kishte 33 shtëpi, në vitin 1544 kishte 11 shtëpi ndërsa në vitin 1568 kishte 10 shtëpi. Në librin e kujtimeve të Manastirit të Shën Trinisë që ka filluar të mbahet prej vitit 1465 janë shënuar disa banorë dhurues të manastirit. Udhëpërshkruesi i misionit Venedikas Jakopo Soranca në shek. XVI (1575) përmend fshatin Palevorenza, që sipas të gjitha gjasave ka të bëjë me këtë vendbanim. Në hartat austriake të vitit 1689 është i shënuar si vendbanim. Gjithashtu si vendbanim ishte shënuar edhe në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) me emrin *Yalbodinçe (?)*, ndërsa më vonë me disa ndryshime. Pas vitit 1912 deri në vitin 1960 shumë banorë janë shpërngulur për në Turqi, Maqedoni, e vise të tjera.



Fig. 64 - Shtëpia e Menduh Faik Dernjanit – Paldenicë

Fig. 64 – The House of Menduh Faik Dernjani – Paldenica

The second coin in diameter of 2.7 cm was found at the village school. In verso is the face of the ruler's right profile with the inscription: IMP (orator) MIVLPN... while in the reverse PROVIN A...DACIA, a female figure that in her right hand holds a flower and in her left nothing is noticed. According to the inscription the currency is produced in the province of Dachia – todays Romania.

According to written Turkish documents written landowners were Shkupjani, Isa-beg-Ishaku, who in 1452 owned 30 houses, in 1468 had 33 houses, in 1544 had 11 houses and in 1568 had 10 houses. In the book of memoirs of the Monastery of the Holy Trinity that started to be recorded since 1465, there are some inhabitants as donors of the monastery. The traveller of Venetian mission Jakopo Soranca in XVI century (1575) mentions the village *Palevorenza*, which most probably has to do with this settlement. In Austrian maps of 1689 it is marked as settlement. Also, it was noted as a settlement in the 'salnams' (registers) of Vilayet of Kosovo of 1893 (1311 h), the year 1896 (1314 h) with the name *Yalbodinçe (?)*, and later with some changes. After the year 1912 until 1960 many residents have moved to Turkey, Macedonia, and other areas.



Fig. 65 - Shtëpia e Ramadan Isuf Çupit

Fig. 65 - Ramadan Isuf Çupi's House



**Shtëpitë tradicionale të banimit – Paldenicë** – Shtëpitë e fshatit Paldenicë sipas rrëfimeve thuhet se i takojnë familjeve të pasura, shtëpi karakteristike me çardak dhe divanhane, odë, ahër, dy hyrje (mysafir dhe familjarë). Materialet ndërtimore kanë qenë guri dhe druri. Trashësia e mureve deri në 1m, dritare dhe dritare qorre (dimensioneve më të vogla), kulme me traje druri. Tavanet e brendshme të mveshura nga druri qershisë me stil të ashtuquajtur “shishetavan”. Katet përdhese janë përdorur për bagëti, kurse katet e sipërme për banim. Dhomat e fjetjes me hamamxhik.

Në fshatin Paldenicë kanë mbijetuar dy shtëpi të këtij tipi : Shtëpia e Menduh Faik Dernjanit dhe Ramadan Isuf Çupit.

Trashëgimia kulturore në Pustenic – PUSËT E NIKËS – Ky vendbanim shtrihet rreth 8 km në jug të Kaçanikut – vendbanim i ndarë në lagje. Sipërfaqja 1.087 ha. Lagjet e fshatit janë të ndara dhe emëruara sipas familjeve ndërsa ka dhe mikrotoponime karakteristike

Për lokalitetin Selika, thuhet se është vendbanim i vjetër, ndoshta edhe kala ilire, në të cilën jetonte popullata krishtere shqiptare. Mbetjet e kishës së dikurshme në fshatin Pustenic të vjetër, mendohet se daton nga shek. X apo XI, por nuk përjashtohet mundësia të jetë edhe më e hershme. Thuhet se ne mëhallën Laci, ekzistojnë gjurmët e kishës së periudhës romake, përderisa në vendin e quajtur Katunishtë (Selishtë) – Ureq, janë gjetur varreza të vjetra me skelete të mëdha. Selishta është në lagjen e Bravëve, në veriperëndim të fshatit. Aty është një gurë i madh që quhet Kepi i Selishtës.

Sipas dokumenteve të shkruara të regjistrit turk të Vilajetit të Shkupit të vitit 1452, ishin 50 shtëpi, 1455 po ashtu 50 shtëpi me emrin Bustenic, më 1468 kishte 58 shtëpi ndërsa si vendbanim është shënuar në hartën austriake të vitit 1689.

<sup>88</sup> Lagjet e fshatit: Bushtë e epërm, Bushtë e Poshtëm, Dacët, Bravët, Baballazhët, Laçët etj.

Mikroponimet: Sumreka, Broboshtina, Sllatina, Kepi i Selishtës, Prroi i Nikobllavës, Gropat e Epra, Kodra e Xhiqevet'Reqit, Rrushi i Thacët, Prroi i Bibinollit, Te kisha, Likona, Dadraha e Demës, te Lamat, Padina , Në Rrafshë, Udha e Dinës, Lugini i Kopnishtës, Lugi i Madh, Te Krojna, Te Muret e selishtës, Lisevë, Rana e Laçit, Ureq, etj

Fshati ishte regjistruar me emrin Postanik ne sallamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) dhe 1900 (1318 h). Në vitet 1920 fillon shpërngulja e popullsisë për shkak të gjendjes politike dhe ekonomike, e pastaj shpërngulja vazhdon edhe pas viteve 1936.

Fig. 66 - Shtëpi e Nazif Bushit

Fig. 66 - Nazif Bushi's House



**Traditional residential homes – Paldenica** – According to tales houses of village Paldenica allegedly belong to wealthy families, homes characteristic with timber-terrace and settee, odas (traditional room of males), stable, two entrances (guest and family). Construction materials were stone and wood, while the thickness of walls up to 1 m, windows and blind windows (small dimensions), roofs with wooden beams. Interior of ceilings coated with cherry wood, style called “shishetavan.” Ground floors are used for cattle, while the upper floors for housing. Sleeping rooms with toilets (“hamaxhik”).

There are only two houses of that type survived in the village Paldenica: Menduh Faik Dernjani's house and Ramadan Isuf Çupi's house.

Cultural Heritage in Pustenik – Puset e Nikës (*Wells*) - This settlement lies about 8 km south of Kaçanik - settlement divided by neighborhoods. Area 1,087 ha. Quarters of the village are named after families while there are characteristic microtoponyms<sup>89</sup>.

For Selika settlement is reported to be the oldest settlement, perhaps Illyrian castle, a habitat of Albanian Christian population. Remnants of the then church in the village Pustenik i Vjetër (Old Pustenik), thought that dates back X or XI centuries, but it is not ruled out to exist even earlier. It is said that in Laci neighborhood there are traces of a Church of the Roman period, whilst at a place called Katunishtë (Selishtë) - Ureq, some old cemeteries with big skeletons were discovered. Selishta is in Brava neighborhood, northwest of the village. There is a large stone called Cape of Selishta.

---

<sup>89</sup> *Quarters of the village:* Bushtë i epërm, Bushtë i Poshtëm, Dac, Brava's, Baballazhi, Laçi, etc.  
*Microtoponyms:* Sumreka, Broboshtina, Sllatina, Cape of Selishta, Nikobllava Stream, Upper Holes, Xhiqevet Reqi Hill, Thacë Grapes, Bibinolli' stream, Church, Likona, Dadraha e Demës, te Lamat, Padina, Në Rrafshë, Dina's Path, Lugji i Kopnishtës, Big Valley, Te Krojna, Selishta Walls, Lisevë, Rana e Laçit, Oreq, etc.

According to written documents of Turkish registry of Vilayet of Shkupi/Skopje of the year 1452, there were 50 houses, in 1455 also 50 houses named *Bustenik*, in 1468 had 58 houses while as a settlement was listed in the Austrian map of 1689.

The village was recorded as *Postanik* in the registers of Vilayet of Kosovo of 1893 (1311 h), year 1896 (1314 h) and 1900 (1318 h). In the 1920s the population starts migrating due to political and economic situation, and this migration continues even after the year 1936.

Fig.67 - Shtëpia te Dacët

Fig.67 – The House of Daca family



## Trashëgimia kulturore në Dremnjak

Vendbanimi<sup>90</sup> shtrihet rreth 7-8 km në jug të Kaçanikut me sipërfaqe prej 615 ha. Vendbanimi i vjetër është shtrirë më poshtë se vendbanimi i sotëm, tek vendi i quajtur Zidina, ku janë të ruajtura gjurmë të shtëpive dhe tani së voni është gjetur një statujë gruaje me madhësi 2m, që dëshmon për vendbanim të vjetër të periudhës romake.

Sipas regjistrimit turk të vitit 1452, fshati ishte i ndarë në dy pjesë, 18 dhe 19 shtëpi; më 1455- 37 shtëpi; më 1468 -16 shtëpi dhe në pjesën tjetër 17 shtëpi, ndërsa më 1568 janë të shënuar 32 shtëpi të fesë se krishterë dhe një myslimane. Në hartën austriake të vitit 1689 shënohet me emrin Tronjak.

Jetonte popullata shqiptare autoktone. Në vitin 1878, pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, ata vendosen në këtë vendbanim. Në vitin 1912, pas masakrës serbe te Mulliri i Ilaz Currit (ku edhe sot ekzistojnë gjurmët e varreve), popullata migroi. Me emrin Dermjak ishte e regjistruar në sallnamet e vilajetit të Kosovës të vitit 1893 (1311 h), të vitit 1896 (1314 h) dhe të vitit 1900 (1318 h). Në mes të dy luftërave botërore shpërngulen shumë familje.

---

<sup>90</sup> Mikroponimet më karakteristike: Kroj i Dërvishit, Kodra Jasiqe, Përroi i Fices, Kroj i Mitrës, Ara e Spancës, Bunari i Demës, Lugi i Thanës, Te Melishtat, Kepi i Mullakës, Te Kisha, etj.

Fig. 68 - Shtëpi tradicionale banimi – Dremnjak  
Fig. 68 – Vernacular house dwelling – Dremnjak



### Cultural heritage in Dremnjak

This settlement<sup>91</sup> is situated about 7-8 km south of Kaçanik in the area of 615ha. The old settlement lies below today's settlement, at a place called Zidina, where are preserved the traces of houses and was found recently a statue of a woman 2 m in size, which proves the old settlement of the Roman period.

According to the Turkish census of 1452, the village was divided into two parts, 18 and 19 houses; in 1455 - 37 house; in 1468 – 16, and in other part 17 houses; while in the year 1568 there were 32 houses of Christian faith and 1 Muslim. In the year 1689 Austrian map marked it with the name *Tronjak*.

There were living native Albanian population and in 1878, after the expulsion of Albanians from Sandzak of Nish/Niš, they've settled in this settlement. In 1912 after the Serb massacre at Ilaz Curri' Mill (where even today there are traces of graves) population migrated. In the registers of Vilayet of Kosovo Dermjak was recorded under that name in the year 1893 (1311 h), in 1896 (1314 h) and in 1900 (1318 h). Many families displaced between the two world wars.



Fig. 69 - Shtëpia e Mehmet Currit – Dremjak

Fig. 69 - Mehmet Curri's Housset – Dremjak

---

<sup>91</sup> More characteristic microtoponyms: Dërvish's Stream, Jasiqe Hill, Fice's Stream, Mitra's Stream, Field of Spanca, Dema's Well, Thana Valley, At Melishtat, Cape of Mullaka, At Church, etc..

**Shtëpitë tradicionale të banimit në Dremnjak** - Në fshatin Dërmnjak sipas të dhënave gojore thuhet se kanë jetuar familje të pasura gjë që dëshmon ndërtimi i shtëpive të cilat kryesisht janë 2 dhe 3 katëshe, të cilat karakterizohen me çardakë dhe divanhane, me dy hyrje, odë dhe ahër. Ishin të ndërtuara nga guri dhe në disa raste me qerpiç dhe dru. Muret karakterizohen me trashësi deri në 1m', Kulmet me traje druri. Katet përdhese janë përdorur për bagëti, kurse katet e sipërme për banim. Sipas rrëfimeve të familjarëve këto shtëpi janë 150 – 200 vjeçare.

**Mullinjë – Dremjak** - Rrethina e Hanit të Elezit ka pasur numër të madh të mullinjve, rreth 21 mullinj me vjetërsi deri në 300 vjet. Kjo kulturë materiale, e mbetur si trashëgimi, prezantohet në formë të gjurmëve ose ndërtime të ruajtura në mjediset e kësaj treve. Sot kanë mbetur vetëm 3 mullinj, njëri ndër ta është dhe “Mulliri i Hakisë” – Dremjak, i cili thuhet se ka vjetërsi rreth 200vjeçare.

#### **Trashëgimia kulturore në Seçishtë**

Fshati Seçishtë, shtrihet në pjesën jugore të grykës së Kaçanikut me sipërfaqe prej 844 ha. Në afërsi të fshatit, në vendin e quajtur Ramanishtë, gjenden gjurmët e vendbanimit të vjetër romake. Aty fshatarët hasin në tjegulla, tulla mure, monedha, shtylla prej gurëve, mbetje qyngash të ujësllësit.

Fig. 70 – Haki's Mill – Dremnjak

Fig. 70 - Mulliri i Hakisë - Dremnjak



**Traditional residential houses in Dremjak** - In village Dërmnjak, according to oral reportings, reportedly lived wealthy families proven by the construction of houses which are mostly 2 and 3-storey buildings that are characterized by garret (terrace) and settee, with two entrances, an oda and a stable. Those were built from stone and in some cases with adobe and wood. Characterized by thick walls up to 1m, wooden roof beams. Ground floors are used for cattle, while the upper floors for housing. According to stories of the family members those houses are 150-200 years old.

**The Mills - Dremjak** – Periphery of Hani i Elezit have had a large number of mills, about 21 mills up to 300 years old. This material culture, the remaining inheritance, is presented in the form of remnants or preserved buildings on the suburbs of this area. Today there are only three mills; one of them is the “Mulliri i Hakisë” (Haki's Mill) - Dremjak, said to be over 200-years old.

#### **Cultural heritage in Seçishtë/a**


Seçishta village lies in the southern part of Kaçanik Gorge, in the area of 844 ha. In the vicinity of the village, at a place called Ramanishte, there are traces of an old Roman settlement discovered. There, villagers face tiles, bricks, walls, coins, stone pillars, and soil-pipe remains

Fig. 71 - Shtëpi tradicionale në Seçishtë  
Fig. 71 – Traditional house in Seçishtë



► Fig. 72 - Harta e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Hani të Elezit, zonat e propozuara për hulumtim të mëtejshëm.

► Fig. 72 – Map of cultural and natural heritage in Hani i Elezit, proposed areas for further research.






Fig. 73 - Skema për konservim të integruar në Hanin e Elezit  
 Fig. 73 - A scheme for integrated conservation in Hani i Elezit



Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet komunale

### **Plani Zhvillimor Komunal (PZHK)**

Me këtë hulumtim do të vlerësohet e tërë “Trashëgimia kulturore” në komunën e Hanit të Elezit, e shqyrtuar në Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit, sipas shtatë parimeve të Kartës së ICOMOS-it për interpretimin dhe prezantimin e vendeve me TK.

*Interpretimi dhe prezantimi* i TK është pjesë e procesit të përgjithshëm të konservimit të Trashëgimisë Kulturore dhe menaxhimit të saj.

### **Të gjeturat dhe konstatimet prej PZHK 2010-2020 të komunës së Hanit të Elezit lidhur me trashëgiminë kulturore**

Në vazhdim do t'i bëhet një vlerësim i përgjithshëm për dokumentin e Planit zhvillimor të Hanit të Elezit. - Në dokumentin e PZHK të HE është e identifikuar trashëgimia kulturore në kuadër të përshkrimit historik të vendbanimeve në komunën e Hanit të Elezit por jo si kapitull i posaçëm. Poashtu për trashëgiminë kulturore është folur në kuadër të zhvillimit ekonomik, zhvillimit të turizmit. Në dokument është prezantuar tabela e monumenteve kulturore, porse asnjëra nga këto nuk është në listën e monumenteve nën mbrojtje nga shteti i Kosovës. Deri më sot nuk dihet nëse në komunën e Hanit të Elezit, ka trashëgimi kulturore, të vlefshme për t'u ruajtur, për t'u përmendur dhe me të për t'u promovuar. Së voni si potencial kulturor është duke u përmendur trashëgimia industriale në Han të Elezit.

Në përgjithësi të dhënat për trashëgiminë kulturore në komunën e Hanit të Elezit janë të përgjithshme, jo të specifikuar për të gjithë monumentet si p.sh: datimi, shpesh vendndodhja, përshkrimi i gjendjes fizike, trajtimi i derisotëm, emërtimet, si dhe të dhëna tjera relevante.

Nuk është specifikuar në tërësi lloji dhe vlera e monumenteve në veçanti të trashëgimisë kulturore sipas gjinive. Mungesa vlerësimit, kategorizimit të vlerave kulturore të trashëguara, konsiderohet mangësi e dokumentit zhvillimor të komunës së Hanit të Elezit. Në PZHK e Hanit të Elezit, nuk është specifikuar audienca për të cilën do të duhej të prezantohej trashëgimia kulturore në veçanti.

Në vazhdim do të specifikohen të gjeturat dhe konstatimet sipas shtatë parimeve një nga një, si instrument për vlerësimin e dokumentit zhvillimor për komunën e Hanit të Elezit, në kuptim të elaborimit të trashëgimisë kulturore: Qasjes dhe kuptimit, burimeve të informatave, ndërlidhshmërisë në kontekst më të gjerë historik, social e kulturor, autenticitetit, planifikimit për të ardhmen, gjithëpërfshirjes dhe rëndësisë së hulumtimeve, vlerësimeve dhe trajnimeve në kontekst të trashëgimisë kulturore:

#### **Parimi 1 – Qasja dhe Kuptimi**

- *Interpretimi dhe prezantimi i programeve duhet të mundësojë qasje fizike dhe intelektuale të publikut të gjerë për vendet e trashëgimisë kulturore*
- *Interpretimi efektiv dhe prezantimi duhet të përmirësojë përvojën personale, ngrit respektin dhe kuptueshmërinë e*

Inclusion of cultural heritage in respective municipal plans

### **Municipal Development Plan (MDP)**

With this research it will be assessed entire “cultural heritage” in the Municipality of Hani i Elezit, reviewed in the Municipal Development Plan of Hani i Elezit, according to the seven principles of ICOMOS Charter for interpretation and presentation of places of CH.

*Interpretation and presentation* of CH is part of the overall process of conservation of cultural heritage and its administration.

### **Findings and conclusions of the MDP 2010-2020 for Municipality of Hani i Elezit on cultural heritage**

Following will be an overall assessment of the Development Plan Document of Hani i Elezit. - In the HE MDP document it is identified cultural heritage within the historical descriptions of settlements in the municipality of Hani i Elezit but not as a separate chapter. Cultural heritage is also discussed in the context of economic development - tourism development. The document presented the table of cultural monuments, but none of this is from the list of monuments protected by the state of Kosovo. To date, it is unknown whether the Municipality of Hani i Elezit have any cultural heritage worth to preserve, mention and promote. Recently, as a potential cultural heritage is being mentioned an industrial heritage of Hani i Elezit.

In generally, the data of cultural heritage in the municipality of Hani i Elezit are vague, with no specification of all monuments such as: dating, often the location, description of physical condition, treatment as today, names, and other relevant data.

It is not fully specified the type and the value of monuments, especially of those of cultural heritage, in terms of category. Lack of an assessment, categorization of cultural inherited values, is considered a deficiency of the document on development of the Municipality of Hani i Elezit. In MDP Hani i Elezit it is not specified for which audiences should be introduced the cultural heritage, in particular.

Following will be specifying the findings and conclusions of the seven principles one by one, as an instrument for assessing the development document for the Municipality of Hani i Elezit, in terms of elaboration of cultural heritage: Access and understanding, sources of information, in perspective of broader historical view, social and cultural, authenticity, planning for the future, comprehensiveness and relevance of research, assessments and trainings in the milieu of cultural heritage:

#### **1<sup>st</sup> Principle – Access and meaning**

- *Interpretation and presentation of programs should provide physical and intellectual access of general public for respected places of culture heritage*
- *Effective interpretation and presentation should improve personal experience; elevate the respect and comprehension*

- publikut dhe komunikon rëndësinë e konservimit të vendeve të trashëgimisë kulturore.
- Interpretimi dhe prezantimi duhet të inkurajojë individët dhe komunitetet të reflektojnë perceptcionet e tyre të vendit dhe ndihmojë në themelimin e lidhjes së qëlluar me të. Qëllimi duhet të stimulojë interesimin e vazhdueshëm, mësimin, përvojën dhe hulumtimet e mëtejme.
- Programet e Interpretimit dhe prezantimit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë audiencën në mënyrë demografike dhe kulturore. Duhet të angazhohet për të komunikuar vlerat e vendit dhe sinjifikancën tek audienca e gjerë dhe e shumëllojshme.
- Aktivitetet e interpretimit dhe prezantimit duhet të jenë të qasshme nga publiku, në të gjitha mënyrat.
- Kur qasja fizike në vendet e trashëgimisë kulturore - limituar për shkak të brengës për konservim, sensitivitetit kulturor, ri-shfrytëzimit adaptiv apo çështjeve të tjera të sigurisë, interpretimi dhe prezantimi duhet të sigurohen nga jashtë vendit në fjalë.

Në dokumentin e Planit Zhvillimor të komunës së Hanit të Elezit, sa i përket qasjes fizike dhe intelektuale të publikut të gjerë për vendet e trashëgimisë kulturore në komunë, vetëdijesimi përmendet si mënyrë për të ardhmen, së bashku dhe me disa plane për qasje të reja fizike infrastrukturore rrugore deri tek to. Kjo e ardhme planifikohet vetëm për shtëpitë tradicionale në komunën e Hanit të Elezit, kur flitet për ruajtjen dhe shfrytëzimin e tyre në kuadër të turizmit fshatar dhe rural. Për objektet e tjera publike apo të trashëgimisë së gjinive tjera, nuk është specifikuar apo dhe planifikuar ndonjë gjë, edhe pse në tabelën e specifikuar është e paraqitur.

Është e potencuar nevoja për konservim të shtëpive tradicionale dhe trashëgimisë industriale, porse për kategoritë e tjera të trashëgimisë kulturore të cilat vetëm se janë listuar në tabelë, mungojnë informata tjera shtesë dhe specifikime të llojit të programimit me projekte specifike dhe aktivitete.

Nuk ka raste të limitimit të qasjes nga popullata, në vendet e identifikuar me sinjifikancë kulturore në komunën e Hanit të Elezit, për shkaqe të konservimit, sensitivitetit kulturor, ri-shfrytëzimit adaptiv apo dhe çështjeve të tjera të sigurisë, porse konsiderohet se do të duhej të ishte e specifikuar! Në dokument do të duhej të kishte limitime në qasje dhe mënyrë të shfrytëzimit kur janë në pyetje mbetjet arkeologjike dhe të monumenteve tjera të cilat janë në rrezik të shkatërrimit total apo të rrënimit për shkak të shfrytëzimit të ri të hapësirave. Dispozita të mundshme për parandalimin e shkatërrimit përmes limitimit të qasjes dhe shfrytëzimit do të mundësonte, ruajtjen e monumenteve përderisa ndermirën hapa të mëtutjeshëm për identifikim, dokumentim, arkivim zyrtar dhe promovim të vlerave të trashëgimisë kulturore në komunën e Hanit të Elezit.

Pra, janë paraparë aktivitete për interpretim dhe prezantim të vendeve me sinjifikancë të trashëgimisë kulturore në Han të Elezit, në formë të fushatës për vetëdijesimin në ruajtjen dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore apo dhe si prioritet strategjik për komunën: “Mbrotjtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore (zhvillimi i turizmit rural dhe kulturor)”

- *of the public and to communicate the importance of conservation for places with cultural heritage.*
- *The interpretation and presentation should encourage individuals and communities to reflect their respective perception of the place and to aid in establishing a respective connection with it. The goal should stimulate a continuous concern, learning, experience and further research.*
- *Interpretation and presentation programs should identify and evaluate the audience in demographic and cultural manner. It needs to get engaged in communicating the values of the place and the signification toward the general and diverse audience.*
- *The interpretation and presentation activities should be accessible by the public, in every way.*
- *When physical access in locations with cultural heritage – limited because of the care for preservation, cultural sensitivity, adaptive re-usage of or other issues concerning the safety, the interpretation and the presentation needs to be provided from out of the mentioned location.*

In the Development Plan document of Hani i Elezit municipality, as for the physical and intellectual access of the public in general about the locations with cultural heritage within the municipality, the awareness is mentioned as a way for the future, along with some other plans for new physical infrastructural road accesses to get to these locations. This kind of future is planned only for traditional houses in Hani i Elezit municipality, when we are dealing with the preservation and utilization of these houses in the context of village and rural tourism. For other public structures or other cultural heritage structures of other genders, it is not specified or planned anything in particular, although these are presented on the specified board.

It is stressed the need for the preservation of traditional houses and industrial heritage, whereas for other categories of cultural heritage which are only listed on the board, are missing other additional information and the specification of the kind of the program with specific projects and activities.

There are no cases of access limitation of the population, in identified places with cultural significance in Hani i Elezit municipality, for preservation purposes, cultural sensitivity, adaptive re-usage or other safety issues, although it is to be considered that should have been specified! In the document was mint to be some limitations access wise and in the manner of usage where the issue is the archeological remaining and other monuments which are endangered out of the total destruction or out of the collapse due to the new usage of space/surface. Possible dispositions for the prevention of destruction through the limitation of the access and usage would have provided the preservation of monuments while new steps would have been undertaken about identification, documentation, placing under official archive and promotion of the values of cultural heritage in Hani i Elezit municipality.

So, some activities were foreseen for interpretation and presentation of locations with cultural heritage significance in Hani i Elezit, in the form of awareness campaign in preservation and the importance of cultural heritage or as a strategic priority for the municipality: “The protection and preservation of cultural heritage (the development of rural and cultural tourism).”

### *Pustenik dhe Gorancë*

Posaçërisht me zhvillimin e turizmit rural dhe kulturor në zonën mes Pustenikut dhe Gorancës veprimet e propozuara janë:

- Shpallja e zonës së mbrojtur të Pustenikut në projekt planin rregullues;
- Zhvillimi i produkteve dhe përkrahja e vendit turistik;
- Planifikimi dhe ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë;
- Planifikimi dhe instalimi i vendpushimeve me ulëse;
- Përcaktimi i zonave të gjuetisë;
- Promovimi i produktit turistik dhe informimi;
- Harta turistike e Hanit të Elezit;
- Hartimi i planit për menaxhimin e integruar të monumenteve natyrore dhe kulturore;
- Hartimi i planeve mbi bashkëpunimin ndërkufitar;
- Hartimi i planit për zonimin e trashëgimisë kulturore për turizëm

### *Dremnjak, Vertomicë dhe Neqafc- Turizëm rekreativ*

- Krijimi qendrës për kamping dhe gjueti në Vertomicë dhe Neqafc;
- Planifikimi dhe rregullimi i shtigjeve;
- Planifikimi dhe instalimi i vendpushimeve me ulëse;
- Zhvillimi i produkteve dhe përkrahja e vendit turistik;
- Promovimi i produktit turistik;

### *Lugina e Lepencit dhe qyteti i Hanit të Elezit- Turizëm transit, industrial*

- Mbrojtja e zonës së Mullirit të vjetër të Luginës së Lepencit në Lagjen e Ranave dhe Laç;
- Stimulimi i zhvillimit dhe mbrojtjes së aktiviteteve artizanale;
- Fushëveprimi institucional dhe organizativ i sektorit të turizmit;
- Kompletimi i infrastrukturës ligjore për turizmin, që është kompetencë e qeverisë lokale;
- Rritja e përdorimit të kuzhinës tradicionale;
- Përkrahja për zhvillimin e turizmit, promovimi dhe marketingu në nivel lokal;
- Identifikimi dhe promovimi i ditëve, ngjarjeve të shënuara në nivelin lokal;
- Përkrahja e zhvillimit të burimeve njerëzore për sektorin e turizmit;
- Aktivitetet promovuese në nivel komunal;
- Krijimi i lehtësirave për investim në turizëm.

#### **Parimi 2 – Burimet e informatave**

- *Interpretimi dhe prezantimi duhet të jetë i bazuar në evidencën e mbledhur përmes metodave të pranuar shkencore sikurse dhe përmes traditave kulturore.*
- *Interpretimi duhet të paraqesë një spektër të informatave gojore dhe të shkruara, mbetje materiale, traditave dhe kuptimeve të atribuara për vendin. Burimet e këtyre informatave duhet të dokumentohen, arkivohen dhe të jenë të qasshme për publikun.*

### *Pustenik and Gorancë*

Especially with the development of rural and cultural tourism in the zone between Pustenik and Gorancë, the suggested actions are:

- Annunciation of protected zone of Pustenik in the regulative draft plan;
- Development of products and support of touristic location;
- Planning and construction of pedestrians paths;
- Planning and installation of relaxation places with seats;
- Designated hunting zones;
- Promotion of touristic product and information;
- Touristic map of Hani i Elezit;
- The draft of integrated management plan of natural and cultural monuments;
- The draft of inter-border cooperation plan;
- The draft of designation of cultural heritage plan for tourism.

### *Dremnjak, Vertomicë and Neqafç- Recreational tourism*

- Construction of camping and hunting zone in Vertomicë and Neqafç;
- Planning and construction of paths;
- Planning and installation of relaxation places with seats;
- Development of products and support of touristic location;
- Promotion of touristic product;

### *Lepenci valley and Hani i Elezit town – Transitional, industrial tourism,*

- Protection of the zone of Old Mill (Mulliri i Vjetër) in Lepenci valley in "Lagje e Ranave" and Laç,
- Stimulation of the development and preservation of artisanal activities,
- Institutional and organizational actions of tourism sector,
- Completion of legal structure for tourism, which is in the competence of local government,
- The usage growth of traditional cuisine,
- Support for tourism development, promotion and marketing in local level,
- Identification and promotion of dates, events taking place in local level,
- Support of development of human resources for tourism sector,
- Promotional activities in municipality level,
- Making of facilitation for investments in tourism.

#### **Principle 2 – Informational resources**

- *The interpretation and presentation should be based on the evidence collected through accepted scientific methods as well through cultural traditions.*
- *The interpretation should present a specter of oral and written information, material remaining, traditions and meanings attributed about the location. The source of these information needs to be documented, archived and to be accessible for the public.*

- *Interpretimi duhet të jetë i bazuar në studime multidisiplinare të vendit dhe rrethinës. Ato duhet të paraqesin interpretim logjik të cilat do të duhej reflektojnë hipoteza alternative historike, traditave lokale apo ngjarje.*
- *Në vendet e trashëgimisë kulturore ku tregim dhënia apo kujtesat e pjesëmarrësve historikë ofrojnë burim të mjaftueshëm për sinjifikancën e vendit, programet e interpretimit duhet të inkorporojnë këto dëshmi gojore – ose në mënyrë indirekte përmes mundësive të infrastrukturës interpretative apo direkte përmes pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të komuniteteve si interpretë në vend.*
- *Rekonstruimet vizuale, qoftë nga artistët, arkitektët apo modelatorët me kompjuterë, duhet të jenë të bazuara në analiza sistematike dhe të detajuara mjedisore, arkeologjike, arkitekturale dhe të dhënave historike duke përfshirë analizat e burimeve gojore, ikonografike dhe fotografike. Burimet e informatave në të cilat renderimet vizuale janë të bazuara, duhet të dokumentohen qartë ndërsa rekonstruimet alternative duhet të jenë të bazuara në të njëjtat evidenca, duhet të ofrohen përkrahasime.*
- *Programet e Interpretimit dhe prezantimit si dhe aktivitetet duhet të dokumentohen dhe arkivohen për referenca në të ardhmen.*

Sa i përket evidencës së mbledhur dhe paraqitur në dokumentin zhvillimor të Hanit të Elezit, ato nuk janë të dala direkt përmes metodave të pranuar shkenore, të evidentuara apo dhe të shkruara porse në këtë fazë evidentimi është bërë përmes mbledhjes së burimeve bazuar në gojëdhëna qytetare, e verifikuar në Qendrën e Trashëgimisë Kulturore dhe MKRS, listës së propozuar për mbrojtje. Interpretimet nuk paraqesin të dhëna të bazuara në studime multidisiplinare të vendit dhe rrethinës, porse ato paraqesin interpretim logjik të cilat do të duhej të reflektojnë hipoteza alternative historike, të traditave lokale apo dhe të ngjarjeve.

Nuk dihet nëse në Hanin e Elezit ka persona tregim dhënës apo pjesëmarrës historikë që ofrojnë burim të mjaftueshëm për sinjifikancën e vendit, dëshmi gojore!

Në dokumentin zhvillimor të komunës së Hanit të Elezit, nuk është paraparë ndonjë aktivitet apo dhe program për dokumentim dhe arkivim për referenca në të ardhmen!

### **Parimi 3 – Vëmendja lidhur me kontekstin**

- *Interpretimi dhe prezantimi i vendeve të trashëgimisë kulturore duhet të korelojnë me kontekst më të gjerë social, kulturor, historike dhe natyror. Interpretimi dhe prezantimi i vendeve të trashëgimisë kulturore duhet të korelojnë me kontekst më të gjerë social, kulturor, historike dhe natyror.*
- *Interpretimi duhet të hulumtojë sinjifikancën e vendit: historike, politike, shpirtërore dhe artistike. Duhet të marrë në konsideratë të gjitha aspektet e vendit: aspektin kulturor, social dhe të vlerave sinjifikante mjedisore.*

- *The interpretation should be based on multidisciplinary studies of the location and surroundings. It should represent a logical explanation which should reflect alternative historic hypothesis, local customs or events.*
- *In cultural heritage locations where narrations or the memory of historic participants provide sufficient recourse about the location significance, interpretation programs should incorporate these oral evidences – or in indirect way through the interpretive infrastructure means or in direct manner through active participation of community members as interpreters of the location.*
- *Visual reconstructions, whether by artists, architects or computer modelers, should be based on systematic and detailed environmental, archeological, architectural and historic data analysis, including oral recourses, iconographical, and photographic analysis. Information recourses, in which visual renderings are based, should be clearly documented while alternative reconstructions should be based on the same evidences, and should be offered for comparison.*
- *Interpretation and presentation programs as well the activities should be documented and archive for future references*

As for the collected evidence and presented on the development document of Hani i Elezit, those data are not directly derived through accepted scientific methods, evidenced or in writing, whereas in this phase the evidence is made through collection of recourses based on citizens' narrations, verified by the Centre of Cultural Heritage and Ministry of Culture, Youth and Sports, proposed list for preservation. The interpretations do not represent data based on multidisciplinary studies about the location and surroundings, but represent logical interpretation which should reflect alternative historical, local traditions and events hypothesis.

It is not known if Hani i Elezit have narrators or historic participants which could offer sufficient recourses about the location significance, oral evidence!

The development document of Hani i Elezit municipality, does not predict any activity or even a program for documentation and archive for future reference!

### **Principle 3 – Awareness about the Context**

- *Interpretation and presentation of cultural heritage locations should articulate with a wide social, cultural, historic and natural context.*
- *The interpretation needs to explore the significance of the location: historical, political, spiritual and artistic significance. It needs to take into consideration all location aspects: cultural and social aspects as well the significance of environmental values.*



- *Interpretimi publik i vendit të trashëgimisë kulturore duhet qartë të dallojë fazat e zhvillimit dhe ndikimet në të. Kontinuitet në të gjitha periudhat në sinjifikancë të vendit duhet të respektohen.*
- *Interpretimi duhet të marrë në konsideratë të gjitha grupet të cilat kanë kontribuar sinjifikancën historike dhe kulturore të vendit.*
- *Pejzazhi rrethues, mjedisi natyror dhe paraqitja e saktë gjeografike janë pjesë integrale të sinjifikancës historike dhe kulturore të vendit për tu marrë në konsideratë gjatë interpretimit.*
- *Sinjifikanca ndërkulturore e vendeve të trashëgimisë kulturore sikurse dhe një sërë e perspektivave për to bazuar në hulumtimet shkollore, incizimet e vjetra dhe traditave të gjalla, duhet të merren parasysh në formulimin e programit interpretativ.*

Interpretimi dhe prezantimi i vendeve të trashëgimisë kulturore në komunën e Hanit të Elezit nuk ndërlidhet tërësisht në kontekst më të gjerë social, kulturor, historik dhe natyror, porse mund të thuhet se në përshkrim historik dhe politik të vendbanimit mësohet për çështje të ndryshme për trashëgiminë kulturore.

Dokumentit të planit zhvillimor të komunës së Hanit të Elezit i mungon elaborimi i tërësishëm i gjinive të tjera të trashëgimisë kulturore, aspekti i interpretimit shpirtëror dhe artistik, të cilat poashtu konsiderohen të jenë të larmishme dhe të çmueshme kur flitet për zonën e maleve të Karadakut, komunën e Hanit të Elezit. Po ashtu nuk paraqiten të dalluara fazat e zhvillimit dhe ndikimet në periudha të ndryshme historike. Shumë pak paraqitet pejzazhi rrethues, ku mjedisi natyror dhe vendndodhja gjeografike si pjesë integrale e sinjifikancës historike dhe kulturore të vendit për tu marrë në konsideratë gjatë interpretimit dhe prezantimit.

#### **Parimi 4 – Autenticiteti i preservimit**

- *Interpretimi dhe prezantimi i vendeve të trashëgimisë kulturore duhet të respektojë bazën e autenticitetit dhe shpirtin e dokumentit të NARA (1994)*
- *Autenticiteti merr për brengë komunitetet relevante njerëzore sikurse dhe mbetjet materiale. Dizajni i programit të interpretimit duhet të respektojë funksionet tradicionale sociale të vendit dhe praktikat kulturore si dhe dinjitetin e banorëve lokal të komuniteteve në fjalë.*
- *Interpretimi dhe prezantimi duhet të kontribuojë në konservimin dhe autenticitetin e vendeve të trashëgimisë kulturore me komunikimin e sinjifikancës pa ndikuar në vlerat kulturore dhe duke mos ndryshuar në të.*
- *E gjithë infrastruktura interpretative e dukshme (kiosqet, rrugicat e ecjes apo panelet informative) duhet të jenë të kujdesshme për nga karakteri, përmbajtja e sinjifikancës së vendit të trashëgimisë kulturore, duke mbetur lehtë i identifikueshëm.*
- *Koncertet në vend, performancat dramatike si dhe programet e tjera interpretative duhet të jenë me kujdes të planifikuara për të mbrojtur sinjifikancën dhe rrethinën fizike të vendit duke minimizuar pengesat për banorët lokalë.*

Kur është fjala për autenticitet të preservimit, nuk mund të flitet se në dokument është marrë parasysh dhe elaboruar, meqë Trashëgimia Kulturore në Han të Elezit ende nuk është vlerësuar, dokumentuar dhe arkivuar. Deri në një masë është marrë parasysh rëndësia për autenticitet, kur flitet për mbetje materiale, në kuptim të përshkrimit historik të qytetit dhe rrethinës.

- *Public interpretation of cultural heritage location needs to recognize clearly the development phases and its impacts. The contributions in all periods related to the significance of the location needs to be respected.*
- *The interpretation needs to take into consideration all groups which have contributed in historic and cultural significance of the location.*
- *The surrounding landscape, natural environment and geographic position are integral parts of the historic and cultural significance of the location that needs to be taken into consideration during the interpretation.*
- *Intercultural significance of locations with cultural heritage and series of perspectives based on educational researching, old recordings and living traditions, all needs to be taken into consideration in the formulation of interpretational program.*

Interpretation and presentation of cultural heritage locations in Hani i Elezit municipality does not interact totally with the wider social, cultural, historic and natural context, but we can say that on historic and political description of the settlement we can learn about different issues for cultural heritage.

The development document of Hani i Elezit municipality, lacks an overall elaboration of other genders of cultural heritage, the aspect of spiritual and artistic interpretation, which also are considered to be diverse and valued when talking about the zone of Karadak mountains - Hani i Elezit municipality. Also the phases of development and impacts on different historic periods are not presented. Very little is presented the surrounding landscape, where the natural environment and geographic position as integral parts of historic and cultural significance of the location in order to be taken into consideration during the interpretation and presentation.

#### **Principle 4 – The authenticity of preservation**

- *Interpretation and presentation of cultural heritage locations must respect the bases of authenticity and the spirit of the document of NARA (1994)*
- *The authenticity takes in care relevant human communities as well the material remaining. The design of the program of interpretation should respect traditional social functions of the location and cultural practices as well the dignity of the local inhabitants of respective communities.*
- *Interpretation and presentation should contribute to the preservation and to the authenticity of cultural heritage locations through the communication of the significance without affecting cultural values and without making any change to it.*
- *The entire visual interpretive infrastructure (kiosks, walking alleys or informational plans) should be cautioned by the character, the content of the significance of cultural heritage location, remaining easily identifiable.*
- *Concerts on the location, dramaturgical performances and other interpretive programs should be planned with utmost caution in order to preserve the significance and physical surroundings of the location by minimizing obstacles for local residents.*

When the issue is the authenticity of preservation, it is not to be discussed that the document is predicted and elaborated, because Cultural Heritage in Hani i Elezit is not yet valued, documented and registered in the archives. The importance of the authenticity was taken into consideration up to a certain degree, when the matter is material remaining, in the sense of historic description of the town and surroundings.

Në pjesën e strategjisë janë paraparë aktivitete për infrastrukturë interpretative të dukshme (promovimi, rrugica të ecjes) për promovim të sinjifikancës së vendit të trashëgimisë kulturore.

#### **Parimi 5 – Planifikimi për qëndrueshmëri**

- *Plani i interpretimit për vendin me trashëgimi kulturore duhet të jetë sensitiv në mjedisin e tij natyror dhe kulturor me zhvillimet e qëndrueshme të parapara në aspekt social financiar, dhe mjedisor.*
- *Zhvillimi dhe zbatimi i Programeve të interpretimit prezantimit duhet të jenë pjesë integrale e planifikimit të tërësishëm, buxhetimit dhe menaxhimit të procesit të vendeve me trashëgimi kulturore.*
- *Interpretimi dhe prezantimi duhet të shërbejë si një set i tërësishëm dhe i gjerë i konservimit, arsimit dhe objektivave tjerë kulturorë. Suksesi i një programi interpretativ nuk duhet të vlerësohet vetëm në anën e vizitave të njerëzve apo edhe shifrave të të ardhurave.*
- *Interpretimi dhe prezantimi duhet të jetë pjesë integrale e procesit të konservimit, duke ndikuar në përmirësimin e vetëdijes së publikut të gjerë në probleme specifike të konservimit të dala nga terreni dhe shpjegimit të angazhimit për të mbrojtur integritetin fizik të vendit si dhe autenticitetin.*
- *Programet interpretative duhet të ofrojë përfitime të qëndrueshme dhe të barabarta ekonomike, sociale*
- *kulturore për të gjithë akterët përmes edukimit, trajnimeve dhe mundësive të punësimit në vend.*

Në dokument zhvillimor të komunës së Hanit të Elezit nuk janë specifikuar zhvillimi dhe zbatimi i programeve të interpretimit dhe prezantimit si pjesë integrale e planifikimit të tërësishëm, buxhetimit dhe menaxhimit të procesit të vendeve me trashëgimi kulturore në Hanin e Elezit.

Kujdes i posaçëm në PZHK të Hanit të Elezit i është dhënë në kuadër të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik/krijimit të infrastrukturës për zhvillim të turizmit me përfshirje të programeve të ardhshme për të shërbyer si një set i tërësishëm dhe i gjerë i konservimit dhe edukimit. Ngritja e vetëdijes së publikut të gjerë për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë është paraparë si aktivitet në dokumentin zhvillimor, përderisa komuna e Hanit të Elezit ka paraparë përfitime ekonomike nga sektori i turizmit, përmes ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit posaçërisht të trashëgimisë tradicionale-popullore dhe asaj industriale të Hanit të Elezit me rrethinë.

#### **Parimi 6 – Brengosja për gjithpërfshirje**

- *Interpretimi dhe prezantimi i vendeve të trashëgimisë kulturore duhet të jetë rezultat logjik i bashkëpunimit në mes të profesionistëve të trashëgimisë, komunitetit vendas dhe të tjerët të asocuar, si dhe të akterëve tjerë.*
- *Ekspertiza multidisiplinare e anëtarëve të komunitetit, ekspertëve të konservimit, autoriteteve qeveritar, menaxherëve të vendit dhe interpretëve, operatorëve turistik dhe profesionistëve tjerë duhet të jetë i integruar në formulimin e programeve të interpretimit dhe të prezantimit.*

In the part of the strategy activities were predicted dealing with visual interpretive infrastructure (promotion, walking alleys) for significance promotion of cultural heritage location.

#### **Principle 5 – Sustainability planning**

- *Interpretational plan for cultural heritage location should be sensitive in its own natural and cultural environment with sustainable developments predicted in financial and environmental aspects.*
- *Development and application of interpretational and presentational programs should be integral parts in overall planning, budgeting and management of entire process in cultural heritage locations.*
- *Interpretation and presentation should serve as an entire and wide set of preservation, education and other cultural objectives. The success of an interpretive program should not be assessed only by the visits of people or by the income.*
- *Interpretation and presentation should be integral parts in the process of preservation, affecting the improvement of awareness of the wider public to the specific problems of preservation derived from fieldwork and the explanation of engagement in securing physical integrity of the location and its authenticity.*
- *Interpretative programs should offer sustainable and equal economic, social and cultural benefits for all actors through education, trainings and possible employment on the location.*

In the development document of Hani i Elezit municipality, the development and application of interpretation and presentation programs were not specified as integral parts in overall planning process, budgeting and managing the process in locations with cultural heritage in Hani i Elezit.

A special care in MDP of Hani i Elezit was given in the frame of the Strategy for Economic Development /creation of touristic infrastructure development with inclusion of future programs in order to serve as a complete and wide set of preservation and education. The improvement of the awareness of the public for preservation of heritage values is foreseen as an activity in development document, while Hani i Elezit Municipality predicts economic benefits from the sector of tourism, through the preservation and promotion of specifically vernacular and industrial heritage in Hani i Elezit with its surroundings.

#### **Principle 6 – Overall inclusion**

- *Interpretation and presentation of places with cultural heritage should be a logical result of the cooperation between professionals of heritage, local community and other associates and other actors as well.*
- *Multidisciplinary expertise of community members, preservation experts, and authorities, managers of the location, interpreters and touristic operators all should be integrated in formulation of programs of interpretation and presentation.*

- *Të drejtat tradicionale, përgjegjësitë dhe interesat e pronarëve dhe komunitetit vendorë dhe të tjerëve duhet të merren parasysh, respektohen në planifikim të programeve të interpretimit dhe prezantimit.*
- *Plani për zgjerimin apo revidimin e programit të interpretimit dhe prezantimit duhet të jetë i hapur për komentet e publikut si dhe involvimin. Është e drejtë dhe përgjegjësi e të gjithëve për të bërë të njohur opinionet dhe perspektivat.*
- *Pyetja e pronës intelektuale dhe të drejtave tradicionale kulturore janë veçanërisht specifike në procesin e interpretimit, paraqitjen në media të ndryshme (prezantime multimedia në vend, media digjitale dhe material të printuar), e drejta pronësore dhe e drejta e shfrytëzimit të imazheve teksteve dhe materialeve tjera interpretive do të duhej të diskutohen, qartësohen dhe dakrodohen në procesin e planifikimit.*

Gjatë hartimit të përmbajtjes së trashëgimisë kulturore nuk mund të thuhet se janë përfshirë akterë të ndryshëm për çështje të trashëgimisë kulturore, të komunitetit vendas civil, ekspertë të konservimit, autoritetit qeveritar, menaxherë të vendit dhe interpretë, operatorë turistik dhe profesionistë, për integrimin dhe formulimin e programeve të interpretimit dhe të prezantimit. Në dokument nuk është përmendur çështja e respektimit të së drejtës tradicionale, përgjegjësisë dhe interesave të pronarëve dhe komunitetit vendor dhe të tjerëve.

Në dokumentin zhvillimor të Hanit të Elezit nuk është planifikuar projekt për zgjerimin apo revidimin e programit të interpretimit dhe prezantimit, të hapur për komentet e publikut si dhe për involvim në dhënie të opsioneve dhe perspektivave. Po ashtu, do të duhej të mendohej në parashikimin e mbrojtjes së të drejtës së pronësisë intelektuale dhe të drejtave tradicionale kulturore, veçanërisht në procesin e interpretimit, paraqitjeve në media të ndryshme përmes prezantimeve multimediale në vend, mediave digjitale dhe materialeve të printuara.

#### **Parimi 7 – Rëndësia e hulumtimeve, trajnimeve dhe vlerësimeve**

- *Vazhdimi i hulumtimit, trajnimit dhe vlerësimit - komponentë themelore për interpretim të vendeve të trashëgimisë kulturore.*
- *Interpretimi i vendit të trashëgimisë kulturore nuk duhet të konsiderohet e kompletuar me kompletimin e infrastrukturës interpretative. Shqyrtimi i rregullt duhet të jetë pjesë integrale në programet interpretative.*
- *Programi interpretativ dhe infrastruktura duhet të jenë të dizajnuar dhe konstruohen në mënyrë që të mundësojnë revidimin e vazhdueshëm të përmbajtjes/revidimin.*
- *Programet e Interpretimit dhe Prezantimit / ndikimi i tyre fizik në vend duhet në mënyrë të vazhdueshme të jetë i monitoruar dhe vlerësuar. Vizitorët dhe anëtarët e komuniteteve vendor dhe profesionistëve të trashëgimisë duhet të involvohen në një proces të vlerësimit të tillë.*

- *Traditional rights, responsibilities and owners' interests, local community interest as well the interest of others should be taken into consideration, should be respected in planning of programs for interpretation and presentation.*
- *The plan for expansion or revision of the program about interpretation and presentation must be open for public comments and their involvement as well. It is the right and responsibility of all to present their opinions and perspectives.*
- *The question of intellectual and of traditional cultural rights are especially specific in the process of interpretation, presentation in different media (multimedia presentation, digital media and printed material), the right to a property and the right of using the images, texts and other interpretative material should be discussed, clarify and agreed in the planning process.*

During drafting of the content of cultural heritage it cannot be concluded that different actors are included for issues related to cultural heritage, such as, local civil community, preservation experts, government authorities, managers of the location and interpreters, touristic operators and professionals, for the integration and formulation of programs about interpretation and presentation. In the document is not mentioned the issue of respecting the traditional right, responsibilities and owners' and local community interests and that of the others.

In the development document of Hani i Elezit was not planned any project for expanding and revision of program of interpretation and presentation, open for public comments and involvement as well in offering options and perspectives. Also, it would have been needed to contemplate in prediction of the guarding of the rights of intellectual property and traditional cultural rights, especially in the process of interpretation, appearance in different media through the multimedia presentation, digital media and printed material.

**Principle 7 – The importance of researching, training and evaluation**

- *The continuation of researching, training and evaluation – basic components for interpretation of cultural heritage locations.*
- *The interpretation of cultural heritage location must not be considered complete with the completion of interpretative infrastructure. A right revision should be an integral part in interpretative programs.*
- *Interpretational program and the infrastructure should be designed and constituted in the way that can make possible continuous revision of the content/revision.*
- *Interpretational and presentational programs/their physical impact on the location should be monitored and evaluated continuously. Visitors and members of local committees and that of the heritage professionals should get involved in a process for such evaluation.*

- Çdo program interpretativ - burim edukimi për njerëzit e të gjitha moshave.
- Trajnimi i profesionistëve të kualifikuar në fusha të specializuara të interpretimit dhe prezantimit të trashëgimisë.
- Programet e trajnimeve në vend dhe kurset duhet të zhvillohen me objektiva të mbindërtimit dhe informimit për trashëgiminë dhe stafit të interpretimit në të gjitha nivelet, komunitetet vendore me zhvillimet aktuale dhe të reja në këtë fushë.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shpërndarja e përvojës - shumë të rëndësishme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e standardeve të metodave interpretative dhe teknologjive. Konferencat ndërkombëtare, punëtoritë, shkëmbimi i stafit profesional, ai nacional dhe takimet rajonale duhet të mbështeten.

Sa i përket çështjes së Trashëgimisë Kulturore në komunën e Hanit të Elezit, nuk është paraparë ndonjë program hulumtuesh, vlerësimesh dhe trajnimesh për çështjet në fjalë. Po ashtu nuk është paraparë me aktivitete dhe programe monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm me involvimin e komunitetit dhe profesionistëve të trashëgimisë.

Nuk janë paraparë trajnimet për kualifikim në fusha të specializuara të interpretimit dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore për Hanin e Elezit. Nuk është paraparë bashkëpunimi ndërkombëtar apo dhe ndërkufitar, në kuptim të konferencave ndërkombëtare, punëtorive, shkëmbimit të stafit profesional, takimeve rajonale dhe nacionale.

## **Konkluzion**

Trashëgimia kulturore në Komunën e Hanit të Elezit, për herë të parë është elaboruar me rastin e hartimit të planit zhvillimor komunal. Trashëgimia kulturore nuk është identifikuar kurrë më parë, kategorizuar sipas gjinive, vlerësuar dhe studiuar më për së afërmi.

Mund të thuhet se në Planin Zhvillimor të Komunës së Hanit të Elezit është e përfshirë trashëgimia kulturore, si ajo arkitekturore, arkeologjike, natyrore porse llojet e tjera të TK nuk janë apo janë shumë pak të elaboruara, si trashëgimia shpirtërore, etj. Elaborimi si i tillë gjendet në pjesën e përshkrimit historik për vendbanimet.

Po ashtu mund të thuhet se, gjatë definimit të “gjeografisë” së vlerave të trashëgimisë kulturore nëpër vendbanimet e komunës së Hanit të Elezit, siç janë katundi Pustenik, Dermjak dhe Paldenicë të cilat shquhen për kulturë lokale tradicionale, kanë vlera apo resurse/potenciale për turizëm kulturor, kanë dhe potencial me të cilën mund të mendohet për bashkëpunim ndërkufitar.

Në dokumentin e Planit Zhvillimor të Hanit të Elezit, nuk është specifikuar apo dhe sugjeruar një trajtim për identifikim të tërësishëm të specifikave të trashëgimisë kulturore në komunë. Rekomandimet apo dhe projektet nuk mbulojnë tërësisht nevojat për trajtim të trashëgimisë kulturore në Hanin e Elezit.

## **Rekomandimet specifike lidhur me Komunën e Hanit Elezit**

Rekomandimet në vijim do të vlerësohen sipas parimeve për prezantim dhe interpretim: Qasjes dhe kuptimit; burimeve të informatave; ndërlidhshmërisë në kontekst më të gjerë historik, social e kulturor; autenticitetit; planifikimit për të ardhmen; gjithëpërfshirjes; rëndësisë së hulumtimeve, vlerësimeve dhe trajnimeve në kontekst të trashëgimisë kulturore në komunën e Hanit të Elezit:

- *Each interpretive program – educational resource for people of all ages.*
- *Training of qualified professionals in specialized fields of interpretation and presentation of the heritage.*
- *Training programs and courses should be held containing objectives about over-construction and information about the heritage and the staff of interpretation in all levels, local communities with actual developments and new ones in this field.*
- *International cooperation and distribution of experience – are of great importance for development and maintenance of standards of interpretation methods and technological standards. International conferences, workshops, exchanges of professional staff, national and regional meetings, all above-mentioned needs to be supported.*

As about the issue of Cultural Heritage in Hani i Elezit municipality, no research program was predicted, nor programs about the evaluation or training programs for subject issue. Also it was not predicted any activity and monitoring program and continuous evaluating program including the community and other heritage professionals.

It was not predicted any qualification training in specialized fields of interpretation and presentation about cultural heritage in Hani i Elezit. It was not planed any international cooperation or even inter-border, in the sense of international conferences, workshops, exchanges of professional staff, regional and national.

## **Conclusion**

Cultural heritage in Hani i Elezit municipality, for the first time was elaborated with the occasion of drafting the development plan of the municipality. Cultural heritage was never before identified, categorized in accordance with the gender, evaluated and closely studied.

We can say that in the development plan of Hani i Elezit municipality the cultural heritage is included, that of architecture, archeology, natural while other forms of cultural heritage are not or are very little elaborated, such as, spiritual heritage, ethnological heritage, etc. The elaboration as such can be found in the historic description for settlements.

Also it is worth mentioning that, during definition of "geography" of values of cultural heritage along the settlements of Hani i Elezit municipality, such as villages Pustenik, Dermjak and Paldenicë which are distinguished for local traditional culture, and have values or recourses for cultural tourism, and also possibility for inter-border cooperation.

In development plan document of Hani i Elezit, is not specified or even suggested a treatment for entire identification of cultural heritage specifications within the municipality. Recommendations or even projects do not cover entire needs for treatment of cultural heritage in Hani i Elezit.

## **Specific recommendations related with Hani i Elezit municipality**

Following recommendations will be evaluated in accordance with the principles for interpretation and presentation: That of the access and understanding; resources and information; interaction in wider historic context, social and cultural; the authenticity; planning for the future; inclusion; the importance of research, evaluation and trainings in cultural heritage context in Hani i Elezit municipality:



- Të specifikohet gjendja e sotme e monumenteve dhe të specifikohen lokacionet, pikat, monumentet ne veçanti me limitime specifike për zhvillim në afërsi dhe shfrytëzim joadekuat të vendeve me sinjifikancë kulturore në komunën e Hanit të Elezit, për shkaqe të konservimit, sensitivitetit kulturor, ri-shfrytëzimit adaptiv apo dhe çështjeve të tjera të sigurisë;
- Të bëhet identifikimi dhe vlerësimi i momunenteve të TK, krijimi i “Listës së monumenteve nën mbrojtje”;
- Të planifikohen programe për dokumentim dhe arkivim të TK të komunës së hanit të Elezit;
- Të elaborohen mundësitë për konservim dhe shfrytëzim për resurs të turizmit kulturor në komunën e Hanit të Elezit;
- Të planifikohet zhvillimi i resurseve tjera të Trashëgimisë Kulturore në Hanin e Elezit, siç janë trashëgimia arkeologjike, shpirtërore, industriale etj.
- Të plotësohet lista e masave dhe veprimeve të parapara për monumentet e vlerave tradicionale-popullore dhe të trashëgimisë industriale, me specifikime të llojit të programimit me projekte specifike dhe aktivitete;
- Të bëhet specifikimi i limitimeve në qasje dhe mënyrë të shfrytëzimit kur janë në pyetje mbetjet arkeologjike dhe monumenteve tjera në rrezik të shkatërrimit total apo të rrënimit për shkak të shfrytëzimit të ri të hapësirave. Hartimi i dispozitave të mundshme për parandalimin e shkatërrimit, deri në marrjen e masave për identifikim, dokumentim, arkivim zyrtar dhe promovim të vlerave të trashëgimisë kulturore në komunën e Hanit të Elezit.
- Specifikimi si prioritet i komunës në rast të vlerësimit pozitiv të Trashëgimisë Kulturore të Hanit të Elezit.
- Hartimi i planit për menaxhimin e integruar të monumenteve natyrore dhe kulturore; Hartimi i planeve mbi bashkëpunimin ndërkufitar; Hartimi i planit për zonimin e trashëgimisë kulturore për turizëm; Shpallja e zonës së mbrojtur të Pustenikut, Paldenicës dhe Dremnjakut; Mbrojtja e zonës së Mullirit të vjetër të Luginës së Lepencit në Lagjen e Ranave dhe Laç,
- Të rekomandohen hulumtime për Trashëgiminë Kulturore në Hanin e Elezit përmes metodave të pranuar shkencore, të evidentuara apo dhe të shkruara; që paraqesin interpretim logjik, reflektim të hipotezave alternative historike, të traditave lokale apo dhe të ngjarjeve;
- Të përfshihen akterë të ndryshëm për çështje të trashëgimisë kulturore, të komunitetit vendas civil, ekspertë të konzervimit, autoritetit qeveritar, menaxherë të vendit dhe interpretë, operatorë turistik dhe profesionistë, për integrimin dhe formulimin e programeve të interpretimit dhe të prezantimit.

- To specify the present condition of monuments and to specify the locations, landmarks, monuments in particular with specific limitations for development in the vicinity and inadequate usage of locations with cultural significance in Hani i Elezit municipality, for preservation purposes, cultural sensitivity, adaptive re-usage or other security issues;
- To undertake identification and evaluation of monuments with cultural heritage, formation of the "List of Protected Monuments";
- Planning of programs for documentation and archive regarding cultural heritage in Hani i Elezit municipality;
- To elaborate possibilities for preservation and usage for resources of cultural tourism in Hani i Elezit municipality;
- Planning of other resource developments related to cultural heritage in Hani i Elezit such as archeological heritage, spiritual, industrial heritage, etc.
- Completing the list of measures and actions predicted for monuments with vernacular values, traditional and that of industrial heritage, with specifications of sort of programming through specific projects and other activities;
- To appoint specifications of limitations regarding the access and way of usage when dealing with archeological remaining and other endangered monuments in danger from total destruction or from collapsing due to new usage of space/surface. Drafting of possible dispositions for prevention of destruction, until undertaking identifications actions, documentation, official archiving and promotion of cultural heritage values in Hani i Elezit municipality.
- Drafting the plan for integrated management of natural and cultural monuments; drafting of plans about inter-border cooperation; drafting of plans about précising the perimeter of cultural heritage for tourism; declaring protective zone of Pustenik, Paldenicë and Dremnjak; preservation of the zone of Mulliri i Vjetër (Old Mill), Lepenci valley in Lagja e Ranave and Laç (village quarters);
- Recommendation on research of cultural heritage in Hani i Elezit by accepted scientific approaches, evidences or in written form; that present logical interpretation, reflecting of alternative historic hypothesis, local traditions or other events;
- To include other different actors related to the issues of cultural heritage, of local civil community, preservation experts, government authorities, location managers and interpreters, touristic operators and other professionals, for integration and formulation of interpretive and presentation programs;

- Të planifikohen masa për çështjen e respektimit të së drejtës tradicionale, përgjegjësi dhe interesave të pronarëve dhe komunitetit vendor dhe të tjerëve;
- Në procesin e planifikimit rekomandohet gjithëpërfshirja për zgjerimin apo revidimin e programit të interpretimit dhe prezantimit, të hapur për komentet e publikut si dhe për involvim në dhënie të opsioneve dhe perspektivave;
- Të mendohet në parashikimin e mbrojtjes së të drejtës të pronësisë intelektuale dhe të drejtave tradicionale kulturore, veçanërisht në procesin e interpretimit, paraqitjeve në media të ndryshme përmes prezantimeve multimediale në vend, mediave digjitale dhe materialeve të printuara.
- Të parashihen programe të hulumtimeve, vlerësimeve dhe trajnimeve për çështjet e TK; aktivitete dhe programe monitorimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm me involvimin e komunitetit dhe profesionistëve të trashëgimisë;
- Ta parashihen trajnimet për kualifikim në fusha të specializuara të interpretimit dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore për Hanin e Elezit;
- Të planifikohet bashkëpunimi ndërkombëtar, ndërkufitar, në kuptim të konferencave ndërkombëtare, punëtorive, shkëmbimit të stafit profesional, takimeve rajonale dhe nacionale.

## Rekapitullim I rekomandimeve

Të gjitha rekomandimet në këtë kaptinë do të përmbliidhen në dy kategori: i) Hapat për kuptim të sinjifikancës; ii) Krijimi i politikave për konservim të trashëgimisë kulturore dhe menaxhimi i tyre;

*i) Sinjifikanca kulturore e vendit dhe çështjet e tjera që ndikojnë në të ardhmen janë më së miri të kuptuara në sekvenca gjatë mbledhjes dhe analizimit të informatave para marrjes së vendimeve;*

- Planifikimi urban është njëri nga teknikat të cilat kontribuojnë në konservim;
- Konservimi i vendit duhet të identifikojë dhe merr në konsideratë të gjitha aspektet e sinjifikancës kulturore dhe natyrore meqë shkalla e ndryshme e sinjifikancës mund të shpjerë në veprime të ndryshme të konservimit në vend<sup>92</sup>;
- Është me rëndësi që të “kuptohet sinjifikanca” ndarazi nga hapi i dytë i “zhvillimit të politikave”. Nganjëherë këto të dyja duhet të bëhen nga njerëz të ndryshëm.

*ii) Politikat për menaxhim të trashëgimisë kulturore duhet të bazohen në kuptim të sinjifikancës kulturore.*

- Zhvillimi i politikave duhet të bazohet në kuptimin e rrethanave tjera për të ardhmen e vendit sikurse që janë nevojat e pronarëve, resurset, vështirësitë e jashtme apo kushteve fizike.

<sup>92</sup> Mbrojtja dhe interpretimi i të gjitha vlerave – shumë vende historike aplikojnë qasjen - “kapsula e kohës” në konservim.

- Planning of actions regarding the issue for respecting traditional rights, responsibilities and other owners' and local community interests and that of others;
- In the planning process it is recommended wider inclusion for extending or revision of the program of interpretation and presentation, open for comments of the public as well for involvement in offering options and perspectives;
- It is needed to reflect about the protection of intellectual property and the rights of traditional culture, especially in interpretation process and presentation in different media, multimedia presentations, digital media and printed materials;
- Foreseeing the research programs, evaluation and trainings related to cultural heritage; activities and monitoring programs, continuous evaluation through community involvements and heritage professionals;
- Trainings should be forecasted regarding qualification in specialized fields of interpretation and presentation of cultural heritage for Hani i Elezit;
- An international cooperation is needed to be planned, inter-border, in the sense of international conferences, workshops, professional staff exchange, regional and national meetings;  
An international cooperation is needed to be planned, inter-border, in the sense of international conferences, workshops, professional staff exchange, regional and national meetings;

### **Summary of recommendations**

All recommendations in this chapter shall be summarized in two categories: i) Steps for meaning of significance; ii) Creation of policies for preservation of cultural heritage and management of the same:

*i) Cultural significance of the location and other issues that affect the future are understood at the best in sequences during meetings and analyses of information before making decisions;*

- Urban planning is one of the techniques which contributes in the preservation;
- The preservation of the location should identify and take into consideration all cultural and natural significance aspects because the different scale of significance can lead in various actions regarding the preservation of the location;
- It is important that the significance being understood separately from the second step of "policy planning". Sometime these two actions should be made by different people.

*ii) Management policies of cultural heritage should be based on the sense of cultural significance.*


- The development of policies are to be based on the sense of various situation for the future of the location as are the need of the owners, resources, outer difficulties or physical conditions.

Aty ku shfrytëzimi i vendit ka sinjifikancë kulturore ajo duhet të ruhet medoemos.

- Konservimi është i bazuar në respekt për ekzistuesen. Kërkon një qasje të kujdesshme të ndryshimeve sa më shumë që është e nevojshme por sa më pak që është e mundur.
- Konservimi duhet të shfrytëzojë sa më shumë nga njohuritë, aftësitë dhe disiplinat të cilat kontribuojnë në studimet dhe kujdesin për një vend.
- Politikat duhet të identifikojnë shfrytëzimin apo kombinimin e shfrytëzimit për të ruajtur sinjifikancën kulturore.
- Shfrytëzimi i ri duhet të involvojë minimum të ndryshimeve;
- Pyetjet të cilat ndihmojnë për të vlerësuar se a është shfrytëzimi i përshtatshëm me sinjifikancën kulturore të vendit do të ishin: Nëse shfrytëzimi i kaluar mund të ruhet, interpretohet dhe të vlerësohet? Nëse ka vend dhe mundësi për rekonstruimin e komponentëve të “humbura” apo dhe të funksioneve?

Fig.74 – Pamje nga industritë e qytetit

Fig.74 – Image of the town's industry





There where the usage of the location has a cultural significance that location must be preserved.

- The preservation is based upon respecting the existing. It needs a careful access of the changes as much as it is needed but as less as it is possible.
- The conservation should use as much from the knowledge obtained, abilities and disciplines which can contribute in the studies and the care for a location.
- Policies should identify usage or combination of usage for preservation of cultural significance.
- The new usage should involve a minimum of changes/alteration;
- Questions which help in evaluation that if the usage is accordance with cultural significance of the location would be: If the previous usage can be preserved, interpret and evaluate; if there is space an possibility for reconstruction of "lost" components or even functions.

---

<sup>93</sup> The preservation and interpretation of all values – many historic locations apply the "time capsule" approach in conservation.

## KONKLUZION I PËRGJITHSHËM

Nga studimi i realizuar, në përgjithësi mund të nxirret një konkluzion i përbashkët se: çështja e trashëgimisë kulturore në raport me planifikimin hapësinor nuk ka një trajtim sistematik dhe të qëndrueshëm. Arsyet për këtë janë të ndryshme, të cilat dallojnë për nga hierarkia e planeve, për nga forma dhe koha në të cilën janë zhvilluar proceset e hartimit të planeve përkatëse, dallojnë edhe për nga qasja dhe gatishmëria e bartësve të proceseve planifikuese, për të trajtuar çështjen në formën e duhur.

Përshtypje e përgjithshme është se, për pjesën më të madhe të planeve të trajtuara hapësinore në këtë studim – trashëgimia kulturore përcaktohet si njëra ndër çështjet shumë të rëndësishme të shoqërisë në përgjithësi. Gati në të gjitha rastet e hulumtimit, vërehen problemet e prezantimit korrekt të gjendjes ekzistuese, e cila shpesh është e ndërlidhur me faktin e mungesës së të dhënave. Ky fakt më së miri vërehet në PHK si dokumenti kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor në Kosovë. Edhe përkundër rëndësisë, në dokument mungon një listë e zonave dhe monumenteve kryesore të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Prezantimi hartografik i të dhënave është i mangët dhe në asnjë mënyrë nuk prezanton gjendjen reale në të gjithë territorin e Kosovës. Edhe pse në Kosovë ka një numër të konsiderueshëm të ndërtimeve të arkitekturës industriale, të arkitekturës së shekullit XX, hapësira karakteristike rurale, vlera të shumta të trashëgimisë shpirtërore, etj. të cilat përmbajnë gjithashtu vlera të dëshmuara, nuk janë të trajtuara fare në dokument. Shikuar nga aspekti i trashëgimisë kulturore, në dokument gjithashtu mungon ose do të ishte e preferuar paraqitja e një shtegu të ashtuquajtur kulturor, i cili për vizitorët do të prezantonte lidhjen dhe qasjen më të lehtë në përmbajtjet e rëndësishme kulturore në Kosovë.

E njëjta situatë paraqitet edhe në rastet e komunave të cilat përpos listave të paverifikuara të monumenteve dhe përmbajtjeve kulturore, sa i përket aspektit hapësinor dhe fizik, nuk prezantojnë një gjendje reale. Një shembull karakteristik në këtë drejtim paraqet rasti i Komunës së Mitrovicës dhe ai i Pejës, në të cilin prezantimi i vlerave kulturore ndryshon varësisht nga koha e hartimit të dokumenteve përkatëse. Karakteristikë tjetër e prezantimit të çështjes së trashëgimisë kulturore paraqet rasti i Komunës së Hanit Elezit. Për shkak të mungesës së informatave dhe faktit se Elez Hani është komunë e posa formuar, prezantimi i trashëgimisë kulturore është minimal.

Sa i përket strategjisë, në të cilën duhet të parashihen rekomandime, veprime dhe aktivitete në drejtim të mbrojtjes dhe trajtimit adekuat të trashëgimisë kulturore, situata paraqitet edhe më e vështirë. Gati në të gjitha rastet e komunave të përfshira në studim, përveç rastit të Komunës së Pejës dhe Mitrovicës, trashëgimia kulturore nuk është çështje e strategjisë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor komunal, ose, në rastin më të mirë rekomandimet i referohen Planit Hapësinor të Kosovës, pa hyrë në zbërthimin e mëtejshëm të aktiviteteve specifike komunale (rasti i Gjakovës dhe rasti i Vushtrrisë). Në rastin e komunës së Pejës, plani i fundit zhvillimor komunal ofron rekomandime të konsiderueshme të formës së përgjithësuar, të cilave u mungojnë veprimet e duhura specifike. Rekomandimet dhe aktivitete për trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore, parashihen vetëm në planet e mëhershme hapësinore të Komunës së Mitrovicës, të cilat fatkeqësisht mungojnë në planin e fundit zhvillimor komunal.

## GENERAL CONCLUSION

As of the carried study, a common conclusion could be envisaged: the question of cultural heritage in relation with the spatial planning does not have a consistent treatment. Reasons to this are different and those differ by the hierarchy of plans, by the form and time in which the plans were made in processes of mapping appropriate plans, and also differ by the approach and readiness of process undertakers of planning processes, in order to treat the issue in appropriate form.

Overall impression is that, for the big part of spatial plans treated in this study – cultural heritage is considered as one of the issues of great importance of public in general. Almost in all cases of researches, problems can be recognized regarding correct presentation of factual state, which very often is interrelated with the fact of missing data. This fact can be seen best in SPK as a main document of spatial planning section in Kosovo. Even for the fact that it is very important, the document is missing a list of locations and main monuments of cultural heritage in Kosova. Mapping presentation of data has weak points and in no way presents factual state in overall territory of Kosovo. Although that Kosovo contains a considerable number of constructions with industrial architecture, 20<sup>th</sup> century architecture, the characteristic rural space, and many values of spiritual heritage, etc. which contains also evidenced values; those are not treated at all in this document. Looking from the aspect of cultural heritage, the document also misses or it would be preferable presentation of a path so-called cultural, which path would present to the visitors the relation and easier access to the important cultural content in Kosovo.

The same situation appears also in cases of municipalities, which besides the lists without any verification of monuments and cultural content, as for the space and physical aspect does not present a real factual state. A characteristic example in this regard presents the case of Mitrovica municipality and that of Peja/Peć, in which presentation of cultural values differs depending on the time of drafting the particular documents. Another characteristics of presentation regarding the issue of cultural heritage is the case of Hani i Elezit/Elez Han Municipality. Due to the lack of information and the fact that Hani i Elezit/Elez Han is a newly established municipality, the presentation of cultural heritage is minimal.

As for the strategy, in which recommendations can be forwarded, actions and activities regarding the preservation and adequate treatment of cultural heritage, the situation appears even more difficult. Almost in all cases of municipalities included in study, except of Peja/Peć and Mitrovica, cultural heritage is not an issue of strategy for future municipal spatial development, or, in the best situation recommendations are referred to Spatial Plan of Kosovo, without further indulging in specific municipal activities (the case of Gjakova/Djakovica and Vushtrri/Vučitrn). In the case of Peja/Peć municipality, the last municipal development plan offers considerable recommendations in general form, without appropriate specific actions. Recommendations and activities for appropriate treatment of cultural heritage, considered are only previous spatial plans of Mitrovica Municipality, which unfortunately are missing in the last municipal development plan.



Karakteristikë tjetër të veçantë në disa prej planeve të deritashme hapësinore komunale, paraqet tendenca e trajtimit selektiv dhe në momente edhe diskriminuese e trashëgimisë kulturore. Duke i pasur parasysh rrethanat politike të kohës, në planet e mëhershme hapësinor të disa komunave, vërehet përpjekja e strukturave të atëhershme që të minimizohen disa vlera përkatëse dhe të favorizohen disa të tjera. Në emër të zhvillimit ekonomik dhe rindërtimit të vendit, hartohen plane dhe realizohen projekte në kundërshtim me kriteret dhe vlerat e trashëgimisë kulturore. Rast tipik i një veprimi të tillë, janë autoritetet e atëhershme të Komunës së Pejës, të cilët aprovojnë planin sipas të cilit, realizohet ndërtimi i Fabrikës së Baterive mbi lokalitetin e dëshmuar arkeologjik.

Një situatë më ndryshe sa i përket strategjisë dhe përfshirjes së çështjes së trashëgimisë kulturore paraqitet në dokumentin e Planit Hapësinor të Kosovës. Sipas studimit dhe analizës që i është bërë, dokumenti në fjalë ofron qëllime dhe objektiva të cilat mbështetën me aktivitete dhe dispozita të mjaftueshme për trajtimin e kënaqshëm të trashëgimisë kulturore. Duke qenë se dokumenti konsiderohet bazë për zhvillimet hapësinore në Kosovë e në veçanti për zhvillimet komunale, konstatojmë se rekomandimet e ofruara janë në harmoni të plotë me kapacitetet ekzistuese dhe si të tilla mund të shfrytëzohen si pikënisje, për të zbërthyer deri në detaje aktivitetet në drejtim të mbrojtjes adekuate të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

## REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

Rekomandimet e përgjithshme janë përmbledhje e rekomandimeve dhe sugjerimeve nga të gjitha rastet e trajtuara në këtë studim. Në fakt, këto rekomandime shprehin përgjigje në shumë çështje që janë identifikuar si problematike në përfshirjen adekuate të trashëgimisë kulturore në dokumentet e analizuara. Si të tilla, ato i kemi klasifikuar në disa grupe, që kryesisht ndërlidhen me institucionet e të gjitha niveleve që janë përgjegjëse për trajtimin adekuat të trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor. Në këtë pjesë, një element të rëndësishëm paraqesin rekomandimet specifike, me të cilat është bërë përpjekje që në mënyrë konkrete dhe të detajuar, të ofrohen zgjidhje për formën dhe mënyrën e përfshirjes së trashëgimisë kulturore, në fazat e ndryshme të dokumenteve përkatëse komunale.

### Niveli qendror Sektori i trashëgimisë kulturore

Duke qenë se sektori i trashëgimisë kulturore me të gjithë strukturën përbërëse, paraqet bartësin dhe përgjegjësin kryesor për çështjen e trashëgimisë kulturore, konsiderojmë se disa nga të gjeturat e studimit duhet të mbështetën dhe janë të ndërlidhura me rekomandimet e listuar më poshtë:

Another special characteristic, in some of current municipal spatial plans, is a tendency of selective treatment of cultural heritage and in some moments discriminative. Having in mind different politic situations, in previous plans, in some municipalities, a tendency could have been recognized when structures of that time tried to minimize some particular values and to prefer some other values. In the name of economic development and rebuilding of the country, different plans were drafted and some projects were undertaken in opposition with criteria and values of cultural heritage. A typical case of such action is previous authorities in Peja/Peć Municipality, which approved a plan by which a battery factory was built atop of recognized archeological location.

Somewhat different situation regarding the strategy and inclusion of the cultural heritage issue is Spatial Plan of Kosovo. According to the study and analyses undertaken, the mentioned document offers purposes and objectives which are supported by sufficient activities and provisions for satisfying the treatment of cultural heritage. For the fact that the document is considered a ground for spatial development in Kosovo and in particular, for municipal developments, we find that offered recommendations are in full harmony with the existing capacity and as such can be used as a starting point, in order to break down into details activities in the direction of adequate preservation of cultural heritage in Kosovo.

## **GENERAL RECOMMENDATIONS**

General recommendations are summaries of recommendations and suggestions derived from all cases treated in this study. In fact, these recommendations answer to many issues that have been identified as problematic in adequate enclosure of cultural heritage in analyzed documents. As such, we have classified in few groups, which basically are inter-related with the institutions of all levels that are responsible for adequate training of cultural heritage in space planning. In this part, a very important element presents specific recommendations, with which an effort was made to offer solutions correctly and in details, to offer solutions about the form and manner of inclusion of cultural heritage in different phases of appropriate municipal documents.

### **Central level Cultural heritage sector**

Due to the fact that the segment of cultural heritage with all its structure, presents carrier and main responsible for issues regarding cultural heritage, we consider that some findings of the study should be supported and are linked with the recommendations listed below:

- Njëri ndër veprimet e para ndërlihet me nevojën e arritjes së një konsensusi gjithëpërfshirës, sipas të cilit të gjitha institucionet relevante duhet të pajtohen për futjen e trashëgimisë kulturore në prioritet me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës;
- Hartimi i Strategjise Kombëtare për ruajtje, promovim dhe zhvillim të Trashëgimisë Kulturore;
- Të rishikohet ligji për trashëgiminë kulturore dhe eventualisht të plotësohet;
- Të bëhet kompletimi dhe zbatimi i pa kushtëzuar i bazës ligjore;
- Në mënyrë urgjente të bëhet harmonizimi i dispozitave të Ligjit për Trashëgimi Kulturore me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor;
- Të punohet në unifikimin e termeve të përdorura në bazën ligjore, të cilat shpesh sjellin situatë të paqarta;
- Të bëhet përcaktimi i qartë i termeve dhe përkufizimeve të përdorura në ligjet përkatëse;
- Të bëhet harmonizimi sa më i shpejtë i Ligjit për Trashëgimi Kulturore në mes versionit shqip dhe anglisht, sidomos në terminologji profesionale sa i përket trajtimit hapësinor të vendeve të trashëgimisë kulturore;
- Të bëhet shpallja sa më e shpejtë e Listës së monumenteve në mbrojtje të përhershme;
- Përcaktimi sa më i shpejtë i Zonave të Mbrojtura për të gjithë territorin e Kosovës bazuar në nenin 2.21 të Ligjit për Trashëgimi Kulturore;
- Të merret vendimi për themelimin e grupit punues për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura (MKRS – MMPH)
- Të bëhet vlerësimi, konservimi dhe promovimi i vlerave reale të trashëgimisë kulturore në Kosovë me të gjithë përbërësit e saj;
- Të bëhet themelimi, kompletimi i vazhdueshëm dhe përcaktimi i qartë i hierarkisë vendimmarrëse të mekanizmave institucionalë;
- Në mënyrë të qëndrueshme të përcaktohet baza financiare për trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore në Kosovë;
- Të bëhet plotësimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore në aspektin e menaxhimit dhe trajtimit të duhur të trashëgimisë kulturore;
- Të hartohet strategjia kombëtare për trashëgiminë kulturore, sipas të cilës do të definohen në mënyrë të qartë planet e ndryshme të veprimit dhe përgjegjësit kryesor të realizimit;
- Krijimi i fondit për trashëgimi kulturore, i cili me një interes të përbalueshëm, do të mund të shfrytëzohej nga pronarët për revitalizimin e objekteve dhe zonave përkatëse;
- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (Konventa Europiane e Peizazhit, Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike të Europës – Konventa e Granadës 1985, Konventa Europiane për mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike – Valleta 1992 etj.);
- Përgatitja e hartës digjitale me përmbajtje të trashëgimisë kulturore të gjeoreferencuara dhe të mbështetura me informata bazike që kanë të bëjnë me:

- One of the first actions has to do with the need of attaining general accord by which all relevant institutions must agree to place cultural heritage as a priority with the objective for sustainable development of Kosovo;
- Draft of National Strategy for preservation, promotion and development of cultural heritage;
- Review of the cultural heritage law and eventually to be supplemented;
- A completion needs to be done and unconditional application of legal ground;
- Immediate standardization of the Cultural Heritage Law provisions with the provisions of the Law on Spatial Planning;
- Work in the unification of terms used in legislation, which often lead to obscure situations;
- Clear definition of terms and definitions used in the relevant laws;
- Instant reconciliation of Albanian and English versions of the Law on Cultural Heritage, particularly of the professional terminology in terms of the spatial treatment of cultural heritage sites;
- Announcement in no delay of the List of monuments in permanent protection;
- Setting of the Protected Zones for the whole territory of Kosovo as soon as possible, based on section 2.21 of the Law on Cultural Heritage;
- Bring of the decision on the establishment of a working group for determining the Protected Zones (MCYS – MESP);
- Evaluation, preservation and promotion of real values of cultural heritage in Kosovo with all its components;
- Establishment, a continuous completion and a clear appointment of decision-making hierarchy of institutional mechanisms;
- Employment of sustainable manner of the financial source for appropriate treatment of cultural heritage in Kosovo;
- Achievement and continuous increase of human capacities in management and appropriate treatment of cultural heritage;
- The creation of cultural heritage fund, which by a manageable interest, would be utilized by the owners for revitalization of constructions and particular zones;
- Ratification of international conventions (European Landscape Convention, Convention for the protection of the Archaeological Heritage of Europe – Granada Convention 1985, European Convention on Protection of the Archaeological Heritage – Valletta 1992, etc.);
- Preparation of a digital map containing cultural heritage geographically referred and supported with basic information which has to do with:

- Shënime të sakta për pronarin;
  - Shënime për territorin që mbulojnë dhe zonën përkatëse mbrojtëse;
  - Shënime për gjendjen momentale fizike; dhe
  - Shënime thelbësore për historikun e secilës përmbajtje.
- Të bëhet inventarizimi i të gjitha përmbajtjeve të rëndësishme;
  - Të bëhet vlerësimi i objekteve dhe tërësive të TK të inventarizuara dhe plotësimi i listës me monumente tjera me status të mbrojtjes për Kosovën. Të bëhet identifikimi i monumenteve kulturore me informata të sakta (datimi, vendndodhja, përshkrimi të gjendjes fizike, trajtimi i derisotëm, emërtimet, si dhe të dhëna tjera relevante me detale); kategorizimi me specifika sipas kategorive (p.sh. trashëgimia industriale, etj);
  - Të përcaktohen procedurat dhe kriteret për përfshirjen e trashëgimisë kulturore në planin hapësinor të të gjitha niveleve;
  - Të definojë qartë formatin e zhvillimit urban historik nëpër etapa të ndryshme të qytetit/komunës, për të gjitha komponentet e trashëgimisë kulturore;

## **Sektori i planifikimit hapësinor**

Sa i përket trashëgimisë kulturore dhe trajtimit të saj, rekomandimet kryesore për sektorin e planifikimit hapësinor janë të ndërlidhura dhe varen drejtpërdrejtë nga bashkëpunimi dhe komunikimi me sektorin e trashëgimisë kulturore në përgjithësi.

- Në dokumentet e planifikimit hapësinor çështja e trashëgimisë kulturore nuk duhet të trajtohet vetëm si çështje formale, e cila shpesh përfundon vetëm me konstatim për gjendjen ekzistuese dhe pa analizë për mundësitë e përfshirjes si faktor i rëndësishëm për zhvillim në përgjithësi. Prandaj, rekomandohet bashkëveprimi me sektorin e trashëgimisë kulturore qysh në fillim të procesit të hartimit të planeve përkatëse hapësinore.
- Në procesin e hartimit të planeve hapësinore dhe atyre urbane duhet të përfshihen të gjithë akterët relevantë, të gjitha grupet e interesit sa i përket trashëgimisë kulturore duke përfshirë këtu edhe Bashkësinë Islame të Kosovës, Ipeshkvinë e Kosovës dhe Kishën Ortodokse Serbe.
- Në bashkëpunim me sektorin e trashëgimisë kulturore, duhet të insistohet në kërkesën që të gjitha nivelet e planifikimit të shfrytëzojnë në parim të njëjtën metodologji të veprimit e cila përmban: evidentimin, gjenezën dhe valorizimin në bazë të zhvillimit historik; analizën e gjendjes ekzistuese; metodat e sanimit dhe programin me rekomandime për mbrojtje, revitalizim dhe përfshirje funksionale adekuate.

- Exact information about the owner;
  - Information on the territory covering the protected zone;
  - Information about the current physical state; and
  - Foundational information about the history for each matter.
- Record of inventory of all important components;
  - Evaluation of objects and compounds of listed Cultural Heritage and completion of the list for all other monuments with protection status in Kosovo. Identification of cultural monuments with exact information (date, location, description of physical state, current treatment, names and other detailed relevant data); categorization with specifics according to categories (for example, industrial heritage, etc);
  - Assignment of procedures and criteria for inclusion of cultural heritage in spatial plans in all levels;
  - Clear definition of the historic urban layout of the city/municipality for all components of cultural heritage;

### **Spatial planning sector**

As for the cultural heritage and its treatment, main recommendations for spatial planning are connected and depend directly on the cooperation and liaison with cultural heritage sector in general.

- In spatial planning documents the issue of cultural heritage should not be treated only as a formal issue, which often ends up only with a conclusion for the existing state and without any examination for the possibilities of including as an important factor for the development. Therefore, it is recommended an interaction with the sector of cultural heritage since from the beginning of the process drafting particular spatial plans;
- The process of the draft of the spatial and urban plans should involve all relevant stakeholders, all interest groups in terms of cultural heritage, including the Islamic Community of Kosovo, Diocese of Kosovo and the Serbian Orthodox Church.
- In the cooperation with the cultural heritage sector, it is needed to insist in the request that – all levels of planning to employ in principle same methodology of action which includes: evidence, genesis and valorization based on historic development; the examination of the factual state; methods of sanitation and program containing recommendations for protection, revitalization and adequate functional inclusion;

- Në bashkëpunim me sektorin e trashëgimisë kulturore, duhet të përcaktohen kriteret për përfshirjen hapësinore të të gjithë komponentëve të trashëgimisë kulturore (materiale dhe jo materiale);
- Në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshëm të bëhet ngritja e kapaciteteve humane për trajtimin e duhur të çështjes së trashëgimisë kulturore;
- Të insistohet në trajtimin e duhur të çështjes së trashëgimisë kulturore në planet e nivelit komunal;
- Trashëgimia kulturore do të duhej të jetë pjesë/kaptinë e ndarë dhe e veçantë në dokumentet e planifikimit hapësinor, madje do të ishte e rekomandueshme që, për rastet karakteristike, çështja e trashëgimisë kulturore të ngritet në nivel të fushës tematike;
- Planet zhvillimore të komunave do të duhej të planifikojnë dhe insistojnë në hartimin e Planeve Rregulluese Urbane të fokusuar në Rizhvillim dhe Konservim të zonave të vjetra të qyteteve dhe zonave tjera me rëndësi historike dhe kulturore;
- Të bëhet specifikimi i hapave të veprimit për hulumtime, me qëllim mbrojtjeje institucionale për: konservim, interpretim, prezantim dhe promovim; Vlerësimi i autenticitetit në kuptim të kategorizimit dhe valorizimit të monumenteve. Rekomandohet të bëhet praktikë e përdorimit të listës kontrolluese të dalë nga institucioni ICOMOS, që mund të përdoret edhe si praktikë edhe për vende me vlera të trashëgimisë kulturore;
- **Plani Hapësinor i Kosovës** - duhet medoemos të trajtojë të gjitha zonat dhe monumentet që momentalisht janë në listën e mbrojtjes ligjore, duke i përfshirë edhe zonat që kanë një vlerë monumentale të qartë dhe trashëgiminë karakteristike shpirtërore;
- Të prezantojë hartën e trashëgimisë kulturore për të gjithë territorin e Kosovës dhe me të gjitha komponentët përbërëse;
- Të prezantojë shtegun kulturor me qëllim të lëvizjes dhe qasjes më të lehtë në përmbajtjet e rëndësishme kulturore për vendin.

### **Niveli lokal**

#### *Drejtoritë komunale për kulturë*

- Mbrojtja e avancuar e trashëgimisë kulturore duhet të ketë qëllim të dyfishtë: të realizojë mbrojtjen e vazhdueshme të vlerave të trashëgimisë arkitektonike dhe në të njëjtën kohë të sigurojë zhvillimin e funksioneve adekuata në to;
- Drejtoritë komunale të kulturës në bashkëpunim me Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore, të bëjnë vlerësimin real të trashëgimisë kulturore në të gjitha komunat e Kosovës.

<sup>94</sup>Shih shtojcën A

<sup>95</sup>Plani i konservimit nuk është i parashikuar/obliguar me Ligjin për Planifikimin Hapsinor, përderisa rekomandohet që vend të Planit rregullues për zona qendrore të qyteteve me karakter historik dhe kulturor, të hartohen këto lloj planesh, dhe në ndërkohë të mbindërtohet LPH.

- In the cooperation with cultural heritage sector, a criteria need to be appointed for spatial inclusion of all components of cultural heritage (material and non-material);
  - In the continuous and sustainable manner to make improvement of human capacities for appropriate treatment of cultural heritage issues;
  - To insist in needed treatment of the issue regarding cultural heritage in municipal level plans;
  - Cultural heritage should be a separated part/chapter in spatial planning documents, even it is recommended that, for characteristic cases, issues related to the cultural heritage to expand in the level of thematic field;
  - Development plans of the municipalities, should have been making planning and insist in drafting of Urban Regulative Plans focused on re-development and preservation of old zones of the cities and other zones with cultural and historic importance;
  - To perform specification of the steps of action for researches aiming institutional protection for: preservation, interpretation, presentation and promotion; the evaluation the authenticity in the sense of categorization and valorization of monuments. It is recommended to utilize practice of usage of the controlling list derived from ICOMOS that could be used also as a practice for places containing cultural heritage values;
- **Spatial Plan of Kosovo** – must treat all zones and monuments that currently are in the list of legal protection, including also zones that have any clear monumental values and spiritual characteristic heritage;
  - To present the map of cultural heritage for entire territory of Kosovo with all its components;
  - To present cultural path aiming the movement and easy access toward the important cultural components for the location

### **Local level**

#### *Municipal culture departments*

- Advanced protection of cultural heritage needs to have dual purpose: to realize continuous protection of continual architectural values and in the same time to provide adequate functions development in them;
- Municipal departments in cooperation with regional offices for protection of cultural monuments, to make real evaluation of cultural heritage in all Kosovo municipalities. To draft a final list of cultural components in particular municipalities;

---

<sup>96</sup>See Addendum A

<sup>97</sup>Conservation plan is not required by the Law on Spatial Planning, while it is recommended that instead of Regulatory Plan for the Central Areas of Cities with historical and cultural character, to develop such plans, and in the meantime to upgrade the LSP.



- Të përpilohet lista përfundimtare e përmbajtjeve kulturore në komunat përkatëse;
  - Në bashkëpunim me ekspertë të dëshmuar të fushës dhe në bazë të formatit të aprovuar nga niveli qendror, të hartohet historiku i të gjitha përmbajtjeve kulturore në komunat përkatëse;
  - Rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet rregullimit të çështjeve pronësore dhe juridike të cilat shpesh paraqesin pengesë në realizimin e mbrojtjes përkatëse;
  - Në bashkëpunim me autoritetet qendrore, të hartojnë politikat adekuate për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe krijimin e lehtësirave financiare për pronarët e objekteve private nën mbrojtje;
  - Të përpilojnë planet lokale për trajtimin e trashëgimisë kulturore në komunat përkatëse duke përfshirë edhe listën e prioritetëve në fushën e trashëgimisë kulturore;
  - Të sigurohet përfshirja e pronarëve dhe grupeve të interesit, në procesin e valorizimit dhe inventarizimit të monumenteve të kulturës;
  - Në bashkëpunim me autoritetet qendrore, të organizojnë fushata vetëdijësi për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore në komunat përkatëse.
- Në mënyrë që trashëgimia arkitektonike të përfshihet në formën e duhur në planet përkatëse hapësinore komunale, rekomandohet një hulumtim dhe analizë paraprake për përcaktimin e programit adekuat të ruajtjes dhe shfrytëzimit funksional, duke respektuar përparësinë në aspektin e rëndësisë dhe vlerës që ka përmbajtja përkatëse;
  - Në mënyrë që përmbajtjet e trashëgimisë kulturore, me theks të veçantë ato të trashëgimisë arkitektonike, të përfshihen në planet komunale, nuk duhet të trajtohen si raste të izoluar por pjesë funksionale e planeve përkatëse;
  - Planet përkatëse komunale, duhet të shfrytëzohen si instrumente kryesore për kontroll të zhvillimeve;
  - Duke pasur parasysh ekzistimin e informatave të mjaftueshme për zonat e veçanta të mbrojtura, është e domosdoshme të bëhet prezantimi adekuat dhe përfshirja funksionale e tyre;
  - Në bashkëpunim me drejtoritë komunale për kulturë, të sigurojnë informatat e nevojshme për prezantimin adekuat të trashëgimisë kulturore në komunat përkatëse;
  - Në bashkëpunim me drejtoritë komunale për kulturë, të insistohet në futjen e trashëgimisë kulturore në agjendën e zhvillimit të përgjithshëm komunal;

#### *Drejtoritë komunale për urbanizëm dhe planifikim hapësinor*

- Drejtoritë komunale për urbanizëm dhe planifikim hapësinor të hartojnë planet zhvillimore komunale dhe planet tjera përkatëse duke i përfshirë në proces të hartimit edhe subjektet kompetente për trashëgimi kulturore dhe të gjitha grupet tjera të interesit, duke përfshirë këtu edhe Bashkësinë Islame të Kosovës, Ipeshkvinë e Kosovës dhe Kishën Ortodokse Serbe;

- In cooperation with proved experts in relation with this field and based on the approved format by the central level, a history of all cultural components in particular municipalities, must be drafted;
- A special importance is to be given to the regulation of on the legal ownership issues which very often represents obstacles in realization of particular protection;
- In cooperation with central authorities adequate policies needs to be drafted regarding the protection of cultural heritage, including financial straightforwardness for the owners of private owned compounds under protection;
- Drafting of local plans, regarding the management of cultural heritage, in particular municipalities, including also the list of priorities in the field of cultural heritage;
- To ensure inclusion of the owners and groups of interest in the process of valorization and the inventory of cultural monuments;
- In cooperation with central authorities, to organize campaigns of awareness about care of cultural heritage in particular municipalities;
- In order that the cultural heritage, specifically of the architectural heritage, that needs to be included in municipal plans, these are not to be treated as isolated issues but instead should be treated as functional parts of given plans;
- Respective municipal plans should be used as main instruments for controlling the progress;
- Having in mind the existence of sufficient information for particular protected zones, it is necessary to make an adequate presentation and their functional inclusion;
- In cooperation with municipal departments of culture, to provide needed information for the adequate presentation of cultural heritage in particular municipalities;
- In cooperation with municipal department of culture, it is to be insisted inclusion of cultural heritage in the agenda of general municipal development;

#### *Municipal departments of urbanism and spatial planning*

- Municipal departments of urbanism and spatial planning are to draft municipal development plans and other particular plans including in the process of mapping also competent subjects for cultural heritage and other stakeholders including the Islamic Community of Kosova, the Diocese of Kosova and Serbian Orthodox Church.
- In order to include architectural heritage in the right form in respective municipal spatial plans, it is recommended to undertake a research and a preceding examination aiming the designation of an adequate program about the preservation and functional usage, always respecting the priority of the importance aspect and value that the particular composition contains;

- Me qëllim të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik komunal, duhet që, përpos aspektit kulturor, trashëgimia kulturore të trajtohet edhe në aspektin ekonomik;
- Në bashkëpunim me përgjegjësit e fushës së trashëgimisë kulturore, të bëjnë përfshirjen funksionale dhe trajtimin adekuat të përmbajtjeve kulturore në planet përkatëse hapësinore dhe urbane, duke përfshirë edhe ruajtjen e mënyrës së të jetuarit dhe aplikimin e metodave të ndërtimit të kohës në të cilën janë ndërtuar objektet përkatëse;

## REKOMANDIMET SPECIFIKE

Rekomandimet për përfshirjen e trashëgimisë kulturore në planifikimin hapësinor dhe urban janë ndarë në pesë grupe sipas pesë kapitujve që përmbajnë dokumentet e planifikimit komunal.

### **Kapitulli i I-rë - Profili i zhvillimit hapësinor dhe analiza e gjendjes**

Në disa pika më poshtë është dhënë ajo që rekomandohet të përfshihet në këtë pjesë të planeve:

- Historiku i shkurtër i monumenteve me vlera të trashëgimisë kulturore;
- Përshkrimi i objekteve të TK (materiali i ndërtimit, kthinat dhe dedikimi i tyre etj.);
- Grupimi i objekteve të TK sipas destinimit të tyre;
- Statusi i tyre i mbrojtjes;
- Gjendja e tyre fizike;
- Shfrytëzimi aktual;
- Prezantimi i trashëgimisë shpirtërore - traditat dhe zakonet popullore, ritet, vallet, muzika, kënga, proza, poezia etj;
- Paraqitja e objekteve të TK në hartë;
- Paraqitja e tyre në ortofoto;
- Paraqitja në hartë e zonave të TK (nëse ka zona të cilave u janë caktuar kufijtë).

- In order to achieve a sustainable municipal economic progress, it is needed that the cultural heritage, besides the cultural aspect, be treated also in the economic aspect;
- In cooperation with the responsible elements of the cultural heritage field, it is needed the functional inclusion and their adequate treatment of cultural elements in given spatial and urban plans, including the preservation of the way of life and application of construction methods of that given time in which these given objects were constructed.

## **SPECIFIC RECOMMENDATIONS**

Recommendation about including cultural heritage in space and urban planning are divided in 5 groups according to 5 chapters, containing municipal planning documents.

### **Chapter I – Spatial development profile and analysis of the situation**

In few references below is given that which is recommended to include in this part of plans:

- A short history of monuments with cultural heritage values;
- The description of objects of cultural heritage (constructing material, rooms and their purposes, etc.);
- The categorization of objects of cultural heritage;
- Their status of protection;
- Their physical state;
- Actual usage;
- The presentations of spiritual heritage – traditions and folk habits, rituals, dances, music, song, prose, poetry, etc;
- Presentation of cultural heritage objects on the map;
- Presentacion in “ortophoto”;
- Presentation of cultural heritage zones on the map (if there are zones with precised borders).

### **Kapitulli i II-të – Vizioni, parimet dhe caqet**

- Në këtë pjesë, në PZHK formulohet deklarata e vizionit ku jepet vizioni për të ardhmen e dëshiruar të komunës, dhe në PZHU vizioni për të ardhmen e dëshiruar të qytetit (qendrës komunale). Nëse ekzistojnë parakushtet - trashëgimia kulturore do të duhej të përmendet në të dy deklaratat e vizionit, sepse nga vizioni dalin edhe synimet për të ardhmen;
- Në plane jepen synimet për të ardhmen e komunës, respektivisht qytetit, në mesin e të cilëve duhet të jenë edhe synimet për të ardhmen e trashëgimisë kulturore. Synimi përmbledhet në një fjali dhe është i përgjithësuar;
- Gjatë formulimit të synimit (synimeve), planerët duhet ta kenë për bazë kërkesën që del nga Ligji për Trashëgiminë Kulturore. Ky ligj kërkon që TK të mbrohet, ruhet dhe promovohet, prandaj synimi do të mund të formulohej si në vazhdim: Mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.

### **Kapitulli i III-të – Korniza e zhvillimit hapësinor**

Në pjesën e tretë paraqitet e tërë ajo që dëshirohet të arrihet në të ardhmen brenda territorit të komunës, respektivisht brenda zonës urbane. Si pjesë e kësaj, duhet të tregohet edhe ajo se çka dëshirohet të arrihet sa i përket trashëgimisë kulturore. Prandaj synimi (synimet) këtu zbërthehet në objektiva të cilët elaborohen tekstualisht. Përpiluesit e planeve dhe të gjithë ata që kontribuojnë në këtë përpilim do t'i zbërthejnë synimet për TK në objektiva më specifike, më konkrete që mund të jenë të formës së treguar në vazhdim:

Objektivat:

- Sigurimi i ekzistencës fizike dhe ruajtja e autenticitetit të plotë të zonave dhe objekteve të TK;
- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore;
- Plotësimi i listës me objekte të TK të shpallura si monumente në mbrojtje;
- Ruajtja e traditave dhe zakoneve popullore;
- Ruajtja dhe kultivimi i valleve, muzikës popullore dhe zejeve artistike;

### **Kapitulli i IV-të – Strategjitë dhe veprimet për zbatim**

Në pjesën e katërt të planeve paraqitet strategjia e zgjedhur për arritjen e të gjitha synimeve dhe objektivave sa i përket të ardhmes së komunës, respektivisht të ardhmes së qytetit (qendrës komunale). Strategjia është një pako e masave konkrete që duhet të ndërmerren, apo e veprimeve konkrete që duhet të kryhen (p.sh. realizimi i projekteve) në mënyrë që të arrihen synimet dhe objektivat e parashikuara më përpara. Si pjesë e kësaj pakoje do të jenë edhe masat apo veprimet e nevojshme për arritjen e objektivave për TK që janë identifikuar dhe elaboruar në pjesën e tretë të planeve. Përveç veprimeve të nevojshme, siç dihet strategjia përmban edhe afatet kohore brenda të cilëve parashihet të realizohen projektet e caktuar, pastaj implikimet financiare për realizimin e projekteve dhe institucionet apo subjektet që janë përgjegjës për realizimin e projekteve përkatëse.

## **Chapter II – Vision, principles and objectives**

- In this part, a declaration of a vision in MDP is formulated where a vision is set on the desired future of the municipality while the UDP envisaged a vision for the desired future of the town (municipal centre). If there are preconditions – cultural heritage ought to be mentioned in both declarations of the vision, because objectives for the future derives from the vision;
- In plans are given objectives for the future of the municipality, respectively of the town, among which ought to be also the objectives for the future of cultural heritage. The objectives are summarized in one declaration/sentence and it is to be general;
- During the formulation of objectives, planning staff should have in mind the the application deriving from the Law on Cultural Heritage. This law requires the protection of Cultural Heritage, preserve and promote, therefore the objective could be formulated as in following: Protection, preservation and promotion of cultural heritage;

## **Chapter III – Framework of spatial development**

Ndërsa për Pejë, ndryshe nga dy rastet e tjera, pjesëmarrësit u njohën me disa modele urbane të ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore me qëllim rritjen e atraktivitetit turistik dhe zhvillimin lokal. Fillimisht, pjesëmarrësit patën mundësinë që të përjetojnë vetë një shembull të mirë të përdorimit të shtëpive tradicionale shkodrane për aktivitete hoteliere-turistike në kompleksin “Tradita Gegë e Toskë”. Më pas, gjatë vizitave në Kalanë e Rozafës, Muzeun e Kalasë dhe në Muzeun Historik të qytetit, të pranishmit u njoftuan me tendencat e reja të menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë dhe të muzeve. Në sajë të shëtitjeve në qytet, si për shembull në rrugën muzeale Kol Idromeno, pjesëmarrësit prekën një tjetër shembull interesant revitalizimi të zonave historike urbane. Një tjetër moment i veçantë ishte dhe takimi me Drejtoreshën e Departamentit e Kulturës në Bashkinë e Shkodrës e cila i shpjegoi pjesëmarrësve arsyet e suksesit dhe ndryshimeve rrënjësore të qytetit gjatë viteve të fundit. Muzeu Marubi përmbylli vizitat në Shkodër, një ndalesë që gjithashtu u vlerësua shumë nga të pranishmit. Memoriali i Skënderbeut në Lezhë ishte ndalesa e rradhës. Kruja, destinacioni i fundit, i ofroi pjesëmarrësve mundësinë e shëtitjeve në pazarin karakteristik të qytetit dhe në kala. Gjithashtu u bë e mundur dhe vizita me ciceronë në dy nga objektet muzeale më të vizituara në Shqipëri, Muzeun Kombëtar Skënderbeu dhe Muzeun Etnografik.

In each of these three workshops, it was considered as appropriate to combine the technical, social and historical knowledge of the cultural and natural richness in each municipality with the review of simple models of utilization of cultural heritage for local development, empowerment of the tourist offer and the improvement of conditions of living.

This double ambition structured the workshops around two main working phases:

1. Debate and work groups composed by participants of different professional profiles and sight.
2. Acquaintance with the practices in the field of cultural heritage in Kosovo and Albania, through field visits and analysis of some examples of effective utilization of cultural heritage assets.

So, for Vushtrri/Vučitrn, besides a half-day of visits in this city, the agenda included a trip to Novobërdë/Novoberdo, where was presented to participants a model of utilization of natural and cultural heritage for rural tourism. Hoça e Madhe/Velika Hoča, the second location selected for the visit, presented to the participants the opportunity to use the traditional houses for "bed and breakfast" services, etc.

For Gjakova/Đakovica, the visits were focused on the region of Valbona, in Albania, where participants were introduced to the possibility of using the traditional houses for guesthouse-type ("bujtinë") tourist services in a mountainous environment. Also in addition to the special nature walks in Valbona, there were visits to sites of cultural and historical value specific to the region, such as the Kulla Mic Sokoli, Kulla known for the Bujan Conference and the tombs of the martyrs of the National Liberation War.

As for Peja/Peć, unlike the two other cases, participants were introduced to urban models of conservation and management of cultural heritage in order to improve touristic attraction and local development. Initially, the participants experienced in first person a good example of reuse of traditional houses for tourism purposes in the "Tradita Geg e Toskë" compound. Later, during the visits in the Rozafa Castle, the Castle's Museum and the Historic Museum of the city, the participants got acquainted with new tendencies of management and promotion of heritage and museums. Thanks to the walks in the city, as for example in the Kol Idromeno street, participants experienced another interesting example of revitalization of urban historic areas. Another special moment was meeting with the Director of the Department of Culture of the Municipality of Shkodra who explained to participants the reasons of the success and radical change of the city in recent years. The visit in the Marubi Museum concluded the trip in Shkodra, a discovery that was also highly acclaimed by the participants. Skanderbeg's Memorial in Lezha was the next stop. Kruja, the last destination, offered participants the opportunity of walking in the traditional bazaar of the city and in the castle. It also became possible to have guided tours in two of the most visited museum facilities in Albania, the National Museum of Skanderbeg and the Ethnographic Museum.

Frymëzimi i pjesëmarrësve nga këto eksperiencat të reja, për të integruar elemente të rinj vlerësimi në kuadër të ballafaqimit të tyre të përditshëm me trashëgiminë kulturore dhe natyrore të komunave të tyre, ka qënë një ndër objektivat 'e fshehta' dhe më të rëndësishëm të punëtorive.

## **OBJEKTIVAT E PUNËTORIVE**

Duke pasur parasysh veçoritë e secilës komunë të trajtuar, qëllimet e punëtorive të mbajtura kanë qënë në mënyrë të përgjithshme:

- Diskutimi gjithëpërfshirës mes përfaqësuesve të komunave, pjesëmarrësit nga shoqëria civile dhe zyrtarët e organeve qëndrore, për sfidat dhe mundësitë e trashëgimisë kulturore dhe rëndësinë që ka mbrojtja dhe zhvillimi i saj në përmirësimin e cilësisë së jetesës, fuqizimin e turizmit dhe në zhvillimin lokal
- Përforcimi i dialogut mes shoqërisë civile, institucioneve vendore dhe qëndrore, për mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore
- Shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme në lidhje me shfrytëzimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si përkrahje për zhvillimin e turizmit

Gjithashtu vlen të përmendet se për punëtorinë e Vushtrrisë, një nga objektivat specifike ishte informimi i komunitetit me përmbytjen e projektit "Konservimi dhe restaurimi i Kalasë së Vushtrrisë". Ky projekt i cili po implementohet aktualisht nga CHwB është financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Qëllimi ishte që kjo punëtori të shërbente si burim informacioni shtesë dhe si platformë bashkëbisedimi ndërmjet palëve pjesëmarrëse dhe ekipit që po punon në kuadër të këtij projekti. Ndërsa për punëtoritë e Graçanicës dhe Partesh/Pasjane, siç u përmend dhe më lart, objektivi ka qënë që trashëgimia kulturore të integrohej në mënyrë optimale në vizionin e ardhshëm për zhvillimin e këtyre komunave. Edhe pse objektivat ndryshonin nga pak prej punëtorisë në punëtori, për secilën nga këto metodologjia e punës ka qënë e ngjashme.

## **PROCESI I PUNËS**

Punëtoritë kanë pasur si kriter kryesor përfshirjen dhe angazhimin e të gjithë palëve të interesit të komunave, duke i mbledhur ata në një hapësirë të përbashkët me kushte, informata dhe mjete të nevojshme për të zhvilluar analiza të ndryshme

Arsyeja e këtij koncepti është fakti që ata e njohin më së miri vendin ku jetojnë dhe veprojnë, prandaj edhe janë në gatishmëri për dhënie të ideve. Dobishmëria e konceptit është që palët e interesit dalin në fund me një vizion më të gjerë për çështjet kritike të trashëgimisë kulturore dhe për identifikimin e pikave të saj të forta dhe që përbëjnë një potencial zhvillimi për komunat.

The inspiration of the participants through these new experiences, in order to integrate new elements of assessment within their daily confrontation with cultural and natural heritage in their municipalities, was one of the 'secret' and most important objectives of the workshops.

### **OBJECTIVES OF THE WORKSHOPS**

Given the characteristics of each municipality, the overall objectives of the held workshops were:

- Comprehensive discussion between representatives of municipalities, civil society representants and officials of the central institutions, on the challenges and opportunities of cultural heritage and the importance of its protection and development to improve quality of life, strengthening tourism and local development
- Strengthening the dialogue between civil society, local and national institutions for the protection and promotion of cultural heritage
- Exchange of different experiences on the utilization of cultural heritage as a support for tourism development

It is also worth noting that for the Vushtrri/Vučitrn workshop, one of the specific objectives was to inform the community about the content of the project "Conservation and Restoration of the Vushtrri/Vučitrn Castle". This project, that is currently implemented by the CHwB, is funded by the U.S. Embassy in Kosovo. The goal was for this workshop to serve as a source of additional information and as a platform of conversation between the parties and the team that is currently working on this project. While for the workshops of Graçanica/Gračanica and Partesh/Pasjane/Parteš/Pasjane, as mentioned above, the objective was to optimally integrate cultural heritage in the future development vision in these municipalities. Although the objectives changed slightly from workshop to workshop, for each one the working methodology was similar.

### **WORK PROCESS**

The workshops had as main criteria the involvement and commitment of all stakeholders of the municipality, by gathering them in a common space with proper setting, information and tools needed to conduct various analyses.

The reason behind this concept is the fact that they have better knowledge on the place they live and work, therefore are competent to provide the most valuable ideas. The usefulness of this concept is that finally the stakeholders emerge with a broader vision for the critical issues of cultural heritage and for the identification of its strengths, that can be considered as potential for development for the municipalities.

Më konkretisht punëtoritë kanë kaluar në disa faza të caktuara:

- Prezantimi i pikave relevante për hartën e memories për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të komunës së trajtuar
- SWOT analiza në grupe multi-disiplinare
- Përcaktimi i tri grupeve tematike:
  - ✓ Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore
  - ✓ Integrimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në jetën bashkëkohore
  - ✓ Zhvillimi lokal/turizmi i bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore
- Përcaktimi i grupit përpilues të hartës së memories
- Përpilimi i analiza së objektivave për çdo grup tematik
- Prezentimi dhe analiza e projekteve/aksioneve për çdo grup tematik
- Konceptualizimi dhe vizatimi i hartës së memories

Disa nga rezultatet e punës dhe momentet e veçanta të pesë punëtorive vijojnë në faqet pasuese. Bëhet fjalë për ekstraktet më domethënëse të raporteve më të plota që lexuesit mund ti gjejnë pranë zyrës së Kosovës në UN-HABITAT (për Graçanicën dhe Partesh/Pasjane) dhe pranë zyrës së CHwB (për Vushtrrinë, Gjakovën dhe Pejën).

More specifically the workshops have passed in several phases:

- Presentation of relevant points for the memory map on the natural and cultural heritage of the municipalities
- SWOT analysis in multi-disciplinary groups
- Determination of the three thematic groups:
  - ✓ Protection and conservation of cultural and natural heritage
  - ✓ Integration of cultural and natural heritage in contemporary life
  - ✓ Local development/tourism based on cultural and natural heritage
- Defining the memory map compiling group
- Preparation of the objectives analysis for each thematic group
- Presentation and analysis of projects/actions for each thematic group
- Conceptualization and design of the memory map

Some of the results of the common work and some of the special moments of the five workshops are presented in the next pages. These are the most significant extracts to the full reports that can be found by contacting UN-HABITAT Kosovo office (for Gračanica/Gračanica and Partesh-Pasjane /Parteš-Pasjane) and CHwB (for Vushtrri/Vučitrn, Gjakova/Đakovica and Peja/Peć).



# GRAČANICA / GRAČANICA

Punëtoria e Vizionimit për planifikim urban dhe hapësinor të përgjithshëm  
Visioning Workshop for general urban and spatial planning

25 - 29 Nëntor / November 2010

Ohër / Ohrid, MAQEDONI / MACEDONIA



**UNOHABITAT**  
FOR A BETTER URBAN FUTURE

**CH  
WB**  
Cultural  
Heritage without Borders  
KULTURNIY UTAH GRANICER

**FRIEDRICH  
EBERT**  
  
**STIFTUNG**

## LISTA E PJESËMARRËSVE/PARTICIPANTS LIST

### Komuna e Graçanicës / Municipality of Graçanica/Gračanica

1. Bojan Stojanovic
2. Igor Aritonovic
3. Aleksandra Djekic
4. Slaviša Ničić
5. Nada Brkljač
6. Nebojša Perić
7. Mirjana Stanojević
8. Nebojša Milovanović
9. Bojan Todorović
10. Sebastijan Šerifović
11. Zana Pljakić
12. Ivana Lazić
13. Igor Rašić
14. Nevenka Rikalo
15. Siniša Šubarić
16. Zoran Mandić
17. Ljubiša Janicijević
18. Nataša Dimitrijević
19. Saša Čosić

### Përfaqësues nga shoqëria civile / Civil Society representative

20. Ivan Nikolić
21. Ivan Todorović
22. Verica Ristić
23. Saša Zdravković
24. Miloš Maksimovic

### OJQ e Kulturës Geto-Teatar/Cultural NGO Geto-Teatar

25. Miloš Tomić

### Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministry of Environment and Spatial Planning

26. Elvida Pallaska
27. Hidajete Zhuri

### Zyra Civile Ndërkombëtare / International Civilian Office (ICO)

28. Frank D'hondt
29. Lorika Hisari

### Trashëgimia Kulturore pa Kufij / Cultural Heritage without Borders (CHwB)

30. Enes Toska
31. Genc Gafurri
32. Edon Mullafetahu

### UN-HABITAT

33. Arijeta Himaduna
34. Ishaku Maitumbi
35. Gloriosa Hisari
36. Vllaznim Osmani
37. Caroline Johansson

## PRAPAVIJA

Komuna e Graçanicës gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përbëhet nga qyteza e Graçanicës dhe 13 zona kadastrale e vendbanime. Qyteza e Graçanicës është zhvilluar rreth Manastirit të Graçanicës. Ajo është e vendosur në jug të Prishtinës në rrugën rajonale me drejtim në Gjilan.

Komuna është themeluar në shkurt të viti 2008 në përputhje me "Planin Ahtisari", prej së cilit disa pjesë të komunave Lipjan, Fushë Kosovë dhe Prishtinë u bashkuan për të formuar këtë komunë. Komuna e Graçanicës përfshin njësitë kadastrale dhe vendbanimet e mëposhtme:

- Nga komuna e Fushë Kosovës: Batusha dhe Uklara.
- Nga komuna e Lipjanit: Gushterica e Epërme, Dobrotin, Gushterica e Poshtme, Lepina, Livadje, Radevo, Skulanevo dhe Suvi Do.
- Nga komuna e Prishtinës: Graçanica (si banorë të komunës), Badovc i ri, pjesë Badovcit të vjetër, Llaplasella, Preoci, Shushica, Kísnica dhe një pjesë e Çagllavicës.

Sipas shifrave të fundit, popullsia është rreth 25000 banorë dhe territori i saj është përafërsisht 131,25 km<sup>2</sup>. Shumica e banorëve janë serbë të Kosovës, por grupet e tjera etnike jetojnë gjithashtu në komunë. Vendodhja e volitshme, me një distancë prej vetëm 8 kilometra nga Prishtina, ofron një mundësi të madhe për zhvillimin e Graçanicës si një vend i begatë, multi-kulturor, me aktivitete tregëtare dinamike dhe rezidenciale.

(Burimi: Plani i Veprimit Graçanicë 2010)

Manastiri i Graçanicës është pjesë e Listës Botërore të Trashëgimisë të UNESCO-s dhe është gjithashtu një Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM). ZVM-ja përfshin zonën urbane të Komunës së Graçanicë, qendrën e saj. Në këtë zonë ka rregulla dhe kritere specifike për çdo zhvillim të ri, që prekin kryesisht ndërtimtarinë brenda zonës.

Gjatë procesit të planifikimit hapësinor dhe urban për Komunën e Graçanicës dhe zonën e saj urbane, ZVM-ja duhet të konsideruar dhe respektuar plotësisht, në mënyrë që ZVM-ja të integrohet në vizionin e tyre dhe në kuadrin më të gjerë të planifikimit hapësinor. Lokacionet e tjera e trashëgimisë kulturore në komunë, me Zonat e Mbrojtura (ZM) që përfshijnë potencialisht, të tilla si kompleksi arkeologjik i Ulpianës, si një vlerë e madhe, duhet të kenë qasje të njëjtë të integruar. Qasja dhe lidhja e përshtatshme e të gjithë objekteve të trashëgimisë kulturore në komunë, përpos mbrojtjes dhe ruajtjes e tyre, kanë një rëndësi të madhe dhe duhet për këtë arsye të merren parasysh gjatë procesit të planifikimit.

## BACKGROUND

The Municipality of Graçanicë/Gračanica is located in the central part of Kosovo and consists of the town of Gracanica and 13 cadastral zones and settlements. The town of Gracanica is centered around Gracanica monastery. It is located south of Pristina on the regional road to Gjilan/Gnjilane.

The municipality was established in February 2008 in accordance with the Ahtisaari's plan, whereby pieces of the municipalities of Lipjan/Lipljan, Fushe Kosove/Kosovo Polje and Prishtina were joined. The municipality of Gracanica includes the following settlements and cadastral units:

- from the municipality of Fushe Kosove/Kosovo Polje: Batusha/Batuse and Uklare/Ugljare
- from the municipality of Lipjan :Gornja Gusterica, Dobrotin, Donja Gusterica, Lepina, Livadje, Radevo, Skulanevo and Suvi Do
- from municipality of Prishtinë/Priština: Graçanicë/Gračanica (as municipal residents), Novi Badovac, part of Stari Badovac, Laplje Selo, Preoce, Susica, Kishnica and part of Caglavica

The most recent figures indicate a population approximately 25000 inhabitants and its territory is approximately 131, 25 square km. The majority of the citizens are Kosovo Serbs, but other ethnic groups live freely in the municipality as well. With its prime location, with the short distance of only 8 kilometers from the capital city Pristina, provides a major opportunity for Graçanicë/Gračanica to develop itself into a prosperous, multi-cultural, vibrant retail, commercial and residential location.

(Source: Action Plan Gracanica 2010)

Graçanicë/Gračanica Monastery is part of the UNESCO World Heritage List and protected through a Special Protective Zone (SPZ). The SPZ includes the urban area of Graçanicë/Gračanica municipality, the center of Graçanicë/Gračanica town. It gives specific rules and criteria for any new development, mainly of a construction nature, within the zone.

During the spatial and urban planning process for the municipality and the urban zone of Graçanicë/Gračanica the SPZ has to be considered and respected accordingly, so that in their planning vision SPZ is well integrated into the broader picture of spatial planning. Other cultural heritage sites in the municipality with their potential Protective Zones (PZs), such as the Ulpiana archeological complex as one of a high value, should have the same integrated approach. An appropriate and good access and connection of all cultural heritage sites in the municipality besides their protection and preservation, is of a great importance and to be considered during the planning process.

## HISTORIA DHE KULTURA

Graçanica është e njohur për një nga manastiret më të famshme mesjetare serbe, Manastiri i Graçanicës, themeluar nga Mbreti Shën Millutin, bashkëshortja dhe bijtë e tij, Simonida dhe Stefan. Ajo është ndërtuar në 1310 dhe i kushtohet përfjetjes të së Shënjtës Mari.

Themelet e Manastirit të Graçanicës janë ndërtuar në formën e kryqit me pesë kupola të vendosura rreth strukturës qendrore. Për këtë arsye ajo renditet si një nga arritjet arkitektonike më të mëdhaja të kohës kur është ndërtuar. Manastiri i Graçanicës paraqet kulmin e arkitekturës serbe në kuadër të traditës bizantine. Për fat të keq, ky thesar i çmuar i Graçanicës u shkatërrua nga zjarret në mes të viteve 1379 dhe 1383. Sot ky thesar përmban një numër të ikonave të vlefshme nga shekujt 16, 17 dhe 18, si dhe disa dorëshkrime të rëndësishme dhe objekte liturgjike.

Manastiri nuk njihet vetëm si një vend për lutje fetare, por ai është gjithashtu në Listën Botërore të Trashëgimisë të UNESCO-s. Kjo është një nga monumentet më të rëndësishme të kulturës së vjetër serbe.



## HISTORY AND CULTURE

Gračanicë/Gračanica is known for one of the most famous Serbian medieval monasteries, Gračanicë/Gračanica Monastery, founded by Saint King Milutin and his wife and sons Simonida and Stefan. It was constructed in 1310 and dedicated to the feast of dormition for the Holly Mother of God.

The foundation of Gračanicë/Gračanica Monastery was built in the shape of cross with five domes towering around the central structure. It therefore belongs to a group of first-class architectural achievements of that era; architectural composition of Gračanicë/Gračanica monastery represents the peak of Serbian architecture in the sierit of Byzantine tradition. Unfortunately the rich Gračanicë/Gračanica treasury was lost in fires between 1379 and 1383. At present treasury stores a number of valuable icons from the 16th, 17th and 18th centuries, as well as several significant manuscripts and liturgical objects.

The monastery is not only recognized as a place for religious worship but it is also on the list of UNESCO world heritage sites. It is one of the most important monuments of old Serbian culture.



## HARTA E MEMORIES

Hapja e punëtorisë u bë me vizualizimin e hartës së memories për komunën e Graçanicës. Gjatë këtij ushtrimi të gjithë pjesëmarrësit u prezantuan dhe rrëfyan shkurtimisht histori (me mbresa të mira) për lagjet e tyre dhe pastaj vendosën në hartë vëndin apo ngjarjen për të cilin folën, me një përshkrim rreth arsyeve të zgjedhjeve të tyre. Si rezultat, u përmëndën hapësira të ndryshme publike, rrugë, lagje, burime natyrore, zona të gjelbërta dhe sidomos Manastiri.

Objektivi i këtij sesioni ishte që të gjeneroheshin sa më shumë propozime në mënyrë që grupi të dëgjonte historitë e njëri-tjetrit.

Disa nga vendet e përmendura të memories janë: Manastiri i Graçanicës, rruga e Dashurisë, pyjet, çeshmet/burimet e vjetra, pellgu i peshqve, lagja rome dhe kujtimet shkollore.




## MEMORY MAP

Introduction to the workshop was made with visualizing memory map of the municipality. In this exercise all participants introduced themselves and gave a short story (some of the good memories) about their neighborhood and then highlighted on the map the favorite place/event of their own, with a description why this place/event/experience was chosen. As a result, different public spaces, streets, neighborhoods, natural resources, green areas, and especially the monastery were mentioned.

The objective of this session was to generate as much input as possible so that the group can hear each others stories.

Some of the memory places mentioned are: Gračanice/Gračanica Monastery, Love Street, the lake, woodlands, old česme/springs, fishpond, romska mahalla/roma neighborhood and school memories.





# SWOT ANALIZA

## Grupi 1 Trashëgimia natyrore dhe kulturore

### Përparësitë:

- Pozita gjeografike
- Manastiri i Graçanicës dhe kishat përreth
- Ulpiana
- Shatërvani
- Liqeni
- Monumenti për Ushtarin e Panjohur
- Natyra e pastër
- Pellgu për peshqit
- Lumenjtë
- Toka bujqësore
- Mulliri me ujë
- Ushqim tradicional
- Gjuetia dhe peshkimi
- Kodrat e Veletinit dhe Vacit
- Miniera e Kishnicës

### Dobësitë:

- Kujdes i pamjaftueshëm për trashëgiminë kulturore dhe natyrore
- Deponitë e paligjshme
- Kanalizimet

- Deponitë
- Fushat e parregulluara të ujit

### Mundësitë:

- Turizmi kulturor
- Krijimi i parqeve pranë Manastirit dhe kishave
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve
- Rregullimi i hapësirave për fëmijë
- Trashëgimia kulturore dhe natyrore
- Pastrimi i deponive
- Zhvillimi i bujqësisë
- Riciklimi i materialeve dhe mbeturinave
- Instalimi i sistemeve të trajtimit të ujit
- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore
- Mundësia e investimeve të huaja dhe donacionet për arsye të atraktivitetit të komunës së re
- Afërsia me qytetin
- Prodhimi i ushqimit natyror

### Kërcënimet:

- Ndërtimi ilegal
- Katastrofat natyrore
- Politika

## SWOT ANALYSIS

### Group 1 Natural and Cultural Heritage

#### Strengths:

- Geographic position
- Monastery Gračanica and nearby churches
- Ulpiana
- Fountain
- Lake
- Monument to Unknown Soldier
- Clear nature
- Fishpond
- Rivers
- Agricultural land
- Water mill
- Traditional food
- Hunting and fishing
- Veletin Hill and Vac
- Kisnica mine

#### Weaknesses:

- Insufficient care of cultural and natural heritage
- Illegal landfills
- Waste waters

- Slag dump
- Unregulated water areas

#### Opportunities:

- Cultural tourism
- Creation of parks nearby Monastery and churches
- Regulation of riverbeds
- Regulation of children playgrounds
- Cultural and natural heritage
- Cleaning of landfills
- Agricultural development
- Recycling of waste materials
- Installation of water treatment systems
- Construction of road infrastructure
- Possibility of foreign investments and donations due to attractiveness of the new Municipality
- Advantage of the proximity of the city
- Production of natural food

#### Threats:

- Illegal construction
- Natural disasters
- Politics

- Mungesa e përhershme e të kuptuarit ndërmjet anëtarëve të komunitetit mbi rëndësinë dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Mangësitë mjedisore

## **Grupi 2** Infrastruktura dhe Mobiliteti

### **Përparësitë:**

- Rehabilitimi i WC
- Një pjesë e rrugëve
- Promenada – buzë lumit
- Shtrati i rregulluar i lumit
- Mbulimi i madh
- Kanalizimet dhe sistemet e furnizimit me ujë
- Krijimi i kompanisë komunale
- Ndërtimi i sistemit të kullimit

### **Dobësitë:**

- Komunikacioni nëpër qendër të qytetit
- Gjendja e keqe dhe bllokimet e rrugëve anësore
- Furnizimi me ujë për vendbanimet e Badovacit dhe Shushicës
- Problemet e furnizimit me energji elektrike
- Pengesat arkitektonike
- Mungesa e stacionit të autobuzëve
- Cilësia e dobët e shërbimeve publike
- Parkingjet

### **Mundësitë:**

- Zonat e rrafshta
- Qasja në aeroport
- Afërsia e kryeqytetit
- Potencialet turistike
- Hekurudha
- Sistemi rajonal i furnizimit me ujë

### **Kërcënimet:**

- Rritja e nivelit të liqenit
- Përmbytjet nga lumi

## **Grupi 3** Zhvillimi ekonomik

### **Përparësitë:**

- Zona Industriale
- Legalizimi
- Pasuritë minerale
- Shpirti sipërmarrës
- Prodhimi i produkteve bujqësore nga sipërmarrësit privatë
- Ulpiana-Manastiri

### **Dobësitë:**

- Mos shfrytëzimi i pasurisë minerare
- Ujitja
- Tregu për vendosjen e produkteve
- Papunësia
- Nivel i ulët i arsimimit

- Permanent lack of understanding amongst community members on importance and preservation of cultural and natural heritage
- Environmental gaps

## **Group 2** Infrastructure and Mobility

### **Strengths:**

- Rehabilitation of WC
- Part of roads
- Promenade – quay
- Regulated riverbed
- Large coverage
- Sewerage and water supply systems
- Establishment of public utility company
- Construction of drainage system

### **Weaknesses:**

- Traffic flow through the town center
- Poor condition and congestion of side roads
- Water supply for settlements of Badovac and Susica
- Problems with electricity supply
- Architectural obstacles
- Lack of buss station
- Poor public utility services
- Parking

### **Opportunities:**

- Plain area Access to the airport
- Proximity of the Capital
- Tourist potentials
- Railroad
- Regional water supply system

### **Threats:**

- Spillover of the lake
- River floods

## **Group 3** Economic Development

### **Strengths:**

- Industrial zone
- Legalization
- Mineral wealth
- Spirit of entrepreneurship
- Production of agricultural products by private entrepreneurs
- Ulpiana-Monastery

### **Weaknesses:**

- Non-exploitation of mineral wealth
- Irrigation
- Market for placement of products
- Unemployment
- Low level of education

- Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe rrugëve ndërlidhëse

#### **Mundësitë:**

- Zhvillimi i biznesit të hoteleve
- Shfrytëzimi intensiv i pasurisë minerare
- Rritja e prodhimit dhe vendosjes së produkteve bujqësore
- Industria përpunuese e ushqimit
- Rritja e cilësisë së të punësuarve

#### **Kërcënimet:**

- Mungesa e interesit të investitorëve
- Emigrimi i të rinjve

#### **Grupi 4 Shërbimet sociale dhe Banimi**

#### **Përparësitë:**

- Numri i banorëve të rinj
- Stafi i ekspertëve
- Fluksi konstant i popullsisë
- Mjedisi multietnik dhe multikulturor
- Qendra për shërbimet shëndetësore
- Qendra për ndihmë sociale
- Ofrimi i arsimit në të gjitha nivelet
- Afërsia e kryeqytetit
- Zona e biznesit
- Qendra për strehimin e njerëzve të rinj dhe të moshuar me nevoja të veçanta
- OJQ-të
- Shërbimet e këshillimit për gra

- Qendrat natyrore sportive - fushat
- Fushat e planifikuara të banimit

#### **Dobësitë:**

- Strehimi
- Hapësirat e objekteve shëndetësore
- Objektet e mbuluara sportive
- Mungesa e objekteve kulturore
- Strehimi për fëmijët pa kujdes prindëror
- Hartat socio-ekonomike
- Hapësirat e shkollave
- Shtëpia e sigurisë, lokalet hoteliere

#### **Mundësitë:**

- Fondet e donacionet
- Kthimi i ekspertëve
- Zhvillimi i biznesit
- Universiteti
- Përmirësimi i standardit të jetesës
- Arsimimi joformal

#### **Kërcënimet:**

- Ekstradimet
- Zhvillimi i qytetit të Prishtinës - Zona industriale
- Ekzistenca e vendbanimeve joformale

## ANALIZA OBJEKTIVAVE (2010 - 2016)

### Grupi 1 Trashëgimia natyrore dhe kulturore

**Moto:** E gjelbërt-më e gjelbërt, e vjetër-moderne, Komuna e shëndetshme dhe tërheqëse e Graçanicës

1. Ndërtimi i rrugës anashkaluese përtej zonës së mbrojtur të Graçanicës
2. Vazhdimi i eksplorimit në zonat arkeologjike dhe i ndërtimit të Muzeut
3. Përmirësimi i infrastrukturës në mënyrë që të lidhë vendet turistike
4. Ndërtimi i qendrave turistike në kodrat e Veletinit dhe Stezevacit (ski, rrugët për biçikletë)
5. Ruajtja dhe revitalizimi i minierës së Kishnicës në mënyrë që të ofrojnë aktivitete të reja të cilat do të jenë në funksion të turizmit kulturor dhe mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit
6. Rregullimi i shtretërve të lumenjve, me qëllim që të mbrohet mjedisi
7. Rregullimi i pellgut për peshq në fshatin Radevo, ndërtimi i restorantit, terrenit për piknik dhe fushave sportive
8. Rikuperimi dhe rivitalizimi i skorjeve të deponisë në Graçanicë - mbuluar me toka pjellore, ndërtimi i parqeve infrastrukturave sportive
9. Ndërtimi i rrugëve, infrastrukturave për këmbësorë dhe biçikleta në mënyrë që të mundësojë qasje në terrenet për piknik, rehabilitimi i burimit ekzistues ujqor me ujë të pijshëm
10. Ripyllëzimi i terrenit të zhveshur përreth lumit të Graçanicës

11. Zbatimi i planit për trajtimin e ujërave të zeza (ndërtimi i objektit)
12. Ndërtimi i sistemeve të furnizimit me ujë në zonat ku ai nuk ekziston

### Grupi 2 Mobiliteti dhe infrastruktura

**Moto:** Komuna e Graçanicës, e qasshme, tërheqëse dhe tradicionale

1. Ndërtimi i rrugës anashkaluese në Graçanicë
2. Zgjidhja e problemit të furnizimit me ujë në Badovc dhe Sushicë
3. Ndërtimi i stacionit qendror të autobusëve
4. Aktivizimi i trafikut hekurudhor
5. Qasje e mirë për të gjitha vendet për personat me nevoja të veçanta
6. Rikonstruksioni i rrugës që shpie në aeroportin e Sllatinës
7. Krijimi i rrugëve për këmbësorë dhe biçikleta (relaksimi i trafikut)
8. Shërbime të përshtatshme publike
9. 24 orë furnizim me energji elektrike
10. Ndërtimi i sistemit të ujitjes
11. Motivimi i agjencive turistike komunale
12. Rregullimi i shtretërve të lumenjve
13. Hartimi i rregullores komunale për hapësira parkimi për ndërtesat e ndërtuara rishtas
14. Dyfishimi hapësirës së parkimit

- Lack of road infrastructure and access roads

**Opportunities:**

- Hotel business development
- More intensive exploitation of mineral wealth
- Increased production and placement of agricultural products
- Food-processing industry
- Enhanced quality of employees

**Threats:**

- Lack of investors' interest
- Emigration of young people

**Group 4 Social Services and Housing**

**Strengths:**

- Number of young inhabitants
- Expert staff
- Constant influx of population
- Multiethnic and multicultural environment
- Center for health services
- Center for social welfare
- Provision of education at all levels
- Proximity of the Capital
- Business zone
- Center for sheltering young and elderly people with special needs
- NGO sector
- Counseling services for women

- Outdoor sport centers – courts
- Planned residential areas

**Weaknesses:**

- Housing facilities
- Space for health facilities
- Indoor sport facilities
- Lack of cultural facilities
- Shelter for children without parental care
- Socio-economic maps
- School premises
- Safe house, hotel premises

**Opportunities:**

- Funds and donations
- Returns of experts
- Business development
- University
- Improvement of standard of living
- Informal education

**Threats:**

- Extraditions
- Development of the City of Pristina – industrial area
- Existence of informal settlements

## OBJECTIVES ANALYSIS (2010 - 2016)

### Group 1 Natural and cultural heritage

**Motto:** Green-greener, old-modern, healthy and attractive Municipality of Gračanice/Gračanica

1. Construction of bypassing road beyond the protected zone of Gračanice/Gračanica
2. Continuation of archeological sites exploration and Museum building
3. Infrastructure improvement in order to connect tourist locations
4. Construction of tourist centers on hills of Veletin and Stezevac (ski runs, bike tracks)
5. Conservation and revitalization of Ksniča Mine in order to provide new activities which will be in function of cultural tourism and protection of nature and environment
6. Regulation of riverbeds in order to protect the environment
7. Regulation of fishpond in the village of Radevo, construction of restaurant, picnic ground and sport courts
8. Reclamation and revitalization of slag dump in Gračanice/Gračanica – covering with fertile soil, construction of parks and sport infrastructure.
9. Construction of road infrastructure, pedestrian and bike tracks in order to enable access to the picnic ground, rehabilitation of existing water spring with drinking water
10. Afforesting of bare terrain surrounding Gračanice/Gračanica river

11. Implementation of plan for waste water treatment (construction of the facility)
12. Construction of water supply systems in areas where they do not exist

### Group 2 Mobility and infrastructure

**Motto:** Municipality of Gračanice/Gračanica, accessible, attractive and traditional

1. Construction of bypass road in Gračanice/Gračanica
2. Resolution of the water supply problem in Badovac and Susica
3. Construction of the central buss station
4. Activation of the railroad traffic
5. Unimpeded access to all places for persons with special needs
6. Reconstruction of the road leading to the Airport
7. Creation of pedestrian and bike tracks (traffic relaxation)
8. Adequate public utility services
9. 24/7 electricity supply
10. Construction of the irrigation system
11. Motivation of municipal tourist agencies
12. Regulation of riverbeds
13. Drafting of municipal regulation on provision of parking space for newly constructed buildings
14. Double the parking space



### Grupi 3 Zhvillimi ekonomik

**Moto:** Komunë moderne me infrastrukturë dhe ekonomi të zhvilluar

1. Zhvillim më intensiv i prodhimit bujqësor
  - Rritja e numrit të serave (2-5 për vit, 10%)
  - Prodhimi i ushqimit organik
2. Zhvillim më intensiv i prodhimit industrial
  - Zhvillimi i industrisë për përpunimin e ushqimit
  - Zhvillimi i ndërtesave të prodhimit të birrës (10 vjet, ZAP 7% OSL.)
3. Industria minerare
  - Gjetja e mundësive për ripërdorimin minierave për aktivitetete të tjera ekonomike
4. Zhvillimi i turizmit
  - Ndërtimi i qendrave turistike
  - Intensifikimi i aktiviteteteve turistike në lidhje me Manastirin
  - Ndërtimi i parqeve pranë burimit
  - Ndërtimi i objekteve sportive pranë fushës së golfit - Shkolla e sportit

### Grupi 4 Shërbimet sociale dhe banimi

**Moto:** Çdo familje në shtëpi të vet, në një mjedisit socio-urban

1. Banesave kolektive për personat e zhvendosur brenda vendit dhe çiftet rinj të rrezikuar (10% + 10%) 5 vjet
2. Banesat individuale brenda fermave 5%

3. Zgjerimi i shtëpive të shëndetit 15%
4. Zgjerimi i objekteve shkollore
  - Para-shkolla - 4 vjet
  - Qendra e shkollës së mesme - 2-3 vjet
  - Ndërtimi i fakultetit brenda 5-7 viteve
5. Teatri - Kinema / 3 vjet
6. Qendra Arsimore - 2 vjet
7. Zonat e gjelbërta - 15-20%
8. Salla e Sportit 2 vjet
9. Hartimi i kartës socio-ekonomike - 2 vjet
10. Zyra One-stop shop - Zyra Mobile



### Group 3 Economic development

**Motto:** Modern municipality with developed infrastructure and economy

1. More intensive development of agricultural production
  - Increased number of greenhouses (2-5 per annum, 10%)
  - Production of organic food
2. More intensive development of industrial production
  - Development of food-processing industry
  - Development of beer production facilities (10 years, 7% ZAP. OSL)
3. Mining industry
  - Finding possibilities to reuse the mine in the sense of other economic activities
4. Tourism development
  - Construction of tourist centers
  - Intensification of tourist activities in relation with the Monastery
  - Construction of parks nearby fountain
  - Construction of sport facilities nearby golf court – School of sport

### Group 4 Social services and housing

**Motto:** Every family in its own house within socio-urban environment

1. Collective housing for internally displaced persons and socially vulnerable young couples ( 10%+ 10%) 5 years
2. Individual housing within farms 5%

3. Extension of health houses 15%
4. Extension of school facilities
  - Pre-school - 4 years
  - Secondary school center – 2-3 years
  - Faculty building- 5-7 years
5. Theatre - Cinema- 3 years
6. Educational center – 2 years
7. Green areas- 15-20%
8. Sport hall 2 years
9. Drafting of socio-economic card – 2 years
10. One-stop shop office - Mobile office



## DEKLARATA E PËRBASHKËT E VIZIONIT DHE MOTOJA

### **Deklarata e përbashkët e vizionit:**

"Komuna e Graçanicës, e pasur me thesare antike dhe mesjetare dhe bukuri natyrore - mjedis modern me ekonomi dhe infrastrukturë të zhvilluar ku të gjithë gëzojnë të njëjtat të drejta dhe liri"

### **Motoja e punëtorisë së vizionimit:**

"Manastiri i Graçanicës - Thesar Botëror dhe Perla jonë"

*Shënim: Ky kapitull përmban ekstrakte nga draft-raporti i UN-HABITAT më të zgjeruar me titull "Draft – Report from Visioning Workshop Gračanica" Ohrid/Ohër, Macedonia 2010*



## JOINT VISION STATEMENT AND MOTTO

### **Joint vision declaration:**

“Municipality of Gračanica, opulent with antic and medieval treasures and natural beauties – modern environment with developed economy and infrastructure where everyone enjoys the same rights and freedoms”

### **Motto of the visionary workshop:**

“Gračanica Monastery – the World Treasure and our Pearl”

**Note:** This chapter contained extracts from UN-HABITAT's extended draft-report named “Draft – Report from Visioning Workshop Gračanica” Ohrid/Ohër, Macedonia 2011



# VUSHTRRI / VUČITRN

**Sfidat dhe mundësitë e trashëgimisë kulturore të komunës**  
**Challenges and opportunities of the cultural heritage of municipality**

16 - 19 Prill / April 2011

Suharekë / Suva Reka, Novobërdë / Novo Brdo,  
Hoçë e Madhe / Velika Hoča, KOSOVË / KOSOVO





## LISTA E PJESËMARRËSVE/PARTICIPANTS LIST

|                           |   |
|---------------------------|---|
| <b>Bekim Ceko -</b>       | Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore<br>The Kosovo Council for the Cultural Heritage   |
| <b>Arben Arifi -</b>      | Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore<br>The Kosovo Council for the Cultural Heritage   |
| <b>Arbën Rrecaj -</b>     | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Instituti për Planifikim Hapësinor<br>Ministry of Environment and Spatial Planning/Institute for Spatial Planning         |
| <b>Festa Nixha Nela -</b> | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Instituti për Planifikim Hapësinor<br>Ministry of Environment and Spatial Planning/Institute for Spatial Planning         |
| <b>Elvida Pallaska -</b>  | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Instituti për Planifikim Hapësinor<br>Ministry of Environment and Spatial Planning/Institute for Spatial Planning         |
| <b>Rrezarta Loxha -</b>   | Qendra për Trashëgimi Kulturore, Mitrovicë<br>Cultural Heritage Center, Mitrovica   |
| <b>Jeton Aliu -</b>       | Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/Departamenti Turizmit<br>Ministry of Trade and Industry/Tourism Department  |
| <b>Lorika Hisari -</b>    | ICO/EUSR  |
| <b>Darko Miljković -</b>  | ICO/EUSR  |
| <b>Ismet Plakolli -</b>   | ICO/EUSR  |
| <b>Dukagjin Hasimja -</b> | Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arkitekturës<br>University of Prishtina, Faculty of Architecture   |
| <b>Shukrane Begu -</b>    | Muzeu Historik Etnografik<br>Ethnographic Museum  |
| <b>Emin Ibishi -</b>      | Media   |
| <b>Arta Haxhaj -</b>      | Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria e Urbanizmit dhe e Mbrojtjes së Mjedisit<br>Municipality of Vushtrri/Vučitrn - Department of Urban Planning and Environmental Protection  |
| <b>Ahmet Shuku -</b>      | Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria e Urbanizmit dhe e Mbrojtjes së Mjedisit/<br>Municipality of Vushtrri/Vučitrn - Department of Urban Planning and Environmental Protection |
| <b>Izet Miftari -</b>     | Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria e Arsimit/<br>Municipality of Vushtrri/Vučitrn – Departement of Education   |
| <b>Qëndrim Uka -</b>      | Lëvizja Koha/ Movement Koha   |
| <b>Eroll Venhari -</b>    | Lëvizja Koha/ Movement Koha   |

|                            |   |
|----------------------------|---|
| <b>Berat Maxhuni -</b>     | OJQ Çeshme<br>NGO Çeshme  |
| <b>Armend Gjoni -</b>      | OJQ Mundësia<br>NGO Mundësia  |
| <b>Blerim Ibrahim -</b>    | OJQ Mundësia<br>NGO Mundësia  |
| <b>Bardhyl Muharremi -</b> | Shoqëria Civile<br>Civil Society  |
| <b>Avdi Mehmeti -</b>      | Shoqëria Civile/Civil Society   |
| <b>Bardh Sadiu -</b>       | Shoqëria Civile<br>Civil Society  |
| <b>Raif Lahu -</b>         | OJQ Star of the future<br>NGO Star of the future                                  |
| <b>Mehmet Selaci -</b>     | Teatri i qytetit Hasan Prishtina<br>City Theatre Hasan Prishtina                  |
| <b>Gazmend Gjyshinca -</b> | Kuvendi Rinor Komunal<br>Municipal Youth Assembly                                 |
| <b>Alfredo Navarro -</b>   | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |
| <b>Zana Rama -</b>         | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |
| <b>Genta Retkoceri -</b>   | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |
| <b>Petrit Pasha -</b>      | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |
| <b>Migjen Berisha -</b>    | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |
| <b>Enes Toska -</b>        | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |
| <b>Mirian Bllaci -</b>     | Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)<br>Cultural Heritage without Borders (CHwB) |



## AGJENDA

| Data            | Vendi                        | Koha  | Aktiviteti   |
|-----------------|------------------------------|-------|--|
| <b>16 Prill</b> | Prishtinë (tek ish Rilindja) | 08:00 | Nisja dhe udhëtimi i pjesëmarrësve nga Prishtina për në Vushtrri       |
| E Shtunë        | Vushtrri (Ura e Gurit)       | 09:00 | Grumbullimi i pjesëmarrësve në kafe (me sandviça)                      |
|                 |                              | 10:00 | Vizitë në terren   |
|                 | Villa Natyra                 | 12:30 | Dreka  |
|                 | Novobërde (Q.e Turizmit)     | 14:00 | Nisja dhe udhëtimi për në Novobërdë                                    |
|                 |                              | 15:00 | Hyrje në projektin e Vushtrisë   |
|                 |                              |       | Hyrje në parimet e trashëgimisë kulturore                              |
|                 |                              |       | Turizmi i integruar bazuar në trashëgiminë kulturore                   |
|                 |                              |       | Metodologjia e punëtorisë  |
|                 |                              |       | Pyetje, përgjigje dhe diskutime të lira                                |
|                 |                              | 18:00 | Akomodimi në Novobërdë   |
|                 |                              | 19:00 | Darka  |
| <b>17 Prill</b> | Novobërdë                    | 08:00 | Mëngjesi   |
| E diel          | (B&B houses)                 | 09:00 | Trashëgimia kulturore e Vushtrrisë                                     |
|                 |                              |       | Rasti i studimit të Novobërdës   |
|                 |                              | 10:30 | Vizitë në terren   |
|                 |                              | 13:00 | Dreka  |
|                 | Suharekë                     | 14:30 | Nisja dhe udhëtimi për në Suharekë                                     |
|                 | (Hotel Solid)                | 16:30 | Akomodimi i pjesëmarrësve  |
|                 |                              | 17:00 | Harta e memories për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Vushtrrisë |
|                 |                              | 19:00 | Darka  |

## AGENDA

| Day                         | Place  | Hours                               | Activity   |
|-----------------------------|--|-------------------------------------|--|
| <b>16 April</b><br>Saturday | Prishtina/ Priština<br>(ex Rilindja Government Building<br>Vushtrri/Vučitrn (Stone Bridge) | 08:00                               | Travel and arrival of Prishtina/ Priština participants to Vushtrri/Vučitrn |
|                             |  | 09:00                               | Gathering of participants in a coffee shop joined by sandwiches            |
|                             |  | 10:00                               | Vushtrri/Vučitrn site visit  |
|                             |  | 12:30                               | Lunch  |
|                             | Villa natyra<br>Novobërdë/Novobrdo Toursim Center  | 14:00                               | Travel and arrival to Novobërda/Novobrdo                                   |
|                             |  | 15:00                               | Introduction to the Vushtrri/ Vuçitrn project                              |
|                             |  |                                     | Introduction to principles of cultural heritage                            |
|                             |  |                                     | Integrated tourism based on cultural heritage                              |
|                             |  |                                     | Methodology of the workshop  |
|                             |  |                                     | Q&A and discussion session   |
|                             | 18:00  | Accommodation at Novobërda/Novobrdo |  |
|                             | 19:00  | Dinner                              |  |
| <b>17 April</b><br>Sunday   | Novobërda/Novobrdo<br>(B&B houses)   | 08:00                               | Breakfast  |
|                             |  | 09:00                               | Vushtrri/Vučitrn cultural heritage<br>Novobërda/Novobrdo case study        |
|                             |  | 10:30                               | Novobërda/Novobrdo site visit *  |
|                             |  | 13:00                               | Lunch  |
|                             | Suhareka/Suva Reka<br>(Hotel Solid)  | 14:30                               | Travel and arrival to Suhareka/Suva Reka                                   |
|                             |  | 16:30                               | Accommodation of participants  |
|                             |  | 17:00                               | Vushtrri/Vučitrn cultural and natural heritage memory map exercise         |
|                             |  | 19:00                               | Dinner   |
|                             |  | 19:00                               | Dinner   |

|                 |               |       |   |
|-----------------|---------------|-------|---|
| <b>18 Prill</b> | Suharekë      | 08:00 | Mëngjesi  |
| E Hënë          | (Hotel Solid) | 09:00 | Nisja dhe udhëtimi për në Hoçë të Madhe   |
|                 |               | 09:45 | Vizitë në terren  |
|                 | Hoçë e Madhe  | 13:00 | Dreka   |
|                 |               | 14:15 | Nisja dhe udhëtimi për te Hotel Solid   |
|                 | Suhareka      | 15:00 | Analiza SWOT për grupet tematike  |
|                 | (Hotel Solid) |       | Prezentimi dhe diskutimi i analizës SWOT  |
|                 |               |       | Analiza e qëllimeve/objektivave   |
|                 |               | 19:00 | Darka   |
| <b>19 Prill</b> | Suhareka      | 08:00 | Mëngjesi  |
